

**UNIVERSITETI I EJK
JHE YHIBEP3MTET
SEE UNIVERSITY**

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
PROGRAMI: GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

PUNIM DOKTORATURE

Socioonomastika e Pejës

Mentori

Prof. Dr. Zeqir Kadriu

Kandidati

Valdet Hysenaj

Tetovë, prill 2019

Falënderim

Falënderoj profesorin tim të nderuar prof. dr. Zeqir Kadriu për përkrahjen e tij, këshillat, sugjerimet dhe komentet konstruktive, në vazhdimësi, që nga fillimi i këtij punimi.

Falënderoj Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL) për sigurimin e një mjedisi të favorshëm për të ndërmarrë këtë studim. Po ashtu falënderoj profesorin ligjërues që gjithashtu i kontribuoi këtij punimi, prof. dr. Mustafa Ibrahim.

Unë jam gjithashtu mirënjohës për miqtë e mi që kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm për këtë studim, në veçanti prof. dr. Hasan Mujaj, prof. dr. Izmit Durmishi dhe prof. dr. Adem Hajdaraj, (post mortum)

Së fundi, falënderimi i veçantë është për familjen time, fëmijët dhe bashkëshorten për mbështetjen morale.

Dedikimi: Dodonës, Drenit dhe Daorsës, fëmijëve të mi

KREU I PARË

A. PARATHËNIE

Gjuhësia shqiptare sot gjendet në një situatë të re studimesh e hulumtimesh në vazhden e trajtimit të çështjeve të pa hulumtuara karshi atyre të njohura, të cilat si koncepte kanë bashkëvepruar duke ndjekur akcila rrugën e vet të një aksiome shkencore. Në mesin e dijeve të pa rrahura ashtu sikundër çdo shkencë tjetër bën pjesë edhe socioonomaistika e cila ka ecurinë e konstituimit dhe të zhvillimit, por në krahasim me shumë dije të tjera është në nismë të zhvillimit. Ajo ka një historik mjaft të shkurtër brenda së cilit pati zhvillim dhe zgjerim të shpejtë në fillim në gjuhësinë amerikane dhe, më pas, edhe në atë europiane. Si shtysa parësore për themelimin dhe zhvillimin e kësaj dijeje u panë synimet për të krijuar mundësinë e hulumtimit të emërtimeve të ndryshme nga pikëpamja sociale dhe vështirimin e tyre nga aspekti social duke u rreshtuar kështu në mesin e dijeve të moderuara shkencore, hulumtimi i së cilës ka traditë shumë të gjatë: që nga retorika antike në krye me Aristotelin, Ciceronin, Kuintilianin, Demostenin, Sokratin, Hermoxhenin, Kratilin etj. për të vazhduar edhe sot e gjithë ditën.

Jemi përpjekur që të krijojmë një fizionomi të qëndrueshme të emërtimeve në përgjithësi, duke i hetuar nga këndi i dritës sociale, e cila njëherësh është edhe demonstrues i mentalitetit. Civilizim. Kulturë. Kompetencë. Formim arsimor dhe edukativ. Metakomunikim etj. Shikuar nga ky raport, është esenciale për sa i përket konsolidimit të mendimit dhe kuptimit të përgjithshëm për kahet e reja studimore të bazohemi mbi idetë e mendimtarëve të kohës nga kjo fushë. Si fenomen me një spektër të gjerë përbërësish, socioonomastika bashkëvepron me shumë shkenca të tjera si p.sh. stilistika, sociofonetika, linguistika interkulturore, politolinguistika, semiotika, estetika, hermeneutika, pragmatika, retorika etj.

Trajtimi i socioonomastikës përkon me synimet, kërkesat, hulumtimin, rëndësinë dhe përfundimin si arritje. Për t'i arritur këto objektiva, synimi im ishte që të këkoja në literaturën e kohës të arriturat e gjertanishme në raportin kohor – historik për këtë dije të re gjuhësore dhe rëndësinë e saj në gjuhësinë bashkëkohore. Në rrugën e hulumtimit tim kam bërë përpjekje dhe kam hasur në vështirësi për sigurimin e literaturës së nevojshme, e cila aktualisht është mjaft e mangët, por pas hulumtimit kam arritur që të grumbulloj materialin e nevojshëm dhe të duhur për të vlerësuar të arriturat nga kjo fushë.

Disiplinat ndërgjuhësore, që prej kohësh, kanë zgjuar interesimin e studiuesve të ndryshëm, në veçanti të linguistëve. Në shtegtimin e qëmtimit e studimit të ndërlidhjeve gjuhësore kam ndjekur disa kritere kërkimi si p.sh. kriterin fonetik, morfologjik, leksikor, frazeologjik etj. Në këtë dritë u kapën edhe kriteret ekstralingistike si: shtrirja gjeografike e popujve dhe e gjuhëve, metodologjia e hulumtimeve, shkollat gjuhësore të kohës dhe pikërisht për këtë, lindën e u zhvilluan edhe disiplina të reja gjuhësore, si shtysa themelvënëse të hulumtimeve të reja, mes tyre edhe socioonomastika, një subdisiplinë shkencore e onomastikës, që ka si detyrë t'i qëmtojë e t'i gjurmojë rrethanat sociale, politike, arsimore, historike, ekonomike etj., të cilat reflektohen edhe në shkencën e onomastikës. Ajo, e integruar me dije të tjera, hedh dritë të re në shtegtimin historik e burimor të etnive të ndryshme duke i hetuar transformimet dhe metaemërtimet onomasike që bëhen dhe imponohen nga rrethanat e sipërthëna.

Në këtë pikëpamje do ndjekur edhe studimet dialektore përherë të shoqëruara nga materia e pasur e krijimtarisë popullore në të cilën ruhen veçoritë e ndryshme gjuhësore dhe onomastike të një etnie dhe krahine. Andaj edhe tiparet dialektore dhe socioonomastike të Pejës me rrethinë do të vështrohen nga këto kënde.

Socioonomastikën e Pejës do ta trajtojmë si pjesë të pandarë të realitetit dhe të jetës së këtij etniteti dhe në vijimësi si përcjellëse të faktorëve onomastikë në dritën sociale gjatë historisë. Po ashtu do atë do ta paraqesim si dëshmi të politikës shkombëtarizuese e tjetërsuese që zbatohej ndaj popullatës së kësaj pjese përmes ndryshimit e ndërrimit të antroponimeve e patronimeve ku të sllavizuara e ku të turqizuara shpeshherë i humbin kështu gradualisht gjurmët e përkatësisë së prejardhjes, jo vetëm të Pejës me rrethinë.

Do të përpiqemi që të ndjekim edhe shkaktarët e ndryshimit të emërtimeve onomastike (antroponimike) që u bënë, në radhë të parë, nga pushtetet e nduarnduarshme të cilët në radhë të parë impononin vetëm ndryshimin e grafisë së emërtimit, për të vazhduar më pas, në rrjedhë motesh edhe me ndryshimet e toponimeve dhe patronimeve burimore.

Nga përvoja shumëvjeçare në fushën e shkrimeve kam paraparë që këtë tezë doktrate ta emërtoj: **Socioonomastika e Pejës me rrethinë**, për vet faktin se socioonomastika si disiplinë e re synon të jetë një studim gjithëpërfshirës që do të trajtojë onomastikën si dije, si shkencë dhe si vlerë kulturore dhe gjuhësore të këtyre anëve.

B. HYRJE

Përpjeka jonë mëton paraqitjen e socioonomastikës si grumbulluese të elementeve risimtare të dijeve të paidentifikuara deri me tani, si formë të re të vetëdijes shoqërore, si një subdisiplinë shkencore të onomastikës, duke ndjekur kështu emërtimet e nxitura e të vëna nga shtysat sociale.

Përmes kësaj disipline ne do të përpiqemi që të ndjekim shenjimin social të emërtimeve antroponimike dhe toponimike, duke hetuar njëkohësisht shtysat motivuese sociale të emrave të personave që u vihen në emërtimet onomastike.

Lënda socioonomastike e Pejës me rrethinë është mjaft e pasur. S'ka dyshim se nga kërkimi i gjithanshëm i kësaj lënde mund të ndriçohen çështje të rëndësishme jo vetëm për onomastikën dhe socioomastikën tonë, por hedhet dritë aty-këtu edhe mbi ndonjë çështje të disiplinave të tjera shkencore.

Përmes kundrimit nga aspekte epistemologjike dhe aksiologjike, si dhe shqyrtimeve të thukëta të emërvendeve (toponimeve), emrave të njerëzve (antroponimeve), si dhe emrave familjarë (patronimeve), dëshmojmë se në Pejë, në rrjedhë motesh, gjithmonë kanë jetuar dhe jetojnë vetëm popullatë shqiptare, autoktone.

Po ashtu, përmes sociopikëpamjeve do të ravijëzojmë praktikën brenda shoqërive të caktuara, gjithashtu do të vëmë në pah shqyrtimin se si gjuha dhe shoqëria kanë ndërvepruar në të kaluarën.

Përmes hulumtimit, analizës dhe shqyrtimit socioonomastik, do të paraqesim anët sociale më të ndërlikuara të kohës të të gjitha dijeve si dhe hedhjen dritë në shqyrtime dhe gjurmime shkencore përmes këndvështrimeve sociouniversale si paraqitje shoqërore, me theks të veçantë origjinën dhe kuptimet e emrave nga këndvështrimi social si dhe ndikimin dhe raportin e tyre shtytës në rrethana të caktuara shoqërore, gjithnjë në dritën e kësaj disipline të re shkencore.

Shenjëzimi i mënyrave dhe rrethanave sociale të jetës, fushave të veprimtarisë si bazë e ekzistencës së popullatës, shtresave shoqërore dhe treguesve sociosemiotikë, do të nënkuptohet edhe në shtysat e sajësive të terminologjisë onomastike. Me socioonomastikën mund të shkojmë tutje, duke e parë atë si një disipline të aplikuar

filologjike, duke i dhënë vend të veçantë në sajë të interesit të përgjithshëm për përmbajtjen dhe trajtimin e gjerë të saj në dritën sociale.

Mungesa e njohurive të mjaftueshme për këtë dije është një nga arsytet se pse kjo shkencë nuk është mësuar, trajtuar dhe hulumtuar deri në ditët e sotme dhe si rrjedhojë, deri më tani nuk ka pasur interesim të duhur për hulumtimin dhe zhvillimin e kësaj shkence në filologjinë shqiptare, andaj përmes lëndës së trajtuar do të dëshmojmë se socioonomastika është subdisiplinë e rëndësisë së veçantë dijesh heterogjene. Po ashtu do të prezantojmë faktorët shtytës të kjo dije edhe në sferën e motivimit emërvënës dhe hapësirat e mundshme të hulumtimeve sociolinguistike dhe socioonomastike. Do të jenë me interes edhe vështrimet e përgjithshme për socioonomastikën antropologjike, antropologjinë sociokulturore, arkeologjinë dhe socioonomastikën, si dhe antropologjinë kulturore dhe sociale të Pejës me rrethinë, me theks të veçantë hulumtimin pragmatik në terren.

Shumë herët në studimet gjuhësore të dhënat e onomastikës e kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm, por aktualisht është e **mbëhishme** që këtyre studimeve t'u bashkëngjiesim edhe vështrimin social si domosdoshmëri kohe.

Ky punim do të ishte i mangët sikurse të mos shfrytëzonim literaturën e studiuesve më në zë siç ishin Eqrem Çabej e Idriz Ajeti, për të vijuar më tej me Mahir Domin, Androkli Kostallarin, Rexhep Ismajlin, Ruzhdi Ushakun, Hasan Mujajn, Mustafa Ibrahim, Izmit Durmishin, Mehmet Halimin, Rexhep Doçin, Bahtijar Kryeziun, Begzat Baliun etj.

Trajtimet e tyre onomastike në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni, japim shpjegime të elementit burimor etnik shqiptar, për të dëshmuar përfundimisht autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre etnike.

Mbëhishme, fjalë me kuptimin: kërkesë kohe, nevojë, domosdoshmëri, (e kam përdorur për herë të parë në revistën letrare "Gurra", me 28 nëntor 1990, nr. 1., faqe 2. Fjala e redaksisë, në cilësinë e kryeredaktorit).

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PEJËN DHE BANORËT E SAJ

Peja njihet si qytet i lashtë që nga koha Ilire dhe një qendër e madhe vendbanimi.

Ta vizitosh Pejën do të thotë të shtegtosh nëpër kohëra të ndryshme, duke filluar nga kohërat ilire, bizantine, osmane, luftërat botërore e deri në ditët e sotme.

Peja me rrethinë është trevë e lashtë dhe ka një histori të begatë, ajo paraqet një thesar të trashëgimisë kulturore, historike, materiale dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme të cilat veçohen si për për nga vlera, po ashtu edhe për nga cilësitë, karakteristikat, rëndësia historike etj. Historia, kultura, tradita, pasuritë natyrore, pozita e shtrirjes, ambienti i mbrojtur, tokat pjellore etj., janë disa nga elementet që e identifikojnë këtë qytet. Në këtë trevë ndër shekuj erdhën e shkuan shumë pushtues të cilët me vete sollën kultura e qytetërime të ndryshme. Dukagjinasi dhe popullsia e kësaj ane mbijetuan, duke ruajtur në vazhdimësi gjuhën, kulturën, doket dhe zakonet e lashta, por pranuan edhe kultura të tjera të cilat mbase mund të ishin pjesërisht jehonë e lashtësisë së saj.

Pas luftës së fundit (1998-99), në aspektin human, doli e vrarë dhe e traumatizuar, në aspektin e trashëgimisë kulturore e djegur dhe e shkatërruar, megjithatë, Peja disponon me një gershëtim kulturash siç janë: qyteti i vjetër i Pejës (Siparuntum), udhët që lidhin këtë pjesë të Dukagjinit me vendet e tjera (Udha e Peklenës), kompleksi i Çarshisë së vjetër, Kalaja e Pejës (Gradina), kompleksi i Patrikanës së Pejës, urat mbi lumin Lumbardh, shtëpitë e banimit, kullat, sarajet, kishat e besimit katolik, kishat e besimit ortodoks serb, xhamitë, teqet, mesxhidet, varrezat, tyrbet, mullinjtë, kompleksi i mullirit të Haxhi Zekës, hamamet, hanet, sahat kullat, shatravanet, krojet, shtëpitë e vjetra qytetare, kultura e veshjes dhe traditat e vjetra të banorëve, punët artizanale etj¹.

Peja shtrihet në skajin veriperëndimor të luginës së plleshme të Dukagjinit dhe rrëzë bjeshkëve të larta të Rugovës si dhe në luginën e lumbardhit e rrethuar me Alpet Shqiptare. Peja me fshatrat e saja ka 603 km². Brenda kufinjëve administrativë ka 97 vendbanime të organizuara në 28 Bashkësi Territoriale.

1. Monumentet kulturore – historike – Pejë, IMMK, 2006

Kufizohet me Istogun, Klinën, Deçanin si dhe me komunat e Malit të Zi: Plavën, Beranen dhe Rozhajën. Në kuadër të saj gjendet edhe Rugova, zonë e rëndësishme kodrinore – malore me 16 vendbanimet e saja².

Shënimet e ndryshme tregojnë ekzistencën e këtij qyteti në mënyrë të organizuar qysh nga kohërat ilire dhe, po ashtu, Peja përmendet si njëri ndër qytetet kryesore edhe rrugë lidhëse e karvanëve të shumtë tregtarë që kanë udhëtuar nga Venediku dhe Raguza (Dubrovniku i vjetër)³.

1.1.Pozita dhe shtrirja gjeografike

Karakteristikë e përgjithshme e pozitës së Pejës është se ajo shtrihet në skajin veri-perëndimor të luginës së plleshme të Dukagjinit, para grykës pitoreske, nën shpatijet e Alpeve shqiptare (Albanian Alps).

Peja shtrihet në luginën e Lumbardhit e rrethuar me Alet Shqiptare.

Qyteti i Pejës ka lartësi mbidetare 505-520 m. Është i ngritur në fushën e rrafshit të Dukagjinit dhe rrëzë bjeshkëve të larta. Peja në pikpamje gjeomorfologjike përbën një tërësi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja, me çarkullimin rrugor lidhet me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën dhe Plavën. Qyteti është i rrethuar me bjeshkë që janë pjesë e masivit dinamik e që përfshijnë tërë Ballkanin Perëndimor. Këto bjeshkë formojnë një kurorë majash të larta siç janë: Maja e Kopranikut (2460 m.), Mali Zhlep (2352 m.), Hajla (2460 m.) Mokra (1932 m.), Malet e Lumbardhit gjegjësisht Guri i Verdhë (2522 m.), Maja e Viellakut (2012 m.), Peklena, Maja e Hasanit etj⁴. Me rrjedhë të shpejtë grykës shkëmbore të Rugovës, lumi “Lumbardhi” fillon të gjarpërojë fushës së Pejës, duke kaluar mespërmas qytetit dhe duke e ndarë atë në dy pjesë. Lumbardhi i cili gjatë rrjedhjes formon fusha pjellore, derdhet në lumin më të madh në “ Drinin e Bardhë”, që buron nga bjeshkët e Zhlepit në fshatin Radac. Lumbardhi ka një sasi uji prej 300 m³ në sekondë. Malet e Pejës janë të pasura edhe me liqej si: Liqeni i Niçinatit dhe ai i Ridit.

2. Plani lokal i veprimt të mjedisit për komunën e Pejës, Pejë, 2005, f.7

3. Monografia Peja, pilot botim. 2016.

4. [www. Wikipedia](http://www.wikipedia)

1.2. Emërtimi i Pejës ndër shekuj dhe historiku i saj

Në literaturën e deritanishme në lidhje me emërtimin e Pejës ekzistojnë disa periudha të emërtimeve. Gjurmët e para të dëshmuara të ekzistencës së jetës së qytetëruar në rajonin e Pejës së sotme datojnë që nga periudha parahistorike dhe ajo e antikitetit.

Emërtimin Siparuntum e gjejmë te Ptolomeu (87-150), në veprën e tij “Gjeographija”, që e mbështesin edhe shumë arkeologë, gjeografë, historianë, publicistë etj. Siparantum sipas burimeve arkeologjike – antike ishte në rang të “Munipiumit” (qytetit) përndryshe lokaliteti i dytë me rëndësi në territorin e Kosovës pas Ulpianës⁷.

Sipas hulumtimeve arkeologjike qyteti Siparunt kishte edhe një kala, mbi gërmadhat e lashta të së cilës mjesisht është ngritur fabrika e baterive.

Prokopi. historian bizantin, me (565) jep përshkrimin për lokalitetin e shënuar si Pentza që zëvendëson emërtimin Siparuntum, e që më vonë e merr trajtën Pek – Pekija – Peja.

Peja si qytet përmendet që nga viti 1202, gjatë periudhës së feudalizmit të zhvilluar, kurse në kartën e Stevan Prvovencanit rreth vitit 1215 përmendet si fshat në rrafshin e Hvosnos. Kah fundi i shek. XIII përmendet si “Pek” dhe “Pek arhiepiskupova”⁸.

Në shek. XIV Peja përmendet nga raguzianët dhe kotorasit që shkonin për të tregtuar në Pejë “ In Pecho”, kurse në vitin 1378 përmendet karvani “In novam montem Pech et Prisren”.

Të dhënat historike rreshtojnë se Peja me rrethinë, pas betejës së Kosovës, 1389 e deri me 1462 administrohet njëherë nga Balshajt e pastaj nga Dukagjinast. Pas kësaj beteje, 1389, filloi edhe depërtimi turk në Ballkan.

Peja, deri në vitin 1462 sundohej nga Leka i III Dukagjini i cili ishte lesak i sulltanit dhe kishte marrë pjesë në betejën e Kosovës të pushtuar nga Sulltan Mehmeti II, me 26.IX. 1462, me ç’rast u formua Sanxhaku i Dukagjinit.

5. <http://www.telegrafi.com/lajme/udhetimi-ne-shtegun-e-hekurt>

6. Monumentet kulturore – historike – Pejë, IMMK, 2006

7. Plani lokal i veprimt të mjedisit për komunën e Pejës, Pejë, 2005

Në gjysmën e dytë të shek. XVI Peja numëron 142 shtëpi të besimit islam dhe vetëm 15 shtëpi të përkatësisë fetare të krishterëve. Islamizimi u përqaftua prej një pjese të aristokracisë shqiptare për të ruajtur privilegjet e veta klasore. Mahmut (Pashë) Dukagjini, me tu bërë mysliman u emërua Sanxhakbe i Sanxhakut të Dukagjinit prej të cilit edhe u krijua dega e re e Dukagjinave myslimanë me emrin Mahmut Begollajt e Pejës. Gjatë shekullit XVII Peja vazhdimisht zhvillohej dhe duke e krahasuar me gjendjen e një shekulli më parë, qyteti i Pejës u rrit me 600 shtëpi dhe 130 fshatra dhe përjetoi një zhvillim të hovshëm të zejtarisë dhe tregtisë⁹.

Gjatë shek. XVII ndodhën edhe trazirat dhe luftërat austro-osmane që e përfshinë edhe territorin e Pejës (1683-1690). Këtë kohë e karakterizon lufta në mes të Begollajve të Pejës, Çauhallajve dhe Bushatllinjve për sundimin e Shkodrës që vazhdoi gati gjysmë shekulli. Gjatë viteve 1782-1784 epidemia e kolerës përfshiu edhe Pejen që shkaktoi shumë viktima. Ndërsa në vitin 1835 mori zjarr kryengritja e përgjithshme që po ashtu përfshiu edhe Pejen. Mirëpo, Turqia ia doli që t'a shtypë kryengritjen shqiptare, në këtë situatë pushtuesi turk hyri në periudhën e tanzimatit dhe reformave.

Në këtë kohë qyteti i Pejës numëronte 12.977 banorë dhe 193 fshatra, kurse pazari i qytetit (çarshia) kishte 550¹⁰ dyqane të regjistruara. Në afërsi të qytetit janë zbuluar tumat e Perçevës (shek. VI=V para K.). Në shek. XVIII kishte një treg me rreth 900 dyqane.

Regjimi serbosllav u mundua disa kisha katolike të mbetura në shumë vende të Kosovës që nga koha Ilire t'i shndërrojë në kisha ortodokse si p.sh. Patrikanën në Grykë të Rugovës. Karakteristikë e Pejës është Çarshi-Xhamia e ndërtuar rreth viteve 1600 - 1700 si dhe Kulla e Haxhi Zekës.

Po në këtë kohë qyteti kishte hyrë në rrugën e një zhvillimi të dukshëm shoqëror-ekonomik. Krijimi i një rrjeti të gjerë dyqanesh e punimesh, marrëdhëniet ekonomike me botën e jashtme e kishin kthyer qytetin në një qendër të rëndësishme. Qyteti i Pejës në këtë kohë ishte një nga qytetet më të pasura të Rrafshit të Dukagjinit¹¹.

8. <https://www.koha.net/.../historia-mijeravjecare-e-pejes>

9. <https://historikuipejes.eebly.com/historiku-i-pejes.html>

10. Monografia Peja, pilot botim. 2016.

11. kk.rks-gov.net/peje/city-guide/history.aspx

Nga pikpamja etnike qyteti i Pejës ishte i banuar me popullsi shqiptare e cila përbënte pjesën dërrmuese të banorëve të saj me kulturë, gjuhë, traditë dhe zakone të veta të lashta.

Në Pejë, në pallatin e Ismet Pashës dukej edhe biblioteka turko-franceze prej vitit 1836. Peja më 1881-1912 bëhet qendër e Sanxhakut të Pejës, kurse mytesarif u emërua Ali Pashë Gucia. Për këtë kohë dokumente të shumëta tregojnë për shkallën e organizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Pejë.

1.3.Lidhja e Pejës - “Besa-Besë”

Historia e Pejës në fund të shek.XIX është e lidhur ngushtë me mbajtjen e Kuvendit të Pejës. Duke qenë së rreziku i copëtimit të tokave shqiptare po rritej, rrethet patriotike shqiptare shtruan si detyrë krijimin e një organizate të re, që të vihej në krye të Lëvizjes Kombëtare. Në krye të lëvizjes u vu **Haxhi Zeka**, një nga udhëheqësit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare në Vilajetin e Kosovës dhe në mbarë Shqipërinë¹¹. Për këtë qëllim në vitin 1899 në Pejë u mbledh një Kuvend, ku morën pjesë delegatë nga e gjithë Kosova. Kuvendi formoi një **Besëlidhje**, që u quajt **“Besa-Besë”** ose Lidhja e Pejës. Besëlidhja e re udhëhiqej nga atdhetari Haxhi Zeka. Lidhja e Pejës i kërkoi Sulltanit që tokat shqiptare të drejtoheshin nga shqiptarët dhe në shkolla e zyra të flitej gjuha shqipe. Perandoria Osmane, e frikësuar, dërgoi ushtri të mëdha dhe e shpërndau Lidhjen e Pejës, me ç’rast, vrau edhe shumë patriotë shqiptarë, midis tyre edhe udhëheqësin Haxhi Zeka më 1902. Përpjekjet e popullit shqiptar për çlirim vazhduan edhe më vonë.

Në këto rrethana, qyteti i Pejës pas luftërave Ballkanike u pushtua nga Serbia dhe Mali i Zi, me ç’rast populli shqiptar i’u nënshtrua genocidit, shkombëtarizmit dhe asimilimit¹².

Më 1913 në rrethinat e Pejës dhe të Gjakovës, u pushkatuan 400 banorë që refuzuan të ndërrojnë fenë e tyre myslimane, ose katolike dhe kombësinë e tyre shqiptare.

Shumë prej këtyre nuk pranuan të ndërrojnë fenë, kështu që, në mënyrë më tragjike e humbnin jetën mbi stufën e skuqur.

12. Monumentet kulturore – historike – Pejë, IMMK, 2006

1.4. Peja antike

Peja e vjetër antike shtrihet në anën lindore të rrjedhës së lumit Lumbardhi, si dhe në të djathtë të stacionit hekurudhor, në fushën e Pejës.

Për Pejën e lashtë flasin shënimet e Evansit, Çershkovit etj. Ashtu siç sipërshënuam, si Siparunt dardan, Peja përmendet edhe në hartën e “Gjeografisë” së Ptolomeut, e cila u përgatit në gjysmën e shekullit të dytë, në Aleksandri.

Me rastin e ndërtimit të Fabrikës së baterive industriale, gjatë gjurmimeve arkeologjike në vitin 1978-79, u zbuluan objekte të lëvizshme (stela, cipus), stoli, armë etj.

Disa nga objektet e gjetura nga ky lokalitet gjenden në Muzeun Etnografik të Pejës¹³. Në mesin e tyre vlen të përmendet sidomos një stela dhe një cipus. Këto dy objekte i takojnë shek. I e.s. Stela është punuar nga mermeri i bardhë dhe ka këto dimensione : 195 x 65 x 25 cm. Nga mermeri i bardhë është punuar edhe cipusi. Lartësia e tij arrin 90 cm.

1.5. Objektet religjioze

Peja paraqet një thesar të pasur të monumenteve kulturore – historike të periudhave të ndryshme të cilat dallohen për llojllojshmërinë, kualitetet dhe rëndësinë historike të tyre.

Të gjeturat arkeologjike të periudhës romake, por edhe të periudhave më të vonshme si: reliket e bazilikës së krishtërimit të hershëm në këtë anë tregojnë për ekzistencën paleokristiane. Sllavët me ardhjen e tyre hasën në popullatë vendase të vjetër dhe të krishterë. Mbeturinat e terminologjisë së vjetër latine në gjuhën e tyre dhe shumë emërvende me bazë shenjtërore dëshmojnë për vjetërsinë e krishterimit.

Si pasojë e okupimit të Pejës nga feudalët sllavë të Nemanjiqëve në shek. XIII u ndërtua edhe Manastiri në bregun e majtë të Lumbardhit në Pejë, për të vazhduar me kishën e Shën Apostujve, kishën e Shën Dimitriut, Tempullin e Zonjës së Bekuar etj.

Në vitin 1555 është renovuar Patrikana e Pejës e cila ka rëndësi të madhe kulturore dhe historike të mesjetës. Gjatë viteve 1327 – 1335 ishte ndërtuar Manastiri i Deçanit, nga Stefan Uroshi I III Deçanski.

Me vendosjen e administratës osmane, pas pushtimit, i gjithë rajoni ndërroi stilin e jetesës.

13. Monografia Peja, pilot botim. 2016.

Gjatë kësaj periode u ndërtuan shumë vepra si: xhamitë, mesxhidet, teqetë, hamamet, medreset etj., vepra këto sarkale.

Gjatë shek XV – XVI u ndërtuan: Çarshi Xhamia, Bajrakli Xhamia, Hamam Xhamia, Hamami i Haxhi Beut, Deftedar Xhamia, Xhamia e Kuqe etj.

Jo rrallë, zjarri gjatë historisë ndërroi kahen e mendimit njerëzor për arkitekturën, urbanizmin dhe çdo gjë rreth tij, gjë që ndodhi edhe me luftën e fundit të UÇK-së.

1.6. Muzeu Etnologjik

Një pjesë e historisë, traditës dhe kulturës së Pejës me rrethinë është ruajtur në Muzeun Etnologjik në Pejë, i cili ishte i themeluar në vitin 1977, ndërsa i hapur në vitin 1983, në ambiente autenike të Konakut të Tahir Beut, i ndërtuar në shek. XVIII, i cili vizitorëve u ofron më shumë se 120 ekspozate të cilat flasin për jetën e pasur të qytetit dhe banorëve të saj nëpër shekuj. Mbishkrimet në gur do t'u kthejnë deri në shek. e II të epokës sonë, ndërsa me veglat që i kanë përdorur banorët, me pak fantazi e nxitë jetën e pasardhësve se si e kishin përpunuar drurin, si i kishin prodhuar veshjet dhe prodhimet e tjera të tekstilit, cilat instrumente muzikore i kishin që kanë ruajtur frymën nëpër shekuj, me çfarë stolish ishin zbukuruar në rastet solemne, çfarë kishin veshur dhe çfarë armësh kanë pasur.

Gjatë vizitës në muze, njehohësisht do të përshkoni edhe historinë e qytetit pitoresk të Pejës.

1.7. Çarshia e gjatë

Çarshia e vjetër në Pejë daton që nga shekulli i XV dhe paraqet një lloj qendre tregtare të qytetit. Rruga e gjatë në çarshi, me shitore të shumëta nga të dyja anët i mashtron vështrimet e vizitorëve dhe ua zgjon frymën konsumuese. Dyqanet janë tipike orientale, ndërsa shitësit janë të gatshëm të merren vesh për çmimin me blerësit e interesuar. Këtu, mjeshtërit e shumtë do t'u ofrojnë kapela cilësore për çdo rast, pelerina, stoli etj¹⁴. Në pjesën e çarshisë së quajtur *rrethi*, në mesin e tij gjendet shatërvani i vjetër.

14. Mathieu, Aref, Shqipëria, historia dhe gjuha, Odiseja e pabesueshme e një pop. parahelen, Tiranë, 2007.

1.8.Rezistenca paqësore dhe lufta e armatosur

Në kushte okupimi të plotë, delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, më 7 shtator 1990 në Kaçanik e shpallën Kosovën Republikë.

Deri në fillimin e luftës së armatosur pushteti okupues i klikës serbe përdori masa dhune të papara ndaj shqiptarëve, gjë e cila e përcolli edhe Pejën me rrethinë, madje edhe me vrazhdësi dhe egërsi më të madhe.

Në zgjedhjet e 24 majit 1992, nën tytat e armëve u mbajtën zgjedhjet parlamentare, ku pasi fitoi shumicën e deputetëve, kryetari i LDK-së dr. Ibrahim Rugova u zgjodh kryetar i Republikës së Kosovës, i cili në vazhdimësi të udhëheqjes iu referua rrethanave ndërkombëtare. Nga kjo kohë edhe në Pejë filloi të veprojë sistemi paralel karshi atij serb. Vitet kalonin e dhuna policore serbe shtoej, kështu që edhe durimit i vinte fundi. E vetmja alternativë e rrugëzgjdhjes dukej lufta e armatosur. Dhe në vitin 1997, në rrethinën e Pejës u shfaqën formacionet e para luftarake të UÇK-së.

Me 5 korrik 1998, në fshatin Loxhë u zhvillua një ndër betejat më të lavdishme të UÇK-së, për 11 orë luftime nga afër, duke i shkaktar armikut humbje të mëdha. Betejën e Loxhës e udhëhoqi kolonel Tahir Zemaj¹⁵, i vrarë në një atentat pas lufte (2002).

Duhet theksuar se edhe në kushtet e luftës procesi mësimor nuk u ndërpre as edhe njëherë, por u mbajt dhe u organizua në rrethana të papara dhe nëpër shtëpi private, nën tytat e armëve, rrahjeve, maltretimeve, burgosjeve, zhdukjeve pa gjurmë, pushkatimeve e çka jo tjetër.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1998, forcat policore serbe krahas sulmeve mbi zonat e UÇK-së të Rrafshit të Dukagjinit, vranë e masakruan qindra civilë, gra, pleq e fëmijë, dogjën e poqën, dhunuan e zhdukën pa gjurmë qindra të tjerë¹⁶.

Edhe pas bombardimit të forcave aleate të NATO - s mbi caqet jugosllave, militarë e paramilitarë ekzekuatun qindra civilë, zhvendosën nga shtëpitë e tyre mbi 80 % të popullatës përmes një ekzodi biblik, me një fjalë qytetin e Pejës e shndërruan në qytet fantazmë, si kam thënë në një raportim për TVSH-në gjatë asaj kohe në cilësinë e reporterit të luftës.

15. Kastrati, Rexhep. 2002. Kështu foli Tahir Zemaj II

16. Hysenaj, Valdet. Nga ditari personal i ngjarjeve me peshë kombëtare dhe luftës së fundit (1989 – 1999).

Pas 72 ditë bombardimesh nga Aleanca Veriatlantike dhe luftës së UÇK-së, ushtria serbe u detyrua të nënshkruante marrëveshjen e Kumanovës, ku me 10 qershor 1999 ushtria dhe policia serbe bashkë me armatimet, brenda 10 ditëve duhej të largoheshin nga territori i Kosovës, pra edhe nga Peja.

Me 12 qershor 1999, forcat paqeruajtëse të KFOR-it hynë në Kosovë. Në Pejë u pritën me entuziazëm të paparë. Këtu edhe përfundon fundi i një regjimi kriminal.

1.9.Turizmi

Peja ka resurse të mëdha dhe tërheqëse për zhvillimin e turizmit. Viteve të fundit turizmi ka marrë hov. Klima malore, bukuritë natyrore, shumëllojshmëria e florës dhe faunës, investimet në infrastrukturë, ndërtimi i objekteve afariste, hoteleve, restoranteve, bujtinave dhe ndërtimi i shumë shtëpive private për shërbimin dhe strehimin e turistëve, janë bërë faktorët kryesorë që mundësojnë turizmin e Pejës me rrethinë.

Historikisht Peja ka qenë pikë e rëndësishme kalimi e lidhjeje përmes rrugës Pejë – Qakor drejt bregdetit të adriatikut, duke përshkuar kanjonin e Rugovës, gjë që ka mundësuar zhvillim ekonomik dhe turistik të qytetit falë kalimtarëve të shumtë anekënd Federatës Jugosllave të atëhershme, të cilët shfrytëzonin këtë rrjedhë udhëtimi për qëllime të shumta¹⁷.

Shfrytëzimi i turizmit daton që nga kohërat Iliro-Dardane, sipas të dhënave që kemi vërejmë se atëbotë shfrytëzoheshin burimet e ujërave termale në Ilixhe (banjën e Pejës) nga shumë nevojtarë vendesh të ndryshme për shërimin e lloj-lloj sëmundjesh me ç'rast kemi një shumëdimensionalitet zhvillimi e përparimi të turizmit shëndetësor, zhvillim ky i cili në vijimësi pati rrjedhë të begatë veprimi deri më ditët e sotme.

Qysh herët lindi nevoja e ndërtimit të konaqeve dhe haneve si brenda qytetit ashtu edhe në të gjitha fshatrat përreth, të cilat shërbenin si vende akomoduese për vizitorët të cilët kanë qëndruar në Pejë.

Më vonë u ndërtuan objekte të ndryshme hoteliere si hotel “Korza”, hotel “Metohija”, pastaj kampi “Karagaç”, moteli “Nora”, shtëpia malore në Bjelluhë, shtëpitë akomoduese në fshatin Bogë të Rugovës dhe në bjeshkët e Lumbarshit, kapacitete këto të cilat shërbenin në ngritjen e ofertës turistike të komunës si dhe ishin me karakter sportiv dhe

relaksues.

Gryka e Rugovës gjendet 3 km. nga qendra e Pejës dhe paraqet një pikë të rëndësishme për zhvillimin potencial të sektorit turistik. Përgjatë gjithë grykës kalon lumi Lumbardhi i gjatë 56 km. Mjaft atraktive mund të jenë vizitata në shpella dhe ngjitjet në mal.

Kontribut të madh jep edhe grupi “Marimangat” që tërheq vendasit dhe të huajt drejt aventurave nëpër këto bjeshkë. Ky grup mundësoi edhe ndërtimin e rrugës “Via Ferrata”, njëherazi e para në Ballkan që mundëson ngjitjen në shkëmbinj për secilin kalimtar kureshtar.¹⁸

Mjaft tërheqës është edhe Shtegu i Gjelbër i cili mundëson shëtitjen në këmbë apo me biçikleta nëpër bjeshkë. Turizmi pejan-rugovas, si më i zhvilluari në këtë komunë, ofron prodhime lokale dhe mikpritje në shtëpitë rurale në të cilat mund të marrësh pjesë në aktivitetet e përditshme të fshatarëve, të shijosh ushqim të shëndetshëm si dhe të bësh ekskursione në këmbë ose me kalë në malet përreth.

Duke ndjekur më pas rrugën, përgjatë saj gjenden restorante si edhe sipërfaqe të gjera të gjelbërta, deri në fshatin Bogë, në zonën veriore të regjionit të Rugovës.

Në këtë fshat bëhet turizëm malor (si në dimër ashtu edhe në verë). Ka edhe një pistë për ski, të gjatë 1100 m., me një kapacitet prej 1000 skiatorësh për një orë¹⁹.

Nga këtu mund të vizitohet edhe fshati Haxhaj, burimet e ujit, pyje të mëdha e të mrekullueshme në të cilat mund edhe të bëhen kampingje. Më pas vie Liqenati, në pjesën e majtë të lumit Lumbardh, pjesa më e pasur nga pikëpamja natyrore dhe më tërheqëse në të gjithë regjionin e Bjeshkëve të Rugovës, me një pozicion shumë të favorshëm për skijim dhe pushim ku ka edhe disa restorante mjaft tërheqëse.

17. <http://www.pejaturism.org/peja.html>

18. Monografia Peja, pilot botim. 2016.

19. <https://www.koha.net/.../historia-mijeravjecare-e-pejes>

1.10. Ekonomia

Peja është njëri nga qytetet më të pasura të Kosovës. Nga 603 km², pothuajse gjysma e territorit të tij është zonë malore, veçohet Rugova e pasur me pyje e kullosa dhe e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë.

Pjesa tjetër e qytetit me rrethin është tokë pjellore dhe e punueshme, e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, pemtarisë, vreshtarisë etj²⁰. Peja ishte qytet industrial më me se 10 fabrika, por për momentin ato kryesisht nuk janë aktive. Në Pejë, po zhvillohet me sukses biznesi privat me mëse 4.000 biznese të regjistruara. Në procesin e privatizimit pritet që në Pejë të hapen vende të reja pune dhe të mëkëmbet zhvillimi ekonomik. Në Pejë, gjithashtu gjendet edhe terminali doganor.

1.11. Demografia

Popullsia e komunës së Pejës sipas sipas 6 regjistrimeve të fundit (1961 – 2006) të marrura nga Enti i Statistikës së Kosovës rezulton me këto të dhëna:

Viti	Shqip	%	Serbë	%	Malaze	%	Romë	%	Bosh	%	Të	%	Gjithsej
Popullsia	Tare				zë				Njakë		tjerë		
1961	41,532	62.35	8,852		12,701		728		1,397				66,656
1971	63,193	70.12	9,298		11,306		433		5,203				90,124
1981	79,965	71.99	7,995		9,796		3,844		8,739				111,071
1991	96,441	75.5	7,815		6,960		4,442		9,875				127,796
1999	104,600		9500				4,000		4,200				113,000
2006	78,712	86.3	10				1,800		5000				91,112

20. Plani lokal i veprimt të mjedisit për komunën e Pejës, Pejë, 2005

1.12. Skitaria

Deri në vitin 1974 skitaria ka qenë pjesë e bjeshkatarisë. Rugova njihet si djep i skitarisë kosovare dhe ballkanike. Klubi i parë i skijimit ishte "Rusolia" nga e cila kanë dalë tri grupe të tjera: KS "Peja", "Alpi" dhe "Rugova". Klubi "Rusolia" ka marrë pjesë edhe në Lojërat Olimpike²¹. Shumë rugovas si: Hajrush Demaj, Riza Demaj, Bekë Demaj, Afrim Shkreli etj., gjatë ish Jugosllavisë ishin ndër skitarët më të mirë në Jugosllavinë 20 milionëshe, madje duke marrë edhe vendet e para për vite të tëra radhazi²². Sot, pista më e zhvilluar e skijimit gjendet në fshatin Bogë, por ka pista shumë të favorshme edhe në vende të tjera, p.sh. në fshatrat: Stankaj, Shkrel, Hajlë, Riekë e Allagës etj.

1.13. Bjeshkataria

Bjeshkataria paraqet një aktivitet rekreativ dhe sportiv që në Pejë daton që nga viti 1928²³. Për dallim nga alpinizmi, bjeshkatari d.m.th. ecje në terren dhe ngjitje në lartësi, pa asnjë mjet, derisa të ndeshesh në pengesa natyrore: shkëmbinj të lartë e të rrëpinjtë. Në kuadër të grupit të bjeshkatarëve funksionon edhe një Grup i Shpëtimit prej 30-40 vetash që ndihmojnë në raste të fatkeqësive natyrore.

1.14. Flora

Regjioni i Pejës me rrethinë, repsektivisht Rugova karakterizohet nga një larmi habitatesh si: livadhe e kullota subalpine e alpine, shkurre e shkurreta, pyll qarri, ahu e halorë, kodrina, gropa e shpatije, përrenj e gryka, zallishte e çakëllishte dhe ujë lumi, gurrash e pusesh, shpella, kthina e gropa karstike, toka gjysmë të lagështa, pothuaj të thata e gëlqerore, acide me ngjyrë të purpurtë, të kuqe e të zezë, me gropa, brigje e lugaja, me masive shkëmbinjsh e gurë të derdhur²³. Kjo shumëllojshmëri habitatesh aq sa të lë të mendosh për një bimësi me diversitet të lartë.

1.15. Fauna

Peja me rrethinë përbën kompleks habitatesh të përshtatshme për praninë e madhe të organizmave të gjallë. Në regjion rezulton një faunë e pasur për nga diversiteti, shtrirja dhe llojet e rralla e të rrezikuara në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

21. Elsie, Robert, <http://books.google.com/books?>

22. Natyra e Rugovës (Eko-Guidë, Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit, Pejë.

23. Mirko Barjaktarevic, Rugova i njeno stanovništvo, Beograd, 1960.

KREU I DYTË**2. PIKËPAMJE SOCIALE EMËRVËNIESH, PËRKIME DHE RRJEDHA**

Socioonomastika kryesisht i bazon studimet e veta mbi emrat e përgjithshëm dhe personalë, me fokus të veçantë pothuajse ekskluzivisht në origjinën dhe kuptimet e emrave nga këndvështrimi social, ndikimin dhe raportin e tyre shtytës në rrethana të caktuara shoqërore, duke paraqitur kështu karakteristikat kryesore të emrit, duke i dhënë sqarime shtesë për formësimet sociale për periudha të caktuara kohore, duke shqyrtuar njëkohësisht edhe ndikimin e faktorëve shoqërorë në zgjedhjen e emrave personalë. Që nga kohërat e lashta rendi shoqëror është i lidhur shpesh me fenomenin e emrave të ndryshëm për klasat shoqërore, ngase emrat që u jepeshin të varfërve argumentonin skllavërinë e tyre, të paktën në një farë mase, sepse në këtë periudhë historike emrat e tillë kishin lindur si emra që dallonin nga ata të cilët përdoreshin në shtresat e larta.

Nga këndvështrimi social, sipas kësaj pikëpamjeje, përmes emrave të tillë shtresash caktuara, ne në njëfarë mënyre hyjmë në çdo kohë, pra i qasemi lirisë dhe jolirisë si dhe njohurive themelore të ekzistencës njerëzore. Për një periudhë të gjatë historike kjo dukuri vlen edhe për shumë shoqëri të tjera, si babilionase në botën greko-romake të antikitetit klasik, me shtrirje edhe në lindje. Hasim po ashtu edhe një pasqyrë të shkurtër të sistemeve të emërimit për burra te grekët dhe romakët, me theks të veçantë emrin për robër dhe aristokratë. Më pas, karakteristikat thelbësore të emrave skllavër të këtyre dy sistemeve të emërimit krahasohen me raportet që rezultojnë si emra nënshtrues për robin dhe lartësues për aristokratin. Emrat grekë dhe romakë të personave të tillë, të robërve, të ofrojë po ashtu si te skllavet femra, një krahasim të robërisë dhe të lirisë, sidomos pasi që të lexojmë literaturë antroponimike të asaj periode kohore do të vërtetojmë sasinë dhe shumësinë e emrave për robër, të cilët në përgjithësi janë të hulumtuar mirë. Edhe në shoqëri të tjera dhe në lindje, nga këndi social vërejmë krahasimin e sistemeve të ndryshme të vënies së emrave për klasa të ndryshme shoqërore, robër dhe aristokratë.

Në fakt, përmes emrave deshifrojmë mungesën e lirisë si një qasje tjetër, shumë ndryshe nga ajo si e kemi mësuar. Në mungesë të fakteve shkrimore, në retrospektivë ne nuk mund të argumentojmë fakte të kësaj natyre për pararendësit tanë, megjithatë, edhe te ne mund të

supozojmë se kemi pasur një rrjedhë të tillë emërvëniesh, statusore shoqërore, ndasore si edhe tek të gjithë popujt e tjerë, kjo për vet faktin se gjuha jonë është ndër më të vjetrat në Gadishullin Ballkanik.

Klasifikimet e tilla në kuadër të dritës sociale për llojet e ndryshme të emrave, me dokumentet mbështetëse, emrat e asaj periode kohore paraqesin edhe klasifikimin e shtresave shoqërore, përmes personaliteteve të bartësemrave, sigurisht hetojmë edhe diferencimet brenda klasave shoqërore.

Socioonomastika ka në interes edhe studimin e larmisë së jashtëzakonshme të emrave fetarë, për të dy gjinitë. Përpos përshtypjelënies, ajo kap nevojën për emrin e donatorit, (dhe transportuesit), në dritën sociale, për të sjellë emërtimin e marrëdhënies së sferës hyjnore. Që nga antika e këndeje, janë dhënë emra perëndish, të biblës, kuranit, të hyjni-kërkimit, që në retrospektivë dhe perspektivë ofrojnë lutje dhe dëshira. Vështrimi social i tyre paraqet edhe ndikimin e bartësve të institucioneve fetare në masat e gjera popullore, frikën nga bartësit e institucioneve fetare (inkuzicioni), apo edhe dëshirën për të qenë pjesë e tyre etj., rëndësinë politike të tyre, kohën e emërvënies, motivet dhe shtysat pagëzuese të cilat janë aktuale edhe sot.

Ajo që ende mbetet e diskutueshme është nëse emrat fetarë në jetën e përditshme nëpërmjet identifikimit të një personaliteti fetar funksionojnë, sa kam vërejtur, në anë tjera të Kosovës emra të tillë kemi me bollëk, por në Pejë sipas hulumtimeve tona janë të rrallë, mund të themi gjithashtu se duhet theksuar se theksi i fortë në sferën fetare në të kaluarën e kësaj treve në përgjithësi ka qenë një fenomen i përhapur dhe mjaft evident.

Mbesin sidomos në përdorim edhe sot e kësaj dite disa emra të cilët nuk janë kuptimplotë, por qëndrojnë kryesisht në dritën e përmbajtjeve fetare.

Pavarësisht nga këto vështirësi, në përshkrimin e çdo sistemi të përcaktimit të kushteve të emërvënies së kësaj natyre, në veçanti ky sistem i emërtimit në Pejë shpeshherë është një modifikim i emrave të lashtë. Tek modifikimet e tilla kemi vërejtur edhe kujdesin që riemri sërish të ketë kuptim logjik brenda shtresës sociale, duke ruajtur kështu përafërin e treguesit të burimit si Bul, Bulion, Bulza, Mari, Mire, Mirashe etj. Emra të tillë me kuptimësi të dyfishtë, për një kohë të gjatë ishin të zakonshëm dhe si të tillë paraqesin tipare tipike të socioonomastikës. Emrat e kësaj natyre mund të jenë prova të rrjedhave historike që na lejojnë një diferencim social ndërmjet kategorive shoqërore, të

parashikueshëm që në marrje, kjo zaten qartëson se kategoritë e caktuara të emrave ishin fillimisht të rezervuar për periudha të caktuara me shtrirje të plotë dhe përkushtueshëm.

Gjatë shekujve të fundit këto kategori dhe dallime fillojnë të zbehen dhe gradualisht edhe të zhduken duke u mëtuar vënia e një ekuilibri social mes shtresash, për të gjetur përfundimisht moszbatim në periudhën tonë, duke u plotësuar me komponentë të rinj, sidomos me fillimin e përdorimit të listave zyrtare, meqë ato kishtare ekzistuese kryesisht figuronin të zhdukura.

Prezantimi i emrave tregon se përkundër ngjashmërive, ka dallime të rëndësishme, kufizime të dukshme identifikohen në sferën e familjes, të cilët në kontekstin publik shpesh hasim shumësi emrash të ngjashëm të identifikuar me tregues të përbashkët, duke paraqitur fatet shoqërore të padiferencuara si modele të përbashkëta.

Pavarësisht kuptimësisë së emrave të tillë të përdorur mund të tregohen dallimet sipas aspekteve sociale.

1. Hysenaj, Valdet. 2016. Bota Sot. Socioonomastika e Rugovës. Opinione.

2.1. KONCEPTI DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË KULTURËS SOCIALE

Nuk ka dyshim se kultura është një nga karakteristikat më të rëndësishme, në mos karakteristika më e rëndësishme e njeriut dhe shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Kjo është mëse e qartë meqë asnjë lloj tjetër nuk ka kulturë. Po ashtu është e qartë se kultura mund të vie në shprehje kur njeriu vështron sjelljet shoqërore në përgjithësi dhe ato individuale në veçanti si fenomene të rëndësishme shoqërore. Nuk mund të pohojmë se paraqitjet kulturore nuk përmbajnë komponentet individuale të personat e caktuar, por ato paraqiten edhe si kategori të pranueshme sociale, sepse kultura mund të definohet për shtresën shoqërore, me objekt trajtimi individin përmes disiplinave të ndryshme shkencore si antropologjisë, filozofisë, historisë, etnologjisë, psikologjisë, biologjisë etj., duhet të theksohen këtu pikërisht ato momente që veçojnë e përcaktojnë karakterin social të kulturës, i cili edhe ashtu sqarohet përmes sociologjisë.

Kur bëhet fjalë për definimin teorik dhe social të kulturës është e rëndësishme që të potencojmë faktin se bartësit fizikë të kulturës përpos kulturës njerëzore, sociouniversale, si paraqitje shoqërore, kemi edhe paraqitjet e personave të caktuar apo grupeve shoqërore që ndikohen nga faktorë të rrethit të ngushtë që prezantojnë pikëpamjet nacionale, klasore, profesionale dhe specifika të tjera të cilat mund t'i quajmë nënkulturë sociale apo sociosubkulturë. Në fushën tonë të hulumtimit definimet e tilla duhet parë nga prizmi i dimensioneve kohore dhe gjeneratave të ndryshme, sidomos meqë kjo zonë gjatë gjithë historisë aq sa kemi konstatuar, që nga antika, mesjeta, renesanca e deri në luftën e fundit ka qenë vatër luftërash të pareshtura e situatash konfliktuoze, për çka rrethit shoqëror në vazhdimësi i janë imponuar sisteme shoqërore antikulturne, përmes dhunës, që edhe në aspektin psikologjik kanë lënë gjurmë në fushën e antivlerës dhe mu për këtë, përkundër të të gjithave, qoftë edhe me të metat e saja, në këto hapësira ka dominuar kultura sociale tradicionale, sepse ka qenë i pamundur integrimi në kultura të tjera, apo socializimi i personaliteteve ndryshe. Të gjitha arritjet dhe vlerat sociale të kulturës së përgjithshme në Pejë faktikisht kanë qenë të bazuara në vlerat humane njerëzore, të cilat në vazhdimësi kanë evoluar pozitivisht. Për këto ndryshime po veçoj një thënie të një rugovasi, Smajl

Arifi nga Shkreli, 95 vjeçar i cili më tha: “Po emnat e silljet kan’ n’drdua besa, po ndrro guri e druni e le ma na, ktyne her u enshim n kam, me prug e tash me limuzina e me salltanet, buken e kem’ pas qesat, e tash me kajde...”.

Vështrime interesante rreth ndikimit kulturor në emërtime antroponimike, toponimike dhe patronimike janë siguruar përmes punës individuale me ekspertë dhe studiues si dhe hulumtimet në rrethe të caktuara. Përmes qasjeve të drejtpërdrejta në terren nga prononcime, opinione apo sugjerime individësh, përmes metodave të testimit të problemit, metodave historike si dhe metoda krahasuese, si metoda të hulumtimit socioonomastik në mbarë terrenin e Pejës me rrethinë është mundësuar që nga njëra anë emërdhëniet gjatë periodave të caktura kohore të kenë qenë të ndikuara nga kultura sociale kohës, kurse nga ana tjetër ndikimi i kulturës sociale të jetë aktual edhe sot e gjithë ditën. Kjo për vet faktin se ky përfundim vie si rezultat i shqyrtimit të një numri të madh variablesh apo faktorësh që u korrespondojnë karakteristikave të ndryshme demografike apo sociale të socio-aspekteve emërtuese që janë përfshirë në këtë vështrim, si përceptues të kulturës sociale. Përmes disa pikëpamjeve të potencuara është mundësuar një vlerësim nismëtar i kompleksit të faktorëve politikë, ekonomikë, juridikë, socialë, moralo-psikologjikë, historikë, tradicionalë etj. Në secilën etapë kohore emërtimet janë bërë nga ndikime të ndryshmet kulturore, në rastin tonë nga ndikime të kulturës sociale, të cilat bazohen në karakteristika të veçanta dhe të përgjithshme, me ç’rast emërdhënësit me a pa vetëdije përcaktohen për ndikim të caktuar kulturor, shpeshherë të kohës, nga socialja e cila ndikon në masë më të madhe, kështu që me ndërrimin e kulturave sociale, ata marrin diç risimtare të aktualitetit dhe hudhin tutje emërtimet paraprake, që mund t’i definojmë si fokus kulturor social p.sh. sot ndikimi i letërsisë botërore ose kombëtare, krijimeve nacionale artistike me peshë që për individin a bashkësinë prezanton stil të ri, teknikë, modë etj., ndikon në ta, duke anashkaluar kështu traditën ekzistuese, mentalitetin shoqëror, temperamentin, duke sensibilizuar kështu në këto raste prurjet e reja në përbërjen e kulturës personale. Kjo, zaten ndodh, madje jo vetën në fushat që potencuam që njëherit edhe paraqet dëshirën e caktuar të të njëjtëve që ato prurje të jenë pjesë e shoqërisë së tyre nga të gjitha fushat.

2.2. RËNDËSI DIJESH HETEROGJENE

Socioonomastika është degë e onomastikës e cila merret me emra nga një perspektivë e sociolinguistikës: Çfarë të bëjmë me emra, cila është rëndësia e tyre, ç'moshë kanë emrat e njerëzve dhe të vendeve, si i kuptojmë konceptet e përgjithësuara të tyre, si shenjëzohen vlerat e caktuara përmes emërvënieve, cilat janë pikat përputhëse te gjenealogjitë e të njëjtëve, si ndikojnë në emërtime rrjedhat hapësinore dhe shtrirja e tyre, si i identifikojmë referencat e origjinës së emrave etj. Të gjitha përgjigjet na shpiejnë drejt burimeve në tëpamje të dritës sociale, dhe jo vetëm kaq, socioonomastika njëherazi heton e zbërthen shtysat sociale të emërtimeve onomastike të cilat përfaqësojnë edhe përbërësit etnopsikologjikë të jetës e të veprimtarisë në krahinat përkatëse.

Socioonomastika paraqet socio-pikëpamjet më të moderuara të kohës të të gjitha dijeve. Megjithëkëtë, është koha që edhe në studimet shqiptare të fillojë mësimi dhe studimi i kësaj dijeje e cila paraqet interes të veçantë për gjurmimet shkencore universale, sepse ka shtrirje në të gjitha fushat e veprimtarisë. Po të mos ishte kështu, d.m.th. po të mos ishte parë rëndësia e madhe e kësaj shkence në të gjitha shkencat, sigurisht se nuk do të studiohej në universitetet më të njohura të Evropës dhe të ShBA-ve.

Në Finlandë, Itali, Suedi, Gjermani, ShBA, etj. botohen revista të veçanta ku trajtohen çështjet socioonomastike, kurse tek ne shkenca e socioonomastikës ka mbetur jashtë interesimit të studiuesve, me gjithë faktin se ajo ka rëndësi të madhe për studimet bashkëkohore në fusha të ndryshme të dijeve filologjike, por edhe në të gjitha dijet e tjera. Duhet të thuhet se në këtë pikëpamje filologjia shqiptare është shumë vjet prapa në krahasim me studimet dhe arritjet moderne perëndimore në fushën e linguistikës.

Ashtu siç kemi vënë re sikurse, sociosemiotika edhe socioonomastika gjejnë zbatimin e integritit në një numër të madh shkencash si p.sh. stilistika, onomasatika, fonetika, teoria e komunikimit, sociosemiotika, psikologjia, antropologjia, retorika, semantika, mediet, arkitektura, shkencat e letërsisë e shumë të tjera. Mund të hetojmë tek kjo dije faktorët shtytës edhe në sferën e motivimit emërvënës.

Socioonomastika vazhdon së kërkuari për të gjetur se çfarë është me të vërtetë në një emër dhe për të hetuar njohuritë kulturore, historinë e shlyerjes, ndryshimit dhe karakteristikat gjuhësore të shpallura në emra, gjithnjë në vështirimin social.

Prof. Hasan Mujaj, duke vështruar fushat parësore të hulumtimit të sociosemiotikës dhe duke i trajtuar si tema sociale të jetës vend qendror zënë: mënyrat dhe rrethanat sociale të jetës, fushat e veprimtarisë si bazë e ekzistencës së popullatës, shtresat shoqërore dhe treguesit sociosemiotikë, të cilët pasqyrohen ose nënkuptohen edhe në shtysat e sajësive të terminologjisë onomastike. Mendojmë se me socioonomastikën mund të shkojmë tutje, duke parë atë si një disiplinë të aplikuar filologjike, duke i dhënë vend të veçantë në sajë të interesit të përgjithshëm për përmbajtjen dhe trajtimin e gjerë të saj në dritën sociale. Ky interes duhet të përdoret për të ndihmuar dhe zgjedhur ato përmbajtje kërkimore të pastuduara si:

- *Motivim të veprimtarisë krijuese shkencore;*
- *prezantim të njohurive të reja të kësaj fushe;*
- *qasje që nuk kufizon përmbajtjet ekzistuese;*
- *disiplinë moderne dhe efikase.*

Për më tepër, përshkrimi i emrave të duhur në modele të ndryshme gramatikore, përshkrimi i emrave në intreferenca të ndryshme gjuhësore shpiejnë drejt kërkimit për aspekte sociale të faktorëve dhe shenjëzuesve të emrit, si dhe gjetjet psikolinguistike, etj., me ç'rast kemi edhe përqëndrimin e marrëdhënieve në mes të socioonomastikës dhe dijeve të tjera. Në këtë rrjedhë doemos duhet përmendur edhe faktorë të tjerë me ndikim si: onomastikën gjuhësore, gramatikën, pragmatikën, arealonomastikën, kronologjinë, psikonomastikën, neuroonomastikën, onomastikën statistikore, leksikografinë e emrit etj. Socioonomastika së bashku me onomastikën ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë, arkeologjisë, etnografisë, folklorit, gjeografisë etj., si në rrafshin historik ashtu edhe në rrafshin bashkëkohor.

Edhe pse besohet se fusha e socioonomastikës me onomastikën në thelb është përtej kufijve të gjuhësisë, prapëseprapë ajo është një disiplinë gjuhësore. Pozicioni i gjuhësisë në socioonomastikë dhe socioonomastikës në gjuhësi sigurojnë një temë të madhe trajtimi, sidomos duke pasur parasysh se gjuhësia në dekadat e fundit në mënyrë vendimtare ka ndryshuar, ajo është e vlefshme për t'u marrë parasysh për ndikimin e saj në onomastikë dhe socioonomastikë.

2.3. ONOMASTIKA DHE SOCIOLOGJIA BURIME TË TEORISË SOCIALE

Onomastika është degë e gjuhësisë që studion emrat e përveçëm të vendeve dhe të njerëzve. Përfshin dy fusha kryesore: toponiminë dhe antroponiminë, bashkë me emrat familjarë patronimet. Onomastika shqiptare ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë, arkeologjisë, etnografisë, folklorit, gjeografisë etj. si në rrafshin historik ashtu edhe në rrafshin bashkëkohor. Para Çlirimit disa autorë të huaj edhe ndonjë vendës janë marrë me mbledhje e botime materiale kryesisht nga fusha e toponimisë. Pas Çlirimit kërkimet onomastike u vunë mbi baza shkencore të organizuara. Pranë disa sektorëve të shkencave shoqërore u ngritën edhe kartotekat e para të onomastikës shqiptare.

Fjala onomastikë vë nga fjala greke **Onoma**, që tregon emrin, titullin, emrat e duhur në tërësinë e tyre si dhe të shkencës që merret me studimin e emrave të duhur. Fushë studimi dhe trajtimi ka emrat personalë, antroponimet, emrat gjeografikë, toponimet dhe emrat e fiseve dhe popujve në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Onomastika e gjen vendin e saj në kryqëzimin e shumë disiplinave shkencore, por nga natyra e subjektit të kërkimit është e përshtatshme për fushë të filologjisë.

Sipas studiuesit **Gjovalin Shkurtaj**, onomastika ka qenë gur themeltar për të gjitha hulumtimet dhe shqyrtimet historiko-gjuhësore rreth iliro-shqiptarëve, i cili ndër të tjera thotë: "... nuk mund të mos themi se, në hapat e parë të kërkimeve rreth shpjegimeve historike për gjuhën shqipe dhe në fazat e hershme të zhvillimit të saj, kanë qenë pikërisht emrat e viseve dhe përgjithësisht onomastika e përmendur nëpër mbishkrime, pastaj edhe në shkrime të ndryshme, që kanë pasur rolin e dëshmuesve të pranisë së shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme".¹

Onomastika e çdo pjese të Gadishullit Ilirik ose Ballkanik ka rëndësi të madhe si për historinë e popullit apo kombit tonë shqiptar, po ashtu edhe për historinë e gjuhës shqipe shkruan dr. Rexhep Doçi.²

1. Shkurtaj, Gjovalin, Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë 2001, faq. 7

2. Doçi, Rexhep. Studim i ri mbi pellazgët, RTV 21.2016

Në bazë të onomastikës, deri me tani është shkruar për komunitetin iliro – shqiptar në trojet ku sot jetojnë shqiptarët, por edhe praninë e shqiptarëve në kohën e lashtë.

Fjala sociologji rrjedh nga bashkimi i fjalës latine “**Socius**“ që do të thotë “**Shoqërues**“ dhe fjalës Greke “**Logos**“ që do të thotë “**Shkencë**“, është shkencë e cila merret me studimin e shoqërisë njerëzore dhe të dukurive të saj. Problemet, fenomenet dhe konfliktet shoqërore apo ndërnjerëzore janë pjesa qendrore e studimeve sociologjike.

Sociologjia është studimi i marrëdhënieve dhe institucioneve shoqërore njerëzore. Lënda e sociologjisë është e ndryshme, duke filluar nga krijimi i fesë, nga familja në shtetin, nga ndarjet e racës dhe klasës sociale për besimet e përbashkëta të një kulture të përbashkët, dhe nga stabiliteti shoqëror dhe ndryshimet radikale në shoqëritë në tërësi.

Sociologjia si shkencë e veçantë e mori emrin dhe u inkuadrua në sistemin e shkencave në vitet e dyzeta të shek XIX.³ Lindi në procesin e zhvillimit të shoqërisë nga forma e përparshme e vetëdijes njerëzore. Karakterin e këtij procesi e ka theksuar drejt **Spenseri** kur tha se ai shkon prej homogjenes kah heterogjenja, d.m.th. se në procesin e zhvillimit shoqëror zhvillohet proces gjithnjë e më i madh i diferencimit dhe specializimit të vetëdijes shoqërore.⁴ Forma e parë e re e vetëdijes që në zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë u nda nga kjo formë e padiferencuar, ishte filozofia. Shkaku i drejtpërdrejt i këtij diferencimi është grumbullimi i njohurive pozitive mbi dukuritë dhe sendet e ndryshme të natyrës dhe të vet shoqërisë. Grumbullimi i elementeve të njohurive është i kushtëzuar nga procesi i prodhimit dhe zhvillimit të forcave prodhuese. Njeriu mund të depërtojë në natyrë, ta njohë atë gradualisht, ta zotërojë vetëm me anë të forcave prodhuese. Kështu, mbase do të konceptonim mbi shoqërinë në historinë dhe filozofinë antike⁴.

Është socioonomastika ajo e cila si grumbulluese e elementeve risimtare të dijeve të paidentifikuara deri me tani na paraqitet si formë e re e vetëdijes shoqërore.

Këtu mund të vërejmë unifikimin *socio* dhe *onomastik* në studimin e përbashkët të këtyre subjekteve të ndryshme të studimit, të të kuptuarit si veprim njerëzor dhe formave të reja të formuara nga strukturat kulturore dhe sociale, duke evidentuar veprimet sociale onomastike dhe duke i studiuar ato në gjirin e shoqërisë njerëzore, duke vënë në pah ndërveprimet e tyre dhe proceset që i ruajnë dhe i ndryshojnë ato.

3. www.slideshare.net/.../sociologjia

4. Edmund. Spenser London. 1611. First folio edition of Spenser's collected works

Hasim dy kënde analizash dinamike të pjesëve përbërëse të shoqërisë, të tilla si institucioni, komuniteti, popullsia, aspektet gjinore, racore apo grupmoshat, statusi social apo stratifikuara, lëvizjet sociale dhe ndryshimet shoqërore, po ashtu edhe çrregullimet shoqërore në formën e ndryshimeve për interesa më të mëdha kërkimore, e hasim këtu po ashtu socio dhe onomastikën e profesioneve, të punës, të kulturës dhe dijes si dhe të teorisë sociale.

Historia e emrave lidhet ngushtë me historinë e popullit (pasqyron marrëdhëniet fisnore, zgjerimin e marrëdhënieve fisnore, lidhjet familjare, zgjerimin e marrëdhënieve me publikun, klasat sociale, strukturën e shoqërisë, si dhe ndryshimin dhe zhvillimin e saj në institucione, në kulturë dhe kështu me radhë.

Tashmë të dhënat e para të shkruara të popujve të ndryshëm kanë përcaktuar ekzistencën e emrave personalë dhe fisnorë që në kohët e lashta, të cilët gradualisht edhe ndryshuan me zhvillimin e shoqërisë, në sisteme dhe vende të ndryshme, kështu për shembull, ndër të tjera, qytetari romak kishte një emër personal (praenomen), emrin e familjes (nomen) dhe pseudonim (mbiemër) të rregullt, dhe i njëjti është emri gjenerik, kurse te qytetarët grekë emri personal i është bashkëngjitur emrit të babait (p.sh. Perikliu, bir i Xanthippe), emra të veshur kështu me karakterin klasë me klasë.

Që në kohërat më të lashta, emrat dhe mbiemrat që dalin më vonë, të gjurmuar zakonisht prapa tyre, kanë dalë nga fenomene natyrore, nga objekte të kulturës materiale, nga fenomene të jetës, familjes, të profesionit, nga socio –fenomenet, politikanët, gjeografia, emra nga karakteristikat individuale të një personi, nga koncepti i besimit, adhurimit dhe ideologjisë dhe të tjerët.

Socioonomastika trajton studimin se si gjuha na shërben për emërdhënie dhe se si është formuar nga natyra sociale e qenieve njerëzore. Në konceptimin e saj më të gjerë socioonomastika tok me sociolingustikën analizojnë mënyrat e shumta dhe të ndryshme të gjuhës dhe të shoqërisë të cilat në vijimësi janë të ndërthurura. Kjo fushë e gjerë e hetimit kërkon dhe kombinon njohuri nga disa disiplina duke përfshirë gjuhësinë, sociologjinë, psikologjinë, antropologjinë etj.

Socioonomastika është njësi themelore për ndërveprimeve sociale, e ndikuar nga ndryshimet shoqërore dhe e prekur prej tyre, duke treguar e analizuar njëherit edhe shumë mënyra në të cilat gjuha dhe shoqëria bashkëveprojnë, në qendër të tyre të interesit si një

pikë referimi dhe duke shqyrtuar lidhjet midis tyre nëpër kohë dhe duke u bazuar në një studim dy komponentësh. Në vazhdimësi janë bërë përpjekje për të sqaruar se si emrat dhe zgjedhja e tyre e parë mund të japin kuptime të ndryshme sociale. Përmes variacioneve në emërvënie, në shtresëzime shoqërore shpjegohet më së miri edhe dëshira e prindërve për t'u identifikuar e socializuar me shoqërinë, si një kontributim në krijimin e modeleve të ndryshme për të, në të cilin vlerat shoqërore të ndryshme dhe atributet janë një çështje e rëndësishme.

Janë evidente emërvëniet nga strukturat e mbiçmuara makro - shoqërore dhe aspektet internacionale të ndikuara nga pozicionime sociale.

Përmes emërtimeve identifikojmë ndryshimet shoqërore në rrafshin real dhe teorik si një kombinim onomastik gjuhësor dhe sociolinguistik të teorive socioonomastike.

Nga një këndvështrim shqyrtimi, pas analizimit të antroponimeve nga terreni, me përfshirje të gjerë hapësinore territoriale, mund të përafrojmë mendimin se prindërit në Pejë dhe jo vetëm në Pejë, në fillim të këtij shekulli janë duke përdorur procesin e emërimit si një burim për të kontribuar në krijimin e identiteteve të ndryshme për njerëzit, veten e tyre dhe fëmijët e tyre. Këtë konstatim e mbështes në një anketë të bërë në terren, në disa fshatra të Pejës me rrethinë si dhe në disa intervista cilësore në grup ku kam përfshirë prindërit me fëmijët e lindur gjatë vitit 2002 dhe 2012. Duke kombinuar këto burime të ndryshme (emrat, anketat dhe intervistat) dhe metoda të ndryshme (sasiore dhe cilësore), ky studim paraqet një përpjekje për të sqaruar se si emrat me zgjedhje dhe emrat e parë na japin kuptime të ndryshme sociale. Nuk mund të bëjmë ndonjë krahasim apo qasje risimtare të kësaj çështjeje në mungesë të studimeve të mëparshme socioonomastike, por ky studim konsideroj se përmban emërtimin e fëmijëve për këtë periudë të caktuar përplot me ndryshime shoqërore, si një koncept të ri socioteorik, mbështetur në një kombinim onomastik gjuhësor dhe sociolinguistik për identitetet - teorike dhe të teorive interaksionale. Rezultatet demonstrojnë se zgjedhja e prindërve për emrin e parë për fëmijën e tyre është një çështje e rëndësishme e aktit social. Nëpërmjet zgjedhjeve për emrin dhe diskutimeve për këto zgjedhje prindërit kanë krijuar atë që njihet si pozicionimin social, e cila nga ana e vet do të kontribuojë në krijimin e identitetit për veten dhe fëmijët e tyre. Kam vënë re një numër të burimeve të identifikuar të cilat janë përdorur nga prindërit për të krijuar pozicion tjetër social në shoqëri në sfera të ndryshme.

2.4. SOCIOONOMASTIKA DHE SOCIOLINGUISTIKA

Ekziston një traditë e lashtë e studimit të dialekteve dhe studimit të raporteve midis kuptimit të fjalëve dhe kulturës, gjithnjë nga qasja sociale. Fillimisht, socioonomastika në përgjithësi është në fazën nismëtare, qoftë për vështirimin e diversitetit shoqëror në bashkësi shoqërore dhe etnokulturore heterogjene, ku bën pjesë edhe fusha e studimit tonë, qoftë për varietetet, rrethanat shoqërore, përmasat, aspektin social të drurit gjenealogjik, dilekteve krahinore dhe izoglosave, përhapjes së teorisë së valëve etj., po edhe diferencat shoqërore dhe sjelljet shoqërore, moshën, seksin (gjininë natyrore), grupin etnik, klasën ekonomiko – shoqërore, nivelin e arsimit, kushtëzimet shoqërore, faktorët etj., që duhet hulumtuar në të ardhmen, kurse studimet sociolinguistike në fakt janë vazhdimësi e studimeve dialektore të ndërmarra në Europë, ShBA e gjetiu gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Kalimi nga studimet dialektore në studimet sociolinguistike është i ndërlidhur me përfshirjen në anketim të respondentëve nga qendrat urbane, krahas modelit tradicional dialektologjik të gjetjes së informatorëve në zonat më të thella të izoluara rurale, të cilët kërkoheshin izoglosat e caktuara. Ky element ka ndikuar që në studimet dialektore të dalë në shesh edhe ndikimi i faktorëve shoqërorë në ligjërime, pikërisht për faktin se shtresëzimi shoqëror i qendrave urbane është shumëdimensional. Elementet e para të studimeve gjuhësore që marrin parasysh ndikimin e faktorëve shoqërorë i gjejmë në studimet e autorëve indianë dhe japonezë, por sociolinguistika e mirëfilltë mund të thuhet se fillon me studimet e gjashtë studiuesve, të cilët mund të konsiderohen si pionierë të sociolinguistikës. Në këtë mes, në radhë të parë duhet përmendur **William Labov**, i cili me punimet e tij të para në fushën e sociolinguistikës sasiore në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar konsiderohet si themelues i kësaj disipline. Përveç tij, themelues të sociolinguistikës mund të konsiderohen edhe sociologu britanik **Basil Bernstein**, i cili me punën e tij mbi kodet e ndërlidhura me klasat hapi shtigje të rëndësishme për studimet sociolinguistike. Autorët e tjerë që ndihmuan në konsolidimin e kësaj disipline janë: **Dell Hymes**, i cili formësoi të ashtuquajturën “etnografi të komunikimit”, **John Gumperz**, i cili mund të konsiderohet si themelues i sociolinguistikës interaksionale, si dhe **Charles Ferguson** dhe **Joshua**

Fishman të cilët zgjeruan edhe më tej hapësirat e studimeve sociolinguistike, duke përfshirë trajtimin e varieteteve gjuhësore dhe dukurive që ndërlidhen me raportet midisi varieteteve gjuhësore. Të gjithë këta autorë, përveç Bernsteinit, ndonëse edhe ai ishte i ftuar, qenë të pranishëm në Institutin Gjuhësor në Bloomington, në verën e vitit 1964, ngjarje kjo që i dha shtytje studimeve sociolinguistike. Këta autorë, të cilët ndonëse tashmë mund të quhen klasikë, mbeten të patejkaluar në studimet sociolinguistike. Autorë të tjerë si Peter Trudgill, Lesley e James Milroy, Walter Wolfram, Nikolas Coupland, Deborah Tannen, Norman Fairclough e të tjerë, me punimet e tyre ndihmuan në avancimin e sociolinguistikës si disiplinë shkencore. Përndryshe, duket që për herë të parë termin sociolinguistikë ta ketë sajuar më 1939 Thomas Callan Hudson.¹ Sot sociolinguistika është disiplinë që ka arritur përparime e rezultate të shumëta studimore dhe ka konsoliduar metodologjinë kërkimore, sidomos në ShBA dhe në Europën Perëndimore. Përveç gjuhësisë, ajo ndërthuret edhe me disiplina të tjera shoqërore si: sociologjia, psikologjia, antropologjia, etnologjia e socioonomastika, gjë që ka ndikuar që kjo disiplinë të marrë karakter me të vërtetë interdisiplinar. Krahas problemeve dhe çështjeve tashmë tradicionale nga fusha e politikës dhe planifikimit gjuhësor, nga fusha e kontakteve të gjuhëve në kuadrin e sociolinguistikës sot trajtohen edhe çështje të variacionit gjuhësor, të varieteteve e të stileve funksionale, problemeve të gjuhës, kulturës e mendimit si dhe çështjeve e problemeve nga fusha e sociolinguistikës interaksionale dhe të analizës së diskursit. Me fjalë të tjera gama e interesimeve sociolinguistike përfshin pothuajse çdo modalitet të ndikimit të faktorëve shoqërorë, kulturorë e psikologjikë në ligjërimin e individit dhe të grupeve të ndryshme shoqërore. Në ShBA dhe në Europë, sociolinguistika zë vend qendror në planet dhe programet e institucioneve të ndryshme universitare dhe instituteve të ndryshme të cilat në kuadrin e tyre kanë edhe departamentet e gjuhësisë.

1. Munishi. Shkumbin, 2013. Studime sociolinguistike të shqipes

2.4.1. Gjendja e sotme e studimeve sociolinguistike dhe socioonomastike

Rëndësia e fushës së studimit tonë socioonomastik, trajtimin social onomastik, e bazuar në bashkëpërkimet reciproke sociolinguistike edhe pse deri më sot të pa hulumtuara, duhet vështruar nga këndi i gjendjes aktuale të të dyja shkencave, jo nga zyrat, por nga rezultatet e punës empirike në terren, ngase që të dyja janë shkenca sa empirike aq edhe teorike. Në Pejë me rrethinë shtresa shoqërore nuk ka qenë fare e privilegjuar, andaj, kurdoherë munguan edhe projektet kërkimore, e gjitha që na vie prezanton interesin praktik të kërimit të individëve të caktuar, kështu edhe interpretimet e dala nga këta individë të cilët përgjithësisht bazoheshin në përvojën personale kanë sjellë edhe rrezikshmërinë, gjë që në të shumtën e rasteve mund të ishin të gabuara. Sa i përket studimeve sociolinguistike në fushën e shqipes, ato janë krejt të pakta dhe nuk mund të flitet për një disiplinë të konsoliduar studimore në gjirin e shqipes. Në bibliografinë e studimeve albanologjike mund edhe të hasësh shpesh tituj punimesh që përmbajnë atributin “sociolinguistik”, por në shumicën e atyre punimeve ka pak ose aspak sociolinguistikë, gjë që nuk mund të themi edhe për “socioonomastikën” sepse ajo rezulton me deficit të plotë. Përderisa bëjmë një kërkim në Google duke përdorur fjalët kyçe “studime” (studies), “sociolinguistike” (sociolinguistics) dhe “shqipe” (Albanian) dhe literatura kryesore e vetme që shfaqet është një publikim i veçantë, nr. 178, i revistës “International Journal of the Sociology of Language”, revistë që ka si kryeredaktor sociolinguistin e mirënjohur **Joshua A. Fishman**, me titull: "Sociolinguistic Studies on the Albanian language" (2006). Në këtë botim, i cili është redaktuar nga Eda Derhemi dhe Pandeli Pani, janë të përfshirë disa punime të autorëve të ndryshëm shqiptarë e të huaj, si: **Gjovalin Shkurtaç, Bahri Beci, Eric P. Hamp, Eda Derhemi, Pandeli Pani, Basil Schader, Xheval Lloshi, Jani Thomaj, Rami Memushaj, Mustafa Ibrahimimi dhe Wilfried Fidler**, shumica e të cilëve nuk shquhen për ndonjë fokusim të veçantë në fushën e sociolinguistikës, kurse socioonomastika edhe këtu paraqet varfëri të plotë. Çdo kërkim tjetër për referenca lidhur me studimet sociolinguistike dhe socioonomastike në fushën e shqipes rezulton mjaft i varfër. Së fundi, po ashtu meriton të përmendet studimi përmbajtësor i dr. Hasan Mujaj, *Kërkime Sociolinguistike*, Prishtinë 2012, me gjithsej 283 faqe, që mbase është i pari i llojit të tillë.

2.4.2. Hapësirat e mundshme të hulumtimeve sociolinguistike dhe socioonomastike

Pasqyra e studimeve sociolinguistike dhe socioonomastike dëshmon qartë se këto dy disiplina të reja shkencore vazhdojnë të mbetet në fillimet e tyre, pa shenja të dallueshme të një përparimi modest. Deri më tani kanë mbetur fushë e interesimeve të kufizuara individuale në të cilat mungojnë studimet sistematike, por edhe ekipore. Sot, bota shqiptare, areali shqipfolës në Ballkan dhe diaspora, paraqesin një parajsë më vete për studime sociolinguistike dhe socioonomastike, pikërisht për shkak të gjendjes politike, ekonomike e kulturore të trojeve shqiptare. Ambienti kulturor e politik në të cilin jetojnë shqiptarët, në Shqipëri e Kosovë, por edhe në Maqedoni, Mal të Zi e në diasporë, aktualisht paraqet një burim të pashtershëm për shfaqjen e dukurive të ndryshme sociolinguistike dhe socioonomastike. Prandaj, studimi i tyre do të ishte me interes dhe dobi të veçantë. Zhvillimi i këtyre disiplinave nënkupton braktisjen e studimeve tradicionale dialektore që edhe ashtu kanë ngecur dhe përqëndrimin në studime të varieteteve të ndryshme të shqipes, me theks të veçantë në studimin e vernakularëve urbanë, të regjistrave e stileve të tjera funksionale të shqipes si dhe të vështrimit social të të gjitha pikëpamjeve në fokus. Gjuha është njësi themelore e ndërveprimeve sociale, që ndikojnë mbi ta dhe duke u prekur prej tyre. Connie Eble ² i Universitetit të Karolinës së Veriut shpjegon se si fusha e sociolinguistikës analizon shumë mënyra në të cilat në gjuhë dhe shoqëri ndërpriten. Sociolinguistika është studimi se si gjuha shërben dhe është formuar nga natyra sociale e qenieve njerëzore. Në konceptimin e saj më të gjerë, sociolinguistika analizon mënyrat e shumta dhe të ndryshme në të cilat gjuha dhe shoqëria janë ndërthurur. Kjo fushë e gjerë e hetimit kërkon dhe kombinon njohuri nga disa disiplina, duke përfshirë gjuhësinë, sociologjinë, psikologjinë, antropologjinë dhe fushën e studimit tonë socioonomastikën. Sociolinguistika shqyrton ndërveprimin e gjuhës dhe shoqërisë me gjuhën si pikënisje. Variacioni është koncepti kyç, aplikuar në gjuhën e vet dhe të përdorimit të saj. Premisa themelore e sociolinguistikës është se gjuha është e ndryshueshme dhe ndryshon. Si rezultat, gjuha nuk është homogjene - jo për përdoruesit individualë dhe jo brenda ose midis grupeve të folësve që përdorin të njëjtën gjuhë.

2. Connie Eble, englishcomplit.unc.edu/.../ebl.

Socioonomastika përcjellë ndryshimet, duke përcjellë veprimet gjatë ndryshimeve, si për individin ashtu edhe për grupet e folësve të së njëjtës gjuhë. Socioonomastika studion praktikat brenda shoqërive të caktuara, gjithashtu shqyrton se si gjuha dhe shoqëria kanë ndërvepruar në të kaluarën. Për shembull, përemrin njëjës ti dhe zëvendësimin e tij me shumësin ju, frekuencë ndryshimi kjo në strukturën e klasës në shek.16 dhe 17. Kjo është socioonomastika historike: studimi i marrëdhënieve në mes të ndryshimeve në shoqëri dhe ndryshimeve në gjuhë gjatë një periudhe të caktuar kohore.

Duke kundruar socioonomastikën historike na mjafton një fjalë e vetme, e rrallë, e trevave të Rrafshit të Dukgjitit, për të vënë dritë mbi shumë aspekte dhe të dhëna që i sipërpërmendëm, fjalën prâj, sqarimi ynë: vend pushimi për kalimtarët, të cilët pushonin në vazhdimësi në këtë praj's, një rrënjë lisi, e madhe, e lespituar, natyrale, në rrugën këmbësore nga fshati Dugajevë për në shatin Kuçishtë (treva e Rugovës), për të sqaruar shumëçka si: Rugova është një zonë malore e izoluar nga bota, me male të larta, si vendi i prajsës, pushimit gjatë rrugëtimit të gjatë nëpër rrugën këmbësore, këmbë e me kuaj, ku njëkohësisht paraqiten kushtet e rënda shoqërore, kushtet shumë të vështira ekzistenciale etj., rrugëtimin për të furnizuar me ushqim familjen nga vendblierjet më të afërta etj.

Për të qartësuar pikëpamjet tona mund të orientohemi bie fjala te burgosjet politike, që ishin shumë të theksuara, vitet e gjata të burgimeve, jetës parapa grilash, shpërngulja për në qytete të tjera dhe fshatra e një pjese të familjeve, kanë qenë faktorë shtytës socialë për ndryshime të varieteteve dhe motërzimit me varietete të tjera, varësisht nga elementi situativ, kështu pra, kanë ndryshuar edhe praktikat e emërtimeve, ashtu si edhe në të gjithë shoqëritë dhe kështu shpesh janë hapur dyert e identiteteve të tjera kulturore, për shembull, në shumicën e emrave të rinj, mbizotëron fryma e kulturave perëndimore, sepse afro 30 % e pejanëve jetojnë në perëndim, madje edhe në kuptimin leksikor, ndërsa në shumë grupe të tjera kulturore, si në mesin e njerëzve vendas, kuptimi i emrave për ta është vendimtar, i besueshëm, si të tillë prezantoj rastin e familjes Bytyqi nga Poqesta e cila jeton në Manhatan, New York, ShBA, që emërvënien edhe sot e gjithë ditën e konsiderojnë të shenjtë, duke ruajtur me fanatizëm emrat nga vendlindja, por supozoj se këto praktika mund të ndryshojë me kalimin kohor. Në aspektin social, mund të theksojmë se emrat nuk janë vetëm etiketa, por para se gjithash emrat kanë kuptimin shoqëror dhe si të tillë, emrat personalë, na ndihmojnë për të kategorizuar njerëzit, për të identifikuar anë

të veçanta të gjinisë, gjuhës, klasës, fesë apo kulturës. Nëse praktikat e emërimit janë të varura në shoqërinë dhe kulturën ekzistuese, atëherë shtrohet pyetja se çfarë do të ndodhë me emërimet kur janë transplantuar, bartur në një tjetër shoqëri, në një traditë tjetër të vënies së emrave? A janë praktikat e dallueshme të emërimit apo edhe përdorimi praktik autokton ka humbur nga pikëpamja sociale e përdoruesit dhe i njëjti është asimiluar në një kulturë tjetër? A do të vazhdojë të mbetet i paprekur edhe pse është larguar nga përdorimi praktik autokton? A mos po evoluojnë në lidhje me situatën e re? Në këtë studim një hulumtim i detajuar për këto pyetje direkte do të referonte përgjigje përmes një analize më të hollësishme të praktikave të emërimit. Në mënyrë të veçantë duhet hetuar socio aspektet emërtuese në komunitetet e reja përkatëse, emri i dhënë në lindje a paraqet ndonjë referencë njerëzore aderimi për komunitetin, cila është vlera sociale e tij, a është emërvënia si rezultat i migrimit etj. Bazuar në praktikat brenda komunitetit të caktuar, emrat e tillë na dalin të luhatshëm dhe se nuk kanë shpjegim adekuat social për mjedisin, i përkasin një rrethi tjetër mjedisor dhe si të tillë dalëngadalë zhbëhen, zbehen, humbin autoktoninë etj., por edhe në këto raste kemi përjashtime të vogla, bie fjala, nëse bartësit e emrave të caktuar, të kulturës pejane në këtë rast, në rrethin e ri shoqëror në të ardhmen do të shquhen, gjë që kohën e fundit kemi mjaft raste, në të gjitha poret e jetës dhe në shumë divergjenca kulturore, atëherë vështirimi social i mjedisit të ri do të rifunksionalizohet dhe emri i ri do të krijojë pikëpamje të reja sociale jo vetëm për të por edhe për pararendjen e tij, qoftë edhe nëse daton si mjaft e hershme. Një riaktualizim i tillë mund të sogjohet vetëm nga këndi socioonomastik. E njëjta gjë nuk mund të ndodhë edhe me gjuhën, sepse tashmë bartësi i emrit nga vendlindja, i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile ka lënë gjurmë administrative, por njëkohësisht gjatë ecjes së tij nëpër kohë, njëherit ai është socializuar me gjuhën e komunitetit ekzistues aq sa vështirë se mund të devijojë. Në të shumtën e rasteve të tilla mund të hasim edhe në pasiguri gjuhësore. “ Pasiguria shfaqet nga çasti kur folësi ka një vetëdijësim si për varietetin institucional (përgjithësisht standardi i cili ka të bëjë me normën subjektive), ashtu edhe për përdorimet e veta (norma objektive), të cilat bien ndesh me këtë normë (subjektive)”.³

Karakteristikat gjuhësore të tij dhe gramatika e përdorur do të jenë kryesisht nga klasa në të cilën jeton dhe vepron, gjë që do të vërehet edhe në pore të tjera jetese si muzikë, argëtim, sport dhe veshje. Nëse bashkëmoshatarët e tij, saj do të flasin për stilin e ndonjë

emri të njohur, kjo e thënë do të formësohet edhe nga ai ose ajo. Me kohën, të rinjtë tanë do të vazhdojnë të përdorin edhe mënyra të tjera dialektesh, dialekte të tjera nga mjediset sociale ku jetojnë. Një gjë e tillë do të përcjellë edhe emrat në të ardhmen. Edhe pse do të zbehet ndikimi gjuhësor autokton, nuk ka rrezik të humbjes së afërt të gjuhës në përgjithësi nga folësi. Për arsye praktike shpesh po e konsiderojnë veten si pjesëtarë të komunitetit ku jetojnë e veprojnë dhe ky element pa dyshim paraqet një shkallë të rrezikshmërisë në pikëpamjen sociale.

Socioonomastika vazhdon së kërkuari për të gjetur se çfarë është me të vërtetë në një emër dhe për të hetuar njohuritë kulturore, historinë e shlyerjes dhe karakteristikat gjuhësore të shpallura në emra, gjithnjë në vështrimin social, pra, kjo disiplinë shkencore ka mjaft afri dhe puqitje me sociolinguistikën, por me një qasje tjetër të hulumtimit dhe rezultateve. Vetëm në dekadën e fundit janë shtuar interesimet për trajtimin e problemeve të shqipes nga këndi sociolinguistik dhe socioonomastik.

2.5.SOCIOSEMIOTIKA SI SHTYSË EMËRTIMESH

Semiotika ose, siç quhet ndryshe, teoria e shenjave gjen zbatim dhe integrim në një numër të madh shkencash si p.sh. stilistika, onomastika, fonetika, teoria e komunikimit, sociosemiotika, psikologjia, antropologjia, retorika, semantika, mediet, arkitektura, shkencat e letërsisë e shumë të tjera. Ajo është me rëndësi edhe për fushën e kërkimit tonë. Mund të thuhet se semiotika është më se e mbëhishme në kundrimet toponimike e antroponimike dhe është ajo shkencë, e cila hulumtimet i shpuri në drejtimin pragmatik.¹ Së këndejmi del e kuptueshme se pa gjurmimet sociosemiotike nuk mund të flitet për studimet e avancuara socioonomastike.

Studiuesi **Grajmasi, Veroni**² etj, me të drejtë kanë vënë re se sociosemiotika do parë në ndërlidhje të ngushtë me etnosemiotikën dhe me emërtesat onomastike.

Fushat parësore të hulumtimit të sociosemiotikës janë temat sociale të jetës ndër të cilat vend qendror zënë: mënyrat dhe rrethanat sociale të jetës, fushat e veprimtarisë si bazë e ekzistencës së popullatës, shtresat shoqërore dhe treguesit sociosemiotikë, të cilët pasqyrohen ose nënkuptohen edhe në shtysat e sajësive të terminologjisë onomastike. Semiotika nuk merret vetëm me shenjat, por ajo ndjek nga një kënd i saj edhe teorinë e kuptimit tek piqet me semantikën³.

Studimet moderne të onomastikës, për zbërjet sa më të thella, duhet të kundrohen edhe nga këndi socioonomastik. Mund të thuhet se në këso gjurmimesh deri më sot nuk është ndjekur një ecure e këtillë hulumtimi në onomastikën shqiptare. Kjo ngjet nga fakti se kërkimet shkencore nuk janë zhvilluar në dritën e dijeve të ineguara, ecure kjo që sot ndiqet në metodologjinë e hulumtimeve të shkencave të avancuara europiane dhe amerikane. Socioonomastika heton e zbërthen shtysat sociale të emërtimeve onomastike, të cilat përfaqësojnë edhe përbërësit etnopsikologjikë të jetës e të veprimtarisë në krahinën përkatëse. Në krahinën e gjurmimit tonë socioonomastik mund të gjenden shumë emërtime onomastike, të cilat përmbajnë tregues jo vetëm onomastikë, porse edhe tregorë me interes sociolinguistik dhe sociodemiologjik.

1. Winfried Noth, Handbuch der Semiotik, Stuttgart, 2000.

2. Po aty.

3. Mujaj, Hasan. 2011. Semiotika dhe zhvillimi i saj, Prishtinë

Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se shumë antroponime sajojnë një segment të komunikimit social, i cili, në rrjedhën e kohës, në pjesën dërmuese ka pasur evoluime të ndryshme dhe e ka humbur anën burimore të semantikës së dikurshme. Megjithëkëtë, për studimet sociolinguistike është me interes identifikimi i faktorëve shoqërorë që shërbejnë si mbështetje dhe si bindje për emërtime të këtilla.

Në antroponiminë shqiptare dikur ishte mjaft i përhapur emri mbi bazën e bishës së egër ujk dhe antroponimi Ujk-a. Ky antroponim përdoret edhe në trajtën e gjinisë femërore Ujkije, sidomos në krahinat veriperëndimore të të folmeve shqipe, gjë që do të trajtohet në fushën e antroponimisë. Nga ana sociolinguistike, në dijen e antroponimisë, është me interes shkencor të ndiqen shtysat sociale të vënies së emrave dhe ato janë të ndryshme aq sa janë të ndryshme edhe grupet dhe shtresat shoqërore si dhe botëkuptimet e tyre. Në emërvënien e njerëzve mund të hetohen edhe ngërthesat diatopike dhe diastratike.

Kështu, kundruar nga ana diatopike, antroponimet metaforike: Bjeshkë, Mal, Lise etj. janë vënë më shumë në viset malore, atje ku rrethanat sociale të jetës ishin më të vështira dhe imponohej edhe qëndresa fizike për t'i përballuar kushtet e jetës dhe të veprimtarisë në klimën e ftohtë të viseve të larta malore. Do vënë në dukje se emra të këtillë nuk janë vënë në qytete dhe vendbanime urbane, porse në ato më anësore nën ndikimin diatopik social. Edhe aspekti ndërshtresor ka reflekset edhe në fushën e antroponimisë.

Simotra e sociolinguistikës etnolinguistika ngërthen në vete botëkuptime, të cilat, me vite të tëra, në rrjedhën e kohës, janë shtresëzuar në ndërdijen njerëzore. Këto botëkuptime shtrihen në fusha të ndryshme të veprimtarisë ndër të cilat edhe antroponimia zë një vend të rëndësishëm ashtu sikundër edhe shumë veprime të tjera të jetës, të punës, të familjes etj. Shtysa të disa emërtimeve dhe veprimeve që mbështeten në besimet e së kaluarës mund të vihen re në antroponiminë etnolinguistike dhe në rite të ndryshme që dikur zbatoheshin në shumë vise të etnisë shqiptare.

Gjithnjë mbi motivin e besimeve kanunore, nga fusha e etnolinguistikës, mund të gjenden edhe emërtime të tjera që u referohen bashkëshortëve si p.sh. “ hej, ky, hejo, ai” që gruaja përdorte për ta ftuar burrin dhe “more, mori, ori, oj, kjo, ajo” që burri përdorte për ta thirrur gruan pasi konsiderohet si “turp” që burri e gruaja të thirreshin në emrat që mbanin.

Tregues etnolinguistikë janë edhe antroponimet: Bjeshkë, Mal, Lis, Lise, etj., të cilët në ndërdije përmbledhin kuptimin e njerëzve fizikisht të mëdhenj, të zhvilluar, të qëndrueshëm. Ky konstatim nënkuptohet edhe nga krahasimi i femrës ose i burrit me lisin, bjeshkën, malin etj.

Antroponime mbi bazën e pargjykimeve dhe besimeve janë edhe emrat: Sose, Shkurtë, Dnore; antroponime të njëjta me emra kafshësh: Shytë, emër femre, por edhe emër pa brirë; Shytan për gjininë mashkullore, njeri dhe dash, Galë, Galo, Sykë etj., antroponime këto që tregojnë edhe rrethanat sociale të jetës, sidomos në viset malore ku burim kryesor i ekzistencës ishte fusha blegtorale.

Një tregues tjetër sociolinguistik dhe etnolinguistik është edhe veprimi sipas kriterëve kanunore në familjet ku mbizotërojnë konceptet konservative: në disa fshatra më të izoluar, në oda burrash e më gjerë në bashkësinë gjuhësore. Sipas këtyre koncepteve femrave dhe fëmijëve në familje dhe në rrethin më të gjerë shoqëror u mohojë e drejta e fjalës, e shprehjes së mendimit të lirë madje edhe në rastet që lidheshin drejtpërdrejt me jetën dhe të ardhmen e tyre si p. sh. fejesa, martesë etj. Ky qëndrim absolut kishte si rrjedhojë edhe deficitin e shprehjes gjuhësore, varfërinë e fjalorit dhe krijimin e dallimeve sociale nga gjinia, mosha etj.

Duke përfillur rregullat e egra kanunore, femra duhej vetëm të shërbente, të qëndronte në këmbë për të shërbyer sipas kërkesave të burrave; po kështu edhe fëmijët duhej të uleshin në fund të dhomës, të mos flisnin, të mos hynin në oda burrash etj. Kështu rregullash zbatoheshin në rrethi familjar.

Diçka analoge praktikoheshin në nivelin më të lartë të bashkësisë shoqërore, në shkallë lagjeje, fshati etj. po kështu ekzistonin kriteret e rrepta kanunore sipas të cilave secili nuk kishte të drejtë fjale. Oda e burrave kishte semiotikën e caktuar ashtu sikundër sallat e parlamenteve shtetërore dhe ajo duhej respektuar. Sipas kriterëve sociale, balli i odës u takonte burrave më të moshuar, atyre që kishin emër të respektuar për vepra të mëdha etj. Edhe nga kjo pikëpamje krijohej shtresëzime individësh e grupesh si dhe kriterë se kush duhej të fliste, kush të dëgjonte, kush të shërbente në odë etj.

Nga fusha e antroponimisë me interes sociolinguistik është edhe përdorimi hipokoristik i emrave vetjakë – një dukuri kjo në antroponiminë shqiptare. Ndryshimet e trajtave

parësore të emrave të njerëzve kanë si pikënisje motivet sociolinguistike dhe etnolinguistike.

Si arsye të ndryshimit të emrave me ndajshesa ose me shkurtime trajtash, studiuesit kanë parë faktorët jashtëgjuhësorë që mbështeten në shtysat afektive të rrethit të ngushtë familjar nga burojnë rimeërtimet kryesisht nga fëmijëria e hershme kur prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes së gjerë bëjnë shtojca të reja dhe modifikime emërtimeësh antroponimike.

Në këtë mënyrë shtresa më pak e arsimuar dhe më e varfër nuk ndjek ndryshimet dhe arritjet e reja shoqërore në fusha të ndryshme, prandaj edhe në këtë pikëpamje është më tradicionale, më konservative dhe më pak inovuese. Ajo, nën ndikimin e kushteve të vështira sociale, nuk paraqet risi as ndryshime as në dijen e antroponimisë dhe kështu përdor emra më tradicionalë.

Nga ana tjetër shtresa shoqërore me standard më të lartë të jetës dhe më e arsimuar paraqet risi dhe avancim edhe në aspektin e vënies së emrave duke përsorur një spektër më të gjerë dhe më domethënës antroponimesh. Pra, treguesit sociolinguistikë janë të pranishëm edhe në dijen e onomastikës.

Edhe emërvendet, edhe antroponimet shpeshherë mund të merren si indeksorë të shtresave sociale dhe të veprimtarisë së tyre dhe kështu paraqesin interes edhe për gjurmimet sociolinguistike.⁴

3. E FOLMJA E PEJËS

E kaluara e gjuhës, e sotmja dhe e ardhmja e saj janë periudha të rëndësishme të një sistemi gjuhësor gjithëkombëtar, që më në fund ka rezultuar me një gjuhë të njësuar, e cila ka arritur në nivel standardi.

Gjuha luan rol të rëndësishëm në jetën e përditshme, atë e përdorim me kompleksitetin më të madh në mendimet dhe idetë tona, andaj është e vështirë të imagjinohet një ditë e tërë pa përdorimin e saj. Gjuha është kudo në shoqërinë njerëzore, përtej çdo kulture.

Për shumicën e njerëzve, gjuha është një aftësi e lehtë që kanë marrë njerëzit para se të mësonin se si të vishnin veten.

Në vazhdimësi duhet të kemi kujdes të shtuar gjatë përdorimit të gjuhës, sepse një pjesë e rëndësishme e mendimeve tona përfshihen në një lloj monologu të brendshëm. Megjithatë, gjuha nuk është e thjeshtë, në fakt ajo është mjaft komplekse dhe ne duhet të jemi në gjendje të përdorin atë sa më shpejt, koha e saj është aq e rëndësishme sa edhe vonesat më të vogla gjatë përpunimit të gjuhës mendohet të jenë me pasoja të thella. Ajo na krijon mundësi për të hedhur dritë mbi mënyrën e të menduarit tonë.

Zakonisht gjen përdorim të shpejtë te ne, jo e normësuar, sepse normat ndryshojnë në mesin e folësve dhe gjuhëve, mesatarisht njerëzit duhet të merren me rreth 2 deri 3 fjalë në sekondë, që është afërsisht 5 deri në 6 rrokje ose 25 deri në 30 tinguj individualë për sekondë. Ndoshta kjo nuk është e habitshme në kushte normale, me koeficientë normalë të inteligjencës, me përgatitje të duhur shkollore.

Një vështrim të detajur për gjuhën e hasim edhe te sociolinguisti Mustafa Ibrahim, i cili mes të tjerash citon: “Akti i krijimit dhe pranimit të një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët, është kuptuar si një vlerë e patjetërsueshme kombëtare. Kjo vërehet edhe në paraqitjen e vështirësive dhe problemeve që kanë dalë e që dalin në rrugën e përvijimit të saj si gjuhë standarde, të cilat nuk janë edhe aq të mëdha e as të pakapërcyeshme”¹.

1. Ibrahim, Mustafa. 2012

Në studimin e historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij ka një paradoks e ky është: nga një anë kemi një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, nga ana tjetër përmendoret e tij të para gjuhësore dalin shumë vonë – në mesjetën e vonë. E historia e gjuhës është edhe historia e vetë atij populli që e ka folur dhe e flet.² Nisur nga këto fakte, edhe e folmja e Pejës përkon me rrjedhat e gjuhës sonë në përgjithësi, në lidhje të vazhdueshme me kulturën, popullin, kombin, lidhje këto të varësisë së tipit kulturor me atë gjuhësor. Për të sqaruar raportin midis individuale dhe shoqërore në të folmen e kësaj ane fillimisht duhet studiuar traditën kulturore gjë të cilën edhe e kemi bërë në këtë punim. Njeriu krijon gjuhën jo vetëm në kuptimin fizik, po edhe në atë shpirtëror. Kjo shpjegohet me atë që njeriu, krijuesi i gjuhës, shpreh nëpërmjet saj vullnetin, imagjinatën, mendimet dhe ndjenjat e veta. Pra, gjuha është pasqyrë e krijuesit të vet, njeriut. Çdo gjë që ka të bëjë me gjuhën, është rezultat i një procesi fizik, ashtu dhe shpirtëror.³ Në realitet, nuk ekziston ideja “kolektivi që flet”, po realitet është “personi që flet”. Prej tij rrjedhin të gjitha, çdo ndryshim apo ndërrim i kuptimit të fjalëve ndodh edhe si rezultat i metaforave poetike me ç’rast çasja në këto ndërrime rezulton me imagjinatën njerëzore. Po vëmë në dukje se gjuha e qytetit të Pejës nuk është unike, pra ka dallime të dukshme fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore, stilistike etj., duke filluar brenda për brenda qytetit, nga lagjeja në lagje, si pasojë e shtresimeve sociale të banorëve, sidomos lëvizjeve demografike të shumta, shpërnguljeve, vendosjeve nga atë të ndryshme, martesave të përziera mes komuniteteve ku nënkuptojë edhe gjuhët në kontakt, me ç’rast veprojnë faktorët e jashtëm, sepse e folmja e tyre paraqet funksionet e jashtme të dygjuhërisë që determinohen nga numri i zonave të kontaktit dhe nga variacionet e secilës përsa i përket zgjatjes, dendurisë dhe presionit. Zonat e kontaktit nënkuptojnë të gjitha mjetet që lejojnë nxënien dhe përdorimin e gjuhëve, përdorimin gjuhësor në shtëpi, në bashkësi, në shkollë dhe në organet e informimit masiv, në radio, televizion dhe shtyp.

Nuk mund të jenë pa ndikim edhe tipet e kontaktit. Kontaktet gjuhësore të shtresave të sipërthëna mund të realizohen në familje, në shoqëri, në shkollë, përmes organeve të komunikimit masiv apo përmes korrespondencës.

2. Ajeti, Idriz. Vepra 4, ASHAK, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, libri 17, Prishtinë, 2001, faq. 7

3. Thoma. Jani. Histori e gjuhësisë, Infbotues, Tiranë 2014, faq. 141

Dallimeve të shumta të të folmes në Pejë i kanë kontribuar edhe një varg faktorësh të tjerë, qoftë në qytet qoftë në fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit, zaten kanë ndikuar:

Grupet etnike. Peja është qytet ku jetojnë komunitete të ndryshme, shqiptarë, turq, serbë, boshnjakë, romë, egjiptianë, hashkalinj etj., që rezulton se të gjithë banorët flasin nga dy gjuhë, e herë – herë edhe më shumë, mundësia që akcili sish ta ruajë gjuhën vet deri në shkallë dominimi varet nga mënyra se si merr pjesë në jetën shoqërore të grupit të vet etnik.

Për shkak të kontaktit fqinjësor, jo rrallë individ i zhytet në gjuhën të cilën e flasin njerëzit e vendit ku jeton, prandaj edhe fqinjësia shpesh e zëvendëson shtëpinë dhe përbën ndikimin më të rëndësishëm në të folurit e tij. Edhe pse shpesh ka lidhje midis grupit etnik dhe grupit fetar, pejanët shpesh i janë bashkuar njërit grup, duke e anashkaluar tjetrin, por duke marrë tok me frekuentimin e grupit edhe gjuhën e tij. Në ndryshimet e shumta dialektore kanë ndikuar edhe forcat kulturore, sepse kërkohej që për arsye kulturore mund të ndodhte që të ishte e domosdoshme që çdo person i kultururës të fliste rrjedhshëm gjuhën, e llogarit kur doemos duhej anashkaluar shqipja e të përdorej serbokroatishja. E folmja shqipe Pejës sot duhet të shihet në këndvështrimin sociolinguistik dhe socioonomastik, sipas moshës dhe gjinisë. Ajo është një produkt i përzierjes së të folures tradicionale pejane me të folmen e rrethinës së qytetit e dominuar nga pjesa jugore dhe lindore. Qendrat urbane sot kanë ndryshuar strukturën e popullatës, ato tashmë janë më heterogjene. Prandaj, nisur nga kjo lëvizje, natyrisht se kemi edhe trysninë e faktorit shoqëror mbi gjuhën. Këto ndryshime kanë ardhur edhe si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të këtij qyteti. Peja tashmë është një qytet universitar, kështu prania e studentëve nga vendet e ndryshme ka sjellë edhe lëvizje të reja gjuhësore. Dallimeve të kësaj të folmeje i kanë ndihmuar edhe ndërndikimi semantik që i detyrohet faktit se procese semantike të njohura rregullohen apo strukturohen ndryshe në gjuhë tjetër. Kemi edhe ndikime leksikore kur kemi futje në të folurit e bilingut, pra, të formave të huaja, qofshin ato njësi apo struktura. Këtu, duhet të bëjmë dallime midis elementeve leksikore që kanë qenë të integruara në dialekt (huazime) dhe atyre që ndeshen në një thënie të bilingut.

3.1. E folmja e Pejës dhe dallimet e saja me të folmen e Rugovës

Përfashtim në këtë mes bën e folmja e Rugovës e cila ka afërsi të dukshme me të folmet e Malësisë së Madhe, veçanërisht me të folmen e Kelmendit, të Hotit e të Shkrelit (Shqipëri), me të folmen shqipe të Plavës e të Gucisë, si dhe me të folmen shqipe të Rozhajës me rrethinë. Gjithashtu, kjo e folme shkon edhe me të folmen shqipe të Peshterit, por ka mjaft pika takimi me kosovarishten. Në përgjithësi, rugovishtja ka veçori të përgjithshme me të folmet e gegërishtes veriperëndimore, mirëpo, për shkak të kontakteve të gjata të banorëve të kësaj ane me banorët e Kosovës vërehen edhe ndikime të ndërsjella, me gjithë ruajtjen e trajtave të vjetra fonetike, morfologjike e leksikore të kësaj zone të thellë malore.

Na duket e arsyeshme që shkurtimisht t'i vërejmë disa karakteristika kryesore dhe ta shohim vendin e kësaj së folmeje në të folmet shqipe të gegërishtes. Deri më sot, nuk është bërë ndonjë studim serioz për këtë të folme, për të cilën A. V. Desnickaja thotë: ⁴ Një vend të posaçëm zë e folmja e grupit të fshatrave të Rugovës afër Pejës... E folmja e banorëve të tyre (kryesisht e brezit të vjetër) gjer më tani ruan karakteristikat themelore të së folmes së Veriperëndimit të malësorëve të Malësisë së Madhe, si (diftingu ua kalimi i mb - p; nd - t; kalimi kl - kj"; gl - gj etj.) Një skicë të vogël mbi këtë të folme e publikoi Menduh Begolli ⁵ Diçka më mirë, po në mënyrë jo të plotë, këtë të folme nisi ta shtjellonte Ahmet Kelmendi, ⁶ po nuk arriti ta kapërthente sa duhet. Kurse një studim të thukët, me interes, të qëndrueshëm shkencërisht, pas një pune serioze në terren, e ka bërë dr. Adem Hajdaraj, duke analizuar dhe shqyrtuar problemet fonetike, morfologjike dhe sintaksore, por duke mos anashkaluar as leksikun. Siç ka vërejtur prof. Ademi, bazuar në sistemet (fonetike, morfologjike dhe sintaksore) të së folmes, nxjerr në përfundim se e folmja e Rugovës bashkëpërkon me shumë veçori të kosovarishtes. Ndërkaq, sipas të dhënave nga punimi i tij kjo e folme shkon me idiomën e Malësisë së Madhe, veçanërisht me të folmën e Kelmendit dhe të Hotit. Ja, disa nga veçoritë fonetike kryesore që kam veçuar nga vepra e tij: ⁷

7. Hajdaraj, Adem. E folmja e Rugovës, IAP, Etruria, Prishtinë, 1996, faq. 22.

1. Hundorësia ruhet në mënyrë të plotë si në të folmet e gegërishtes veriperëndimore, posaçërisht si në të folmet e Malësisë së Madhe, mbase me një intensitet të njëjtë, si bie fjala: nâna, hûni, pêni, dryni etj. P.sh. nga kjo që thamë po marrim vetëm disa shqiptime të antroponimeve: Abáz, Adém, Agón, Alúsh, Albánë, Bálë, Bardhó, Báli, Beháre, Cáfë, Cól, Cúbë , Dánë , Dritón, Dýl, Edmónd , Gálë, Gurakúq, Grósh, Fatón, Fatós, Flútur, Gálë, Gént, Hálil, Icó, Hâla, Hâka, Hâna, Zâna, Sâna, Mâna, Syna etj.
2. Togu i zanoreve ua ruhet vetëm te pjesorja e foljes (punua, shkua, xhua etj.); si dhe te koha e tashme e foljes dua e jo du a due, si e kanë disa të folme të kosovarishtes; te emrat me ue në rrënjë ruhet ky tog (truell, muej, duej etj.), e jo truall, muaj, duaj ose trajtat me uo, që i kanë ruajtur e i ruajnë edhe sot diku-diku disa të folme (truoll, muoj, duoj etj.).
3. Togjet konsonantike gl e kl i ruan në gjendje të hershme të papalatalizuara: gjûni, gjûha, kjê:n etj. Togjet konsonantike mb, nd, ng, ngj etj., paraqiten në variante të nduarduarshme, që e afron këtë të folme me të folmet e Malësisë së Madhe si (ndalu-dalu, nduk-tuk, ndejta-têjta, ngutem-gutena, ngadalë-kadale, ngjyey- çyey, mbush-bushi, mbeta- peta, mbrapa-prapa etj. Në sistemin morfologjik vërehen këto veçroi më karakteristike:
 1. Përdorimi i infintivit të tipit të vjetër: me shkua, me punua, me ha:p, me fje:t etj.
 2. Përdorimi i së pakryerës së tipit: shkojsha, pûnojsha, disha, flêjsha etj.
 Në sistemin sintaksor nuk vërehen dallime të mëdha nga të folmet e tjera, qoftë të afërme me rugovishten, qoftë më të largëta.

3.1. 1. Disa karakteristika të përgjithshme në të folmes e Pejës

1. Ruajtja e zanores hundore: zâni, hîri...
2. Ruajtja e a-së nazale (hundore) e theksuar: nâna, lâmi, hâna...
3. Ruajtja e grupit nistor “vo”: voj, vorr, votër...
4. Ruajtja e n-së intervokalike: rana, bana...
5. Ruhet seria e zanoreve të gjata: plak – pla:kë
6. Ruajtja e diftongut “ue”: grue, duer, punue...
7. Fjalët oksitone (turke) kalojnë në paraoksitone: teneqe, shishe, baba...
8. Asimilohen grupet e vjetra konsonantike mb, nd, ng (përjashtim bëjnë: të folmet e ⁸

8. Gjinari, Jorxhi. 1982. Dialectologji, ASHARPSH

Dibrës, të Rekës, të Pejës).

9. Bashkëtingëllorja hundore qiellzore “nj” kalon në “j”: rraja, huj, ftoj...

10. Ruajtja e bashkëtingëlloreve të zëshme⁸: vend, zog

3.1.2. Shembuj të ndryshimeve fonetike të tingujve në të folmen e Pejës

Alternimet

Rrënja e foljes **pjek** paraqitet me ndryshimet fonetike, që vijojnë: *pjek, poq-a piq.*, (Raushiq, Baran, Zllapek, Zahaq, Ruhot etj).

Dallime fonetike vëmë re edhe në rrënjët e fjalëve që vijojnë: *i madhi- i math, (Shtupeq i Math) Rugovë, vëndi-vët, (ortografikisht i madh. vend)*

Alternimet: *I math, djek, diqte, zok, por shkruajmë i madh, djeg, digjte, zog, ie (je) /o, ie (je) /i, g/gj, k/q.*

Po kështu dhe alternimet e parashtesave: 1) **s/z**: *skuq, sterrë, skamje, spastrim-* me parashtesën s para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, por *zmadhoj, zbardhem, zbukuroj, zgjat, zvogëloj, zverdhem, zbuloj* – me parashtesën z përpara bashkëtingëlloreve të zëshme.

Alternimet historike P.sh. në rrënjën e formëfjalësheve *dal – del – dil – dola* kemi alternimet a/e, e/i, a/o.

3.1.3. Alternimet historike të zanoreve në të folmen e Pejës

Metafonia ose umlauti, (nga greq. meta – prefiks që shpreh idenë e çvendosjes, pas + phon = tingull; ndërtuar sipas gjermanishtes um-laut).

Metafoni quajmë alternimet e zanorevet **a/e dhe e/i** (kjo e fundit quhet metafonizim i mëtejshëm).

Shembuj: *dash – desh* (historikisht nga një dashi), *natë -net* (historikisht nga një nati), *plak – pleq* (historikisht nga një plaki).

Tek foljet: *dal – del, marr – merr, vras – vret.*

Apofonia ose ablauti

(Apofoni nga greq. apo – prefiks që tregon idenë e shmangies + phone-tingull: është krijuar si kalk i fjalës gjermane ab-laut).

Apofoni quajmë alternimet e zanorevet **e/o** ; **ie / o** (ortografikisht nganjëherë **je/o**) dhe **a/o**.

Shembuj: *heq – hoqa, dredh – drodha, bredh – brodha, hedh – hodha.*

Piek – poqa, viel – vola, mbiell – mbolla, siell – solla.

Shembuj:

Mend > mënd, zemër > zëmër, gjemb > gjëmb, dhen > dhën, kuvend > kuvënd, qen > qën, e enjte > e ënjte, ve (< ven) > vë, le (< len) > lë, ze (< zën) > zë.

Krasis

Krasis (nga greq. = shkrirje) quhet alternimi i dy zanoreve me një të tretë, e cila del nga shkrirja e të parave.

P.sh. bashkimi i trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë *më + e > ma, të+e > ta (të tregova, e tregova – të e tregova > ta tregova)*.

Dukagjin e Nikaj – Mertur, bie ë-ja; m'e dha, t'e dha, t'e thashë.

3.1.4. Shtesat e tingujve

Epenteza – Shteza e tingullit në mes të fjalës.

P.sh. andresë – adresë, zembër – zemër...

Epiteza – Epiteza është shtesa e tingullit në fund të fjalës.

P.sh. tinë – ti, tynë – ty, tymë – tym, nuku – nuk...

Hiati – Një grup prej dy zanoresh që vijnë njëra pas tjetrës dhe pjesë në dy rrokje të ndryshme.

Si tinguj antihiatizues kemi: j, h, v.

P.sh. punova, lexoji, kthehu, tregohu...

3.1.5. Rëniet e tingujve

Afereza

Rënia e tingullit në fillim të fjalës.

P.sh. Bani – Shabani, Gimi – Agimi, Goni – Agoni...

Sinkopa

Sinkopë quhet rënia e tingullit në mes të fjalës.

P.sh. kshtu – kështu, shpi – shtëpi...

Apokopa

Rënia e tingullit në fund të fjalës.

P.sh. kish – kishte, ish – ishte, erdh – erdhi ...

3.1.6. Procese fonetike

Asimilimi (lat. adm+ similis) bëj të ngjashëm – quhet ai proces fonetik, si rezultat i të cilit dy tinguj që janë pranë njëri-tjetrit bëhen krejtësisht të njëjtë ose të ngjashëm⁹.

Shembuj:

- a) tm-m: mbetmë – mbem(ë)
- b) tn – n: vritni – vrini; fshatnë – fshan(ë)
- c) pm-m: (n) empa – nema (nëma)
- d) in-n : kalnë – kalë ; malnë – malë
- e) Lln – ll: suallnë – suallë; mbyllnë – mbyllë
- f) rn- rr: zjarrë – zjarr (ë) ; u thernë – u therr (ë)

Disimilimi

Dy tinguj të njëjtë ose të afërt në tiparet e tyre, bëhen të ndryshëm ose largohen nga këto tipare.

P.sh. birbil – bilbil, arbitër – albitër...

Haplologjia (Një nga rastet e disimilimit) Quhet rënia e njëres nga dy rrokjet e njëjta që vijnë njëra pas tjetres si rezultat i disimilimit.

P.sh. rëndësia e kësaj çështjeje, anijeje, marrëveshjeje...

Përngjitja (Aglutinimi) – Bashkimi në një njësi të vetme leksikore i dy ose më shumë fjalëve që përdoren dëndur pranë njëra – tjetres.

P.sh. atëherë = atë + herë, mandej = më + andej, përballë = për + ballë...

Sand’hi – Në kufijtë midis fjalëve, kur ato shqiptohen të lidhura mund të lindin tinguj të ndryshëm. Në këtë rast themi se ata kanë lindur në sand’hi (lidhje, bashkim).

P.sh. i jati – i ati, e jëma – e ëma...

Buzorëzimi (Labializimi) i zanoreve: - Zanoret që janë pranë bashkëtingëlloreve buzore mund të ndikohen prej tyre dhe të kthehen në zanore të buzorëzuara.

P.sh. krypë – kripë, hypi – hipi, rrypi – rripi...⁹

9. Hysenaj.Valdet.Ligjërata nga Gjuha shqipe I, Fakulteti I Edukimit “Fehmi Agani” Gjakovë 2018. (Fonetika Jorgji Gjinri, Tiranë, 1968)

Qiellzorizimi (Palatalizmi) i zanoreve: - Nën ndikimin e bashkëtingëlloreve qiellzore, zanoret mund të kthehen në qiellzore (palatale).

P.sh. qengji – qingji, një – nji, gjendje – gjindje...

Metateza – Ndërrimi i vendeve të tingujve në fjalë.

P.sh. trubull – turbull, shloj – lëshoj...

Bashkimi (Junktura) Elementi fonetik që shënon kufijtë midis dy njësive të kuptimshme të ligjëritimit.

P.sh. përçaj > për çaj, përfitim > për fitim, në përshkrime > nëpër shkrime...

Sinalefa - Dukuria e reduktimit të dy tingujve në një të vetëm.

- Me anë të elizionit (m'i dha);

- Me anë të kontraksionit (alkool > alkol, koordinoj > kordinoj...

Sinereza – Kur dy zanore që janë pranë, bashkohen në difongje.

P.sh. stadium, idiot, vëllai, babai¹⁰...

Në lëmin e vokalizmit për karakteristikën e të folmes së Pejës janë tipike këto dukuri :

E folmja e Pejës, akoma e ruan shqiptimin e diftongjeve ue , ye, ie, kurse përdorimi tyre paraqitet në një shkallë të lartë, i monoftogizuar, në të gjithë Pejën me rrethinë, me perjashtim të Rugovës, në vend të diftongjeve, shqiptohen monoftongjet : u, y, i, dukuri kjo e përhapur nga jugperëndimi, nga krahinat qendrore të zonës dialektore geqe.

Gjendjen e luhatjeve mes dy tipeve të shqiptimit, mjaft qartë e shprehin shënimet e tregimeve gojore që janë shënuar në fshatrat e rajonit të Pejës, në Prozën Popullore të Drenicës, nga Anton Çetta¹¹, Për shembull, në një tekst të vogël: ish kon shku, kam pas menu , m'kallzu. A o mir m'e ngu grun? ose në Letërsinë Popullore të Demush Shalës: - Kush po thrret? e peyti i shoqi gruen. – Ata gjahtarët, janë ardh tu dera e pe lypin lepurin. Nuk a lepri i tyne – ja kthei burri e zu me bo be¹² ... Në këta shembuj, trajta e partcipeve dhe e infinitivit dëftojnë zëvendësimin e diftongut ue me monoftongun u : shku, menu, m'kallzu.

Fjalët grue dhe duer paraqiten në dy variante : gruen dhe gru, duer dhe dur. Rëndësia esenciale për karakteristikën e të folmes së Pejës ka dukuria që është e lidhur me

10. Hajdaraj, Adem. E folmja e Rugovës, IAP, Etruria, Prishtinë, 1996, faq. 22

11. Çetta, A. Proza Popullore e Drenicës II, 1986. ETMM KSAK, Prishtinë, fq. 255

12. Shala, Demush. Letërsia Popullore, 1982. Prishtinë. Biblioteka Tekstet Universitare, faq.323

shqiptimin e përgjithshëm të artikulimit të zanoreve, që është tërhequr dukshëm prapa dhe që qëndron në të forcuarit përkatës të elementit të velarizimit gjatë shqiptimit të një vargu të zanoreve. Kjo gjendje e përditshme e shqiptimit më tepër shprehet në të tërhequrit prapa të zanores a të gjatë, që përcillet me një labializim.

3.1.7. Përdorimi i gabuar i kriterëve gjuhësorë në të folmen e Pejës

Formën e folur, si edhe atë të shkruar, qoftë në jetën e përditshme, qoftë në të gjitha institucionet e qytetit, mund të veçohet një mal i dendur shkeljesh të kriterëve shkencorë, të cilat mund të përmbliken në dukuritë vijuese:

1. Fjalitë dhe frazat e gjymta nga ana kuptimore: fillimi i shprehjes së mendimit me fjali të varura pa fjalinë drejtuese për të përmbyllut mendimin si rrjedhojë e mosnjohjes së sintaksës.
 2. Mungesa e kongruencës sipas kategorive gramatikore në ndërtimin e fjaltive p.sh. "...u shfaqën fiset ilire, për të cilët thuhet se...".
 3. Shprehjet e pambëhishme tautologjike që, siç dihet, nuk shprehin asgjë të re, veçse paraqesin paqartësi semantike.
 4. Varfëria leksikore si pasojë e kulturës së ngushtë letrare, gjuhësore dhe të përgjithshme.
 5. Mosnjohja e stilistikës letrare dhe e stilistikës gjuhësore si dije të sajimit të shprehësisë më ekspresive dhe më impulsive të tekstit shkrimor ose të komunikimit gojor.
 6. Mungesa e njohurive nga pragmalinguistika, gjuhësia e tekstit, figurat retorike, sinonimia, prozodia, frazeologjika etj.
- Përderisa mungon formimi nga fushat e përmendura, është e kuptueshme se do të mbizotërojë, thënë me terminologjinë e Lebovit, teoria e deficitit gjuhësor.

3.1.8. Lëshime gjuhësore

Shembull: Nga një paraqitje publike e një politikani

Lëshimet:

Foljet: *kishin pas than* (kishin thënë); *gjemoj* (gjëmoi); *osht* (është); *e shisha* (e shihja); *me ma lexu* (të më lexojë); *me m'tregu* (të më tregojë); *asht than* (është thënë); *p'e shitni* (po e shisni); *filloj* (filloi); *kemi pranu* (kemi pranuar); *jemi çertifiku* (jemi certifikuar); *pe shesum*, (po e shesim); *p'e dojm*, *p'e dum*, (po e duam); *të pa dënum* (të pa dënuar); *kujdesna* (kujdesem); *m'u brengos* (të brengosem); *t'gjykohmi* (të gjykohemi); *ka dërgu* (ka dërguar); *m'i ba* (t'i bëjmë); *asht kompletu* (është kompletuar); *me shqyrto* (të shqyrtojë); *ka ardh* (ka ardhur); *ndodh* (ndodhur); 4 herë- *menoj* (mendoj); *ka rreh* (ka rrahur); *ka vra* (ka vrarë); *kan ba* (kanë bërë); *jan kan* (kanë qenë); *kena* (kemi); *m'i ik* (t'i ikim); *m'ju shmang* (t'i shmangemi); *i jikum* (I kemi ikur); *tham* (them); *kishmi* (kishim); *kishin than* (kishin thënë); *thuni* (thuani); *kisha pa* (kisha parë); *ish dasht* (ishte dashur); *me vendos* (të vendoset); *keni provu* (keni provuar); *keni demonstru* (keni demonstruar); *keni deshtu* (keni dështuar); *keni qëllu* (keni qëlluar); *me ul* (ta ulin); *m'u friksu* (të frikësohem); *leni* (lëreni); *kry* (kryer); *m'u pastru* (të pastrohemi); *bahen* (bëhen); *s'kishmi votu* (nuk kishim votuar); *m'i ni* (t'i dëgjojmë); *keni me gabu* (do të gaboni)

Emrat: *parafolsit* (parafolësit); *vot* (votë); ...*Rambujes* (Rambujesë); *Kosoven* (Kosovën); *Vjen* (Vjenë); *bashksis* (bashkësisë); *nderkombtare* (ndërkombëtare); *drejtsi* (drejtësi); *Serbis* (Serbisë); *përgjithsi* (përgjegjësi); *ushtris* (ushtrisë); *Hag* (Hagë); *mnyr* (mënyrë); *fmi* (fëmijë); *gja* (gjë); *mundsin* (mundësinë); *zana* (zëra);

Mbiemrat: *afatgjat* (afatgjatë); *e meritum* (e merituar); *e im* (e imët); *i randsishem* (i rëndësishëm).

Përemrat: *ja* (ia); *ksajna* (kësaj); *une* (unë); *ket* (këtë); *ksaj* (kësaj); *na* (ne); *e jemja* (e imja); *kërkush* (askush); *kti* (këtij); *do* (disa);

Leksik: *demek* (që do të thotë); *tuti* (frikësoheni); *hala* (ende); *apet* (prap);

Nga sa u pa më sipër, fjalori i të folmes së Pejës mendojmë se hë për hë problemet më të dukshme i ka tek:

-përdorimi i zanoreve hundore të gjata;

-asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve me –mb, -nd (që vetëm në qytetin e Pejës janë dukshme, më të shpeshta , si dhe i vendosen aty ku s’duhet), që dalin si: m, n, ñ

-zëvendësimi i bashkëtingëllores –nj- me –j-, ku ndodhet sidomos në fund të fjalës tek shumësi i emrave

-mospërdorimi ë-së fundore të patheksuar dhe zgjatja e zanores së theksuar

-monoftongimi i togjeve –ua-, -ue- në –u

-prania e paskajores së tipit –me bâ- dhe –kish pásë kónë

-n-ja ndërzanore nuk kalon – r- (rotacizmi)

forma e së ardhmes –do të- del në formën –kâm- të paskajores, etj.

Siç vëren studiuesi Hasan Mujaj, pjesa dërrmuese e punëtorëve në organizatat shoqërore, si dhe punonjësit e institucioneve të tjera, krijojnë nyjtim tingujsh, rrokjesh e fjalësh në shpërpjesëtim me kriteret drejtshqiptimore të njësive gjuhësore. Nga ky aspekt vihet re mbizotërimi i nyjtimit rajonal në përdorimin zyrtar të gjuhës standarde. Edhe në rastet kur bëhen përpjekje për t’u shprehur në variantin standard të gjuhës, kultura e pamjaftueshme nga shkencat e përmendura gjuhësore, diskutimin e nxjerr artificial dhe në kundërshti me rregullat e artikulimit të drejtë të tingujve gjuhësorë në aparatin e të folurit. Duke mos i ditur pozicionet e organeve pjesëmarrëse në nyjtimin e drejtë të tingullit ë, kjo zanore shpeshherë del si e p.sh. “duke berë” në vend të duke bërë, zeri për zëri, duke thenë për duke thënë etj.

Për t’iu shmangur këtij nyjtimi të gabueshëm, duhet të dihet artikulimi i këtij tingulli: “goja hapet mesatarisht; pjesa e mesme e gjuhës ngrihet mesatarisht drejt qiellzës së fortë; buzët nuk marrin pjesë në nyjtimin e ë-së¹³.”

Te shumë deputetë dhe te zyrtarë të tjerë, e-ja, në pozicionin midis dy konsonanteve hundore: **m- n**, nuk nyjëtohet si **e** e mirëfilltë, porse, nën ndikimin e artikulimit rajonal, del me prirje nazaliteti si p.sh. “dokumente, argumente, instrumente, elemente etj.”

Dukuri shumë e shpeshtë e shkeljes së gjuhës standarde nga ana e deputetëve dhe e të tjerëve në fushën e fonetikës është edhe shkrirja e togjeve zanore: **ue, ua, ie, ye** në sistemin emëror e foljor edhe në rastet kur ato duhet të ruhen të plota.

13. Hysenaj, Valdet. Kumtesë.Gjuha dhe letërsia – sfidë specifike në zhvillimin socio-etik dhe atë profesional, 21-22 prill 2017. Universiteti Shtetëror i Tetovës

3.1.9. Përdorimi i grupeve të bashkëtingëlloreve

Grupet e bashkëtingëlloreve në gjuhën shqipe konsiderohen si tinguj të përbërë, sepse shqiptohen vetëm me një nyjetim të vetëm të përbërë.

Po veçojmë disa karakteristika kryesore rreth të folmes së Pejës me rrethinë, si p.sh.: Cila është e folmja e Pejës brenda të folmeve të gegërishtes verilindore?

Sa janë ruajtur këto togje të bashkëtingëlloreve në këtë të folme? Si paraqiten ato në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe etj¹⁴.

Duke u bazuar në studimet të cilat janë bërë, grupet bashkëtingëllore **mb**, **nd**, **ng** janë rast tipik dhe paraqesin dallim në krahasim me të folmet e tjera. Togjet në qytetin e Pejës janë ruajtur në përgjithësi, e veçanërisht togjet mb, nd, ng. Këto togje kanë përdorim të madh sidomos nga folësit e Pejës, mirëpo nuk do të thotë që nuk i kanë ruajtur këto togje edhe banorët të cilët janë të ardhur në Pejë dhe është vështirë t'i vëresh se a janë apo nuk janë pejanë. Këto grupe janë reduktuar në bashkëtingëlloren e parë **m** dhe **n**.

2.6. Grupi mb

Parimi i ruajtjes së këtij grupi bashkëtingëllor vlen për qytetin e Pejës, p.sh. në Pejë thuhet: *U dal me mbledhë dredhëza*, ku përderisa në fshatrat përreth thuhet: *U dal me mledh dredhëza*, si banorët e fshatrave Qyshk, Zahaq etj. Mirëpo, vlen të përmendet se artikulimi i fjalës *mbledhë* në Pejë ka edhe një variant tjetër nga banorët e fshatrave të Rugovës, ku togu (mb), fonemë kjo e përbërë, na del në tri reflekse si pasojë e një asimilimi progresiv: **mb>b**, **mb>m**, **mb>p**. Grupi mb në të folmen e Rugovës ka dhënë (**b**) kryesisht në ballë të fjalës¹³. (bledhet, bushet, bathet, blohet) etj. Megjithatë, parimi i ruajtjes së këtij grupi bashkëtingëllor vlen për qytetin e Pejës me rrethinë, që i bie se Peja në krahasim me të folmet e tjera është në përafrim me gjuhën standarde. Pra, në Pejë thuhet: Ma **mbush** gotën me ujë, **mbledhet**, **mbështet**, (**mbështetu** për mua), **dembel**, një**mb**ëdhjetë, **kumbull**¹⁵ etj. Në ADGJSH¹⁴ (Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe) harta 16 që shpjegon gjendjen e grupit bashkëtingëllor **mb**, pika 28, që është brenda të folmes së Pejës grupi bashkëtingëllor **mb** ruhet në të gjitha pozicionet: *mbiell grurin, krastit*¹⁵.

14. Hajdaraj, Adem. E folmja e Rugovës, IAP, Etruria, Prishtinë, 1996, faq. 22

15. Po aty, faq. 26

3.1.10. Grupi nd

Togu konsonantik (**nd**) në të folmen e Pejës ruhet, ndërsa në të gjitha fshatrat rreth tij është reduktuar në (**n**). Në fshatra ky grup është reduktuar (**nd>n**). Kurse në të folmen e Pejës e kanë ruajtur këtë grup bashkëtingëlloresh, p.sh thuhet **ndej** (Pejë) , ndërsa në fshat (**nej**). Përderisa në të folmen e Rugovës edhe ky grup si grupi (**mb**), raportet e asimilimit janë përafërsisht të njëjta me ato të **mb-së**: **nd>d**, **nd>p**, **nd>n**.

Kështu në të folmen e Rugovës kemi: **duroj** për **ndaloj**, **digioj** (ndëgjoj), **doshta** (ndoshta), **dalena** (ndalem), **dikoj** (ndikoj), ku grupi konsonantik (**nd**) në pozicionin nistor ka rënë elementi i parë (**n**) dhe ka mbetur i dyti (**d**) përmes rrugës **nd>d**. Dihet se në disa të folme të Kosovës si dhe në disa të folme të tjera geqe, **nd**-ja sikurse edhe **mb**-ja, mbarojnë sot e gjithë ditën në elementin e parë (**naloj**, **nigoj**), që nuk janë kalime përmes rrugës: **nd>nn>n**, po siç u tha edhe për togun **mb**, gjithnjë kemi rënie të elementit të dytë. Por karakteristikë në të folmen e Rugovës¹⁶ qoftë në elementin e parë, qoftë në të dytin, e kemi hasur vetëm në pak fjalë, kryesisht të reja: **tundaç**, **dallandyshe**, **sanduk**, **sandalle**, e ndonjë tjetër. Tek numërori nëntë dhe të gjithë numërorët: **nânthet**, **nânumth:t**, i **nânthetretit** e edhe te disa trajta joveprorese (**nd-ja**) në pozicion në mes rrudhet në elementin e dytë: **múdet**, **shkúdet**.

3.1.11. Grupi ng

Edhe grupi bashkëtingëllor (**ng**), si dy grupet e tjera, në fshatrat e Pejës është i reduktuar. Mirëpo, këtë dukuri pejanët i kanë ruajtur në përgjithësi mirë si: **ngusht**, **ngopet**, **ngujoj** etj, përderisa banorët e fshatrave të Rugovës e reduktojnë n-në si :**gusht**, **gujoj** për **ngusht**, **ngopet**, **ngujoj** etj. Në ADGJSH harta numër 17 pika 28¹⁷, grupi bashkëtingëllor **ng** është paraqitur i plotë në të gjitha kushtet fonetike, si p.sh.: *ngusht*, *kungull*, *trung*, *cung*, *ngan*, *ngat* etj.

Mund të konkludojmë se gjatë krahasimit, përshkrimit, pra mënyrës së artikulimit të zanoreve dhe grupeve të bashkëtingëlloreve, pamë se banorët e qytetit të Pejës kanë arritur t'i ruajnë vetëm grupet **mb**, **nd**, **ng**, me ç'rast hasëm edhe në puçitje dhe dallime.

Puçitja qëndron tek fakti se, fshatrat e qytetit të Pejës i artikulonin këto grupe njësoj duke reduktuar bashkëtingëlloren e dytë: (**mbaj**) për (**maj**), përveç banorëve të fshatrave të Rugovës të cilët e reduktonin bashkëtingëlloren e parë: (**mbath**) për (**bath**)¹⁸, që i bie se kjo trevë kishte tri mënyra të artikulimit të këtyre grupeve. Ndërsa, sa i përket dallimit,

konstatuam se e folmja e banorëve të Pejës me rrethinë dallonte përderisa ata i ruanin këto grupe.

Nga kjo mund të konkludojmë se dallimet fonetike janë të qarta dhe të theksuara, por duhet cekur këtu që dallimet fonetike janë të grupuara në dy sosh: në sistemin e zanoreve dhe atë të bashkëtingëlloreve.

Dallimet fonematike në përbërjen e një fjale ku dhe këto janë dy llojesh, nga të cilat disa janë të kushtëzuara fonematikisht, ndërsa të tjerat janë të pakushtëzuara nga ana fonetike. Si p.sh. : në të folmet e Pejës gjejmë, **aborr**, **uborr** për **oborr**, **daktor** për **doktor**, **vetell**, **vetlla**, për **vetull**, **flutër**, **flutra** për **flutur** etj¹⁹.

Ajo që i përbashkon dhe, natyrisht, i diferencion ngapak të folmet e shqipes është pikërisht leksiku më i përgjithshëm e që parakupton përhapje mbarëkombëtare dhe njohje të gjithmbarshme²⁰. Sikurse dallimet që kanë veshjet tona kombëtare, po ashtu edhe dallimet fonetike, edhe pse ekzistojnë, kanë mjaft elemente përbashkësie.

Mund të arrijmë në përfundim që dallimet fonetike si në grupin e zanoreve ashtu edhe në atë të bashkëtingëlloreve na del si një ndryshim jo i madh në të folurit e gjuhës shqipe, shikuar për nga shtrirja gjeografike e dialekteve.

17. Grup autorësh. 2007. Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. ASHSH. Napoli

18. Hajdaraj, Adem. E folmja e Rugovës, IAP, Etruria, Prishtinë, 1996

19. Demiraj, Shaban. 1988. Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë

20. Shkurtaj.Gjovalin. Shqipjae sotme.SHBU. U.F.O. Press. Tiranë.2010.faq. 179

KREU I KATËRT

4. SOCIOONOMASTIKA ANTROPOLOGJIKE

Në shkencat shoqërore, një shoqëri më e madhe shpesh është përfaqësuar *shtresimesh* ose dominim modelesh në nëngrupe.

Një nga artikujt e hershëm të kuptimit antropologjik të termit të "kulturës" erdhi nga Sir **Edward Tylor**, i cili shkruan në faqen e parë të librit të tij 1897: ¹ "Kultura apo qytetërimet, të marra më gjerë, në kuptimet e tyre etnografike janë se i gjithë kompleksiteti që përfshin njohuritë, besimin, artin, moralin, ligjin, me porosi dhe me aftësi të tjera dhe shprehjet e fituara nga njeriu si anëtar i shoqërisë. " termi "civilizim" i dha më pas rrugën për përkufizimet nga **V. Gordon Childe**, me kulturë, duke formuar një term mbuloje dhe qytetërimi, duke bërë një lloj të veçantë të kulturës. ² Ai koncept antropologjik i "kulturës" reflekton pjesërisht si një reagim kundër diskurseve të mëhershme, bazuar në një opozitë në mes të "kulturës" dhe "natyrës", sipas të cilit disa genie njerëzore jetonin në një "gjendje të natyrës".

Antropologët kanë argumentuar se kultura është "natyra njerëzore" dhe se të gjithë njerëzit kanë një kapacitet për të klasifikuar përvojat e tyre dhe përmes klasifikimeve simbolikisht mësojnë abstraksionet e të tjerëve.

Që njerëzit të fitojnë kulturën nëpërmjet proceseve mësimore të zhvillimit dhe socializimit, njerëzit që jetojnë në vende të ndryshme apo rrethana të ndryshme zhvillojnë kultura të ndryshme. Antropologët gjithashtu kanë theksuar se përmes shoqërorizimit njerëzit mund të përshtaten me mjedisin e tyre në mënyra jogjenetike, në mënyrë që njerëzit që jetojnë në mjedise të ndryshme shpesh do të kenë kultura të ndryshme. Pjesa më e madhe e teorisë antropologjike e ka origjinën në një vlerësim të shprehjes dhe interesit në tensionin midis kulturave (të veçanta) lokale dhe globale (një natyre universale njerëzore, apo lidhjeje midis njerëzve në vende të ndryshme, sipas rrethanave).

1. Tylor .Edward. London. 1871. The Orgons of culture.

2. Childe .V. Gordon, Berlin.1909. Culture-historical archaeology

Shtresimesh: SHTRESIM m. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve shtresoj, shtresohet. Shtresimi i lëndëve. Shtresimi i leksikut.

Nga ky këndvështrim mund t'i qasemi një aspekti evident dhe statistikor të një numri të përgjithshëm të banorëve të Pejës (që mund të kap shifrën afro 120.000 njëqind e njëzet mijë), dhe të konstatojmë se pa mëdyshje, afro gjysma e tyre afro 40.000 mijë sish, jetojnë jashtë territorit të Pejës, gjegjësisht jashtë Kosovës, të socializuar në mënyrë jogjenetike, të rritur dhe ambientuar në kultura të tjera anëkënd metropoleve të botës.

Kjo e dhënë statistikore, migrimi në masë, në rend të parë ka paraqitur teorinë e diferencës dhe deficitit socioonomastik, ngase ata, fëmijët dhe të rriturit, nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë dhe operojnë me mjetet simbolike që janë kërkuar nga shoqëritë ku janë vendosur. Shumë shpejt në këto rrethana kemi të bëjmë edhe me bilinguizmin, bilinguizmin ose polilinguizmin individual, plurilinguizmin, që për socioonomastin paraqesin vështirësi antropologjike, sidomos kur këtu shtojmë edhe martesat patrilinguale, patrilokale dhe egzogaminë. Megjithëkëtë, folësin në socioonomastikë mund t'a krahasojmë me qelizën në shkencën e biologjisë (nëse ne nuk e kuptojmë se si funksionon një qelizë nuk mund të kuptojmë se si funksionojnë një grup qelizash).

4.1. Vështrim i përgjithshëm mbi antropologjinë

Bazuar në studimet e antropologut **Gunnar Sevelius**³, konstatojmë se antropologjia në kuptimin e mirëfilltë nënkupton studimin njerëzor në të kaluarën dhe në të tashmen. Për të kuptuar spastrimin e plotë dhe kompleksitetin e kulturave përgjatë gjithë historisë njerëzore, antropologjia tërheq vëmendjen dhe është ndërtuar mbi njohuritë nga shkencat sociale dhe biologjike, si dhe shkencat humane dhe fizike. Një shqetësim qendror i antropologëve është aplikimi i njohurive në zgjidhjen e problemeve të njeriut.

Antropologët në përgjithësi u janë kushtuar kryesisht katër fushave: antropologjisë sociokulturore, biologjike, antropologjisë fizike dhe arkeologjisë gjuhësore. Antropologët shpesh integrojnë perspektivat e disa prej këtyre zonave në hulumtimet e tyre, mësimdhënies, jetës profesionale, dëshmimeve të mbledhura në terren, identifikimit kudo që të jetë e mundur të bartësve të emrave, duke i shqyrtuar në fillim etimologjikisht dhe

3. Sevelius. G. Paperback.2010. An Anthropological Review of History (hyrje).

duke shikuar anën materiale të tyre, duke i përpunuar në vazhdimësi dhe duke mundësuar nënshkrimin e një numri të analizave të mëtejme.

Antropologët kontribuojnë dukshëm në fusha ndërdisiplinare të tilla si studimeve ndërkombëtare dhe studimeve etnike dhe gjinore. Puna e tyre mund të përfshijë ndërtimin e partneriteteve kërkimore, vlerësimin e nevojave ekonomike, vlerësimin e politikave, zhvillimin e programeve të reja arsimore duke shënuar historitë pak të njohura të komunitetit, siç është rasti me qytetin e Pejës, së cilit edhe i referohemi në këtë punim, pastaj sigurimin e shërbimeve shëndetësore dhe aktiviteteve të tjera relevante shoqërore. Është në interes të këtij punimi adresimi i problematikave sociale dhe kulturore si dhe qasja shoqërore në burime të kufizuara socioonomastike në nivel regjional dhe kombëtar.

4.2. Arkeologjia dhe socioonomastika

Arkeologët kanë studiuar popujt dhe kulturat e kaluara, nga parahistoria më e thellë për të kaluarën e afërt, nëpërmjet analizës së mbetjeve materiale, duke filluar nga objektet dhe provat e mjediseve të fundit të arkitekturës dhe peizazheve. Provat materiale, të tilla si qeramikë, vegla guri, kocka të kafshëve dhe mbetje të strukturave etj., janë shqyrtuar në kontekst të modeleve teorike për të trajtuar tema të tilla si formimin e grupimeve sociale, ideologjive, modeleve të jetesës si dhe ndërveprimeve me mjedisin. Ashtu si edhe fushat e tjera të antropologjisë, arkeologjia është një disiplinë krahasuese; ajo merr kontinuitete themelore të njeriut mbi kohën dhe vendin, por gjithashtu pranon se çdo shoqëri është produkt i historisë së veçantë të saj dhe se brenda çdo shoqërie ka të përbashkëta dhe ndryshime.

Studiuesi ynë i mirënjohur Gjovalin Shkurtaç, ndër të tjera gërmimet arkeologjike i krahason me të dhënat e onomastikës iliro - shqiptare.

4.3. Antropologjia kulturore dhe sociale

Paralelisht me rritjen e antropologjisë kulturore lindi antropologjia sociale, në të cilën shoqërohet koncepti qendror i përbashkët e cila fokusohet në studimin e statuseve sociale dhe roleve të tyre, grupeve, institucioneve dhe marrëdhënieve mes tyre, duke u zhvilluar si një disiplinë akademike. Në termin mbulojë, antropologjia socio-kulturore i referohet të dy traditave kulturore dhe antropologjisë sociale.

Do të jetë me interes nëse për ilustrim marrim për të zbërthyer domethënien e fjalës “Besë”, të përdorur aq shpesh në Pejë, që na del fillimisht si koncept antropologjik kulturor dhe social, ku në esencë, në vështirimin e parë ravijëzojmë traditën e shqiptarëve në jetën familjare, në kohët e luftërave, në pajtim të gjakeve, në logje kuvendesh, në mbrojtjen e truallit, nderit dhe gjuhës amtare, në mbrojtjen e të tjerëve dhe në mbrojtjen e objekteve fetare; vështirimi i dytë i përket trajtimit të besës shqiptare dhe rëndësia e saj në përpjestimin social, vështirimi i tretë është frymëzimi i krijuesve popullorë nga rëndësia e besës dhe e besnikërisë në raportet ndërshqiptare dhe ndërmjet shqiptarëve e të tjerëve dhe vështirimi i katërt ka të bëjë me karakterin multidisiplinar të studimeve për besën etj.

Besa si temë studimesh multidisiplinare trajtohet në rrafshë shumëdimensionale si besa në gjakmarrje, në mbrojtjen kolektive, në etnopsikologjinë e shqiptarit, në folklorin shqiptar etj. dhe si e tillë ndër shqiptarë ajo është shprehja më e fuqishme e nderit dhe e burrërisë. Ajo e ka zbutur zakonin e gjakmarrjes dhe ishte faktor i fuqishëm në luftën çlirimtare kundër të huajve. Në folklorin shqiptar besa zë një vend të posaçëm. Për besën ka shumë të dhëna, gojëdhëna dhe këngë popullore të cilat mbështeten në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Besa është faktor i rëndësishëm i moralit shqiptar, besa ka luajtur një ndër rolet më të rëndësishme në besëlidhjen e Lezhës, në Lidhjen e Prizrenit, Lidhjen e Pejës, Besëlidhjen të Verrat e Llukës, në Kuvendin e Junikut etj. Në anën tjetër, shqiptari në shumë raste bëhet rob i besës dhe i mikpritjes. Në emër të besës shqiptari e gjeti veten në mbrojtjen e hebrenjve dhe në mbrojtjen e objekteve sakrale, sidomos të kishave ortodokse në Kosovë. Në këtë kontekst veçoj ruajtjen e kishës së Pejës, në emër të besës, nga familja Nikçi e fshatit Shtupeç i Madh, me krenari dhe dinjitet, si vlerë kulturore të kësaj ane. E hasim besën edhe në pikëpamjet e rilindësve, ngase ata e vlerësuan lartë besën si faktor

mobilizues në luftën për pavarësi. E gjejmë të theksuar gjerësisht në veprat e Pashko Vasës, Sami Frashërit, Shtjefën Gjeçovit, J. De Radës, A. Z. Çajupit, Pal Doçit, Dom Ndoc Nikajt, Asdrenit, F. Konicës, Mark Krasniqit etj. Nga shkrimet e rilindësve rezulton se institucioni i besës në kohën e tyre ishte dobësuar, por kurrësi nuk kishte humbur.

Besa ndikoi në rritjen e qëndrestarisë dhe të luftës për çlirim, me çlirimin dhe luftën për pavarësim të vendit, për aspekte të ndryshme të jetës, të së tashmes dhe të shkuarës, për kulturën e për historinë, për përpjekjet për liri, për politikën, për zhvillimin ekonomik e vështirësitë që ndeshte ai, për raportet brenda vendit dhe me fqinjët, për impaktin ndërkombëtar të Kosovës në vend dhe në botë. Përmes kësaj fjale të vetme, shpjegojmë interesat e zhvillimeve të brendshme, nevojat për ndriçime të segmenteve të ndryshme të së sotmes dhe të së kaluarës, ndërsa në spektrin social kjo fjalë ka ndjekur lakoren e interesave dhe të interesimeve të mjediseve përkatëse. Përshkruhet dhe shqiptohet me mirëkuptim e simpati nëpër të gjitha periudhat, të vështira dhe të lehta, e përqendruar në aspektet më aktuale që e shpjegojnë domethënien e saj sipas perspektivave përkatëse.

Trajtesa jo të pakta në konotacionin pozitiv për këtë fjalë në aspektin social dhe kulturor ka pasur edhe nga popuj të tjerë, me tone të theksuara, ku përmes besës paraqiteshin të dhëna të rëndësishme dhe të përgjithshme për aspektet e ndryshme të realitetit, të së kaluarës, të jetës dhe të zhvillimeve në Kosovë, sa më të plota dhe të verifikuara.

Në gamën e rritjes së pikëpamjeve socioonomastike në hapësirat mabrëshqiptare, fjalë të tilla na paraqesin vlera me interes për dijet sociale, fjalë që do të duhej të dëgjoheshin kryesisht përmes individëve dhe studiuesve të veçantë.

KREU I PESTË**5. ANTROPONIMET NË DRITËN SOCIALE**

Përpjekja për të ndriçuar emrat vetjakë nga këndvështrimi socioonomastik pa dyshim shënon përpjekjen e parë të kësaj natyre në fushën e gjurmimit dhe hulumtimit në qytetin e Pejës me rrethinë. Deri më sot aspekti social i antroponimisë nuk ka pasur ndonjë objekt studimi a trajtimi të kësaj çështjeje. E kaluara historike e Pejës sikurse e gjithë historia e etnisë sonë, na paraqet një fushë të pa hulumtuar dhe pa të dhëna të shkrura. Me ato pak dëshmi të argumentuara që i hasim që nga viti 1485 në “Defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës”, si dëshmi për Pejën si vend të banuar, që në fillim të punës kërkimore dhe punës në terren na dalin një varg sfidash me të cilat duhet përballur, sepse çështjen e trajtuar duhet ndjekur në planin sinkronik, rrugë kjo që është ndjekur edhe nga ata pak pararendës që trajtuan këtë problematikë, me theks të veçantë emrat e njohur të gjuhësisë së kësaj ane prof. dr. Hasan Mujaj dhe prof. dr. Adem Hajdaraj, prof. dr. Avdullah Zymberaj, dr. Xhealdin Zymberaj etj. Së këndejmi, edhe sot e kësaj dite hasim të ruajtura toponime dhe antroponime të gurrës ilire, si: Bardh, Bardhaj, Dashaj etj., siç ka vënë re edhe prof. Çabej¹.

Në përgjithësi një emër është një emërtim për një emër, një person të veçantë, një vend ose gjë. Janë quajtur ndonjëherë emra të përveçëm. Pjesa tjetër e emërvënieve merret me emra për njerëzit (emra personalë), por edhe me emrat e vendeve dhe të emrave të llojeve të tjera për emrat e duhur. Përmes emërvënies në aspektin socioonomastik kërkohet që të hetohet dhe të gjendet se çfarë është me të vërtetë në një emër, arsyet se pse është i tillë në rrethana dhe kushte të caktuara shoqërore, qëllimi, shkaqet, përparësitë etj., njëkohësisht hetohen njohuritë kulturore, etimologjia, historia, pse jo edhe karakteristikat gjuhësore të shpallur në emra, si dhe shpjegimkuptimi i emrave në të gjitha format dhe diskutimet socioonomastike dhe teorike për pikëpamjet dhe konceptet etj. Antroponimet në këto anë kanë përdorim të gjerë, si një reflektim shoqëror gjithëpërfshirës, të cilat në planin përmbajtësor paraqesin një model strukturor të një koncepti të nënkuptuar (implicit) dhe përshkrimi të qartë (eksplicit). Përmbajtja e tyre është e larmishme si: antroponime konfeksionesh, të besimit katolik dhe mysliman, antroponime sipas vetive fizike, botës shtazore, botës bimë, antroponime sipas konfiguracionit, antroponime të ndryshme

Çabej, Lidhjet ilire – shqiptare, në SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 28

hipokoristika, emra fisesh, vëllezërish, barqesh dhe shtëpish etj.

Për arsye historike tashmë të ditura, të cilat edhe janë cekur më lart, sasia më e madhe e emrave vetjakë të shqiptarëve i përket grupit të dytë d.m.th. kanë mbizotëruar emrat me prejardhje të huaj: greke, romake, sllave, orientale (arabo – turke – persiane), hebraike, italiane, franceze, gjermane, spanjolle, ruse e tashti së fundi (me një vrull të paparë e me një forcë shkombëtarizuese tejte të rrezikshme) edhe anglo-amerikane. Kuptohet se e gjithë kjo mori emrash kanë pasur e kanë dënduri e shtrirje të pabarabartë në krahinat shqiptare, po edhe u përkasin periudhave a epokave të ndryshme historike dhe siç u tha, paqyrojnë fatet dhe hapat e bashkësisë shoqërore shqiptare në shekuj.

Zhvillimi dinamik i shoqërisë çdo ditë e më shumë sjellë edhe emra risimtarë fushash dhe rrafshesh të ndryshme. Sipas prof. I. Smailoviq, “ emrat e njerëzve kanë të njëjtin fat si dhe fjalët e tjera: lindin, ndërrohen, shkurtohen, vdesin, plotësisht zhduken, pastaj sërish paraqiten të rinj”.² Shfrytëzimi i materialeve mbi bazën e të arriturave të deritashme si dhe materialet e mbledhura në terren në kohën kur kam punuar si mësues i gjuhës shqipe në shkollën fillore “1 Maji” në Haxhaj të Rugovës dhe në shkollën fillore të mesme të ulët “Xhemail Kada “ në Pejë, mund të bëjmë një vështrim socioonomastik të antroponimeve të këtyre anëve sipas pikëpamjes së cekur më sipër.

5.1. Vështrim socioonomastik mbi antroponimet e besimit katolik

Në Pejë dhe rrethinën e saj jetojnë popullsi konfeksionesh të ndryshme, duke veçuar besimin mysliman, por gjurmët e kulturës materiale të besimit katolik edhe sot e kësaj dite janë mjaft të dukshme, duke filluar nga vendet e kishave e deri te toponimet e shumta. Kështu për shembull në mikrotoponimet e hasura në shumë fshatra të Pejës dhe në Rugovë si: Llazi Gjonit dhe Udhe Llazit Gjonit, ndeshim në antroponimin Gjon për të cilin P. Daka pohon se “është ndër emrat e parë dhe më të hershëm që solli krishtërimi” dhe, i njëjti autor, zënafillën e këtij antroponimi e lidh me emrin ebraik Jeho – hanon duke shtuar se ky emër “u suall në Evropë në shekujt e parë të epokës së re “³ Antroponime të këtij besimi këndeje gjetëm edhe në mikrotoponime të tjera si p.sh. Llazi Kol’s (Kolë duket të ketë dalë nga Nikollë me veprimin e aferezës), Kroni Kol’ Muj’s, Brija e Ded’s, Bregu u Kish’s, Bregu i Nike (Nikaj, është patronomikë e formuar nga antroponimi Nikollë në trajtë të apokopuar), Bregu i Luzit, Lugu i Cemit, Gropa e Lucit, Kodre Kurtit, Kodre

Ndreut, Kodre Stakut, Kodre Lek Sanik's, Maje Nik'Pep's, Sheu i Kurtit, Mrizet e Nike, Shpije Kol' Muq's, Kërshi Prele, Kroni Kol' Ded's, Kroni Nik' Ul's, Livadi Lek's, Shpelle Nek's, Kërshi Prelvuke, Livadi Martinit, Livadi Preng's, Shpelle Kol's, Maje Nik' Ded's, Gurre Mris' (Mri, mund të ketë mbetur me veprimin e dukurisë së sinkopës M (a) ri; M (ë) ri; Mri) etj. Përveç të dhënave nga fusha e toponimisë, në të mirë të pohimit se në Pejë para myslimanizmit jetonte popullata e besimit të krishterë, shkojnë edhe dëshmitë patronimike si p.sh. Palaj që edhe sot bën jetë këndeje. Duhet të vëmë në dukje edhe antroponimet e kësaj treve nga Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, i Selami Pulahës: 7) Ziameti i Deçanit, varet nga Peja; në zotërim të Hasan beut, shërbimin në ushtri e kryen në Shkodër. Fshati Rugovax, varet nga Peja

Dimitri, i biri i Dabzhivit

Bagdani i biri i tij

Bogosavi i biri i tij

Bogdani i biri i Bogosavit

Nikolla, i biri i Bogdanit

Radosavi i biri i Bogosavit

Oliviri, i biri i Radiçit

Bozhidari i biri i Radashinit

shtëpi	beqarë	të veja	Ispenxhe	grurë	thekër
69	41	6	2786	barrë 43	barrë 15
				1390	300
Taxhi	elb dhe të tjera	Lini	mullinj:2	(taksa e) perimeve	
490	barrë 30	15	60	70	
	480				
(taksa e) bletëve	bletëve (taksa e) barit	(taksa e) druve	bidati (derrve)		
130	134	138	20		
Shuma 6124 ⁴					

Për mesjetën dhe shtrirjen gjeografike të shqiptarëve në të deri më sot nuk kemi akoma studim të gjithanshëm, të thelluar, të analizuar e dokumentuar, sidomos të regjistrave kadastralë osmanë të kësaj periudhe si dhe të burimeve të onomastikës në prizmin historik dhe atë gjuhësor. Nisur nga aspekti socioonomastik mund të konstatojmë se prania e banorëve me emra sllavë dëshmon se të njëjtit të jenë shqiptarë ortodoksë me emra nga sfera e antroponimisë fetare ortodokse sllave. Nuk përjashtohet mundësia e pranisë së katolikëve dhe ortodoksëve brenda një krahine, fshati a vëllezërie. Së këndejmi, përpjekjet e historiografisë së huaj për këtë periudhë, gjoja për praninë e banorëve sllavë gati në të gjitha fshatrat e rrethit të Pejës nuk mund ta tumirim, përkundrazi një konstatim i tillë nuk qëndron për vet faktin se në disa fshatra, sidomos në Rugovë, nuk ka pasur as edhe një herë banorë sllavë dhe se raporti i sllavëve me banorët vendës nuk mund të matet vetëm se këta emra po i përkisnin onomastikës sllave, mund të flasim vetëm për faktorët politikë e fetarë si dhe për zonën kufitare të kontaktit për shekuj me radhë. Mund të supozojmë se antroponimet sllave mund të jenë përdorur vetëm në regjistrat administrativë e fetarë të kohës, me kompromis të vet banorëve, karshi emrave autoktonë, gjë që meriton trajtim të mëtejshëm. Mund të marrim një shembull të mëvonshëm, bie fjala bajraktarin e Hotit, (Deli) Met Çuni nga Malësia e Madhe, i cili për të parandaluar një sulm ushtarak turk të nënshtrimit të të gjithë Malësisë së Madhe, me kompromis pranoi konvertimin e fesë dhe ndërroi edhe emrin, duke parandaluar konvertimin e mëtejshëm të zonës. Përpos antroponimeve dhe patronimeve, nga të dhënat e Defterit kuptojmë edhe shumë veçori të tjera të cilat ndihmojnë për të ndriçuar më mirë aspekte të jetës dhe punës në Pejë me rrethinë. Përpos numrit të banorëve, shtëpive, beqarëve, të vejave etj., shohim edhe kushtet e jetesës përmes veprimtarive të shumta si mbajtja e bagëtisë dhe ushqimit të tyre me barë (sanë) dhe taxhi gjatë stinës së dimrit e kullotave gjatë stinës së verës, zhvillimi i bletarisë, që edhe sot e kësaj dite ofron kushte të jashtëzakonshme, me ç'rast kuptojmë edhe shumëllojshmëri të florës, si kusht të domosdoshëm për zhvillimin e saj, sigurimin e ushqimit, grurit, thekrës, druve për ngrohje, dhe mullinjëve për bluarje.

Kuptojmë, po ashtu edhe varësinë nga pushteti përmes pagesës së taksave, argument ky që

2. I. Smailoviq, MIOPBH, Sarajevë, 1977, f. 13.

3. P. Daka, Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe, në Kon. e dytë të stu.alb., Tiranë 1969, f. 278

e forcon tezën tonë se antroponimet sllave në rend të parë kanë qenë antroponime administrative.

Edhe prof. Demiraj duke folur për përpjesëtimin e elementit anas ndaj elementit të huaj shton: Është një gjë e ditur që gjuhët, qofshin të një familjeje apo familjesh të ndryshme, gjatë kontakteve historike marrin e japin midis tyre. Kjo dukuri nuk njeh përjashtime. Natyrisht disa gjuhë, për arsye të ndryshme i janë nënshtruar një ndikimi të huaj më të fuqishëm. I tillë është sidomos rasti i gjuhëve të atyre popujve, që kanë mbetur për një kohë të gjatë nën sundimin e huaj, siç është p.sh. rasti i gjuhëve ballkanike etj.⁵

5.2. Antroponime myslimane

Ndikimi i turqve gjatë sundimit të tyre shumëshekullor në trojet tona që shumëdimensional në të gjitha fushat dhe porët e jetës. Populli shqiptar gjatë këtij sundimi përjetoj të dëbohej me forcë, me ndarje, me shpërngulje, me denatyrim, duke provuar të gjitha mënyrat e errësimit, zvogëlimit dhe uljes së qëllimshme të vlerave ekzistuese, përmes përgojimeve, si asnjë popull tjetër në Ballkan e që e gjithë kjo ende nuk është shpjeguar nga historiografia shqiptare.

Dominimi shumëvjeçar turk tek popujt e Ballkanit në përgjithësi, ndërsa tek populli shqiptar në veçanti, ravijëzoi ndikime të mëdha në fusha të ndryshme të veprimtarisë, me theks të veçantë islamizmin, fenë e re, që u shtri edhe në fushën e antroponimisë duke vënë në përdorim një numër të madh emrash vetjakë myslimanë të gurrës orientale që edhe sot janë të shpeshtë në Pejë me rrethinë. Ashtu si edhe në fusha të tjera, mungesa e të dhënave shkrimore të duhura për kohën akoma mbetet e hapur. Me këtë rast ne do të pikëzojmë ca shkëndijëza në këtë drejtim. Kësaj çështjeje mund t'i përgjigjet vetëm ndonjë supozim analog me anë të tjera të Kosovës apo edhe më gjerë. Në këtë plan, duke e ndriçuar çështjen e përkatësisë etnike dhe fetare të popullatës së Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI prof. M. Tërnavë, ndër të tjera, shkruan: "... popullsia e besimit islam të Prishtinës brenda jo plot një shekulli, nga viti 1487 kur numëronte 51 shtëpi, në këtë kohë, midis viteve 1566 – 1574, kishte arritur t'i ketë 309 shtëpi".⁶ Kështu brenda kësaj periode dhe më vonë, sipas pohimeve të historianëve bie në sy rënia e dukshme e

4. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f.113

5. Demiraj, Shaban, Gjuha shqipe dhe historia e saj, ASHRSH, Onufri, Tiranë, 2013, f. 1866.

6. Tërnavë, Muhamet, Popullsia e Prishtinës në gjysmën e dytë të shekullit XVI..., në DK Prishtinë, 1979, f. 112.

numrit të popullsisë së krishterë dhe rritja e vazhdueshme e popullsisë me përkatësi fetare islame që, njëkohësisht, është rezultat i zhvillimit të procesit të islamizimit dhe i pranimit të tij nga popullata e krishterë. Ndërkaq, prof. M. Krasniqi vë re se me 1591 më se 420 familje shqiptare të Podrimes kishin antroponimi të përzier katolike e myslimane që dëshmon se “ procesi i islamizimit të shqiptarëve në këtë kohë kishte marrë përmasa të mëdha”.⁷

Edhe pse “Në trevat malore, ku osmanët nuk ushtronin një autoritet të fortë, popullsia i bëri ballë me lehtësi trysnisë islamizuese dhe e ruajti fenë e mëparshme”,⁸ potencojmë se treva e Rugovës së Pejës ishte madje kalaja e fundit e islamizimit. Këtë të dhënë e hasim dendur edhe në krijimet nga letërsia popullore edhe nga të dhënat e të parëve, gjë që vërehet edhe nga etnogjenezat familjare rugovase.

Do të ishte me interes socioonomastik të veçonim rastin në Shkrel (Shqipëri), pikërisht në pjesët fushore e më pak të mbrojtura ku shkeli turku do të bigëzohej edhe besimi: njëra lagje mbeti katolike dhe mban mbiemrin Ndreaj, kurse tjetra u kthye në besimin mysliman dhe u quajt Isufaj.⁹, andaj me të drejtë kjo problematikë quhet bigëzim socioonomastik shqiptar, sepse faktori shoqëror në këtë rast është parësor për zhvillim ngjarjesh sipas kësaj kronologjie. Bazuar në të dhënat e përgjithshme si dhe deri diku në bazë të emrave të breznive vendëse që i shënuam në terren p.sh. *Arbnori*, *Arbnor Agroni*, *Agroni*, *Agron Mehmeti*, *Mehmeti*, *Mehmet Sadiku*, *Sadiku*, *Sadik Bajrami*, *Bajrami*, *Bajram Nimani*, *Nimani*, *Niman Hyseni*, *Hyseni*, *Hysen Aliu*, *Aliu*, *Ali Gera* dhe raste të tjera të ngjashme supozojmë se në gjysmën e dytë të shekullit XVII duhet kërkuar me saktësi koha e islamizimit të popullatës kur edhe u përhapën antroponimet fetare myslimane në këto anë. Sido që të jetë, duke qenë zonë malore dhe anësore, islamizmi në këtë anë nuk ka mundur të depërtojë shpejt dhe krahas me anë të tjera.¹⁰ As për mënyrën e pranimit të islamizimit të banorëve të këtyre anëve nuk ka të dhëna bindëse. Të moshuarit këtë e shpjegojnë se kinse feja islame u është dukur më e mirë¹¹

7. Krasniqi, Mark, Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike, në OK, Prishtinë, 1979, f. 385

8. Shpuza, G. Islamizimi ndër shqiptarët, në KP, 1-2, 1995, f.161

9. Shkurtaj, Gjovalin, Onomastikë dhe etnolinguistikë, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 23

10. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 443.

11. Shumë informatorë si Shaban Haxhiu, Smajl Arifi, Bali Shabani, Mehmet Çela etj., që të gjithë mbi të nëntëdhjetat, kanë shpjeguar se feja myslimane u është dukur më e mirë, për çka edhe kanë kaluar në besimin islam.

Ne na duket se edhe këtë çështje do parë në mënyrë analoge me treva të tjera; në fillim kanë kaluar në fenë islame vetëm meshkujt me qëllim që të shpëtojnë ose, së paku, të lehtësohen nga pagimet dhe tatimet e ndryshme e pastaj ky proces është bërë i përgjithshëm. Në anën tjetër, duke qenë përherë në përballje të ashpërta me pushtuesit, duke qenë prore në papajtueshmëri me sistemin, klasën sunduese, grupin shoqëror imponues, duke pësuar në vijimësi veprimtari goditëse të organizuara dhe të zhvilluara nga sistemi shoqëror, duke qenë në shënjestër të mposhtjes dhe asgjësimit, mund të themi se banorët, si vetqeverisës, domosdoshmërisht pranuan regjistrimin e përgjithshëm të tokave, më 1506 dhe sipas dispozitave themeltare të regjimit feudalo – ushtarak dhe të marrëdhënieve shoqërore – ekonomike, po ashtu pranuan që pushtetit osman t’i jepnin një taksë (haraç) fikse, dhe ndryshe nga timaret, që aplikoheshin në të 32 vilajetet e Perandorisë Osmane në trojet shqiptare, si edhe në zonat e tjera quhej zonë haraçi. Zaten, kjo edhe nuk nënkuptonte nënshtrim, por bindje për palën kundërshtare se veprimtaria e këtyre anëve dhe gjithçka tjetër i shërbente asaj, prandaj këtë me të drejtë edhe mund ta quajmë luftë politike, ideologjike, ekonomike dhe diplomatike. Duke bërë fjalë rreth çështjes së islamizmit A. Hanezhiq konstaton: “Problemi i islamizmit në historiografinë tonë ende nuk është fare i ndiçuar”.¹²

Po ky autor vë në spikamë se rreth këtij problemi të rëndësishëm, sidomos rreth fillimit të këtij procesi dhe intensitetit të tij, ka pikëpamje të ndryshme. Ndërkaq I. Smailoviq, përkritazi me këtë çështje shton: “Problemi i islamizmit të banorëve tanë edhe më tutje kërkon analizën dhe sintezën e vet shkencore pa të cilat nuk mund të jepen mendime të sigurta. Kjo punë u përket gjithsesi historianëve “. ¹³ Sidoqoftë, me pranimin e fesë së re islame, është dashur që të pranohet edhe emri vetjak ” si shënim formal i përkatësisë së religjionit të ri “. ¹⁴ Pra, emrat myslimanë të gurrës orientale (me origjinë arabe, turke, persiane) kanë hyrë tek ne si pasojë e islamizimit të popullatës. Sa për studimin e emrave myslimanë, mund të thuhet se krahas ndonjë vështrimi të mëparshëm, më thellë dhe më gjerë gjurmohen në veprën leksikografike të A. Shkaliqit me titull: “ Turqizmat në gjuhën serbokroate ”, ¹⁵ sipas veprës së I. Smailoviqit në të cilën, në mes të 8742 fjalëve, gjenden

12. Hadzic, A., O islamizaciji u sjeveroistočnoj Bosni, Prilozi za orijentalnoj filologiju, SV XVI-XVII, 1966-67, Sarajevo, 1970, f. 5. 13. Smailoviq, I., MIOPBH, Sarajevë, 1977, f. 49.

14. Po aty, f. 49.

15 Skalic, A., Turcizmi u srpskohrvatskom jeziku, izd. Svjetlost, Sarajevë, 1965.

edhe 875 emra vetjakë myslimanë. Këtyrë antroponimeve autori u qaset nga këndvështrime të ndryshme si: aspekti burimor, kuptimor, prekja e çështjes së theksit të tyre etj.

Një kontribut të madh në fushën e kërkimit të emrave vetjakë myslimanë jep prof. I.

Smajloviq¹⁶ i cili i mblodhi dhe i analizoi gjithanshëm 3073 antroponime myslimane të gurrës orientale të të dy gjinive në territorin e Bosnjës dhe të Hercegovinës, duke përfshirë këtu edhe hipokoristikat. Antroponimet myslimane në anën e hulumtimit tonë kishin shtrirje më të tepërt në të kaluarën, por që sot nuk kanë shtrirje të gjerë. Nga antroponimet e këtilla, ashtu sikundër edhe nga antroponimet e tjera shkojnë edhe formohen edhe patronime që, siç dihet, kanë jetë më të gjatë se antroponimet. Emrat e marrë nga sfera fetare shpeshherë shkojnë dhe lidhen me emrin e ndonjë feste të besimit të popullatës; në rastin tonë është i shpeshtë për shembull emri Bajram i burimit oriental (nga tur. dhe pers. “bayram” - festë, argëtim). Në FGJSSH ka këtë sqarim: Bajram m. fet. Emër i dy festave fetare kryesore të myslimanëve, që festohen pas ramazanit (në vendet ku vepron feja myslimane). Bajrami i madh (i vogël)¹⁷.

Pikërisht, antroponimi i dalë nga kjo festë i përdorur mjaft dendur në këtë trevë, në rrjedhë kohe, në aspektin socioonomastik përshkohet në rend të parë po nga aspektet shoqërore, dëshirën e prindërve që edhe emri i fëmijës së tyre të shërbejë për fisnikërimin e shpirtit dhe rritjen e besimit në vlerat më sublimë të njeriut, këtu është shprehur qëllimi i vërtetë social i cili duhet të jetë shembull dhe mësim i sakrificës për të tjerët. Morali islam këtë sakrificë e konsideron një nga virtytet më të larta të njeriut dhe si nevojë morale të shoqërisë. Prej kësaj rrjedh parimi i njohur i moralit islam: “Njeriu më i mirë është ai prej të cilit kanë dobi njerëzit, kurse më i keqi është ai cili u bën dëm atyre”. Ky emër rëndom u jepet fëmijëve që pagëzohen në këtë festë fetare myslimane ose edhe në prag të saj. Duke shkruar për këtë antroponim I. Smailoviq thotë:¹⁷ “ Kësi emri zakonisht i jepet fëmijës që lind ditën e parë të kësaj feste.

Duke bërë fjalë rreth emrave fetarë prof. M.Krasniqi, ndër të tjera, thekson: “Në lidhje me emrat nga sfera bie në sy që prindërit në këto raste dëshirojnë që fëmija i tyre të pagëzohet me emrin e ndonjë shejti të njohur”.¹⁸

16 Smailoviq, I., MIOPBH, Sarajevë, 1977, f. 49

17. FGJSSH, Rilindja. Prishtinë

18. Krasniqi, Mark, Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike, në OK, Prishtinë, 1979, f. 386

Vështruar nga ky kënd, këndeje përdoret emri Muhamet nga tur. dhe ar. që do të thotë shumë i lavdëruar, i festuar¹⁹. Emri Muhamet është shumë i shpeshtë tek të gjithë popujt e islamizmit, sepse kështu është quajtur themeluesi i tyre.

Sipas një gazetaresje spanjolle ky emër është më i përhapuri në botë, ajo pohon se afro 150 milionë njerëz në botë e bartin këtë emër, madje është mbizotërues si në Indi, Pakistan, Bangladesh etj., po ashtu, ajo bën me dije se ky emër është i përhapur edhe në vende të tjera me ndryshime leksikore, hipokoristike, shënimi ynë, p. sh.:

- Në Turqi: **Mehmet**;
- në vendet e Azisë: **Mohamed**;
- në vendet e shkretëtirës afrikane: **Mamadou**;
- në Bosnjë: **Meho**;
- në disa provinca të Francës: **Meho**.

Për nga përhapja është i gjashti në mbretërinë e Britanisë së Madhe, po ashtu ky emër ka shtrirje të konsiderueshme tek myslimanët në Spanjë.

Përdorim të dendur ka nga refugjatët myslimanë në vende të ndryshme të botës. Aspektet fetare ndërlidhen me jetën familjare dhe shoqërore, ky emër lidhet edhe me ritualet përmes besimit deri te veprimtaria shoqërore dhe ndihmesa sociopsikologjike në të gjitha aspektet: individuale, shoqërore, ekonomike, politike dhe shpirtërore. Sigurisht se ky antroponim jep një kontribut jo të vogël për qëndrueshmërinë sociale dhe si i tillë ka një rol social, gjithashtu edhe për rregullat të cilat duhet të zbatohen duke u bazuar në aspektet shoqërore. Në një farë mënyre, kjo emërvënie vë rregulla humane në jetën sociale, është një emër ritual tek i cili aspektet shpirtërore duhet të reflektojnë më shumë sesa ato fizike, familjare etj. dhe t'i përkushtohet vetëm çështjes shoqërore, besimore, ndjenjësore, psikologjike, sociale, etj.

Në vazhdim po i paraqesim disa emra myslimanë orientale që janë përdorur më herët apo që përdoren edhe sot në Pejë me rrethinë, duke e sqaruar burimin dhe domethënien e tyre në gjuhën tonë. Avdyl, mendojmë se është hipokoristik nga emri Avdullah, i cili rrjedh nga ar. “abe” - rob, shërbëtor dhe “allah” - Zot; se Avdyl është shkurtim nga Avdulla e dëshmon edhe mendimi i G. Elezoviqit²⁰: “Avdyl – pa dyshim është hipokristik nga emri

19. Smailoviq, I., MIOPBH, Sarajevë, 1977, f. 363

20. Elezoviqit, G., RKMD S I Beograd, 1932 f. 3

Avdullah, Adem (prej ar. Adam – lloj njeriu), Agan (nga tur. Aga – zotëri, udhëheqës), Ahmet (nga ar. Ahmad – i lavdëruar), Ajshe (ar. e gjallë, ekzistuese), Ajete (nga emri mashkullor Ajet me formantin – e), Ali (ar. i gjatë), Beqir (tur. Bekir – fëmija i parë i lindur); etimologjinë e këtij antroponimi I. Smailoviq e paraqet të diskutueshme Beqë, hipokoristik nga Beqir, Bedri (ar. Hënë e plotë), Bedri, me ndërrimin e vendit të theksit, nga emri mashkullor është bërë emër i gjinisë femërore, Begie (tur. Beg), Brahim, Ibrahim, Braho (hipokoristik nga Ibrahim), Bektesh (pers. i rritur, i njëjtë), Bekë (shkurtim nga Bektesh), Behare (pers. pranverë), Qerim (modifikim nga Kerim), Deli (tur. i fortë), Dervish (pers. i varfër), Xhemajl (ar. bukuri), Xhemë (hipokoristik nga Xhemajl), Xhevahire (tur. gur i çmuar), Xhevdet (tur. shq. kualitet i lartë), Gjylë (pers. shq. lule), Emin (tur. shq. i ndershëm), Emine (nga Emin me formantin - e), Enver (tur. shq. shumë i ndritur), Fadil (tur. shq. i jashtëzakonshëm, i shkëlqyeshëm), Fahrie (tur. shq. e mburrur, autoritative), Fatime (në përkthim nga ar. dmth. “ e larguar nga gjinjtë “), Fazli (tur., shq. i mirë, i merituar), Gani (ar. shq. i pasur), Haxhi (në Pejë, siç thuhet në terren rëndom i jepet fëmijës që pagëzohet në festën myslimane Haxhi – Bajram); emri Haxhi zakonisht për festën fetare të Haxhi – Bajramit u dhënka edhe tek popullata myslimane e Bosnjë dhe Hercegovinës. Hajdar (tur. shq. luan), Hajrie (tur. shq. Fatlume), Haki (ar. shq. i drejtë, i vërtetë), Halil (ar. shq. mik i besueshëm), Halime (ar. shq. e butë, e kujdesshme), Hasan (tur. shq. i bukur), Hazir (ar. shq. i kujdesshëm, i përgatitur), Hysnie (ar. shq. e bukur), Ibrahim (ar. shq. baba i popullit), Ibër (hipokoristik nga Ibrahim), Idriz (burimi i paqartë), Islam (ar. shq. thirrje e religjionit mysliman), Ismet (tur. shq. ruajtje, mbrojtje), Jah (hipokoristik nga Jahja); emër me burim të diskutuar; Jashar (tur. shq. ai jeton), Kadri (ar. shq. ai që është i lidhur për fatin dhe dëshirën e Zotit), Kapllan (tur. shq. tigër, leopard), Kumrie (ar. shq. zog), Kurt (tur. shq. Ujk), Mehmet (tur. shq. i festuar), Muharrem (ar. shq. i ruajtur, i ndaluar), Musafë (tur. shq. i zgjedhur), Naim (tur. shq. i butë), Nezir (ar. shq. ai që tërheq vërejtjen të shkohet rrugës së drejtë), Nuria (ar. shq. dritë), Osman (ar. shq. “zog i ri” ose “gjarpër i ri”; se si u bë emër i përveçëm është vështirë të thuhet, por është e besueshme sipas I. Smailoviqit, të jetë emër mbrojtës; Osman është quajtur edhe themeluesi i shtetit të pavarur turk sipas të cilit edhe është quajtur p.sh. sundimi osman; Pakize (pers. shq. e pastër), Rabë (hipokoristik nga Rabie), Ramadan (ar. emri i muajit të nëntë të islamit), Ramë (hipoko. nga Ramadan), Ramiz (ar. ai që tërheq vërejtjen në diçka,

që shprehet figurativisht), Rexhep (emri i muajit të shtatë të numërimit fetar mysliman i muajve), Rexhë (hipoko. nga Rexhep), Rizë (ar. shq. kënaqësi), Rrustem (pers. shq. i fuqishëm, i shq. i singertë), Sadie (ar. shq. fat), Sadri (ar. i pari i fesë), Salih (tur. shq. i mirë), Selim (ar. shq. i shëndoshë, i ruajtur), Serbeze (tur. shq. e lirë), Skënder (tur. shq. mbrojtës i njerëzve), Sylë (hipoko. nga Sylejmani), Shaban (emri i muajit të tetë në numërimin islam të muajve), Shiqere (pers., shq. ëmbël), Shehrie (pers., shq. Qytet), Sherif (ar., shq. i parë, autoritativ), Tahir (ar., shq. i pastër), Zajm (tur. shq. udhëheqës), Zarife (ar. shq. e bukur), Zizë (hipoko. nga Hazize) etj.

Nga sa u pa në aspektin socioonomastik, të gjitha antroponimet e përmendura në rend të parë kanë vlerat morale dhe se kuptimi i tyre reflekton pikënisjen dhe dëshirën e prindërve për fëmijët e tyre që ata të jenë shembuj veprash të mira. Rëndësia dhe vlera e madhe në përmbajtje e këtyre antroponimeve është e lidhur me fenomene të rëndësishme të cilat paraqesin simbolikisht ide të e larta dhe domethënëse për mbarë njerëzimin. Të gjitha kuptimet paraqesin ide të shëndosha e përparimtare që kanë shpërndarë retë e errëta të mosdijes, duke arritur kulmin e madhështisë, duke prezantuar qytetërim, fuqi, vlerë, kulturë, dinjitet etj., si faktorë të rëndësishëm të bashkësisë njerëzore. Rëndësia dhe vlera e madhe e kuptimësisë së këtyre emrave është e lidhur edhe me ndërgjegjen e pastër, manifestimin e barazisë dhe paqes dhe gatishmërinë për mbrojtje të nderit, gjuhës dhe traditës. Të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh profesionin e prindërve, pozitën dhe shtresën shoqërore që përfaqësojnë, kanë njësoj të drejtë për emërmarrje, madje as titujt dhe pozitat shoqërore nuk favorizojnë asnjërin, (bajraktarë e udhëheqës luftarakë), të gjithë janë të barabartë. Shumica e emrave provojnë durimin dhe qëndrueshmërinë, e kjo në këtë trevë ishte më se e domosdoshme, andaj përmes emrave të tillë edhe marrim porosi të qarta se si do të duhej të dukeshin në mendjen e banorëve emërbartësit, me theks të veçantë në dëshirën kolektive që ata të kenë virtyte të larta njerëzore. Antroponimet në një farë mase simbolizojnë domosdoshmërinë e mënjanimi nga të gjitha veset negative dhe synimin për lavdinë, famën, të vërtetën, trimërinë, guximin etj. dhe secili sish ngërthen në vete shumë data, shumë ndodhi, shumë histori. Mjafton që në tëpamje të vështrojmë kuptimin e emrave të besimit mysliman: zot, udhëheqës, i lavdëruar, dritë, gur i çmuar, luan, baba i popullit, i festuar, i jashtëzakonshëm, i shkëlqyeshëm etj., që të kuptojmë një gjithëpërfshirje përmbajtësore në të gjitha etapa të caktura kohore, që nga

islamizimi e këndej. Siç mund të shihet edhe nga shembujt e sjellë, emrat myslimanë të burimit oriental në anë të Pejës me rrethinë janë mjaft të shpeshtë madje, po të shikohen në krahasim me emra të ndonjë burimi tjetër, mund të thuhet se zënë vendin më të madh në antroponiminë e kësaj treve. Siç u shtruan edhe më lartë, ata në përgjithësi shprehin cilësi të mira dhe të çmuara morale dhe fizike, ose mbajnë emrin e ndonjë shtaze të njohur e me të cilën është menduar të mbrohej fëmija; ka edhe mjaft raste kur përmes antroponimeve të këtilla shprehet respekti ndaj besimit fetar të fesë përkatëse etj.

Vlen të theksohet se në fillet e pranimi të fesë së re e njëkohësisht edhe të emrave myslimanë të gurrës orientale, popullata, siç dëshmohet edhe në terren, nuk e dinte domethënien e antroponimeve të tilla, gjë që nuk kishte ndodhur vetëm në anën tone, sepse kjo dukuri ka qenë e përgjithësuar. Një dukuri të tillë sot e hasim pak ose fare pak. Përkritazi me këtë çështje prof. I.Smailoviq, ndër të tjera shkruan: “janë të pakët ata që ia zgjedhin emrin oriental fëmijës së vet të vetëdijshëm për domethënien e tij”.²¹ Kjo vlen edhe për anën e hulumtimit tonë. Së këndejmi, shihet nevoja e madhe që për këtë grup antroponimesh të shkruhet dhe të shpjegohet domethënia e tyre edhe në gjuhën tonë.

21. Smailoviq, I., MIOPBH, Sarajevë, 1977, f. 172

5.3. Antroponimet sipas vetive fizike

Emëdhënia sipas vetive fizike të personit duke përfshirë këtu edhe paragjykimet dhe besimet e ndryshme të prindërve në dukuri të mbinatyrshme me rastin e pagëzimit të fëmijës është një rrugë mjaft e ngjeshur e kërkimit dhe e marrjes së emrave vetjakë. Ishte dëshirë e prindërve që fëmijët e tyre të kishin veti dhe cilësi të atilla çfarë përmbanin në të vërtetë edhe kuptimet e antroponimeve përkatëse.

Në të shumtën e rasteve, duke mos qenë në gjendje të shpjegojnë fenomenet dhe dukuritë natyrore, prindërit përmes këtyre antroponimeve të këtij grupi apo edhe të ndonjë grupi tjetër, në mendjet dhe psikologjinë e tyre shihnin mbrojtjen, fatin dhe shëndetin e fëmijëve të tyre.

Emri Bardh, antroponim i këtij grupi, pa dyshim zgjoi interesim të veçantë të hulumtuesve të derisotëm, emër të cilin e hasëm në shumë fshatra si dhe në fshatin Kuçishtë, me ç'rast në të njëjtin fshat ekziston edhe si patronim me sufiksin e njohur patronomik –aj, Bardhaj; në fshatin Bogë, Ruhot, Kosuriq, Novosellë etj. edhe sot e hasim antroponimin Bardh, Bardhec e të gjinisë femërore Fatbardha, në fshatin Dugaivë të Rugovës deri tash vonë rrënja bardhë bënte jetë në antroponimin e gjinisë femërore – Bardhe; në fshatin Haxhaj ekzistonte deri vonë antroponimi Bardhec dhe një Bardhec gjetëm të ketë ekzistuar edhe në Shtupeç të Vogël e që edhe sot po ruhej në toponimin Livadi Rexhep Bardhecit etj. Shihet pra se ky antroponim kishte shtrirje të gjerë edhe këndeje. Po me një këso shtrirje këtë antroponim e gjejmë edhe nëpër treva të tjera shqiptare p.sh. “Bardheci (në Grabanicë të Rrafshit të Dukagjinit), Sadik Bardhecaj dhe Bardhani në Dobërdol e Perqevë të Llapushës (Prekorukës), Bardiqt në Gradicë të Drenicës”.²³ Në Defterin e regjistrimit të vitit 1485 e shohim në trajtat e Bard, “Bardo, i biri Lazarit” Bardi, i biri i Gjergjit”²⁴ etj. Sidoqoftë, shihet se kemi të bëjmë me një antroponim mjaft të hershëm që kishte sikundër ka edhe sot përhapje të gjerë; siç ka vënë re linguisti shqiptar prof. E. Çabej ky antroponim është një nga shembujt e shumtë që flasin në të mirë të bijësisë ilire të shqipes tek del, në ilirishtet, me trajtat Bardius, Bardyllis, Bato etj. e “ që ngjan të përmbajnë të gjitha fjalën Bardhë ”²⁵.

23. Doçi, Rexhep, Onomastika e shqiptarëve të Llapushës, punim magjistrature faq. 32-33.

24. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 436

25. E. Çabej, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 28.

Kjo, pra lidhja shqiptare-ilire në fushën e onomastikës tashmë është një çështje e mirëditur dhe e pohuar nga shumë dijetarë ndër të cilët edhe nga arkeologu i Arbanasit të Zarës A. Stipçeviq, i cili duke bërë fjalë për këtë problematikë, veç të tjerash thotë: “ Emra shqiptarë qartë me origjinë ilire ka aq sa prania e tyre duhet të vlerësohet si një ndër lidhjet më të forta ndërmjet shqiptarëve dhe ilirëve të vjetër”²⁶.

Shikuar nga ky kënd, edhe Peja me rrethinë është një nga trevat e shumta shqiptare ku vihen re lidhjet gjenetike onomastike ilire-shqiptare. Fjalën bardhë, në strukturë antroponimike e gjetëm edhe në fshatrat Zahaq, Malaj, Jabllanicë e Vogël, Treboviq, Pepiç, në kompozitën antroponimike Fatbardhe. E hasim në përdorim të shpeshtë edhe tek emrat e shtazëve p.sh. emra lopësh: Bardhanë, Bardhukë, Bardhujë; si emër kau: Bardhoj’; emër qeni: Bardhosh; emër deleje: Bardhok’; emër dashi: Bardhukan; emër cjapi: Bardhec etj., po ashtu ata që e kishin ngjyrën e lëkurës të bardhë në të trëndafilte në këto anë quheshin Bardhavela, etj. Ky antroponim na del të jetë mjaft i shpeshtë, i strukturuar dhe i shtresëzuar, kujtojmë se me fjalën bardh ngërthejnë në vete edhe elemente etnografike.

Nga aspekti socioonomastik emrat vetjakë Bardh dhe Bardhe në ndërdije në të shumtën e rasteve emërtoheshin me paragjykimin se emërbartësit do t’i përcjellë fati i mirë dhe lumturia në jetë, se ata do të ndritin me një dritë të hapët në ngjyrë të qumështit, të borës, të pambukut etj. dhe se në jetë do të shkëlqejnë si rrezet e dritës. Po në këtë grup emrash bën pjesë edhe antroponimi Qorr e nga ky edhe patronimi Qorraj që përdoret edhe sot në fshatin Drelaj dhe Pavlan; në fshatin Dugaivë gjetëm të jetë përdorur para disa breznish njëfarë Mujë Qorri; ²⁷ me emrin Qorr është quajtur edhe një fytyrë historike e Llapit që ruhet në këngën popullore, Qorr Ilazi.

Në këso rastesh, siç kemi konstatuar edhe më herët, antroponimi e nga ky edhe patronimi, shohim të mbetet sipas një veçorie fizike të personit.

Të kësaj dore janë edhe emrat apo mbiemrat Topalli, Shurdhani e ndonjë tjetër.

Mendojmë se duhet parë dy mënyra të përhapjes së antroponimeve të këtilla: një, zyrtare, që duke dalë nga përdorimi i ngushtë i një rrethi shoqëror me kohë merr shtrirje të gjerë përdorimi dhe një tjetër jo zyrtare, që gjithashtu mbetet sipas një veçorie të personit, por që më tepër përdoret me kuptim pejorativ nga një rreth i ngushtë shoqëror dhe si trajtë

26. A. Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë, 1967, f. 169.

27. Qorr turqizëm, shqip i verbër.

përbuzëse nuk popullarizohet. Përdorimi i emrave sipas një veçorie ose një të mete fizike²⁸.

Në trevën e studimit tonë janë të shpeshta edhe antroponimet Mire, Mirashe, Bute, Mirushe etj., që kanë për bazë mbiemrat e mirë, e butë, e trashë²⁹. Antroponimet me rrënjën mirë, Shuflaj³⁰ me të drejtë i cilëson si emra shqiptarë, si edhe i kishte parë: Mira, Miran, po ashtu në Defterin e vitit 1485 është regjistruar një Mirash³¹ etj.

Nga aspekti social tek këto antroponime kuptojmë qartë dëshirën e prindërve që fëmijët e tyre t'i përcjellin në jetë cilësi të atilla çfarë shpreh atributi sipas të cilit formohet emri, i mirë, i pastër, i panjolllosur, i çiltër, bujar, që në jetë do të sjellë të mira. Po ashtu, mund të konstatojmë se ky antroponim në këtë trevë na del edhe nga figura e mitologjisë popullore, e mirë, e ngjashme me zanën, orën etj.; secila nga të tri gratë që, sipas mitologjisë popullore, i presin fatin një foshnjeje pranë djepit të saj natën e tretë pas lindjes ose që u ndihmojnë njerëzve kur këta ndodhen ngushtë; fati i mirë, fati, e mira e malit (e bjeshkëve), shpella e të mirave, thirri të mirat në nevojë, desh e mira e nuk zgjati shumë, e solli e mira shëndoshë në shtëpi etj. Në fshatin Shkrel kemi një antroponim të rrallë, Kaçun, analog me Kaçelin e Fishtës, për të cilin mendoj se rrjedh nga trëndafili i egër, kaçëja, bimë barishtore e vogël, që nxjerr në fillim të pranverës lule me petla të bardha në të verdheme a në ngjyrë vjollce dhe që ka në rrënjë një zhardhok me shijen e pjeprit të papjekur, mbase këtë mund ta ilustroj edhe me vendlindjen e Kaçunit, që është përplot me kaçë, madje meqë këto lule dalin në vjeshtë, mund të konstatojmë edhe stinën e lindjes së të njëjtit, vjeshtën. Emri në fjalë, në një masë përshkruan konfigurimin e terrenit. Në fshatin Dugaivë ekziston edhe sot antroponimi Keq; në fshatin Kuçishtë antroponimi Keq ruhet në mikrotoponimin Hani Keqit, i cili antroponim është marrë nga mbiemri i keq. Këtij antroponimi mund t'i qasemi edhe nga këndi social, ngase lindja e tij supozojmë të ketë ndodhur në gjendje a kushte të vështira ekonomike, në vështirësi, me zor, gjë që ka qenë e zakonshme këndeje, po edhe të ketë lindur në gjendje të keqe shëndetësore ose parashikimi i së ardhmes së tij, e ngushtë, e ligësht, e keqe e më keqe, ose gjallë e keq, do të rrojë (jetojë) keq.

28. Shuflaj, Milan, Historia e shqiptarëve të veriut, Prishtinë, 1968, f. 53.

29. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 447.

30. Shuflaj, Milan, Historia e shqiptarëve të veriut, Prishtinë, 1968, f. 53.

31. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 171

S'ka dyshim se emri Keq mbyll në vete sikundër edhe ndonjë antroponim tjetër me elemente etnografike, elemente të besimit të hershëm pagan të popullatës, të besimit në forca të mbinatyrshme, kur mendohej se fëmijën mund ta marrë ndonjë figurë mitologjike. Mendimit tonë për këtë gjë sikur i jep krah fakti se ky antroponim herët përdorej në familje ku nuk jetonin fëmijët, prandaj me dhënien e këtij emri, mendohej se fëmija do të jetojë.

Mendojmë se tek ky antroponim kemi të bëjmë me emër mbrojtës. Mirëpo, në kushtet e sotme të zhvillimit shoqëror, arsimor e kulturor, me depërtimin e së resë në fusha të ndryshme të veprimtarisë, me njohjen e fenomeneve të ndryshme dhe me kundrimin dialektit të botës, popullata po shkarkohet nga paragjykimet e hershme dhe nga besimet e ndryshme pagane dhe mistike sipas të cilave emri do t'a mbrojë fëmijën nga veprimi i fuqive të mbinatyrshme si dhe nga veprimet e ndryshme magjike, prandaj ky antroponim më nuk po përdoret.³² Konsiderojmë se mbështetje në besimin pagan dhe në dukuri mitologjike, sipas të cilave emri mund të ndikojë edhe në përcaktimin e gjinisë, kanë edhe antroponimet femërore Cubë dhe Shkurtë që i hasëm në Dugajevë dhe Stankaj, pastaj Sose dhe Dnore që i gjetëm në Shtupeç të Madh e që, kujtojmë janë formime nga foljet sos dhe dnoj³³. Këso antroponimesh, siq thuhet edhe në terren, janë dhënë në rastet kur në familje lindnin vetëm vajza. Në këtë mënyrë është menduar se emri mund të shënojë ndryshimin e gjinisë së fëmijës.

5.4. Antroponime sipas botës shtazore

Rugova si krahinë etnogeografike ka karakteristikat dhe specifikat e veta, si territor kodrinor-malor. Një pikë të rëndësishme të hulumtimit onomastik në këtë trevë pa mëdyshje e paraqet edhe emërtimi i personave, gjegjësisht i familjeve sipas emrave të shtazëve të buta shtëpiake dhe të atyre të egra, emërtim ky që gjatë të gjitha hulumtimeve të bëra deri më sot, ka zgjuar kureshtjen e shkencëtarëve për vet mënyrën emërtuese. Kështu prof. Çabej përmend shembullin Gjin Bua Shpata; bua, trajtë e vjetër e buallit ose Muzak, muzak edhe sot në Devoll³⁴

32. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 448.

33. Në të folmen e Rugovës folja dnoj përdoret në kuptimin pakësoj, heq diçka nga diçka që është shumë

34. E. Çabej, Diskutim rreth kumtesës së H. Boisin Sprovë e përkohshme..., në KPSA Tiranë, 1965, f. 354.

Zanafilla e këtyre emërtimeve antroponimike në onomastikën shqiptare daton që nga koha ilire, zaten, kjo është një dëshmi kohërash e lidhjeve ilire-shqiptare edhe në këtë pikë të vështrimit socioonomastik. Vështruar nga kjo pikëpamje, në fshatin Malaj edhe sot përdoret patronimi Dashi. E tumirim mendimin që ky patronim të ketë dalë nga emri i kafshës shtëpiake dash. Prof. Çabej fjalën dash e kishte nxjerrë nga ilirishtja Dasius, mesap. Dazimas, shq. Dash³⁵ Është e ditur se në rrethinën e Pejës mbahen shumë delet dhe deshtë, prandaj është e mundur që emra nga sfera baritore të kenë kaluar edhe tek emrat e njerëzve. Edhe pse mënyra e jetesës në këto anë ka ofruar tipin e kullave, pikërisht në kullën e familjes Dashi dhe në shumë kulla të tjera dukagjinase kemi hasur deshtë e oxhakut, pjesët e dala prej guri në të dy anët e vatrës, prapëseprapë ky konstatim mbetet i paqëndrueshëm.

Është mëse i përhapur edhe antroponimin Ujk, nga bota shtazore të cilin e gjejmë edhe në trajtë të zgjeruar me anë të prapashtesës-an, Ujkan dhe po nga rrënja ujk, me shtimin e prapashtesës-i, përdoret edhe antroponimi femëror Ujki. Nga kjo rrënjë na dalin edhe emrat Uk (hipokoristik) e Ukshin. Është mjaft i theksuar patronimizimi dhe toponimizimi i tij p.sh. Uka, Ukaj, Ujka, Livadi Ujk's në Riekë të Allagës, Ara Ujk's në Shkrel etj.

Vlen të theksohet se edhe ky antroponim, përveç funksionit të rëndomtë antroponimik, mpleks në vete edhe elemente të bestytive të hershme të popullatës sipas të cilave fëmijët me këtë emër do të kenë jetë të gjatë dhe do të jenë të “mbrojtur”, sepse “forcat e mbinatyrshme nuk do të guxojnë t’u qasen”³⁶ Në qasjen tonë sociale konstatojmë se herë – herë, ky antroponim paraqiste edhe njeriun shumë të fortë dhe të shëndoshë, njeriun shumë të aftë për punë, po edhe njeriun e rrahur me jetën që ka parë e ka kaluar shumë të këqija e rreziqe, njeriun që nuk trembet nga rreziqet e nga kërcënimet. Vet antroponimi Ujk parafrazon frikën, trembjen, kanosjen, njeriun shumë të egër e të pamëshirshëm, gllabëruesin dhe lakmuesin e pangopshëm. Sipas prof. M.Krasniqit: “Në viset malore, ky emër mund të ketë edhe domethënie specifike: që ujku mos të sulmojë grigjën as bariun e saj që mban emrin Ujk”³⁷. Përdorimin e këtij antroponimi me paragjykime të kota e kishte vënë re edhe V. Karadzhiq në fjalorin e vet: “Kur ndonjë gruajeje nuk i jetojnë fëmijët, atëherë i japin fëmijës emrin Ujk, sepse mendojnë se fëmijët i hanë shtrigat e në ujk nuk

35. E. Çabej, Lidhjet ilire – shqiptare, në SGJ III, Prishtinë, 1976, f. 28.

36. Mujaj, Hasan, Rite rreth kërkimit të ninullave në Rugovë, Rilindja, Prishtinë, 31.03.1973, f. 7.

37. Krasniqi, Mark, Antroponimet e Kosovës në dritën e shkencës etnografike, në OK, Prishtinë, 1979, f. 393.

do të guxojnë të afrohen, për këtë edhe mua më kanë dhënë kesi emri”³⁸.

Në burime të shkruara antroponimi Ujk përmendet më 1455 si Ulko, Ujka, kurse më vonë, më 1485 në Jabllanicë të Pejës shohim të jetë regjistruar “Nikolla, i vëllai i Uqës”³⁹; në Vraniq që varej nga Peja regjistrohet “Jovani, i biri i Ukut”; në fshatin Prekullukë të Deçanit që varej nga Peja përmendet “Ulku, biri i Boshkos”, “Uku, i vëllai i tij”, e veja Ulka etj.⁴⁰ Edhe tek antroponimi Ujk kemi një emër sipas emrit të shtazës së egër ujk.

Antroponimin femëror Rushë është i shpeshtë, gjithashtu e fusim në grupin e emrave me prejardhje nga bota shtazore pasi, siç sqarohet edhe në terren, konsiderojmë se është përfitim me aferezë nga emri arushë pra (A) Rushë. Nisur nga fusha e trajtimit tonë do të shtonim se ky antroponim shpesh paraqiste njeriun e fuqishëm dhe të guximshëm, njerin që nuk lodhej kurrë, që hiperbolikisht këndej e përdornin si arushë mali, po përdorim të dëndur ka edhe në kuptimësinë figurative, si luan arushë me dikë keq, tallet me dikë, e sjellë vërdallë sipas qejfit të tij, i lë këmbët e arushës në dorë, shpëton vetë duke ia lënë rrezikun, barrën a kokëçarjet një tjetri, ia hedh dikujt.

Këtë antroponim e hasim edhe si emër të një yllësie në gjysmërruzullin verior të qiellit, Arusha e Madhe astr., që përbëhet nga shtatë yje të renditura si qerre, Qerrja e Madhe, Arusha e Vogël, në astronomi etj. Është me interes të veçojmë edhe antroponimet femërore Sykë dhe Share, të cilat i kemi hasur në fshatin Haxhaj, emra këta që janë shumë të rrallë dhe jo vetëm këndej, por, sa kemi mundur të gjurmojmë, janë mjaft të rrallë në mbarë antroponiminë tonë. Në viset malore këta emra janë të shpeshtë si emra deleesh. Kështu, rrethina e Pejës, duke qenë vend i njohur blegtoral, sidomos më herët, këta emra duke i pasur në përdorim të shpeshtë si emra deleesh, mendojmë se kemi të bëjmë me antroponime të marrura nga sfera baritore. Shtrirje posaçërisht të dëndur ka emri sykë si emër deleje që, siç shihet, është një zgjerim i fjalës sy me formantin –k (ë) dhe “... kemi të bëjmë më një kalim nga sfera shtazore te njeriu”. Ndërkaq antroponimi Share është formuar nga rrënja sllave shar me prapashtesën –e; po nga rrënja shar, me prapashtesën –an. T. Maretiq gjen edhe Sharan; ky autor mendon se emrat me këte bazë, së pari

38. V. Karaxhiq, Srpski rječnik, Beç, 1852, f. 88.

39. R. Doçi, Onomastika e shqiptarëve të Llapushës, punim magjistrature f, 23.

40. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 247, 278, 279, 297, 345 etj.

kanë qenë ofiqe ⁴¹. Prof. P. Skok fjalën share me të drejtë e sheh të terminologjisë blegtorale – emër deleje ⁴²; në Lugun e Baranit, të Trestenikut, Leshanit, në anën e Potgurit dhe në Rugovë përdoret edhe si emër deleje, edhe si emër femre. Sipas nesh, antroponimi Share është emër i marrë nga bota shtazore. Po nga kjo fushë këndeje përdoren edhe antroponimet Pulë, Qurë, Shotë, Flutur, Luan etj. Dëshira e prindërve që vajzat e tyre të bëheshin si fluturat shumëngjyrëshe, si disa lloje kandrrash fluturuese, me katër krahë të mbuluar me luspa të imëta si pluhur, me ngjyra të ndryshme, paraqet butësinë, lehtësinë, shpejtësinë, bukurinë, ndijesinë shkathtësinë etj., për banorët ky antroponim përbën shenjë e lumturisë, rinimit dhe mençurisë. Antroponimet Pulë, Qurë e Shotë, janë më të rrallë dhe paraqisnin kujdesin për punët e shtëpisë, mbarësinë, pedantërinë, shoqërorizimin në bashkësi, humanizmin etj. Në përdorim më të shpeshtë është sidomos emri Luan. Edhe ky antroponim përdoret më tepër me qëllim parandalues (profilaktik); si emër mbrojtës sipas emrit të shtazës së fuqishme - luanit, përdoret edhe në gjuhë të tjera p.sh. gr. Leon, shq. Luan, ar. Hajdar, tur. Arsllan, pers. Shir, rus. Lev etj. ⁴³ Në dritën sociale përmes këtij antroponimi paraqitet njeriu trim, guximtar, i fortë, po edhe ironizimi, me ç'rast pjesa më e madhe dhe më e mirë e diçkaje që e merr më i forti për vete, pa përfillur të tjerët. Antroponimin Galë, si emër femre, këndeje e gjetëm në përdorim në disa raste. Fjala galë ka shtrirje të gjerë në anë të ndryshme të Kosovës dhe kudo përdoret me kuptimin e zezë për gjininë femërore dhe i zi për gjininë mashkullore. Përdoret shpesh edhe në terminologjinë blegtorale. Galë për dele të zezë dhe Galan për dash të zi. Baza gal mund të ketë lidhje me emrin Gall, Gallojë, që e gjetëm në përdorim për ka të zi dhe Gallujë për lopë të zezë. ⁴⁵ Kemi po ashtu një rast kur ky antroponim është përdorur në gjininë mashkullore: Gal Reku, që sipas hulumtimit tonë i njëjti është pagëzuar kështu pikërisht nga i ati, i cili kishte kope të madhe delesh, ku pjesën më të madhe të deleve e kishte gala. Nuk e përjashtojmë mundësinë që edhe ky antroponim si emër mbrojtës të jetë marrë nga bota shtazore.

41. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, në SGJ, P – ZH, II, Prishtinë, 1976, f. 121.

42. Maretiq, P., Rad JAZU, knjiga LXXXII, Zagreb, 1986, f. 212.

43. Skok, P., ERSJ, Zagreb, 1974, f. 382.

44. E. Çabej, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II, A – B, Tiranë, 1976, f. 378, e pohon mendimin e prof. Joklit se është fjalë e burimit të shqipes që hyri edhe në greqishten e re.

45. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 451.

5.5. Antroponime sipas konfiguracionit

I hasim kryesisht në Radac, Jabllanicë të Vogël, Jabllanicë të Madhe, në Lipë dhe në fshatrat e Rugovës, sepse pozita gjeografike ka mundësuar konfiguracion mjaft të vështirë dhe të diskutueshëm të terrenit, gjë që ka ndikuar edhe në përdorimin e antroponimeve të kësaj natyre, ku do të veçojmë dy nga më të përdorurat si Mal’ dhe Bjeshkë me burim nga apelativet përkatëse që fillimisht shprehin pamjen e terrenit. Antroponimi Mal’ është i shpeshtë në disa fshatra të Rugovës si në Bogë Mal Isufi, në Drelaj Mal Dervishi, Mal Qorraj, Mal Lajqi, në Haxhaj Mal Bajrami, Mal Ahmeti, në Shtupeç të Madh, Mal Nikqi, në Dugaivë Mal Zekaj etj. Këtë emër e shohim të dalë nga apelativi mal si simbolizim i madhështisë dhe i qëndrueshmërisë së personit.

Në vështtrimin social ky antroponim na lë të kuptojmë se kemi të bëjmë me një njësi etnografike të veçantë dhe me klimë të mirë, me një krahinë malore, me përmasa shumë të mëdha, malësi apo vendbanim malor, ku nënkuptojmë kreshtën, shpatin, faqen, brinjën, qafën, grykën po edhe rrëzën e malit, rrugën e malit, çajin e malit, shpendët e malit, erën e malit, vargun e maleve etj⁴⁶. Simbolika e këtij antroponimi ka gjithmonë të njëjtën dëmtënie, qëllimin bazë për jetë, dëshirën për të arritur majën, ecjen drejt qëllimit dhe arritjet afatgjata, jetëgjatësinë, vijëzimin jetësor etj. Këtë emër e gjejmë edhe në bazë të patronimit mjaft të përhapur në vise të ndryshme të Kosovës te patronimi Malok. Fjalën shqipe mal tek ky patronim e kishte parë me të drejtë edhe G. Elezoviq: Malok-patronim shqiptar në Vuçiternë me rrethinë nga fjala shqipe mal-bjeshkë, kodër⁴⁶. Një patronim tjetër me antroponimin Mal në bazë, formuar me prapashtesat –ush (Malush) dhe –aj, (Malushaj) të cilët i hasëm në fshatin Llozhan dhe Kotradik, në verilindje të Pejës; edhe antroponimi Maliq të cilin e gjetëm në disa fshatra, duket të jetë ngritur mbi bazën antroponimike Mal. Sa dëshmojnë regjistrimet e tashme zyrtare, për disa vite të fundit, gjetëm vetëm një rast të përdorimit të ri të emrit Mal. Ky antroponim nuk mungon as në burime të shkruara, si p.sh. : në “Defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës” të vitit 1485, e shohim të jetë regjistruar si Male, Malëza, Malsh, Malko etj⁴⁷. Kujtojmë se fshati i këndejshtëm Malaj është formuar nga antroponimi Mal me prapashtesën –aj⁴⁸.

46. Elezoviq, G., RKDM, Beograd, 1932, f. 384.

47. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 102, 326, 347, 83.

48. Nuk na duket i drejtë shpjegimi i dhënë se emërtimi Malaj mbeti sipas fjalës mal.

Ndërkaq, antroponimin Mal, siç u tha, e shohim të jetë dhënë sipas apelativit mal. Sa për fjalën mal, tumirin mendimin e prof. Çabejt, i cili duke e hetuar në toponiminë e hershme të viseve të Ballkanit, e merr si fjalë ilire - shqiptare,⁴⁹ kurse prof. P. Skok e kishte marrë për trake ose ilire⁵⁰ Nga kjo sferë deri tash, së voni, në fshatin Dugaivë ekzistonte antroponimi femëror Bjeshkë, i cili, siç dëshmojnë edhe të dhënat nga terreni, në kuptimin e simbolizimit të shëndetit të mirë, të madhësisë dhe të zhvillimit fizik të femrës. Edhe këtu mendohej për vajzat që zakonisht të jenë si bjeshka të bëshme e plot shëndet, largpamëse, bujare, fisnike, të qëndrueshme, me uratën që të rrojnë sa bjeshkët!

Ky antroponim është shumë i rrallë në anën tonë. E hasëm edhe në fshatin Haxhaj, Bjeshkë Ibraj. Antroponimet që formohen nga disa apelative I. Maretqi i kishte quajtur antroponime metaforike; ai heton se dëshira e prindërve që “sa më bukur ta thërrasin fëmijën” ka bërë që shumë emra të jenë metafora⁵¹ Kështu edhe në antroponiminë e Rugovës antroponime metaforike janë ato që formohen nga disa apelative p.sh. Lise, Bjeshkë, Lule etj.

Emërdhënia metaforike e bimës, lules, ngërthen në vete edhe dëshirën prindore të gjasimit metaforik me shijimin e së bukurës, estetikës, të rrallës, lules me ngjyra të ndryshme, e zakonisht me erë të mirë, që rritja e saj, e tyre, të imitonte atë që rritej vetë në natyrë a që mbillej për bukuri e për erë, që në jetë të jenë të egra për armikun e të buta për mikun, t’i shoqërojë përjetësisht shumëngjyrësia, qofshin ato të verdha, të kaltërta, të kuqe a të bardha, qofshin lule livadhi, pylli, kënete, uji, kopshti a dhome, po ashtu prezanton ndjesinë prindore si kurorëzim i së mirës, hijeshisë, bukurisë, elegancës, shtathedhurës, sjelljes së përgjithshme të lumturisë, zbulimit dhe shijimit e kënaqësive që ofronte natyra, me një fjalë ky antroponim konsiderohet edhe si një dhuratë natyrore, me aftësi frymëzimi, ku si vlerë do të prezantojë miqësinë dhe ofrimin e ndihmesës për njerëz. Zakonisht, përpos përdorimit antroponimik, lulja këndeje përdorej edhe në fusha të tjera, bie fjala si zbukurim me ngjyra të ndryshme, të vizatuara në pëlhurë, në mushama etj. ose të gdhendura në gur, në dru, në metal etj.; zbukurime të ndryshme të qëndisura në petk, rroba me lule, basmë (fustan) me lule, mur (tavan) me lule, tepsi me lule, me lajle e me lule etj.

49. Çabej, E., Ilirishtja dhe shqipja, në Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, USHT, Tiranë, 1969, f. 41.

50. Skok. P., ERSHTJ, Zagreb, 1974, f. 382.

51. Maretqi, P., Rad JAZU, knjiga LXXXII, Zagreb, 1986, f. 80.

5.6. Antroponime të ndryshme

Jo të gjitha antroponimet e Pejës me rrethinë që për nga aspekti burimor na prezantojnë shumëllojshmëri, i gjejmë në klasifikimet e paraqitura dhe të vështuara deri këtu, po u qasemi prej një pikë të veçantë, duke vështuar dhe ndriçuar sado pak disa antroponime, burimi i të cilave tash për tash mbetet i pahetuar si dhe disa antroponime me prejardhje të gjuhëve të huaja. Kështu, në fshatin Zahaq para disa vitesh përdorej antroponimi Bul, kurse sot, po në këtë fshat ruhet si emër familjar: Bulajt. Sot ky emër është shumë i rrallë. Në trevën e kërkimit tonë e gjetëm edhe në Nabergjan në trajtën e antroponimit femëror Bulake, kurse në trajtë patronomike kemi vënë re të ekzistojë edhe në rrethinë të Istogut në trajtën Buleshkaj. Antroponimi Bul, sa duket është një nga antroponimet mjaft të hershme shqiptare, na del të jetë përdorur qysh në antroponiminë ilire si Bul në Bulioni, Bulliones etj.,⁵² kurse në vitin 1485 e shohim të regjistruar në trajtën Buliza, i vëllai i Milloshtit, pastaj Bulza, Bulosha, Bulaq etj.⁵³ Duke ecur më tej gjurmëve të antroponimisë së këtyre anëve pamë të përdoret shpesh antroponimi Balë, ky antroponim ruhet këndeje edhe në mikrotoponimi si për shembull D'bani Bal's, Shpije Bal'Alis', Mali Bal's në fshatrat Nabergjan, Lutogllavë, Koshutan, Zahaq etj., por del shpesh edhe në trajtën Bali, Shpella e Balis' në Hajlë të Shkrelit. Siç dëshmojnë edhe dokumentet e shkruara, antroponimi Balë, Bali është mjaft i vjetër. Kështu për shembull në anë të Pejës hetohet në vitet 1222 – 1228⁵⁴. Në regjistrime të hershme e gjejmë edhe në Defterin turk të vitit 1485 si Balor, Bali, Balqko etj.⁵⁵ Gjuhëtarët tanë të njohur, mendimin e të cilëve e tumirim edhe ne këtu, kanë bërë fjalë edhe për çështjen e lidhjes së trajtave Bal-bardh; prof. E. Çabej p.sh. për ilustrim përmend shembullin Bardylis (mbret) shq. Bardho,⁵⁶ kurse edhe prof. I. Ajeti, në disa shembuj të sjellë nga jeta baritore, sidomos të viseve të Malit të Zi, të Bosnjë Hercegovinës dhe të Kosovës, në rrënjorin shqiptar bal, sheh fjalën bardh, i bardhë.⁵⁷

52. Çabej, E., në SGJ, IV, Prishtinë, 1976, f. 199.

53. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 142, 925, 186, 322.

54. Doçi, R., Onomastika e shqiptarëve të Llapushës, punim magjistrature f. 34

55. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 148, 147, 211.

56. Çabej, E., Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1978, f. 29.

57. Ajeti, Idriz, Për historinë e marrëdhën. të hershme gjuhësore shqiptare sllave, në GJA – SSHF, Prishtinë, 1974, f. 39.

Në fshatin Koshutan para një kohe ishte në përdorim antroponimi Bil, kurse sot nuk hetuam raste të përdorimit të ri të këtij antroponimi, veçse ruhet në mikrotoponimi të po këtij fshati p.sh. Livadi Bil's, Shtegu i Bil's etj.

Një shtrirje më të gjerë ky antroponim kishte në katundet e Llapushës, ku gjithashtu po ruhej edhe në toponimi p.sh. Gurrabili, Bilevci etj.⁵⁸

Antroponimin Bil e shohim edhe tek mbiemri i poetit arbëresh B. Bilota. Për emrin Bil është shprehur mendimi se mund të jetë i burimit bizantino - grek ose hebraik⁵⁹. Në fshatin Shkrel më heret ishte në përdorim antroponimi Grosho Ibra, kurse sot këtë antroponim e hasëm në Fushë të Pejës, Grosh Kurtaj dhe, me sa kemi vënë re nuk përdoret as në anë të tjera, sidomos kohët e fundit. Emrin Grosh, studiuesi S. Gashi e merr si një nga shembujt e përkimeve antroponimike midis popullatës së Vranjës, të rrethinave të Novoberdës dhe të Deçanit. I njëjti autor vë re se në rrethinë të Kamenicës një vendbanim u quajtka Groshata dhe se “ emra të këtij tipi dalin në ujdhesa të bregut kroat të Adriatikut, në ambiente të populluara me popullatë romane”⁶⁰. Me trajtën Groshi del edhe në regjistrime të hershme⁶¹. Vështruar nga ana burimore, mendojmë se ky antroponim është i gurrës romane. Në këto anë gjetëm edhe disa antroponime të fosilizuara me prejardhje sllave sa duket, të cilat sot nuk janë në përdorim, si emra vetjakë veçse ruhen në emërtime toponimike. Kështu p. sh. në fshatin Bogë po ruhej mikrotoponimi Livadi Bozhit. Ky antroponim nuk mungon as në regjistrime të vjetra si Bozhjan, Bozhidari, i biri i Vukotës etj. Prof. P. Skok këtë antroponim e kishte parë si hipokoristik të emrit Bozhidar dhe me gurrë sllave⁶². Mendojmë se antroponimi në shqyrtim, me trajtën Bog, gjendet në bazë të emërtimeve të toponimit Bogë të Rugovës. Është e mundshme që personi me emrin Bog të ketë qenë kryepari i këtij fshati sipas të cilit fshati mban emrin edhe sot. M. Grković shpreh mendimin se Bog është shkurtim nga Bogolub.⁶³

Për emrin vetjak Stank gjithashtu mendojmë se është i burimit sllav nga Stan - ko.

58. Gashi, S. Antroponimet e etnosit shqiptar të viseve të Toplicës në gjysmën e I të shek. XV në dritën e burimeve raguzase, në Dituria 1 – 2, Prishtinë, 1978, f. 139.

59. Doçi, R., Onomastika e shqiptarëve të Llapushës, punim magjistrature f. 72.

60. Gashi, S., shih fusnotën 58, f. 114.

61. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 152.

62. Skok. P., ERSIJ, Zagreb, 1974, f. 180.

63. Grković, M., RLIS, Beograd, 1977, f. 4058. Gashi, S. Antroponimet e etnosit shqiptar të viseve të Toplicës në gjysmën e I të shek. XV në dritën e burimeve raguzase, në Dituria 1 – 2, Prishtinë, 1978, f. 139.

Në Rugovë të Pejës ky antroponim sot ruhet vetëm në emërtime toponimike si Maje Stankut, Kroni Stankut dhe Llazi Stankut në fshatin Dugaivë, kurse në fshatrat e rrethit të Pejës ka shtrirje pothuajse të përgjithësuar.

Mbi bazën antroponimike Stank, me shtimin e prapashtesës –aj, shohim të jetë formuar emërtimi i fshatit të sotëm Stankaj, (që tashmë po përdoret Stakaj), që gjithashtu duket të ketë qenë kryepari i fshatit. Antroponimin Stank M. Grkoviq e quan emër mbrojtës ⁶⁴.

Të ruajtur në mikrotoponimi e gjetëm edhe antroponimin Ivan, në emërtimin Gurre Ivanit të Shtupeçit të Vogël, në Dobërdol, Llozhan, Grabovc, Baran etj., Livadi Stankut.

Ky antroponim është i burimit hebraik (biblik) nga Johanon dhe sipas P. Skokut ka domethënie teoforike “bog daj”,⁶⁵ trajta Ivan është e sllavizuar. Në të *sosur* të terrenit të Rugovës dhe në afërsi të kufirit të territorit të Rozhajës ruhet edhe sot emërtimi Livadi Mariqit. Mariq, duket të ketë mbetur nga emri femëror biblik Marija; Mar(e)-iq ⁶⁶. Lidhur me përcaktimin e antroponimeve sipas konfesionesh e në bazë të kësaj edhe përcaktimin e etnosit, është me rëndësi të citohet mendimi i prof. I. Ajetit i cili konstaton: “Disa emra të krishterë janë të përbashkët për të dy grupet etnike: Nikolla, Andreja, Lazar, Stepan, Dimitër, Petër, Mihal etj., gjë që e vështirëson përcaktimin e përkatësisë etnike.” ⁶⁷ Kjo çështje është theksuar dhe është parë drejt e në mënyrë të bazuar edhe nga prof. S. Pulaha, sidomos kur është fjala për antroponime me prejardhje sllave, i cili vë në dukje se për përcaktimin e etnosit të hershëm sipas antroponimisë çdoherë duhet pasur parasysh edhe rrethanat shoqërore, politike dhe fetare, sepse siç dihet (shek. XI-XIV) shumë krahina shqiptare qenë nën sundimin e feudalëve serbë të shtetit të Dioklesë dhe të Rashkës, prandaj edhe ishte i arsyeshëm mbizotërimi politik e fetar sllav. Kështu pra, “në këto rrethana ishte shumë më lehtë që një shqiptar të merrte emër sllav se sa e kundërta”.

Siç dëshmohet edhe në Defterin e vitit 1485, në të gjitha krahinat kishte raste ku babai mbante emër shqiptar kurse i biri mbante emër sllav, apo e kundërta p.sh. në fshatin Pantalesh të Kuqit përmendet “Vukaqi, i biri i Lula Loparit”. ⁶⁸

64. Ajeti Idriz, Po aty, f. 135

65. Skok. P., ERSNJ, Zagreb, 1974, f. 737.

66. Grkoviq, M., RLIS, Beograd, 1977, f. 127.

67. Ajeti, Idriz, Kontribut për stud. e onomastikës mesjetare, në kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978, f. 366.

68. Pulaha, Selami, Të dhënat on. të Defterit dhe karakteri etnik i pop., në DSSSH - 1485, f. 32.

5.7. Hipokoristika në antroponiminë e Pejës me rrethinë

Ndryshimet, shkurtimet dhe zgjerimet e emrave vetjakë në ligjërimin e popullatës së Pejës me rrethinë, ashtu si edhe anakënd trevave të tjera, janë të dukshme, duke u larguar herë – herë pjesërisht nga trajtat e para. Këto çështje si dhe lindja e trajtave të dyta mund të themi se janë një dukuri mjaft e shpeshtë në antroponiminë tonë dhe në atë të popujve të tjerë. Mendojmë se janë dy arsye kryesore që shpiejnë tek ndryshimet e trajtave të para të emrave vetjakë, arsyeja hipokoristike dhe arsyeja pejorative, ndryshime këto që nuk mund të themi se janë të prera. Nga ky këndvështrim mund të thuhet se, natyrisht, ka lëvizje dhe ndryshime nga vendi në vend.

Kështu, duke folur rreth kësaj problematike P. Daka, ndër të tjera shkruan: “Pra, kuptohet se arsyet e shkurtimeve apo të zgjerimit të emrave nuk janë të njëjlojta për të gjitha vendet dhe emrat, ata ndryshojnë shpesh jo vetëm nga një rreth në tjetrin, po edhe brendapërbrenda një rrethi, lokaliteti, fshati a lagjeje”⁶⁹. Ndryshime të kësaj natyre domosdo vërehen tek emrat e të dy gjinive. Vlen të theksohet se trajtat e dyta të emrave vetjakë në kuptimin hipokoristik, siç mund të kuptohet edhe në terren, më tepër lindin në fëmijëri të personit, kurse ndryshimi i trajtës së emrit në kuptimin pejorativ më tepër ngjet në moshën madhore. Lindja e trajtave të dyta të antroponimeve në anë të Pejës me rrethinë realizohet përmes veprimeve të dukurive fonetike që në anën e gjurmimit tonë më shpesh ndeshen të veprojnë afereza dhe apokopa. Afereza për shembull, duket se veproi tek emri Mikel dhe, me anë të këtij fenomeni fonetik, ra silaba dhe kështu mbeti antroponimi Kel, të cilin e gjetëm në përdorim në fshatin Qyshk pra: Kel nga Mikel, antroponimin Nushë e gjetëm në disa fshatra të Lugut të Drinit, në Trestenik, Lutogllavë, Ruhot e gjetkë.

Shpesh ngjet që trajta e parë e këtij antroponimi të jetë Manushë dhe, po me veprimin e aferezës, bie rrokja ma-dhe; Ma-nushë; Nushë. Tek antroponimi Manushë ekziston edhe mundësia e zgjerimit nga emri Manë me shtimin e prapashtesës – ush (ë); Manushë, e cila prapashtesë këtu ka natyrë përkëdhelëse. Kjo prapashtesë, po me këtë kuptim, gjendet edhe tek emra të tjerë të kësaj ane p.sh. Havushë nga Havë, Mirushë nga Mire, Fatushë nga Fatime, Mahushë nga Mahie etj.

69. Daka P., Mbi disa veçori ..., në KDSA Tiranë, 1969, f. 280.

Pastaj antroponimi Man, duket u përfitua me aferezë nga një trajtë më e plotë antroponimike, nga Selman ose edhe nga Osman: (Os) Man: Him me zbunim, po me dukurinë e aferezës, nga Brahim; në fshatin Haxhaj përdoret antroponimi Dan, Dan Selmani: tek Dan shohim një trajtë të shkruar nga Ramadan, gjithashtu me veprimin e aferezës; edhe Demë është përfitim me aferezë nga Adem. Antroponim i shpeshtë këndej është edhe emri Ali, trajta përkëdhelëse e të cilit shpesh del Alush; kështu në fshatin Koshutan ekzistonte para pak kohësh antroponimi Lush, trajta e parë e të cilit do të ketë qenë Ali, por me shtimin e prapashtesës – ush dhe me veprimin e aferezës te zanorja a, mbeti Lush pra; Ali: Alush; (A) Lush ndonëse Lush përlijet të dalë edhe nga antroponimi Malë me të njëjtat mjete gjuhësore; Mal; Malush; (Ma) Lush; edhe antroponimi Malush është në përdorim edhe sot e kësaj dite në fshatin Kotradiq. Antroponim hipokoristik është edhe emri Lil, përfituar me veprimin e aferezës së ha-së nga antroponimi Halil, që këndej është i shpeshtë. Trajtë diminutive ka edhe emri Tem që përdoret edhe sot në Shtupeç të Madh, i cili u përfitua me aferezë nga antroponimi Rrustem. Antroponimet e shkurtuara Cuk', Cen', Cuf', Can', Caf', Col etj., që me këto trajta përdoren në anën tonë, janë hipokoristika, përfituar me anë dukurish të ndryshme fonetike e që me trajtat e para të plota tash piquen vetëm në ndonjë element të rrënjorit themelor. Tek hetimi i trajtave themelore të këtyre antroponimeve, kujtojmë se ka mbështetje të tumiret mendimi i P. Dakës, i cili trajtën e shkurtuar Cuk p.sh. e nxjerr nga Lacuk me aferezë të la-së e këtë nga Lac- uk, kurse trajtat Can, Cen, Cuf – nga antroponimet e plota Hasan, Hysen, Isuf me veprim të aferezës tek ha - hy- i dhe me alternimin e s:c: trajta Col është shkurtrim i antroponimit Sokol, përfituar me alternimin e s-së në e dha veprimin e dukurisë së sinkopës tek rrokja –ok-, mbeti Col, kurse trajta Cafë është përfitim me aferezë nga Mustafë dhe me alternim të st: c: Mu – st: c: Cafë.⁷⁰ Sikundër mund të vërehet edhe nga shembujt e sjellë, dukuria fonetike e aferezës ka shtrirje të gjerë te emrat vetjakë; ajo shpesh vepron edhe bashkë me dukuri të tjera simotra. Në antroponiminë e këtyre anëve shpesh hetohet të veprojë edhe apokopa që gjithashtu formon hipokoristika. Për shembull trajta hipokoristike antroponimike Hysë është përfitim me apokopë nga trajta e plotë Hysen; po kështu Rexhë, që në Pejë është emër i shpeshtë, është shkurtrim me apokopë nga Rexhep; antroponimi Meho që ekzistonte në fshatin Raushiq dhe që ruhet edhe sot në mikrotoponimi p.sh. Grope Mehit, është trajtë

e apokopuar e antroponimit Mehmet, Bajro nga Bajram, Ramë nga Ramadan etj. Mendojmë se sipas kësaj rruge, me rënien e rrokjes së fundit - ri, mbeti antroponimi Shuk nga Shukri. Emri Shuk kishte ekzistuar më heret në Shtupeç të Vogël; sot nuk është përdorim në këtë anë, po në të njëjtin fshat po ruhej në toponimi në emërtimin Brie Shukut; kjo trajtë antroponimike është shënuar edhe në regjistrime të hershme p.sh. Shuk Gjoni, Shuk Ermeni etj.⁷¹ Tek antroponimet e gjinisë femërore gjithashtu këndej përdoren mjaft trajta hipokoristike, formuar rëndom me rënien e një rrokje në fund të emrit dhe në vend të rrokjes se apokopuar emri merr një prapashtesë me të cilën shprehet trajta zbunuese e antroponimit p.sh. prapashtesën –ke;⁷² Razë, por dëgjohet shpesh këndej edhe Rake si trajtë zbunuese e emrit Razë, Rabë që këndej është i shpeshtë, por edhe Rake, Zade, trajta diminutive Zake, por lypset dalluar nga emri Zake si antroponim i mirëfillët, pa kuptim zbunimi; po kështu edhe Zizë – Zike, Havë – Hake, Hyrë – Hyke, Zojë – Zoke, Gjylë – Gjyke etj. Edhe në anën e gjurmimit tonë ka mjaft raste ku hipokoristikat marrin përmasë të gjerë shtrirjeje, dalin nga rrethi i ngushtë familjar dhe farefisnor ku edhe zë fill përdorimi i tyre dhe përhapen pastaj, të shpeshtën, në të folurit e rrethit shoqëror, por edhe në të shkruar madje shkojnë si të tilla dhe përdoren edhe në dokumente të ndryshme duke u bërë kështu trajta të popullarizuara.⁷³

Rreth lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë dhe kalimit të tyre në trajta zyrtare, Gj. Shkurtaj shkruan "... mjaft nga trajtat e dyta të lindura për zbunim në kushte të ligjërimit familjar kanë marrë shtrirje më të gjerë dhe kanë dalë nga ligjërimi në lëmin e gjerë të së folmes, duke u bërë edhe emra zyrtarë. Një shembull kapërcimi nga trajta zbunuese në trajtë të rëndomtë antroponimike, në një antroponim të mirëfillët kemi në rastin tonë tek antroponimi Hake, duke u bërë edhe emra zyrtarë".⁷⁴ Midis këtyre trajtave nuk ka kufi të prerë domethënë ato janë të ndërkëmbyeshme. Ky antroponim që në rrethin e ngushtë kishte kuptim zbunues, përfituar nga emri Havë të marrë në trajtë të cunguar dhe me shtimin e prapashtesës –ke; Ha-k, bëri kuptimin përkëdhelës pasi mori shtrirje të gjerë dhe sot përdoret pa kuptim zbunues.

70. Daka P., Mbi disa veçori ..., në KDSA Tiranë, 1969, f. 285.

71. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 124, 155.

72. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 455.

73. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 456.

74. Shkurtaj, Gjovalin. Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë, Përparimi, nr. 4, Prishtinë, 1979, f. 668.

Por, për të shprehur trajtën hipokoristike antroponimet e tilla shkojnë dhe dalin me trajta të dyta po me kuptim hipokoristik p.sh. tek shembulli i përmendur dëgjohet shpesh trajta e dytë hipokoristike Hale etj. Ndër prapashesat më produktive që përdoren këndej për formimin e hipokoristikave është prapashtesa –ke, por duhet shikuar që kjo të mos përzihet me raste kur është pjesë përbërëse e temës, për shembull tek antroponimet Zake, Zyke etj.; për të shprehur trajtën diminutive antroponimet që ke-në e kanë pjesë përbërëse të temës, domethënë kur kjo nuk është e shtuar si prapashtesë, marrin formatin –le p.sh. Zale, Zyle etj.⁷⁵ Sidoqoftë, mund të thuhet se shkurtimi i emrave vetjakë është dukuri mjaft e shpeshtë që realizohet përmes veprimesh të zhvillimesh të ndryshme fonetike.

75. Mujaj Hasan. Koha 4, Titograd, 1983, faq. 456.

5.8. Emra fisesh, vëllezërish, barqesh dhe shtëpish

Rrugëtimi i fiseve gjatë etapave të caktuara historike është dinamik dhe me hapërimë të nduarnduarshme. Dëshmi të këtij rrugëtimi gjatë hulumtimit tonë hasëm qysh tek ilirët, duke vënë re kështu mjaft zgjerime dhe asimilime fisesh të ndryshme. Prof. E. Çabej ka vënë në dukje se fiset e sotme, të shpeshtën janë produkt emigrimesh, shpërnguljesh dhe lëkundjesh të ndryshme “si pasojë e dyndjes së turqve në Ballkan”.⁷⁶ Kjo, pra, më tepër për arsye të shtegtit të shqiptarëve jo vetëm jashtë, por edhe brenda. Lidhur me këtë shtegtim, prof. Çabej kishte shkruar: “... sa larg mund të shtegtojë një fis, na e dëshmojnë kelmendasit. Këta dimrin e kalojnë me bagëtiti e veta në Bregun e Matit. Po kanë lëshuar degë me një anë gjer në Sirmie, ku themeluan dy katunde”.⁷⁷

Duke i veçuar rastet, në Rugovë të Pejës kemi vrojtuar se një shtëpi në Haxhaj dhe një në Shkrel shkojnë me fisin Selcë, fshati Shkrel i takon fisit Shkrel, një shtëpi Berishë e hasëm në Stankaj, disa të tjera Kastrat në Shtupeç të Vogël dhe Llaz si dhe katër - pesë shtëpi të fshatit Drelaj që i takojnë fisit Shalë, Rugova në përgjithësi i përket fisit të Kelmendit. Këtu shtrohet pyetja se a është Shkreli fis apo vëllezëri e Kelmendit?

Përgjigjeja për këtë pyetje është e diskutueshme. Duke shkruar për çështjen e fiseve, siç pohon edhe vet, më tepër në mbështetje të gojëdhënave, A. Maloku shton se Shkreli nuk është fis, por vëllezëri e Kelmendit.⁷⁸ Megjithëkëtë, në përkrahim mendimin e prof. M. Shuflajt i cili me të dhëna bindëse pohon se Shkreli është fis e jo nënfis; lidhur me këtë, ky shkencëtar, ndër të tjera thekson: “Patrici i Kotorrit Bolizza njofton në vjetin 1614 se fiset e veriut (Hotët, Kuqët, Shkrelët etj.) tue dhanë betimin themeluan lidhjen për ndihmën dhe mbrojtjen reciproke kundër Turqve “ dhe, vazhdon autori, “atëbotë Kelmendët kishin 650 luftëtarë, Shkrelët 80.”⁷⁹ etj.

Sa për emrin e fisit të Kelmendit, M. Shuflaj shkruan: “Emri i Kelmendve, që ma vonë qenë të fuqishëm del prej kështjellit byzantine Clementiana...”⁸⁰.

76. Çabej, E., për gjenezën e literaturës shqipe, Prishtinë, 1970, f. 13.

77. Po aty.

78. Maloku, A., Disa shënime mbi përhapjen e fiseve në Kosovë e Metohi, Përparimi, Prishtinë, 1963, f. 27.

79. Shuflaj, Milan, Historia e shqiptarëve të veriut, në Serbët dhe Shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 71.

80. Shuflaj, Milan. Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë, 1968, f. 151.

Përkritazi me anë historike të fiseve, me të drejtë kishte konstatuar dijetari E. Çabej se gjeneza e fiseve shqiptare është e errët,⁸¹ prandaj vështrimi i çështjes së fiseve të Pejës si dhe të vëllezërive më gjerë në planin historik është mjaft kompleks dhe meriton studim më të thellë, kësaj radhe le të mjaftohemi këtu vetëm me paraqitjen e çështjes në materialin e trajtuar.

5.8.1. Emërtimet e vëllezërive

Siç kemi potencuar edhe tek patronimet, në anë të Rugovës gjenden sot këto vëllezëri të Kelmendit: Lajqi që kap fshatrat; Stankaj, Pepiç, Dugaivë, Malaj, Shtupeçi i Vogël, Llutovë dhe pjesërisht Drelaj; Nikqi me fshatra: Rieka e Allagës dhe Shtupeçi i Madh; Muriqi me fshatrat Haxhaj dhe Koshutan; Vukli me fshatrat Bogë dhe Kuçishtë. Emrat e vëllezërive këndej sikur edhe në anë të tjera në më të shpeshtën e rasteve kanë bazë antroponimike; ata ruajnë në bazë antroponime të fosilizuara që, siç dihet, kanë jetë shumë më të gjatë se sa antroponimet, pasi më lehtë u qëndrojnë ndryshimeve dhe ndikimeve të faktorëve të ndryshëm.

Emrin e fisit Shalë, pjesëtarë të të cilit fis jetojnë sot në Drelaj, prof. L. Mulaku i sheh si mjaft të hershëm edhe në strukturën e toponimit Shalë e Bajgorës.⁸²

5.8.2. Emrat e barqeve

Emrat e barqeve gjithashtu kanë bazë antroponimike dhe, mbi këtë bazë, sajohen me formantin e njohur – aj p.sh. Mujaj, Hysenaj, Hajdaraj, Husaj, Rexhaj, Plakaj, Kuklecaj, Imeralijaj, Elesalija, Smakaj, Lekaj, Cukaj, Lulaj, Ibërdemaj, Kurtaj, Demaj, Elezaj, Xhaferaj, Haxhijaj, Zekaj, Bajrimeraj, Kurbogaj, Hysenaj, Abazaj, Kurdedaj, Palaj, Lucaj, Lokaj, Vaqaj, Desportaj, Aliqkaj, Dreshaj, Tafaj, Qunaj, Metujkaj, Alaj, Ahmetaj, Zeqiraj, Nelaj, Mulaj, Sejday, Dashaj, Rexhepaj, Beqiraj, Nilaj, Broqaj, Qorraj, Gjevukaj etj. Disa nga këto

81. Çabej, E., Për gjenezën e literaturës shqipe, Prishtinë, 1970, f. 27

82. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 124, 155.

emërtime barqesh kanë bazë antroponimike, të cilat, sipas regjistrimesh të vjetra, gjejmë të jenë përdorur mjaft heret. Kështu për shembull tek patronimi Mekaj, të cilin sot e ndeshim në fshatrat Stankaj, Bogë dhe Riekë e Allagës, shohim antroponimin e kahershëm shqiptar Meks. Ky antroponim duket se dëshmohet edhe në të dhënat raguzase të gjysmës së parë të shekullit XV pikërisht në librin e Mih. Llukareviqit me trajtën Gin e Mechxa.⁸³ Edhe në burime të hershme shkrimore janë regjistruar antroponimet Meka dhe Meksha.⁸⁴ Rrënjorin Mek e shohim edhe tek mbiemri i publicistit rilindës Jorgji Meksi.

Edhe antroponimin e hershëm Plak, i cili del i pranishëm edhe në burime të hershme shkrimore, prof. M. Domi e heton tek mbiemri Petro Placa, të cilin e gjen në burime të shkruara të shekullit XV tek sheh me të drejtë fjalën shqipe plak.⁸⁵

Në fshatin Rasuha të Pejës, siç dëshmohet në Defterin turk të vitit 1485, është regjistruar Pjaku, i vëllai i tij, Plak etj.⁸⁶ Me antroponimin Plak në bazë kemi edhe formime të tjera por me ndonjë formant tjetër si –iq, -oll etj.⁸⁷ Ky patronim përdoret në anë të ndryshme të Kosovës me trajta Plakiq, Plakoll etj.

5.8.3. Emërtimet e shtëpive

Tek emërtimet e shtëpive në anë të rrethinës së Pejës ashtu sikundër edhe në anë të tjera, të shpeshtën, kemi të bëjmë me kompozita antroponimike formuar nga ngjitja e dy emrave vetjakë duke marrë në fund edhe elementin –t, i cili shpreh përfshirjen e shumësisë së përbërjes familjare, përkatësisht shtëpiake p.sh. Rambajramt, Balitahirt, Isufzymert, Ibishbrahimit, Ramidrizit, Shytamett, Baliqukt, Veselmust, Ibishdett, Ukshabant, Smakhaxht, Baliarift, Malushramt, Zenesylt, Rexhepukt, Danselmant etj. Përveç kësaj mënyre, shpeshherë emërtimi i familjeve përkatësisht i shtëpive në anën tonë bëhet edhe me fjalë të prejardhura, që shikuar për nga aspekti strukturor, formohen mbi një bazë antroponimike me anë të formantit –aj pas të cilit vjen shtesa –t p.sh. Idrizajt, Metajt, Halilajt, Rekajt, Veselajt, Mehajt etj.⁸⁸ Emërtimet e këtilla ndonëse përkojnë me patronime për nga ana strukturore, nuk janë patronime, por emërtime shtëpish.

83. Mulaku, Latif, nga onomastika e Kosovës, Buletini I, Prishtinë, 1963, f. 187.

84. Gashi, S., Prania e shqiptarëve në Krahinën e Gollakut, Moravës e të Serbisë jugore në gjysmën e I të shek. XV (1411-1438) në dritën e materialit onomastik, GJA, SSHF, Prishtinë, 1978, f. 107.

85. Domi, Mahir, Burime dhe materiale të shqipes së shek. XV, në SF, 3, Tiranë, 1968, f. 266.

86. Pulaha, Selami, Defteri i Sanxhakut të Shkodrës, i vitit 1485, f. 297, 154.

87. Po aty

88. Mujaj, Hasan. Koha 4, Titograd, 1983, faq. 458.

5.8.4. Emërtimet tripjesëshe strukturore të emrave

Një e dhënë me rëndësi në onomastikën shqiptare në përgjithësi e hasur edhe në trevën e kërkimit tonë, e shtruar nga dijetarët që prej kohësh dhe që meriton të ndiqet më tej, është edhe çështja tripjesëshe strukturore e emrave; antroponimi – një pjesë dhe patronimi dypjesësh p.sh. Rifat Hysnikaj, Idriz Kurbogaj, Salih Rexhëbogaj, Demë Demëbogaj, Alban Muçkurtaj, Drilon Dembogaj, Rustem Kuklecaj etj. për të cilën çështje gjuhëtari shqiptar prof. **E. Çabej**, veç të tjerash, shkruan: “... parimi i paraqitjes së këtyre emrave me këto pjesë është interesant; në popujt e tjerë të Ballkanit, nga sa di unë, me përjashtim të disa emrave bizantinë nuk del një gjë e tillë; është pra mjaft specifike për popullin shqiptar formimi i patronime të përbëra nga patronimet. Edhe tek patronimet ngjet të vërehen ndryshime apo shtrembërime nga trajtat e drejta. Prandaj, përdorimi i drejtë i patronimeve në të shkruar dhe në të folur është çështje e rëndësishme. Dukurinë e ndryshimeve të trajtave patronimike e kishte vënë re edhe linguisti frëng **H. Boisin**, i cili kishte shkruar; “... emrat e familjeve, ashtu si dhe të gjitha fjalët e tjera të gjuhës, u nënshtrohen patjetër ligjeve fonetike dhe se, sipas krahinave, disa emra të përveçëm mund të paraqesin variante të ndryshme “⁹⁰. Por, ndryshimet në trajtat e patronimeve sidomos në elementin fundor nuk ngjasin vetëm si pasojë veprimesh të dukurive fonetike, po në anë të Pejës, së shpeshti, ato janë rrjedhojë shënimesh zyrtare administrative, të cilave shpeshherë nuk u është shtruar kujdes i merituar, sidomos në të kaluarën.

Në këtë mënyrë ngjet shpesh që te patronimi të ngatërrohet me antroponim. Ndërkëmbimet e patronimeve dhe të antroponimeve hetohen pra në elementin fundor; kështu në vend të formantit –aj, tek formimet patronomike këndeje shpeshherë shkojnë dhe përdoren elementet fundore – i , -a, -u dhe mu për këto shtesa edhe ngjet të mos kuptohet mirë dhe qartë se a ndiqet antroponimi nga një antroponim apo nga një patronim të përdorur pa vend me një prapashtesë tjetër.⁹¹ Për shembull patronimet Hajdaraj, Bardhaj, Qorraj, Mekaj, Zekaj, Demaj, Kurtaj, Beqiraj, Mujaj, Rexhaj, Qelaj, Lulaj, Dreshaj etj.

89. Çabej. E. Rreth kumtesës së H. Boisit Sprovë e përkohshme ..., në KPSA, Tiranë, 1965, f. 354.

90. Boisin. H. Sprovë e përkohshme për një klasifikim të emrave të përveçëm në shqipe, në KPSA, Tiranë, 1965, f. 176.

Këndeje shpeshherë dëgjohen dhe shkruhen: Hajdari, Bardhi, Qorri, Meku, Zeka, Dema,

Kurti, Beqiri, Muja, Rexha, Qela, Luli, Dreshi etj⁹¹. Kështu pra shpesh ngjet të bëhet njëjtësimi i patronimit me antroponim dhe, njëherës, paraqitet edhe vështirësimi i dallimit të tyre.

5.9. Gjendja e sotme e antroponimeve në Pejë me rrethinë

Shtimi i madh i popullsisë, lëvizjet e vendasve, shkollimi, popullimi gjithnjë e më i madh me banorë të rinj, zhvillimi i turizmit, ngritja e dhjetëra objekteve të rëndësishme hoteliere, zhvillimi i teknologjisë, lufta e fundit, kontaktet me anas të tjerë anekënd Kosovës dhe më gjerë, miqësitë e shumta etj., janë faktorë kyq edhe në fushën e antroponimisë së sotme të Pejës, ku në krahasim me të kaluarën, mund të vërehen ndryshime, sidomos në planin e zgjedhjes së emrave të rinj. Në këtë mënyrë antroponimia e sotme e Pejës po të shikohet në aspektin krahasimtar me atë të para një-dy deceniesh, natyrisht se është më e pasur me antroponime më të shumëduarta e sidomos bie në sy futja në përdorim e antroponimeve me mbështetje kombëtare dhe lënia anash më tepër e antroponimeve të gurrës orientale. Përmes sferës së antroponimisë këndeje mund të shihet shprehja e dashurisë ndaj kombit dhe ndaj simboleve kombëtare, admirimi dhe krenaria për të kaluarën e lavdishme historike dhe për lashtësinë shqiptare, hetohet mburrja me cilësi të larta fisnike dhe njerëzore, interesimi për zhvillimin e arsimit dhe kulturës etj.

Kryesisht këto edhe janë fushat më kryesore nga merren dhe kërkohen sot antroponime të reja. Siç kemi vërejtur, emërvënie mjaft të shpeshta të kohës së sotme janë antroponimet që për rrënjë kanë trajtat e hershme të emrit të popullit tonë Alb - e Arb⁹² si për shembull antroponimet: Alban, Albana, Arbër, Arbërie, Arbnore, Arbenitë, Arbneshtë, Albatros, Arbër etj. Sikundër dëshmohet edhe në traditën vendëse, antroponimet e këtilla jepen me mburrje kombëtare si ringjallje e trajtave të lashta të emrit të shqiptarëve. E rëndësishë socioonomastike është ruajtja dhe kujtimi për njërin nga fiset kryesore ilire që banonin në Shqipërinë e Mesme, ruajtja e emrit përmbledhës për shqiptarët në mesjetë, ruajtja e emrit që përdoret sot për shqiptarët e Italisë së Jugut, të Greqisë dhe të Dalmacisë etj., që në njëfarë mënyre përmes këtyre antroponimeve mund të nxjerrim dritë për shtrirjen

91. Mujaj Hasan, Koha 4, Titograd, 1983, faq. 459.

territoriale të etnisë sonë në përgjithësi. Po ashtu përdorim të dendur në antroponiminë e sotme kanë edhe antroponimet kompozita të përbëra. Ato, të shpeshtën shkojnë dhe formohen nga ngjitja e dy emrave, nga ngjitja e një ndajfoljeje me një emër, nga ngjitja e një emri me një mbiemër, nga ngjitja e një foljeje me një emër etj.⁹³ p.sh. Afërditë, Syzanë, Fatbardhe, Leuditë, Arditë, Mirlinde, Fatmire, Mirditë, Fatlume, Arburim etj. Shprehet këtu njëkohësisht edhe dëshira prindore që fëmijët e tyre në përgjithësi të kenë shumë fat, të jenë fatlumtur, t'i shoqërojë e mira dhe jeta t'u sjellë mbarësi, të shoqërohen me ditët e lumtura, fatmirësisht e lumturisht. Nuk hezitohet që përmes emërvënieve të nderohen krahinat me zë si ajo e Mirditës, që tregon njohje, afri dhe unitet.

Antroponime të shpeshta në anë të Pejës me rrethinë janë edhe emrat që në një mënyrë shprehin cilësi të larta dhe të çmueshme njerëzore p.sh. Besnik, Besim, Bujar, Bashkim, Fisnik, Fatos, Lavdim, etj.

Antroponimet e kësaj dore këndeje nuk jepen pa ndonjë domethënie, përkundrazi, me antroponim shprehet edhe dëshira e emërdhënësit për cilësi sipas kuptimit të emrit. Përpjekjet e shqiptarëve për çlirim kombëtar nuk pushuan asnjëherë, por përkundrazi ato vazhduan duke gjetur forma të reja të rezistencës, përmes mbajtjes deri në fund zotimeve të bëra, mosshmangies asnjëherë nga detyrat e marrura përsipër, ndjekja e pa lëkundur e parimeve me të cilat është lidhur nga një ideal a nga një qëllim i përbashkët, përmes mosndryshimit të ndjenjave dhe qëndrimeve kundrejt dikujt a diçkaje, ruajtja deri në fund e dashurisë për fjalën e dhënë, mbrojtja e saj me çdo kusht e çmim, deri në fund, si luftëtar, ushtar, shok, mik, pra si besnik i bindjes së fortë se diçka është e vërtetë ose se do të kryhet patjetër, ndjenja të sigurisë për dikë që ka merita e veti të larta, bindje në çiltërinë, ndershmërinë dhe ndërgjegjen e dikujt, sigurinë në forcën e arsyes dhe drejtësinë e dikujt, qëndrimin e mbështetur në këtë bindje, në besim të patundur dhe të pakufishëm etj. Në antroponiminë e sotme të Pejës me rrethinë gjejmë mjaft vend edhe emra sipas emrave të simboleve kombëtare, antroponime nga fusha e ilirologjisë, sipas emrave të trupave qiellorë, antroponime sipas toponimeve, sipas titujve të revistave dhe të veprave letrare, antroponime sipas emrave të heronjëve të popullit, sipas emrave të shkrimtarëve dhe të patriotëve eminentë kombëtarë etj. p.sh.: Shqiponjë, Shqipri, Shqipe, Flamur, Teutë, Ilir, Agron, Yll, Venerë, Ylber, Vlorë, Valbonë, Kosovare, Jehonë, Antigone, Norë, Naim,

92. Çabej, E. Për gjenezën e literaturës shqipe, Prishtinë, 1970, f. 27.

93. Mujaj, Hasan. Koha 4, Titograd, 1983. faq. 460.

Ramiz, Ganimete, Bajron, Migjen, Visar, Luigj, Bajram, Ismail, Isai etj.

Vlen të përmendet se antroponimet e fundit sot këndeje nuk jepen me ndonjë paragjykim dhe besim fetar sikundër jepeshin në të kaluarën, por siç dëshmohet edhe në terren, këto antroponime jepen me mburrje kombëtare në shenjë ringjalljeje të emrave dhe të veprave madhore të militantëve zulmëdhënje kombëtarë. Mjaft i shpeshtë del sot këndeje edhe antroponimi Arsim, që në një farë dore është shprehje e dëshirës për arsimim dhe shprehje e afirmimit të rolit të misionit të rëndësishëm të arsimit dhe të kulturës në zhvillimin dhe në transformimin shoqëror. Kohët e fundit kemi mjaft antroponime edhe nga fusha e kinematografisë, muzikës, sportit etj. Kanë dalë mjaft antroponime edhe nga lufta e fundit. Përsëritja e emrave tashmë është dukuri e rrallë, me përjashtim të rasteve të veçanta, sidomos të ndonjë rasti tragjik. Vlen të theksohet se sot këndeje nuk përdoren si antroponime të reja emrat që shprehin besimin pagan të popullatës si dhe paragjykimet e gabueshme se emri do ta sigurojë fëmijën në jetë si për shembull: Keqo, Ujk, Ujkie etj. Më në fund na duket e arsyeshme t'i themi edhe dy fjalë rreth çështjes së shkrimit të drejtë të antroponimeve të Pejës me rrethinë. S'ka dyshim se shkrimi dhe përdorimi i drejtë i antroponimeve në përgjithësi paraqet një pikë të rëndësishme të ortografisë sonë. Rreth kësaj çështjeje në shkrime të ndryshme shpeshherë paraqiten dysi dhe kështu dalin edhe trajta të gabuara shkrimore antroponimike. Por, është e arsyeshme se kësaj çështjeje, në anë të Pejës si dhe në anë të tjera, në të kaluarën, në mungesë të nivelit të duhur të arsimit të popullatës, nuk ka qenë e mundshme t'i ndalet vrapi dhe kështu emrat të shkruhen pa gabime të mëdha gjuhësore. Kështu, në regjistrime të mëparshme gjejmë të jenë shkruar p.sh. Lirijë, Luanë, Lulë, Eminë, Fatimë, Binakë, Gzim, Ilirë, Agimë, Hajri etj. Në vend se të shkruhen: Lirie, Luan, Lule, Emine, Fatime, Binak, Gëzim, Ilir, Agime, Hajrie etj. Ndërkaq sot, siç mund të shihet edhe nga regjistrimet e reja të antroponimeve në shkrimet zyrtare, antroponimet dhe patronimet, në krahasim me të kaluarën, shkruhen dukshëm më mirë dhe, ç'është edhe më e rëndësishme, vërehet kërshëri dhe intersim që të shkruhen sa më drejtë gjuhësisht. Megjithëkëtë, shkrimit dhe përdorimit të drejtë të antroponimeve dhe të patronimeve sidomos regjistrimit të emrave vetjakë në fletoret zyrtare duhet t'i kushtohet kujdes më i madh. Së fundi, mendojmë se edhe në sferën e antroponimisë është arritur të përfitohet një pasqyrim më i qartë mbi antroponiminë e Pejës, prapëseprapë, edhe nga kjo hapësirë mbesin edhe çështje që meritojnë të kërkojnë më tej.

Elwys De Stefani, studiues onomastike nga Zvicra, duke përshkruar rëndësinë e emrave dhe strukturën e tyre sociale, emrat e përveçëm i sheh në prizmin e kërkimit onomastik gjuhësor, kryesisht nga një perspektivë historike të ekzaminuar. Mendojmë se një analizë sinkronike e kësaj çështjeje duhet t'i nënshtrohet edhe vështirimit social. Emrat e përveçëm në mjedisin e hulumtimit tonë janë të përfshirë nga kënde të ndryshme shqyrtimi. Janë ruajtur me fanatizëm, madje kanë kaluar edhe në pseudonime familjare, që në këtë komunitet janë të zakonshëm. Këtu, gjuha sociale e njësive antroponimike shërben për të vëzhguar dhe mësuar toponominë vendase. Ky vëzhgim siguron studiuesin për dallimet e emrave të përveçëm, zakonisht kategorizimin ndërmjet emrave personalë dhe emrave të vendeve në fjalë themelore. Gjatë punës hulumtuese kemi hasur në shumësi përdorimesh unike dhe kontradiktore të termave socialë.

Në faktorin kohë dhe hapësirë, socioonomastika koncepton nevojën për paraqitjen e kushteve të reja, si problem specifik terminologjik, me theks të veçantë analizën strukturore të llojeve të ndryshme të emrave risimtarë duke zëvendësuar kështu termat e vjetëruar përmes pozicionimit gjuhësor.

Në këtë rrjedhë doemos duhet përmendur edhe faktorë të tjerë si: onomastikën gjuhësore, sistemonomastikën, gramatikën, pragmatikën, arealonomastikën, kronologjinë, psiko onomastikën, neuroonomastikën, onomastikën statistikore, leksikografinë e emrit etj.

5.10. Fjalor i antroponimeve të Rugovës

A

Abáz - i, e. m.

Adém - i, e. m.

Adnán - i, e. m.

Adíl - i, e. m.

Afërditë - e. f.

Afrorë - e. f.

Afrím - i, e. m.

Agíme - ja, e. f.

Agrón - i, e. m.

Agón - i, e. m.

Agán - i, e. m.

Ahmét - i, e. m.

Aídë - a, e. f.

Ajshé - ja, e. f.

Ajet - i, e. m.

Ajdín - i, e. m.

Alí - a, e. m.

Alúsh - i, e. m.

Albán - i, e. m.

Albánë - a, e. f.

Altín - i, e. m.

Albértë - a, e. f.

Alísë - a, e. f.

Albéri - a, e. f.

Amár - i, é

Antigónë - a, e. f.

Anjézë - a, e. f.

Avdýl - i, e. m.

Avdí - a, e. m.

Azém - i, e. m.

B

Bálë - a, e. m.

Báli - u, e. m.

Bánush - i, e. m.

Bájram - i, e. m.

Bardhó - i, e. m.

Báde - ja, e. f.

Bégi - ja, e. f.

Békë - i, e. m.

Bélë - i, e. m.

Békim - i, e. m.

Besim - i, e. m.

Besnik - u, e. m.

Bésë - a, e. m.

Bestáre - ja, e. f.

Bésime - ja, e. f.

Beháre - ja, e. f.

Behár - i, e. m.

Béqir - i, e. m.

Bédri - u, e. m.

Bélkó - u, e. m.

Bésmir - i, e. m.

Bínak - u, e. m.

Bíkë - a, e. f.

Arbnóre - ja, e. f.

Ardít - i, m.

Arditë - a, e. f.

rdiánë - a, e. f.

Ardijëtë - a, e. f.

Argjénd - i, e. m.

Aríf - i, e. m.

Arbnëshë - a, e. f.

Arbúrim - i, e. m.

Armén - i, e. m.

Artán - i, e. m.

Artë - a, e. f.

Astrít - i, e. m.

Atifëte - ja, e. f.

Aurórë a, e. f.

C

Cáfë - a, e. m.

Cánë - a, e. m.

Cénë - a, e. m.

Cól - i, e. m.

Cóle - ja, e. f.

Cúbë - a, e. f.

Cúfë - a, e. m.

Cúklinë - a, e. f.

Cymë - a, e. f.

Ç

Çún - i, e. m.

Çélë - a, e. m.

Bislím - i, e. m.

Blérim - i, e. m.

Blínerë - a, e. f.

Bléron - i, e. m.

Blin - i, e. m.

Brahim - i, e. m.

Brah - i, e. m.

Buláke - ja, e. f.

Búte - ja, e. f.

Bútrint - i, e. m.

Bujar - i, e. m.

Búl - i, e. m.

Búdak - u, e. m.

Bárdhec - i, e. m.

Báshkim - i, e. m.

D

Dínore - ja, e. f.

Díje - ja, e. f.

Ditrónë - a, e. f.

Dituri / e - a, e. f.

Dritë - a, e. f.

Dritón - i, e. m.

Drén - i, e. m.

Dritëmirë - a, e. f.

Dránë - / e, a, e. f.

Dnóre - ja, e. f.

Drenúshë- a, e. f.

Dodónë - a, e. f.

Dónikë - a, e. f.

Deónjetë - a, e. f.

Çéltina - a, e. f.

Çétinë - a, e. f.

Çiljetë - a, e. f.

D

Dánë - a, e. m.

Dafinë - a, e. m.

Delfinë - a, e. m.

Dashuri / e – a, e. f.

Dákë - a, e. m.

Dalinë - a, e. f.

Dárdan - i, e. m.

Dárdane - ja, e. m.

Dasártë - a, e. f.

Dáorsë - a, e. f.

Dáltinë - a, e. f.

Dárdaneshë - a, e. f.

Démë - a, e. m.

Démush - i, e. m.

Déli - u, e. m.

Désarë - a, e. f.

Déa e. f.

Délonë - a, e. f.

Délvinë - a, e. f.

Dëshire - ja, e. f.

Dinë - a, e. m.

Dionís - i, e. m.

Díellëzë - a, e. f.

Díamant - i, e. m.

F

Dónisë - a, e. f.

Duruntinë - a, e. f.

Dórëllirë - a, e. f.

Dúdë - a, e. f.

Dúresë - a, e. f.

Dúarartë - a, e. f.

Dúl - i, e. m.

Dýl - i, e. m.

Dýkë - a, e. f.

DH

Dhuratë - a, e. f.

E

Emínë - ja, e. f.

Emín - i, e. m.

Elonë - a, e. f.

Elífe - ja, e. f.

Erëmirë - a, e. f.

Erëza, e. f.

Emrím - i, e. m.

Edúard - i, e. m.

Edmónd - i, e. m.

Elnart - i, e. m.

Egzon - i, e. m.

Elvirë - a, e. f.

Elvis - i, e. m.

Elsë - a, e. f.

G

Fatbardhë - a, e. f.
 Fatime - ja, e. f.
 Fatlume - ja, e. f.
 Fatjonë - a, e. f.
 Fatmíre - ja, e. f.
 Fatón - i, e. m.
 Fatós - i, e. m.
 Faík - i, e. m.
 Fatjón - i, e. m.
 Fatlína - i, e. m.
 Fadíl - i, e. m.
 Farúk - i, e. m.
 Fazë - a, e. f.
 Fahríe - a, e. f.
 Faslí - /a, u, e. m.
 Fatjetë - a, e. f.
 Feríz - i, e. m.
 Fjoralbë - a, e. f.
 Fekë - a, e. m.
 Festinë - a, e. f.
 Feríd - i, e. m.
 Fehmi - i, e. m.
 Festón - i, e. m.
 Filloretë - a, e. f.
 Fidajete - ja, e. f.
 Fikríe - a, e. f.
 Fitím - i, e. m.
 Fidan - i, e. m.
 Fisník - u, e. m.
 Fidajete - ja, e. f.

Ganí - /a, u, e. m.
 Ganimét - ja, e. f.
 Gálë, - a, e. f.
 Gazménd - i, e. m.
 Gazmír - i, e. m.
 Galdim - i, e. m.
 Gezím - i, e. m.
 Gentiánë - a, e. f.
 Gént - i, e. m.
 Gentrít - i, e. m.
 Getoár - i, e. m.
 Gentián - i, e. m.
 Glaúk - u, e. m.
 Gríshë - a, e. f.
 Grósh - i, e. m.
 Gramén - i, e. m.
 Granít - i, e. m.
 Gramoz - i, e. m.
 Gurakúq - i, e. m.
 Guxim - i, e. m.

GJ

Gjelbrím - i, e. m.
 Gjevahíre - ja, e. f.
 Gjévë - a, e. f.
 Gjevríe - ja, e. f.
 Gjemáil - i, e. m.
 Gjýlë - a, e. f.
 Gjýkë - a, e. f.

Flamure - a, e. f.

Flakë - a, e. f.

Florentinë - a, e. f.

Floríe - a, e. f.

Flórent - i, e. m.

Flútur - a, e. f.

Flamendë - a, e. f.

Fortesë - a, e. f.

Fráshën - i, e. m.

Frymëzim - i, e. m.

Frosínë - a, e. f.

Freskím - i, e. m.

Furtúnë - a, e. f.

Fuád - i, e. m.

Halít - i, e. m.

Háxhë - i, a, e. m.

Hazíre - ja, e. f.

Hilmí - u, e. m.

Hidajéte - ja, e. f.

Hikméte - ja, e. f.

Hýkë - ja, e. f.

Hyrí - ja, e. f.

Hýrë - a, e. f.

Hysníje - ja, e. f.

Hysén - i, e. m.

I

Ibér - a, e. m.

Idríz - i, e. m.

H

Hálë - a, e. f.

Hákë - a, e. f.

Hálil - i, e. m.

Hajríe - a, e. f.

Hajdár - i, e. m.

Hátë - a, e. f.

Hatíxhe - ja, e. f.

Halít - i, e. m.

Haredín - i, e. m.

Hasíme - ja, e. f.

Halíme - ja, e. f.

K

Kamar - i, e. m.

Kamer - i, e. m.

Kasem - i, e. m.

Kadri - i, e. m.

Kapllan - i, e. m.

Kadrije - ja, e. f.

Kadire - ja, e. f.

Kashire - ja, e. f.

Kaltrinë - a, e. f.

Kosovare - ja, e. f.

Kreshnik - u, e. m.

Krenare - ja, e. f.

Kumri - e, ja, e. f.

Kushtrim - i, e. m.

Kysmete - ja, e. f.

Ilír - i, e. m.

Ilirianë - a, e. f.

Ilmíje - ja, e. f.

Ismét - i, e. m.

Islám - i, e. m.

Imer - i, e. m.

Is - a, e. m.

Icó - i, e. m.

Isúf - i, e. m.

Izét - i, e. m.

J

Jáh - a, e. m.

Jahír - i, e. m.

Jakúp - i, e. m.

Janinë - a, e. f.

Jashár - i, e. m.

Januz - i, e. m.

Jehonë - a, e. f.

Jetmir - i, e. m.

Jeton - i, e. m.

Jetë - a, e. f.

Jetmirë - a, e. f.

Jetlir - i, e. m.

Jona - e. f.

Jetullah -u, e. m.

Jehon - i, e. m.

Jetdrit - i, e. m.

Manë - a, e. f.

Mahije - ja, e. f.

L

Lacë - a, e. f.

Lavdim - i, e. m.

Laurë - a, e. f.

Lekë - a, e. m.

Leonore - ja, e. f.

Leuditë - a, e. f.

Lirim - i, e. m.

Lirak - u, e. m.

Lirie - a, e. f.

Liridonë - a, e. f.

Lule - ja, e. f.

Luljetë - a, e. f.

Lume - ja, e. f.

Luan - i, e. m.

Lulëzim - i, e. m.

Lumturie - a, e. f.

Lavdie - a, e. f.

Labinot - i, e. m.

Lisjan - i, e. m.

M

Malë - i, e. m.

Marigonë - a, e. f.

Masar - i, e. m.

Malush - i, e. m.

Nexhat - i, e. m.

Norë - a, e. f.

Manushë - a, e. f.

Makfired - e, e. f.

Malsore - ja, e. f.

Meritë - a, e. f.

Metë - a, e. m.

Mehmet - i, e. m.

Metush - i, e. m.

Mehrije - ja, e. f.

Mentor - i, e. m.

Meritë - a, e. f.

Meriton - i, e. m.

Melisë - a, e. f.

Mekrih - u, e. m.

Mejreme - ja, e. f.

Melo - i, e. m.

Mërgim - i, e. m.

Mic - i, e. m.

Micol - i, e. m.

Mire - ja, e. f.

Misin - i, e. m.

Minire - ja, e. f.

Mirditë - a, e. f.

Mirsad - i, e. m.

Miradie - ja, e. f.

Mirvete - ja, e. f.

Mirëlinde - ja, e. f.

Muhamet - i, e. m.

Muharrem - i, e. m.

Musë - a, e. m.

Mustafë - a, e. m.

Mulë - a, e. m.

Nuri - ja, e. f.

Nushë - a, e. f.

Nitë - a, e. f.

Nëntor - i, e. m.

Nderim - i, e. m.

O

Osman - i, e. m.

Orges - i, e. m.

Orgesë - a, e. f.

Ora - a, e. f.

Olisa - a, e. f.

Omer - i, e. m.

Ornesë - a, e. f.

Ojesë - a, e. f.

Olti - i, e. m.

P

Pajtim - i, e. m.

Pandorë - a, e. f.

Petrir - i, e. m.

Pajtesë - a, e. f.

Pleurat - i, e. m.

Plator - i, e. m.

Pranverë - a, e. f.

Puhizë - a, e. f.

Poemë - a, e. f.

Patriot - i, e. m.

Pavarësim - i, e. m.

Muqë - a, e. m.

Premton - i, e. m.

N

Q

Naim - i, e. m.

Qamil - i, e. m.

Naser - i, e. m.

Qazim - i, e. m.

Natyrrë - a, e. f.

Qëndrim - i, e. m.

Nadire - ja, e. f.

Qershore - ja, e. f.

Nasibe - ja, e. f.

Qëndresë - a, e. f.

Naxhije - ja, e. f.

Qëllim - i, e. m.

Naile - ja, e. f.

Qemal - i, e. m.

Nepe - ja, e. f.

Qerim - i, e. m.

Njomëz - a, e. f.

Qiljetë - a, e. f.

R

SH

Ramë - a, e. m.

Share - ja, e. f.

Ramiz - i, e. m.

Shake - ja, e. f.

Razë - a, e. f.

Shaqir - i, e. m.

Rafete - ja, e. f.

Shahire - ja, e. f.

Ragip - i, e. m.

Shaban - i, e. m.

Ramadan - i, e. m.

Shate - ja, e. f.

Raif - i, e. m.

Shegë - a, e. f.

Rabë - a, e. f.

Sherif - i, e. m.

Rake - ja, e. f.

Shehrie - a, e. f.

Ramok - u, e. m.

Shefqet - i, e. m.

Remzije - ja, e. f.

Shkurtë - a, e. f.

Refik - u, e. m.

Shkëndijë - a, e. f.

Rexhë - a, e. m.

Sheqere - ja, e. f.

Rexhep - i, e. m.

Shyhrete - ja, e. f.

Rizë - /a, i, e. m.

Shytë - a, e. f.

Rinor - i, e. m.

Resmie - a, e. f.

Rea - a, e. f.

Redonë - a, e. f.

Rozafë - a, e. f.

Rukë - a, e. f.

Ryvë - a, e. f.

S

Sadik - u, e. m.

Sadri - a, e. m.

Salih - i, e. m.

Sabrie - a, e. f.

Sadie - a, e. f.

Sanie - a, e. f.

Sarafinë - a, e. f.

Sarandë - a, e. f.

Sadete - ja, e. f.

Serminë - a, e. f.

Skënder - i, e. m.

Selman - i, e. m.

Serbeze - ja, e. f.

Sevdie - a, e. f.

Selvie - a, e. f.

Selim - i, e. m.

Sutë - a, e. f.

Sylë - a, e. m.

Synë - a, e. f.

T

Tane - ja, e. f.

Tahir - i, e. m.

Trashe - ja, e. f.

Teutë - a, e. f.

U

Ukë - a, e. m.

Ujk - a, e. m.

Ujkan - i, e. m.

Ujkie - a, e. f.

V

Vake - ja, e. f.

Vasë - a, e. f.

Valdet - i, e. m.

Valbonë - a, e. f.

Veton - i, e. m.

Violetë - a, e. f.

Visar - i, e. m.

Vlorë - a, e. f.

Vjollcë - a, e. f.

Z

Zajm - i, e. m.

Zake - ja, e. f.

Zade - ja, e. f.

KREU I GJASHTË

(Pjesa e parë)

6. SOCIOONOMASTIKA TOPONIMIKE

Studimet për dijen e onomastikës shqiptare kanë shkuar mjaft përpara dhe kështu mund të thuhet se sot është krijuar një themel i fortë për gjurmime të mëtejme në këtë fushë.

Një pikëpamje e tillë nuk mund të thuhet edhe për socioonomastikën e cila deri me sot nuk është trajtuar, analizuar e studiuar sa duhet, me ndonjë përjashtim të vogël, andaj ky studim mendojmë se do të jetë me interes të kësaj dijeje risimtare, me fushëveprim aspektin social dhe trajtimin toponimik në dritën sociale.

Socioonomastika, një disiplinë shkencore e onomastikës, me gjithë faktin se paraqet interes për metahulumtime të kësaj dijeje, ka mbetur në margjina kërkimi. Ajo ndriçon e zgjeron rrethanat sociale e rajonale të shumë emërtimeve toponimike dhe antroponimike; ajo kundron të dhënat onomastike sipas fushave të veprimtarive të popullatës të anëve përkatëse, të cilat (veprimtari) shërbejnë si shtysa motivuese emërtimeve onomastike.

Përpjekja jonë në këtë punim është që të ravijëzojmë aspektet socioonomastike të toponimisë, me theks të veçantë njohjen dhe përdorimin e toponimeve jo të standardizuara në disa zona të ndryshme të qytetit të Pejës me rrethinë që në vazhdimësi kanë qenë vend studimesh e kërkimesh historike, dialektore, etnologjike, gjuhësore, arkeologjike etj. Kundruar nga konteksti i trashëgimisë arkeologjike dhe të ndryshimeve të toponimeve, gjejmë dëshmi të hershme të vendbanimeve në këtë trevë që nga parahistoria.¹

Edhe studiuesja **Edi Shukriu** e saktëson një fenomen të tillë: ...kultura e hershme e konstatuar në rajon është ajo neolitike e Starçevës, e konstatuar me vendbanimin e vogël të Rugovës (lokalitetet Kalldërma dhe Selishtë).²

Qëllimi i hulumtimit tonë është një përpjekje për të zbuluar se si karakteristikat e ndryshme të banorëve dhe marrëdhëniet e tyre me zonën ndikojnë në njohuritë e tyre dhe përdorimin e toponimisë (kompetenca toponimike) duke pasur kështu parasysh edhe ndikimin e rrethinës.

Disa mikrotoponime, nga emërtimi, tregojnë fushën e veprimtarisë së vendësve p.sh.

1. Muja, Hasan, Të dhëna nga onomastika e Rugovës, Çështje të Stud, Albanol., Prishtinë, 1987, faq.313.

2. Toponimia e Gjakovës me rrethinë . Kuvendi Komunal Gajkovë, Gjakovë 2002, faq. 45.

mikrotoponimi **Mrizet**: vend nën hije ku qëndrojnë delet kur bën vapë e madhe;

Vatha: vend i rrethuar me gardh ku i mbyllin delet natën në bjeshkë;

Shtrunga: shteg brenda vathës nga kalojnë delet një nga një për t'i mjelë etj.

Për etimologjinë e këtij mikrotoponimi kishte shkruar prof. **E. Çabej** dhe e pa të dalë nga folja shtrëngo. Emërtimet e këtilla shtrihen kryesisht në bjeshkët e përshtatshme me ujë e kullota për bagëtinë.

Emërtimi mikrotoponimik **Ograjë/a** është një hapësirë në fushë e rrethuar me gardh në të cilën rritet bari më shumë dhe ruhet për të kullotur vjetat.

Mikrotoponimet *Ara e Gjatë, Orrnica, Kopirishta, Selishta* etj. (në fshatin Shkrel) i përkasin fushës së bujqësisë dhe shtrihen në shumë fshatra që po kështu dëshmojnë rrethanat e jetës e të veprimtarisë së popullatës.

Mikrotoponimi **Prâjs** emërtin vendin, të përshtatur për t'u ulur qoftë mbi gurë, qoftë mbi rrënjë të gjatë lisi pranë rrugës, të latuar për të krijuar sipërfaqe më të gjerë uljeje të udhëtarëve këmbësorë pas rrugëtimit të gjatë.

Mikrotoponimet e këtilla duhet të ndiqen në dritën e dijeve të integruara si p. sh. **socioonomastikë, sociosemiotikë, pragmalinguistikë** etj. nga mund të nënkuptohen: *shtresat sociale, ekonomia familjare, relievi, tiparet sociolinguistike të një zone etj.*

Socioonomastika aplikative është e pranishme edhe në fushën e antroponimisë, sidomos në rastet e përdorimit hipokoristik të antroponimeve qoftë me formante formëformuese, qoftë me shkurtime emrash nga shtysa përkëdhelie p.sh. **Temko** nga Rustem, **Beqë** nga Beqir etj.

Kjo disiplinë shkencore e onomastikës (*socioonomastika*) mund të gjendet e ndërmpleksur në disa antroponime metaforike, të cilat, si pikënisje emërvënie, kanë forcat e mbinaryrshme, teorinë e gjasës dhe koncepte ireale të së kaluarës së errët.

Antroponimet mbi bazën metaforike shtrihen më shumë në krahinat malore të bjeshkëve të Rugovës, të Malësisë së Madhe etj. p.sh. **Bjeshkë – a, Lise, Lis-i, Ujk** (emër mbrojtës), **Mal (mal) Dash, Boronicë** etj.

Emrat e vendeve të pa standardizuara u mblodhën dhe u përzgjedhën rastësisht, duke u vendosur në një pyetësor socioonomastik, duke testuar kështu kompetencën toponimike në zonat e trajtuara. Të anketuarit janë pyetur gjithashtu për karakteristikat e tyre sociale,

opinionet, qëndrimet, aspektet emocionale dhe marrëdhëniet e tyre me zonën. Të dhënat u testuan statistikisht nga testi Wilcoxon dhe testi Kruskal-Wallis. Është konstatuar se njohuritë dhe përdorimi i toponimeve varen nga mosha dhe gjinia e të anketuarve, ndërkohë që niveli i arsimit është me më pak ndikim. Gjatësia e qëndrimit në zonë pjesërisht ndikon në kompetencën toponimike, por më i rëndësishëm është lloji i qëndrimit (*si fëmijë, turist, banor etj.*). Aspekte të tjera që ndikojnë në kompetencën toponimike janë: njohja e zonës, interesi në jetën e komunitetit, njohja e dialektit, qëndrimi ndaj riemërimit, qëndrimi ndaj hulumtimeve onomastike, duke e konsideruar zonën si një shtëpi. Njohuria dhe përdorimi i toponimisë ndikohet gjithashtu edhe nga karakteri social dhe ekonomik i zonës. Mund të themi përmes pikëpamjeve sociale të antroponimeve dhe toponimeve kemi kuptuar edhe kushtet natyrore të Pejës, klimën, relievin, florën, faunën si dhe strukturën sociale të popullsisë.

Mjafton që të përmendim emrat e fushave, arave, lagjeve, burimeve, varrezave, majave, shkëmbinjëve, grykave, shpellave, qafave, bjeshkëve, gurrave etj., që përmes aspektit social të saktësojmë zonën e trajtuar. Po ashtu, edhe në aspektin etnografik janë mjaft me interes disa toponime që tregojnë vende, Qafa e Dasmorëve, Kacuberri, Qafa e Diellit, Livadhi i Nuses, Dromodoli, Kodra e Kujit etj.; vendvarre: Varret e Krushqve, Varret e Llatinve, Varret e Katolikëve, Varret e Shehitëve, Varri i Shkaut etj. dhe objekte karakteristike nga tradita dhe jeta e popullit të kësaj ane si: Ara e Kishës, Bregu i Arushës, Bregu i Dashës, Shpella e Pëllumbe, Kapireshka e Cuke, Brija e Qylit, Qafa e Bukur, Gropat e Camit, Qafa e Murgashi, Gurra e Mrize, etj.

Onomastika përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash:

a) emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (**antroponimet**) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (**patronimet**) dhe b) emrat e vendeve (**toponimet**) të cilat, duke qenë të shumta dhe të ndryshme mund të grupohen edhe sipas disa ndarjeve të tjera:

Oikonimet apo emrat e vendeve të banuara (*qytete, qyteza, katunde, lagje etj.*); si pjesë e tyre mund të shihen edhe **etnonimet** apo *emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nënndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme*;

hidronimet apo emrat e ujërave (*dete, lumenj, liqene, përrenj etj.*);

oronimet apo *emrat e maleve, fushave, kodrave etj.*³

3. Shkurta, Gjovalin, Onomastikë dhe etnolinguistikë, ShBLU, Tiranë 2001, faq. 13.

Toponimia është ajo ndarje e onomastikës e cila merret me emrat gjeografikë të vendeve – toponimeve, të cilët i kuptojmë si objekte fiziografike dhe të pabanuara nga njerëzit, duke përfshirë emrat brenda njësive administrative, të tilla si qytete dhe fshatra.

Kështu, në kuadër të toponimeve dallohen: emra vendesh, emra të terrenit, emrat malorë, emrat e ujit, emërtimet urbane dhe rurale. Toponimet karakterizojnë objektin, pa e specifikuar atë si një njësi (*p.sh. emri i lumit Bistricë, si një toponim të përhershëm*).

Studimet toponimike lëvizin, ato përfshijnë çështjet e origjinës, tipologjinë e emrave të njohur në lidhje me objektet, klasifikimin e emrave, formalë, kulturorë, gjeografikë etj., emrat lokalë, ojkonimet ose makrotoponimet, emrat e qyteteve, fshatrave, vendbanimeve, kolonive etj.

Emrat e terrenit, ose **ojkonimet**, shpesh i quajmë *mikrotoponime*, të cilat i kemi objekt studimi, nga një prizëm social, pastaj emrat e vendeve të pabanuara nga njerëzit, të tilla si: emrat e fushave, livadheve, pyjeve, gropave, kodrave, rrugëve. Specifikë e kësaj fushe është tipari se vargu i tyre ka zonë të ngushtë të operimit, zakonisht të kufizuara në komunitete të vogla, sidomos në zonat rurale.

6.1. Rreth termit Socioonomastikë

Termi socioonomastikë (dhe variacionet e tij si **onomastike sociale, sociale antroponimike** etj.) po fillon të bëhet më i përdurur dhe më i specializuar në literaturën onomastike e zbuluar që nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të.

Mund të gjenden një numër të dhënash që fokusohen në aspekte sociale të shfaqjes dhe funksionimit të emrave të tyre që më herët, sidomos në fushën e antroponimisë, por autorët e tyre nuk e bëjnë këtë.

Në terma më të gjerë, termi **socioonomastikë** është dhënë nga gjuhëtarët gjermanë **H. Walther** (1972, f. 49-50) dhe **F. Debuss** (1977, f. 167-204), të cilët mund të konsiderohen ndër themeluesit e kësaj subdisipline onomastike.

Studiuesit gjermanë punuan me material antroponimik, ata vëzhguan frekuencat e emrave individualë dhe aspektet që ndikuan në zgjedhjen e emrit.

H. Walter (Walther, 1973, f. 13-30) bazohet në një koncept të gjerë të teorisë së komunikimit, frekuenca e emrave sipas tij është e lidhur me vlerat e komunikimit dhe ekzistencën jetësore të emrit.

V. D. Bondaletov (1970, f. 17-23), në literaturën profesionale sllave ishte një nga pionierët e **socio-ekonomisë** i cili këtë disiplinë e përcaktoi si: "**Onomastics and Sociolinguistics**", si zona të depërtimit të këtyre dy shkencave ai e përdori për të termin "**Onomastics social**".

V. A. Nikonov (Nikonov, 1974) po ashtu kontribuoi rreth këtij termi, me ç'rast trajtoi kriteret sociale të mbiemrave dhe diferencimin e tyre social, si dhe emrat e tyre personalë, zgjedhjen dhe përkatësinë e tyre në shtresën shoqërore.

Po ashtu, në **Kongresin e XII Ndërkombëtar të Onomastikës**, të mbajtur në vitin 1975 në Zvicër, kontribut të çmuar dhanë:

O. Höfler (1954, f. 26-53);

I. Lutterer (1967, f. 581-587) dhe

V. Blonar (1972, f. 203-208).

R. Šamám (1976, f. 78) për Kongresin përmendi: "Diskutimi u hartua dhe gjithashtu përdoret termi **socio-onomastik**, që do të thotë studimi i karaktereve sociologjiksht të kushtëzuara dhe i funksioneve të emrit të tyre në komunikimin gjuhësor".

Që nga vitet e tetëdhjeta të shekullit të 20-të, termi socioonomastikë është bërë gjithnjë e më popullor.

Kështu, socioonomastika u formua në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, në kohën kur shumica e studiuesve onomastikë kanë promovuar tashmë një koncept më të gjerë të onomastikës në krahasim me parimin aktual historik dhe etimologjik.

Hulumtimi i emrave të tyre në lidhje me aspektet e tyre sociale, megjithatë, sigurisht nuk ishte një çështje që është një fakt që mund të shpjegohet deri në një farë mase nga shfaqja e nëndisiplinave të reja të orientuara nga sociologjia.

Në dy dekadat e fundit të shekullit të 20-të, dy studime që në një farë mase referoheshin si programatike ishin vendimtare për krijimin e socio-ekomimisë.

W. F. H. Nicolaisen (1985, f. 118-132) boton studimin e parë të titulluar:

"**Socio-Onomastics**", si një përgjigje të vogël ndaj termit të deritashëm të përdorur: **Socio-ekonomik** në vendet anglishtfolëse dhe i atribuohet kësaj teorie socio-ekonomike si të zhvilluar keq dhe mbi të gjitha e vë në pah të zhdukurit e kësaj terminologjie, ku përmes një metodologjie të kuptueshme ai nuk pajtohet me konceptin **socio-ekonomik**, si pjesë e sociolinguistikës, pasi nuk e konsideron onomastikën si pjesë të gjuhësisë, por e përcepton atë si një *shkencë të pavarur*.

Nicolaisen (1985, f. 121) "... në thelb është i interesuar për interpretimin dhe kuptimin e emrave në përmbajtjen e tyre të plotë në çdo kohë në ekzistencën e tyre", prandaj, ai merret me të ashtuquajturën jetë të emrit, në kontekste të të gjithave - jo vetëm gjuhësore. Socioonomastikën **Nicolaisen** e definon si "pjesë të onomastikës e cila ka të bëjë me emrat si dukuri sociale dhe kulturore, ai heton fushën e emrave dhe të shoqërisë" (fq. 122).

F. Zbres (Zbres, 1996, f. 393-399) në studimin e tij, ndryshe nga Nicolaisen, i cili bazohet në qasjen tradicionale gjuhësore ndaj onomastikës, socioonomastikën e konsideron si *pjesë të sociolinguistikës*.

H. Walter në moton "**Namensozilogie (Socioonomastik)**" flet se onomastika është më tepër orientim social, mundësitë duken vetëm në antroponimi, prandaj përkrah lindjen e socioonomastikës.

6.2. Shqyrtimet e derisotme socioonomastike

Në trajtimin e çështjes se çfarë është në të vërtetë "**Socioonomastika në toponomi**", ne kemi vendosur për të gjetur shqyrtimet e deritashme dhe për të analizuar veprat që kanë trajtuar socioonomastikën toponimike. Këto të dhëna po i paraqesim në mënyrë kronologjike nga ku edhe Ne do të fillojmë këtë analizë.

- a) **Eichler E. Walther H.** "**Zur altsorbischen Soziotoponymie**" (1969, p. 239-247).

Artikulli merret me emrat lokalë (Old-Lothian).

Sociotoponimia është analiza sociologjike e llojeve toponimike. Autorët, bazuar në analizën e llojeve të formave të emrave të popullsisë, rindërtojnë zhvillimin social dhe ekonomik të popullsisë.

- b) **Gläser, R.** "**Toponimet e Australisë në dritën e socioonomastikës**" (1998, fq. 133-140).

Autori në këtë punim është i bazuar në material toponimik australian. Duke iu referuar Glaser-it, studiuesi **A. W. Reed**, e vë në kontekst të socioonomastikës evropiane. Sipas Reed, toponimet që kanë të bëjnë me emrat aborigjen (**Aboriginal**) vend, sipas Glaser-it thelbi sociotoponimik mbush qasjet që shqyrtojnë emrat e vendeve në kontekstin e kulturës, mitet, letërsinë dhe artet e tjera dhe aborigjenëve në lidhje me ndikimet politike dhe ekonomike.

Shënim: Aboriginského - *substrate në vend, emra bashkëkohorë australianë dhe që lëshojë një emër zyrtar - në disa raste u zëvendësuan plotësisht me emra Aboriginal emra anglisht, ndërsa në disa parqe kombëtare kanë dy emra të të njëjtit status. Vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu motivimit të nderit që zbatohet për motivimin e shumë toponimeve angleze.*

- c) **Rutkowski, M.** Monografi: "**Mikrotoponimi në ngjitje – hapësirë**" (**Microtopomy Przestrzeni Wspinaczkowej**). Studime socioonomastike (*Studia socioonomastyczne*), Sidnej, Australi, (2001).

Monografia merret me emrat e emërtimeve të përdorura në mjedisin e ngjitjes. Autori, së bashku me funksionet e gjera të analizës, emrave të motivimit, të vendeve dhe të metodave të mënyrës së pasurimit toponimik, i kushton vëmendje

të konsiderueshme, sidomos sistemit të interkoneksionit (*anoikonyms*) ngjitje me ngjitje - sociolekt. Socio-mikrotoponimi konsiderohet nga autori si një mjet identifikimi - njohuritë e tij prej përdoruesi toponimik paraqesin një arritje në një grup të veçantë interesi. Gjithashtu, vë në dukje ndikimet e sociolekteve të tjera (të tilla si gjuhët e folura të të rinjve) të përdorura në ngjitjen e emrave.

- d) **Pablë, A. “Miti dialektik” dhe “Socio-onomastics”.** (Adrian Pable, “**Miti i dialektit dhe socioonomastikës**”).

Emrat e kështjellave të Bellinzonës në një perspektivë integrimi " (2009, fq. 152-165). Autori reflekton përdorimin e gjallë (jo të standardizuar) toponiminë në Bellizona (rajonin e Zvicrës ku flitet gjuha italiane) në komunikimin e përditshëm. Kemi një vijimësi nga puna e tij e mëparshme e cila merrej me krahasimin e emrave, kompetencave, për vend (*p.sh. njohja e emrave*) dhe përdorimi aktual i toponimeve, duke marrë parasysh karakteristikat e informatorëve (përveç variablave të zakonshme sociologjike këtu fokusohet nëse ajo është një "përdorim lokal", përdoruesi i dialektit zviceran-italian, ose një emigrant që përdor italishten standarde rajonale). Hulumtimi origjinal zgjerohet me përdorimin e perspektivës së të ashtuquajturës gjuhësi integruese. Në materialet e marrura përmes intervistave të strukturuar, në të cilat intervistuesi paraqitet si një i huaj që ka një takim në një vend të quajtur “i pari” (toponimet e standardizuara tregojnë një nga tri kështjellat mesjetare në Bellizonë), autori provon se ka një kod të caktuar për njohuritë dhe për përdorimin e standardizuar të anëtarëve, të karakterizuar nga të njëjtët ndryshore sociologjike.

- e) Një pamje mjaft të plotë socioonomastike në fushën e kërkimit në toponimi e sjellë në hyrje të botimit **T. Ainiala dhe Jan –Ola Ostman: Socio-onomastics - The pragmatics of names**, (2017).

Ata merren më në detaje me hulumtimin e kompetencës toponimike: "*Ndryshimi social në emrat e vendeve është një temë kryesore në studimin e Kompetencës toponimike* (i (e) njohjes së caktuar - *Names*).

- f) Më tutje **Ainiala** shton: Kur ne studiojmë kompetencën toponimike të njerëzve, ne përpiqemi për të gjetur sa më shumë lloje të emrave, të vendeve, të njerëzve të

moshave të ndryshme, profesioneve, gjinive si në rrethet e tyre, në shtëpi etj., (*shih e.g. Pitkänen 1998, 2010*).

- g) Ne mund të shqyrtojmë të gjithë emrat apo variantet e emrave të njerëzve të ndryshëm, të origjinës së tyre, (i (e) vendasve dhe jo vendasve) përdoren për vende të veçanta (*shih e.g. Pablo 2009*).

Për më tepër, ne jemi të interesuar për të studiuar pse kompetencat toponomastike të njerëzve ndryshojnë nga njëri-tjetri, pse ata përdorin emra të ndryshëm në vend. **Ainiala** shton se variablat e përdorura në sondazhet e kompetencës toponimike janë të njëjta si në hulumtimet sociolinguistike: mosha, gjinia, përkatësia etnike, klasa socio-ekonomike, mënyra e jetesës, etj., përfshirë këtu edhe metodat më të përdorura të hulumtimit të socio-ekonomik. Pastaj Ainiala të njëjtat i sqaron përmes intervistave dhe pyetësorëve. Fusha të tjera të hulumtimeve toponimike socio-ekonomike përfshijnë, për shembull, kërkime në të ashtuquajturën peizazhe gjuhësore etj.

- h) **Kristýna Zouzalová** (*studiuese çeke*), duke trajtuar çështjet e përgjithshme onomastike, vie në përfundimet që kam ardhur edhe unë, se: socioonomastika është disiplinë relativisht e re gjuhësore, ende pa një zhvillim dhe teori të plotë, fokusi i së cilit është raporti dhe marrëdhëniet në mes të emrave në koherencë si dhe të ndryshimet që pësojnë ata në fushat e shoqërisë dhe individëve, duke zgjidhur kështu pyetjen se çfarë kritere zbatohen për të zgjedhur emrat e tyre personalë brenda shtresave të ndryshme shoqërore dhe në varësi të fenomeneve sociale.
- i) Studiesit amerikanë, **L. Leslie, Paul & K. Skipper, James**, drejt një teorie mbiemrash: **Një rast për socio-onomastikën** (1990). (*Emra. 38. 273-282. 10,1179 / nam.1990.38.4.273.*) zhvilluan një formë të re analize për pseudonime dhe nofka, ata propozuan një konstrukt teorik, duke përdorur njohuritë empirike të nofkave dhe duke paraqitur një perspektivë unike sociologjike, ku përshkruajnë dhe shpjegojnë pseudonimet si aspekte të procesit të veprimit shoqëror. Qasja e tyre ishte e lidhur me një teori të emërimit potencialisht të dobishëm për të gjithë dijetarët e emrave, të cilët studiojnë pseudonimet njerëzore, emrat e zyrave postare

në Kentaki, (*vendi i hulumtimit të tyre*) emrat e kafshëve, të pjesëve të trupit, apo toponimet fetare të Guatemalës, (*po ashtu vendi i hulumtimit të tyre*).

j) Rrejt i nordik socioonomastik

(*Birgit Eggert, Emilia Aldrin dhe Terhi Ainiala*)

Duke folur për socioonomastikën në trendet e reja nordike, **Birgit Eggert** nga Universiteti i Kopenhagenit, **Emilia Aldrin** nga Universiteti Halmstad dhe **Terhi Ainiala** nga Universiteti i Helsinkit themeluan një rrjet rreth të socioonomastikës, ku objektivi kryesor i krijimit të tij ishin tendencat e reja në socioonomastikën nordike, me qëllim të stimulimit dhe zhvillimit risimtar të kërkimit në terren. Është kjo një përpjekje që t'u mundësohet hulumtuesve të vendeve të ndryshme nordike që bashkërisht të frymëzohen për të shfrytëzuar zhvillimet e fundit teorike dhe metodologjike brenda kësaj fushe përmes qasjeve të reja dhe kreative.

Hulumtimi i emrit është një fushë e vogël kërkimore dhe ka pak studiues në këtë fushë në çdo vend nordik. Prandaj, një rrjet i përbashkët nordik ka për të luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e një mase kritike dhe opioneve për një ndarje të fokusuar të mendimit.

Organizimi i seminareve të rrjetit inkurajon pjesëmarrësit të eksplorojnë perspektiva teorike relevante për studimet socioonomastike, si dhe mjete të reja metodologjike të përshtatshme për studime bashkëkohore, historike dhe diakronike onomastike.

- k) Studiuesi gjerman **I. M. Nick** në një publikim rreth metodologjisë socioonomastike, botuar në internet *me 18 prill 2017, në faqet 129-142*, në një hetim të shkallës së vogël, përmes metodës së përzier në dy eksperimente hetoi praninë e mundshme të *paragjykimeve të mësuesve* të shkollës dhe mësimeve të nxënësve në lidhje me emrat e parë të nxënësve.

Në të parën, mësuesve të shkollave gjermane iu kërkua të vlerësonin në mënyrë cilësore dhe sasiore një ese letrare autentike të shkruar nga një nxënëse gjermane

me një gjuhë amtare. Për të testuar paragjykimet e mundshme të emrit u përgatitën tri versione gati identike të esesë. I vetmi ndryshim midis tyre ishte emri i parë i fëmijës që radhitet si autor i esesë (**Uwe, Achilleas dhe Mustafa**).

Në eksperimentin e dytë, grupi i emrave personalë u zgjerua për të përfshirë emrat e parë të gjinisë femërore (**Heike, Athena dhe Fatma**) dhe pjesëmarrësit e studimit ishin trajnues vullnetarë mësuesish.

Në të dyja eksperimentet u identifikuan dëshmi për paragjykime të fshehta të emrave. Në bazë të këtyre dhe gjetjeve të tjera, artikulli përfundon me sugjerime konkrete për hulumtime të ardhshme.

- 1) Studiuesi amerikan **Carol Gaye Lombard** në tezën e tij të doktoratës: **Rëndësia socioonomastike e markave amerikane të kafshëve** (*Studimi i rastit të Montanës, në nëntor 2015*), ndër të tjera shpjegon se për më shumë se dy shekuj fermerët e bagëtive në Montana dhe shtete të tjera amerikane si Teksasi dhe Wyoming kanë përdorur markat e hekurit të nxehtë si mjet kryesor për identifikimin, ndjekjen dhe promovimin e pronësisë për bagëtitë e tyre. Përkundër të ariturve të reja si zhvillimi dhe përdorimi i radiofrekuencës (RFID), markat e nxehta të hekurit mbeten mjeti më i preferuar i identifikimit të kafshëve në rajonet perëndimore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Një nga argumentet kryesore të paraqitura në tezën e tij është se sistemi i markave të bagëtive amerikane është në thelb gjuhësor, me një onomastikë të shquar, komponente. Ky supozim bazohet në faktin se markat e kafshëve janë entitete komplekse që përmbajnë simbole (*imazhe*), si dhe forma korresponduese të folura dhe të shkruara të cilat funksionojnë si emra të duhur. Përveç zotërimit të karakteristikave onomastike të tyre, markat e bagëtisë shfaqin një sërë shoqatash me emra të tjerë. Ky rrjet i marrëdhënieve onomastike është konstruktuar në mënyrë shoqërore, prandaj pasqyron kuptimet shoqërore themelore. Për këtë arsye është parashtruar se megjithëse markat e gjedheve nuk posedojnë domethënie leksikore ose gjuhësore, fitojnë dimensionet e ndryshme, do të thotë në bazë të shoqatave të tyre, me elemente të ndryshme në rrethet e tyre socio-kulturore.

Lomabard konstatoi dhe shpjegoi rëndësinë shoqërore dhe kulturore të kuptimin kontekstual të markave të kafshëve dhe përcaktoi shkallën dhe rolin në të cilën emrat dhe emërtimet e markave luajnë në themelimin e tyre. Sipas Lomabardit, eksplorimi i marrëdhënieve midis veçorive onomastike të markave të kafshëve dhe kuptimeve të tyre socio-kulturore, janë paraqitur si një studim në socioonomastikë. Hulumtimi ka identifikuar dy praktika të shquara onomastike të cilat luajnë një rol të fuqishëm në vendosjen e kuptimeve në kontekst ose shoqërimin e markave të kafshëve. Procesi i parë nënkupton përdorimin e llojeve të ndryshme të emrave (*duke përfshirë edhe pjesët e emrave*) si bazë për hartimin vizuel të bagëtisë, simbolet e markës, ndërsa në qasjen e dytë emrat e markave të kafshëve janë miratuar si lloje të tjera të emrave. Studimi tregon se përdoruesit e markës së bagëtive (*gjuhësore*) përdorin qëllimisht këto emërtime si strategji për të krijuar shoqata midis markave të kafshëve dhe elementeve të ndryshme në socio-kulturën e tyre. Studimi, po ashtu ka treguar, për shembull, se si tregimet që bashkohen me markat e kafshëve me anë të virtytit dhe shoqatave onomastike shkaktajnë kujtime për njerëzit, për vendet dhe për ngjarjet, që konsiderohen të rëndësishme në jetën e individëve, familjeve dhe grupeve të njerëzve që janë të lidhura me to.

m) **Patrícia Helena Frai**, studiuese portugeze, e përqendruar në fushë kërkimi në përshkrimin e fenomeneve gjuhësore, kulturore, të diskursit, të diversitetit etj., në artikullin socioonomastik: **Një çasje e re metodologjike** (2016) - thekson dallimin midis metodologjisë së emërimit antroponimik në një zonë të caktuar, përmes një studimi specifik të emrave të njerëzve, duke hetuar mënyra të ndryshme kërkimi antroponimik si: *etimologjia, origjina e emrit*, pastaj *analiza studimore e marrëdhënieve mes përdoruesve të emrit* etj. Ajo vërejtë disa metoda diferencuese gjatë kërkimeve të saja. Artikulli shpjegoi një metodologji të re për kërkimin e sigurt socioonomastik të zonës së sipërthënë, duke theksuar rëndësinë e metodave të veçanta për secilën objektivë studimi.

n) **Frai** vëren se sipas **Dick (1992)**, krijimi i një antroponimi është i lidhur ngushtë me faktorët historikë dhe socialë që përdor një komunitet i tillë.

Studimi i emrave të duhur është pjesë e fushës së madhe të *Leksikologjisë*, që synon studimin shkencor të fjalëve, kategorizimin e tyre dhe strukturimin, kurse sipas **Biderman (1998)**: "Leksikoni i një gjuhe natyrore është një mënyrë për të regjistruar dijen e universit. Në emërtimin e qenieve dhe objekteve, njeriu i klasifikon ato në të njëjtën kohë".

Në këtë drejtim, onomastika është një litar i studimit të *Leksikologjisë* që ka për qëllim studimin specifik të emrave të duhur të njerëzve, të emrave të vendeve, të qyteteve dhe të rrugëve (tomonimia), si dhe emrat e personave dhe mbiemrave.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar sferës socioonomastike e onomastike të emrave që lidhen me ngjarjet shoqërore.

Frai (2016) për këtë perspektivë teorike ka kryer një studim me synimin qendror të hetimit të motiveve që çojnë në zgjedhjen e emrit të dytë të fëmijës dhe lidhjeve të tyre (*emrave të dytë*) me ngjarjet historike dhe sociale, studim ky i kryer në qytetin *Rondon - Portugali*.

Fusha e studimit të emrave në antroponimi ka dy mënyra të ndryshme studimi, një është për të analizuar arsyet pse prindërit zgjidhnin një emër për fëmijën e tyre dhe e dyta se si zgjidhja është e lidhur me kontekstin sociokulturor. Në mënyrë që të dimë vërtetë se pse prindërit caktojnë një emër të dytë për fëmijët e tyre, përmes një interviste gjysmë të strukturuar ajo zgjodhi si procedurë metodologjike mënyrën që kërkuesi të mund të fliste drejtpërdrejt me informatorët. Theksi vihet mbi rëndësinë e një zgjedhjeje të veçantë, pasi, në këtë mënyrë, shumë informacione shtesë mund të mblidhen.

Një qasje e tillë kontribuon në forcimin e kësaj fushe studimi, duke treguar kështu se ekzistojnë shkathtësi adekuate dhe metoda të avancuara për t'u ndjekur në një hulumtim socioonomastik. Përveç kësaj, kemi të bëjmë me atë se pse kompetencat toponimike ndryshojnë nga njëra tjetra, pra, pse përdoren emra të ndryshëm lokalë.

- nj) Një hulumtim të detajuar të kompetencave toponimike, realizuar përmes hulumtimeve të thukëta, e ka dhënë edhe mr. **Jana Rausová**: "**Aspektet socio-onomastike të toponomisë në zonat e përzgjedhura**", tezë doktrate në Universitetin e Ostravës, 2018.

Prandaj, le të përpiqemi të përmbledhim drejtimet kryesore të hulumtimeve socioonomastike në fushën e toponimisë bazuar në literaturën e analizuar:

- *Toponimia e grupeve të ndryshme shoqërore;*
- *ndryshueshmëria toponimike;*
- *kompetenca toponimike (njohja dhe përdorimi i toponimeve);*
- *toponimet e pa standardizuara, toponimet zhargon;*
- *toponimet shoqërore përgjegjëse (p.sh. nderimi), riemërimi dhe*
- *peizazhet gjuhësore.*

6.3. Toponime të grupeve të ndryshme shoqërore

Në Pejë toponimisë i kanë kushtuar vëmendje studiues vendas dhe të huaj, studime këto të cilat sot janë si një gur themeltar për vazhdimet e mëtejme të kësaj fushe studimore, që në retrospektivë i shohim në një rrjedhë kronologjike të ndarjes, grupimeve të toponimeve si vijon: Kështu para njëqind e më shumë vitesh **F. Mikloshiqi** nga toponimia sllave dhe një klasifikim të toponimeve, i cili u pranua dhe u ndoq edhe nga studiues të mëvonshëm jo vetëm sllavistë, por edhe nga të tjerë. Ai kishte parë se ekzistojnë dy grupe kryesore toponimesh: 1. *Toponime që formohen nga emra njerëzish dhe* 2. *Toponime që emërtohen nga apelativet.*⁴ Ndërkaq **P. Shoku** jep këtë klasifikim: 1. *Emërtime të formuara nga biemrat;* 2. *Emërtime të substantivuara;* 3. *Emërtime të formuara nga apelativet toponimike dhe* 4. *Emërtime të përbëra dhe të përngjitura.*⁵

Me gjithë vlerën e mirë që kanë, sërish këto klasifikime, më duket, mbesin të ngushta dhe nuk arrijnë të kapin në tërësi lëndën toponimike, përkatësisht mënyrat e mbërthimit të saj. Po nga onomastika sllave një klasifikim më të kompletuar dhe më përmbledhës të toponimeve e ka dhënë studiuesi **P. Shimunoviq,**⁶ i cili arrin të depërtojë në thelbin e tipeve të shumta toponimike. Ai, duke u nisur nga disa kënde të mbërthimeve të emërtimeve toponimike, nxjerr në dritë shumë grupe dhe nëngrupe të toponimeve dhe kështu jep një klasifikim me mbështetje praktike. Një grup i toponimeve, sipas këtij autori, është ai që në bazë ka një termin vendpërshtkrues; në këtë grup të toponimeve, autori sheh:

- a) *Toponime që i përkasin konfiguracionit;*
- b) *Toponime që lidhen me përpunimin e tokës.*

Këtyre u shton edhe shumë nëngrupe.

Në onomastikën shqiptare kasifikimet më të plota dhe më të pranueshme deri sot për toponimet e një krahine, siç është thënë edhe nga disa studiues, janë klasifikimet e dhëna nga **A. Dhrimo**⁷ dhe **Izmit Durmishi**⁸, të cilët nisen më tepër nga toponimet më markante duke paraqitur kështu disa lloje toponimesh dhe disa mënyra të mbërthimit të emërtimeve toponimike. Grupimet e dhëna nga këta autorë i shohim si shumë të qëndrueshme.

Toponimia e Pejës ashtu sikundër edhe toponima e ndonjë treve tjetër paraqet të dhëna të rëndësishme jo vetëm për shkencën onomastike, por edhe për disiplina të tjera shkencore, prandaj, po deshëm që toponiminë e një ane ta vështrojmë në mënyrë të thukët dhe të gjithanshme, po deshëm që të arrijmë në konkludime të bazuara onomastike, atë duhet parë në dritën e ndërsjellë të dijes duke mos anashkuar rrafshin social.

“Toponimet ose emrat e viseve, veçanërisht përhapja gjeografike dhe mënyra e formimit të tyre paraqiten me interes jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për disiplina shkencore të tjera si për arkeologjinë, historinë, etnografinë, gjeografinë e gjeologjinë, për folklorin etj. Toponimia ka me këto shkenca lidhje të ndërsjellta”⁹, prandaj, emërvendet duhet trajtuar gjithnjë në kontekstin social, duke i analizuar në përshtatje me faktorin kohë, me mëtimin që të arrihet një korrespondim koherent me shkencat dhe disiplinat e tjera, për një qëndrueshmëri reciproke në rrafshin shkencor.

Në Pejë me rrethinë, baza e toponimisë është e burimit vendës, duke mos përjashtuar edhe emërtime vendesh të burimeve të tjera dhe fjalë të burimit latin, sllav, turk etj.

të tillë, si **S. Stijoviq** “O onomastici ...”, **M. Grković**, “O toponimu ...”, **S. Stanojević** “...lična imena...” sipas disa toponimeve dhe antroponimeve e përgjithësojnë praninë e elementin sllav në onomastikën e Pejës, po e marrim vetëm një të dhënë: S. Stijoviq, shtrembëron emërtimet, bie fjala mikrotoponimin e katundit Pepiç, *Errnobora* e përshtat në *Crnobora*, përderisa duke u bazuar në të dhënat toponimike të Defterit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, autori vie në përfundim se në Rugovë, “përpara popullsisë së

4. Gj. Shkurtaj, në psh. Pukë, 1977, f. 80;

5. Po aty, f. 81.

6. P. Shimunović, Toponimija Istarskog razvoda, Zagreb, 1976, nr. 6, f. 21.

7. Dhimro A. Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit, Tiranë, 1969, f. 298.

8. Durmishi, Izmit, Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit, Gostivar, 2008.

9. Gj. Shkurtaj, në psh. Pukë, 1977, f. 80.

tashme rugovase kanë jetuar serbët” (*përkthimi ynë nga serbokroatishtja*), mendim ky aq kategorik, sa i njëjti nuk jep mundësi as për simbiozë popujsh! Mendojmë se venerimet e tilla onomastike nuk kanë mbështetje të duhur shkencore dhe si të tilla dalin të paqëndrueshme në dritën e studiuesve dhe studimeve onomastike. Në këtë rrafsh përfundimet arbitrare të studiuesve serbë janë krejtësisht të pabazuara dhe të pa argumentuara për vet faktin se këtu kemi të bëjmë me ndikime të ndërsjella ndërmjet gjuhëve në kontakt, madje edhe me gjuhë të tjera, me bazë ballkanizmat, e këtë më së miri do ta ilustrojmë me të dhënë se në disa lagje të mëdha të Beogradit hasim mjaft toponime turke si: **Kalemekdan, Çubura, Dorqoll, Topçder** që nuk do të thotë se përpara sllavëve në këtë qytet na paskëshin jetuar turqit, kur fare mirë i dimë rrjedhat historike, ku mund të përmendim garnizonet ushtarake në këto qendra, dhe banorët e përkohshëm turkosundues, gjuhët në kontakt dhe ndikimet administrative etj.¹⁰

Po ashtu, në përkrahje të gjithë kësaj që potencuam mund t’i çasemi një vështirimi shoqëror dhe një përfundimi logjik se antroponimi i trajtuar ernobora, mund të zbërthehet deri diku me konfiguracionin e terrenit të këtij fshati, me dimrat e gjatë dhe të vrazhdët, jetën e vështirë të banorëve të këtij vendbanimi, ndër më të largët në Rugovë, majat e larta si shtatore, të mbulauara edhe gjatë verës me trashësi bore dhe mbase edhe bora rron në këto anë, “ **E rrno bora**”. Është e vërtetë se të dhënat onomastike hedhin dritë të konsiderueshme në këtë fushë, por ato nuk duhet të mbiçmohen dhe kështu të merren si kritere vendimtare të determinimit etnik. Mendojmë se për përcaktimin e popullatës së hershme të një ane dëshmitë onomastike nuk janë të vetmet argumente në mbështetje të të cilave mund të nxjerren mendime të prera dhe të qëndrueshme.

Përpjekjet e pareshtura për pushtim dhe nënshtrim, luftërat e pandërprera nëpër shekuj, jeta e vështirë, pamundësia për qasje në sistemin administrativ, po ashtu janë faktorë që kanë ndikuar që një numër i konsiderueshëm i toponimeve dhe antroponimeve të regjistrohesh si sllave bie fjala: Malević për Malaj, Malo për Mal, Joshanica për Stankaj dhe Kurtović për Kurtaj dhe Haxho për Haxhë apo Adžija për Haxhi etj.

Këtij problemi mund t’i qasemi kronologjikisht, në vazhden e përpjekjeve edhe të

10. Mujaj, Hasan, Të dhëna nga onomastika e Rugovës, Çështje të Studimeve Albanologjike, Prishtinë, 1987, faq. 313;

studiuesve të tjerë që në bazë të toponimeve të determinohet etnosi i hershëm sllav në treva të banuara prej shqiptarësh, ndeshen edhe të gjuhëtari bullgar **J. Zaimov** në studimin: *Emrat gjeografikë bullgarë në Shqipërinë e shekullit XV*¹¹ si dhe te **A. Selishçev** në veprën: *Popullsia sllave në Shqipëri*¹², të cilët, duke i absolutizuar të dhënat topografike, shtrembërojnë apriori realitetin historik.

Për këtë çështje kishte bërë vërejtje edhe albanologu i njohur **N. Jokli** dhe e kishte vënë në dukje karakterin josllav të disa zbërthimeve etimologjike të emrave të vendeve. Këtë të dhënë, të ngritur pa vend nga studiuesit sllavë që i sipërpërmendëm dhe të tjerë, e pa si të pabazë dhe e vuri në kritikë të arsyeshme njohësi i mirë i onomastikës shqiptare prof. **M. Domi**, i cili, ndër të tjera, shkruan: Sipas tyre një toponim sllav është vënë gjithnjë nga banorë, që flasin sllavisht, nga një popullsi sllave e sllavofolëse, çka nuk i përgjigjet së vërtetës.¹³ Shikuar çështjen nga ky kënd, ne tumirim mendimin e prof. Domit, i cili ka vënë re se pjesa më e madhe e toponimisë shqiptare, që emërtohet me fjalë sllave përmban apelative, fjalë të leksikut të përgjithshëm të shqipes me burim nga gjuhët sllave jugore bullgarishtja dhe serbishtja dhe kanë marrë fytyrën e fjalëve shqipe, prandaj toponimet përkatëse janë vënë nga një popullsi shqiptare e jo nga një popullsi e huaj. Fjalët sllave në emërtimet toponimike sikundër edhe në fusha të tjera, edhe në fushën e toponimisë këndeje kanë depërtuar në bazë të kontakteve të ndryshme me popullatën sllave si përmes rrugës administrative,

përmes huazimesh gjuhësore e të tjera. Kështu për shembull në toponiminë e Pejës me rrethinë, përdoren shpesh toponimet me apelative si Bregu, Podet, Zabeli, Ledina, Ograja, Mexha, Stani, Orrnica, Zastaja, Ziti, Ulica etj. por duhet vënë në dukje të dhënë e pamohueshme, e cila edhe shpesh nuk është parë drejt se këto toponime dhe të tjera të kësaj dore nuk shkojnë me toponiminë e huaj, prandaj edhe s'mund të konsiderohen si të dhëna bindëse për caktimin e etnosit të hershëm të Pejës pasi këto janë emërtime të etnosit shqiptar, emërtime të vëna nga një popullatë shqipfolëse, por me fjalë të burimit të huaj që, siç dihet, si apelative të këtilla këndeje, si dhe në shumë vise të tjera shqiptare, janë në përdorim të përditshëm.¹⁴

11. Domi, Mahir, Çështje të toponimisë me burim të huaj, në psh. Pukë, 1977, f. 12;

12. Po aty, f. 13;

13. Po aty, f.14.

14. S.Pulaha, DRSSH i vitit 1485, Tiranë, 1974, f. 38.

Prandaj, prania e elementit sllav në toponiminë e Pejës, konsiderojmë, s'është dëshmi bindëse e as e mjaftueshme se kjo trevë herët ishte e banuar me popullsi sllave siç është provuar të interpretohet.

Duhet të përmendim këtu si mjaft të drejtë edhe konstatimin e **S. Pulahës**, i cili ndër të tjera shkruan: ... nuk mund të shërbejë si kriter absolut për të përcaktuar si sllave karakterin etnik të popullsisë as edhe parimi i ndjekur në mënyrë aq konsekuente nga historiografia e huaj se çdo fshat me toponimi sllave paska qenë edhe gjatë shekullit XV truall i populluar nga banorë sllavë.¹⁵

Duke u mbështetur në materialin e pasur onomastik, në kërkim e me qëllim të zbërthimit dhe të ndriçimit të gjithanshëm të kësaj lënde, prof. **Hasan Mujaj** do t'i vështrojë toponimet nga dy pikëpamje kryesore:

- 1) *pikëpamja strukturore dhe*
- 2) *pikëpamja kuptimore.*

Sipas pikëpamjes së parë toponimet mund të jenë: *fjalë të parme, fjalë të prejardhura, fjalë kompozita dhe togfjalësia*. Toponimet fjalë të parme nuk janë të shumëta në krahasim me llojet e tjera. Ato rëndom shënojnë konfiguracionin e terrenit dhe përdoren në rasën emërore të njëjësit p.sh.: *Brija, Llazi, Rrasa, Rrahi, Zhari, Gropa, Podi, Otava, Ashti etj.*¹⁶ Nga aspekti social toponimet fjalë të parme të përmendura përgjithësisht përshkruajnë gjendjen fizike, ta zëmë **otava**, nënkupton kositjen e livadheve për herë të dytë, gjë më e pazakontë në shumë fshatra të thella malore, për shkak të klimës së egër, andaj ku ka otava nëkuptojmë fshatin apo vendin me kushte më të mira klimatike ku kultivohen edhe rendimente të tjera përpos patates si: misri, thekra, tërshëra etj., po njëkohësisht vetëm përmes këtij toponimi kuptojmë se po në fshatin ku është përdorur, nga sfera e pemëtarisë kultivohet edhe kumbulla, dardha, molla, si dhe ky toponim na jep të kuptojmë se në afri të tij ka kushte të përshtatshme edhe për zhvillimin e bletarisë, gjë që nuk mund të pohohet për toponimin fjalë të parme **Rrasa**, ngase në aspektin social mjafton të na bëjë me dije se kemi të bëjmë me një pjesë shkëmbore, ku mund të jetë i përshtatshëm vetëm për blegtori, kullosë bagëtish, por po në këtë zonë mund të hasim edhe në kaçë, dëllinja, boronica, dredhëza, mjedrra, thana etj.

15. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 704.

16. (Po aty) faq. 704.

Nga ky grup toponimesh ka edhe të tilla që lidhen me frutikulturën si për shembull dardha, molla, thana, etj; nga toponimet fjalë të parme përdoren edhe emërtime të vendeve sipas bimësisë, sipas fushës ujore, të tilla që emërtohen sipas ndonjë objekti të ngritur në vend e që mund të jetë i pranishëm ende apo mund të jetë zhdukur, por vendi edhe më tej vazhdon të mbajë thirrjen sipas objektit të dikurshëm etj., p.sh.: *Plepi (Topolla), Ahu, Vrella, Gurra, Kroni, Puzi, Rieka, Shkolla, Luqi, Staja, Llomi* etj.¹⁷

Në funksionin social për toponimet në fjalë kuptojmë vendin ku hasim shumësi plepash, përbërje toponimike kjo nga bota bimore, dru i butë për t'u përpunuar, lëndë e parë për zdrukthëtarin, i përshtatshëm për drugdhendje, pastaj malin me aha, i së njëjtës kategori toponimike, lloj druri i fortë të cilin e përdorin për lëndë djegëse po edhe për mjeshtëri si: *bisht sakice, dysHEME, tavan* etj., pastaj hidronimet *vrella, kroni dhe gurra* prezantojnë vendburim uji me rrjedhë të fortë uji të pijshëm, me çka nënkuptojmë edhe fshatin dhe shtëpitë në afri të tyre, gjë që nuk vlen edhe për pusin, ujë i vogël, i cekët, i palëvizshëm, herë-herë edhe në vende të pabanuara, si në bjeshkë etj., i cili përdoret për të shuar etjen bagëtia, pastaj *lumi (rieka)*, rrjedhë uji, herë - herë e rrëmbyeshme, në të cilën shpesh fëmijët e kësaj treve ndërtojnë puse brenda shtratit të tij, për t'u larë, sidomos në verë kur ofrojnë kushtet klimatike. Secili toponomin ka në vete edhe elementin social, element ky i cili nënkuptohet që në shqiptim të parë.

Një numër i mirë i toponimeve të këtyre anëve janë fjalë rrjedhoja (*derivate*), të cilat janë formuar nga fjalët e ndryshme me anë të mjeteve gjuhësore. Vështruar nga ky kënd mund të thuhet se mënyra më e shpeshtë e mbërthimit të toponimeve *fjalë rrjedhoja* janë ato të prapashtesimit, por nuk mungon as parashtesimi. Në formimin e fjalëve rrjedhoja për emërtimin e toponimeve gjen vendpërdorim një numër i mirë i prapashtesave dhe ndonjë parashtesë që paraqesin interes kërkimor edhe në fushën e fjalëformimit.

Këtu po i paraqesim disa formime të toponimeve me anë të prapashtesimit:

me prapashtesën – aj, janë formuar emra të vendeve nga patronimikat mbi një bazë antroponimi p.sh. : Lulaj (nga *Lul*), Bardhaj (nga *Bardh*) Dashaj nga (*Dash*), Dreshaj (nga *Dresh*) Rexhaj (nga *Rexhë*), Zekaj (nga *Zekë*), Malaj (nga *Malë*), Haxhaj (nga *Haxhë*), Bogë (nga *Bog*), Stankaj (nga *Stank*), Pepiç (nga *Pepë*) etj.

17. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 704.

Sikundër dihet, trajta e hershme e kësaj *prapashtese* ishte – **anj** siç dëshmohet në ndonjë patronimikë të jugut të Shqipërisë p.sh. *Hasananj* si dhe tek arbëreshët e Greqisë p.sh. *Dhimitranj, Gjinaj etj.*¹⁸

Duke u nisur nga këto formime antroponimike me anë të prapashtrimit, më duket me interes që paraprakisht të potencoj edhe disa antroponime ilire: *Bardez, Bardus, Dazimass, Dasius etj.*, ku gjejmë zbërthimin e tyre shkencor vetëm me patronimet dhe antroponimet shqiptare që i potencuam si: **Bardhaj**, një patronim i toponimizuar me një shtrirje të gjerë, por edhe si emër njerëzish i të dy gjinive: *Bardh dhe Bardhe; Dashaj (patronim) dhe Dash (emër vetjak)* - në kuptimin toponimik, patronimik dhe antroponimik, i ruajtur edhe sot etj. Përmes këtyre toponimeve **Prof. Çabej**, me fakte shkencore vërtetoi autoktoninë e shqiptarëve dhe vijimësinë iliro - shqiptare duke hedhur poshtë konstatimet e disa autorëve të huaj, si p.sh. të **G. Weigand**, të **V. Georgiev etj.**, sipas të cilëve provohej të shtrihej hipoteza kinse shqiptarët nuk janë vendës në trojet e tyre. Antroponimi **Malë** i përdur mjaft dendur në të gjitha fshatrat e Rugovës dhe patronimi **Malaj**, në kundërimin social, në ndërdijen e banorëve të kësaj ane paraqet dëshirën e tyre për jetëgjatësi të fëmijës, dëshirën për të krahasuar atë me malet e këtyre alpeve shqiptare, dëshirën për shtatlartësi, dëshirën për qëndrueshmëri në kushte të rënda atmosferike etj. Këtë toponim e hasim kryesisht në zona malore, gjë që nuk e hasim në qytete dhe zona të zhvilluara.

Me prapashtesën – ajë në toponiminë e Pejës përdoret ndonjë formim i rrallë toponimik nga apelativet p.sh. **Fierajë** (nga fier dhe – ajë), **Lugajë** (nga lug dhe – ajë), **Dushkajë** (nga dushk dhe – ajë) etj. *Me – ak* në fshatin Shkrel përdoret toponimi **Çardak**, kurse në fshatin Riekë e Allagës ndeshëm në toponimin **Shtupurak**; këtu na duket, kemi edhe *prapashtesën – ur* dhe kështu këtu shohim këtë strukturë: shtup-ur-ak. *Prapashtesën –ak* gjuhëtarët tanë e nxjerrin autoktone shqipe.¹⁹

Për toponimin Fierajë, në FGJSH hasim këtë sqarim: **Fier m. bot.** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të hollë, me gjethe të gjelbra e të dhëmbëzuara në trajtën e një pule, pa lule, e cila rritet nëpër pyje e në toka të varfra e të thata dhe përdoret zakonisht për t'ua shtruar bagëtive, për të mbuluar kasollet etj. Fier i njomë (i thatë). Fier mashkull fier, rrënja e të cilit përdoret si bar kundër shiritit. Fieri i pyllit.

18. A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 221

19. A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 207.

Fierajë, vend i veshur me fier, vend ku ka shumë fier. I shtrojnë fier bagëtisë. Mbuloj me fier.²⁰ Në rrethin e Pejës nuk ka përdorim të dendur, por përdoret në krahinën e Rugovës, pothuajse në të gjitha fshatrat e saja, në rend të parë na paraqet aspektin social të terrenit të egër malor e shkëmbor të kësaj treve dhe vështirësitë që ofron jeta, madje mungesën e shtrojës, qoftë për njerëz qoftë për bagëti dhe përdorimin e tij (fierit) për shtrojë, nevojën e banorëve për këtë lloj bime barishtore për të mbuluar kasollet, vendrritjen e tij në zona më të pakapërcyeshme dhe nëpër kullota, ku përmes vështirimit social, bazuar në të dhënat kuptimore për fierin, njëherit kuptojmë edhe llojin e tokës, thatësinë dhe varfërinë e saj si dhe pamundësinë për të prodhuar.

Edhe toponimi **çardak** ngërthen në vete qasjen sociale, ku në rend të parë banorët vendës nënkuptojnë parahyrjen në oda burrash dhe sigurisht se ku kishte çardak kishte edhe kulla e shtëpi, ku flitej e bisedohej, ku ndahej pleqëri e organizoheshin gazmende të ndryshme, dhe se vendi ku ishte çardaku tregonte edhe gjendjen e mirë materiale. Në emërtimin **Braçinë**, që shënon disa gropa të vogla uji në mal, shohim një formim me *prapashtesën-çinë*, brra-çinë; **prof. Çabej** tek kjo fjalë sheh një formë të zgjeruar në mënyrë sllave.²¹ të fjalës bërrakë. Fjalën brraçinë e kishte shënuar edhe **Gazulli** me sqarimin – *vend ujtak*²² Edhe ky toponim na paraqet gjendjen e konfiguracionit të terrenit të këtyre anëve, në rend të parë në aspektin social na ofron dëshmi për shirat e pandërperë që kaplojnë këtë trevë, duke e lidhur me kushtet atmosferike dhe banorët e dinë se braçinat janë më të shpeshta në zonat sa më të thella, ngase reshjet janë më të dendura. *Prapashtesën –ell*, por me trajtën –yell, pra të diftonguar, e gjejmë në mikrotoponimin **Kapërçyell** dhe ky, një formim nga folja kapërcej. Kështu –trajtat *me –yell* kanë dalë nga një diftongim *i e –së* përpara *ll-së* në silabë të mbyllur.²³ Me formantin –*et*, duket janë formuar toponimet **Rashiqet** dhe **Gaxheviqet**, që emërtojnë livadhe të punueshme me mal të rrallë, megjithëse tek këto toponime ekziston edhe mundësia e formimit të tyre me prapashtesën –*iqe* siç kishte vënë re **Jokli** po me këtë *prapashtesë*, tek shumësi i fjalës gardh po dhe si emër topik Gardhique.

20. FGJSSH, Toena, Tiranë, 2001.

21. Çabej, E., Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, në SGJ, f. 64, Prishtinë I, 1976.

22. Gazulli, N., Fjalorth i ri, Prishtinë, 1968, f. 197.

23. Po aty, f. 197.

Toponimi **gardh**, **gardhqe**, po ashtu na lë mundësi qasjeje në jetën e vështirë baritore, nevojën për të rrethuar livadhet me gardhqe, për të mbrojtur nga bagëtia, si parapërgatitje për të kositur livadhet, në mënyrë që të sigurohet ushqimi i kafshëve për sezonin e dimrit, po ashtu për të ndarë kullotat, për të ndarë pronat nga njëri – tjetri etj., gjë që assesi nuk mund të përjashtohet elementi i jetës së vështirë të kësaj treve.

Mikrotoponimet **Ulicë** dhe **Trupicë** janë formime me *prapashtesën* –icë nga rrënjët ul dhe trup; kjo prapashtesë formon emra deminutivë.²⁴

Toponimi **Lugjik** është formim me prapashtesën –ik nga apelativi lug; ky toponim paraqet vendin ku heret gjendeshin disa lugj druri nën gurrë e që mbusheshin ujë për nevoja të kafshëve, prandaj duke u nisur edhe nga kuptimi i këtij apelativi, mendojmë se kemi të bëjmë me një fjalë derivate të formuar nga shumësi i emrit lug, lugj dhe nga prapashtesa –ik. Në ilirishte me këtë prapashtesë formohen emra të vendeve dhe të fiseve p. sh. **Lopsic**²⁵ e ndonjë tjetër.

Ky toponim i cili lidhet me sferën baritore, i cili gjallëron në mesin e kompleksit të mikrotoponimeve të lashta, po ashtu për vendasit nënkupton vendushqimin për dele, qengja, po edhe vendqëndrimin e ujit që buron nga gurra e kroï. Vend ku laheshin teshat, madje, në fund të tij, ishte një pjesë e zgjatur e drurit ku rriheshin rrobat me maj, mbajtëse druri, ku më pastaj vareshin në vendet e caktuara për tharje, terje etj. Tek mikrotoponimi **Molikë** gjejmë prapashtesën –ik të zgjeruar me një –ë- që dha –ikë; molikë. Në formimin e emrave topikë si më prodhimtare se disa të tjera, na paraqitet *prapashtesa* –inë. Me ndihmën e saj, prej apelativesh të ndryshëm, formohen emra të vendeve, që tregojnë përbërjen e vendit, ndonjë veti të tij si dhe shtrirjen e terrenit që i përket rrënjës p.sh. **Kërshinë**, nga kërsh, **Llazinë** nga llaz, **Pishtinë** nga pishë, **Sepetinë** nga sepet, **Zharinë** nga zhar, **Gurinë** nga gur etj. Disa nga fjalët që në përbërje e kanë këtë prapashtesë janë formime nën ndikimin sllav, por edhe fjalë të huazuara nga sllavishtja.²⁶ Te emri i fshatit **Pepiç** kemi *prapashtesën* –iç, e cila i është prapangjitur një baze antroponimike, antroponimit **Pep**, me të cilin emër, mendojmë del burimi i këtij toponimi.²⁷

Prapashtesa –iç siç dihet i jep fjalës kuptim deminutiv, por edhe përbuzës.

24. A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 237.

25. A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 238.

26. A. Xhuvani, E. Çabej, Prapashtesat, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 242.

27. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 707.

Nga toponimi Pepiç si edhe shumë të tjerë të kësaj natyre na paraqesin etapa të caktuara kohore dhe shtresëzime shoqërore, madje ofrim dëshmish të shtrirjes kristiane – katolike në këtë trevë edhe pse të gjithë banorët janë myslimanë.

Në rastin tonë kujtojmë se antroponimit Pep, kjo prapashtesë i është dhënë në kuptimin zvogëlues; në të mirë të pohimit tonë shkon edhe tradita vendëse sipas së cilës Pepa ishte biri më i vogël nga djemtë e Nikës, që këndej nguliten të parët.²⁸

Prapashtesa më prodhimtare në formimin e toponimeve fjalë rrjedhoja është *prapashtesa –ishtë*. Emrat topikë të formuar me ndihmën e këtij sufiksi shënojnë, veç emërtimit që shpreh rrënjori, praninë e shumësisë së terrenit të tillë në vendin e emërtuar p.sh. **Kuçishtë** nga kuq dhe –ishtë, **Gurnishtë** nga *gur* dhe –ishtë, **Hejdishtë** nga *hejd* dhe –ishtë, **Rrahishtë** nga *rrah* dhe –ishtë, **Ahishtë** nga *ah* dhe –ishtë, **Bunishtë** nga *bun* dhe –ishtë, **Fierishtë** nga *fier* dhe –ishtë, **Plehnishtë** nga *pleh* dhe –ishtë, plehna, **Torishtë** nga *tor*, **Elbnishtë** nga *elb*, **Qarrishtë** nga *qarr*, **Dbanishtë** nga *dban*, **Selishtë** nga *sel*, **Kopirishtë** nga *kopir*, **Melishtë** nga *mel* etj.

Së këndejmi, në tëpamjen sociale toponimet e sojit të tillë ngërthejnë në vete një burim social të lidhur me jetën në këto anë, krahas arës së mbjellë me mel, kuptojmë edhe burimin e ushqimit. Edhe pse **M. Bajraktareviç** dhe të tjerë toponimin **Kuçishtë** janë përpjekur që ta paraqesin si të burimit sllav, vështruar nga këndi i gjendjes fizike të këtij fshati mendojmë se ky emër vie falë tokës, gurëve dhe shkëmbinjëve me ngjyrë të kuqe, mbi të cilët është i vendosur fshati. Një mendim të tillë e përkrah edhe **Fazli Gjevukaj** në punimin e tij:²⁹ Ana kuptimore e disa mikrotoponimeve në trevën e Rugovës.

Edhe toponimi **Brezishtat** është formuar me po këtë prapashtesë veçse më tepër përdoret në shumësin e shquar. Ky toponim paraqet një vend brezash, që nuk janë të paktë në, në përgjithësi, po ashtu vështrimi social na jep dëshmi për shumëllojshmërinë e llojeve të drunjëve të këtij regjioni.

Edhe emërtimi **Qiknishtë** është formuar me gjasë, me këtë *prapashtesë*, burimi i të cilit tash na mbetet i pahetuar. Me prapashtesën e gurrës sllave, *-ovina, -ovinë*³⁰ këndej

28. Nga gojëdhënat e shumta është mësuar se Pepa ishte biri më i vogël i Nikës...

29. Gjevukaj, Fazli, Ana kuptimore e disa mikrotoponimeve në trevën e Rugovës, Revista letrate Gurra, nr. 17-18, Pejë, 1996, faq. 12.

30. Xhuvani - Çabej, SGJ, III, Prishtinë, 1976, f. 258.

gjetëm toponimin **Maçkovina** ndërkaq toponimet **Çeskova**, **Llutova** dhe **Rugova** janë formime me formantin *-ova*, siç kemi edhe *Gjakova*, *Tetova*, *Kuçova*, *Kumanova* etj.

Prapashtesën sllave *ova*, të cilën e hasim edhe tek makrotoponimi *Kosova*, *-ova*, po ashtu është marrë nga gjuhët në kontakt dhe se nuk mund të shpjegohet ndryshe. Të gjitha tezat e studiuesve sllavë dhe të tjerë, për etimologjinë e fjalës *Rugovë*, mbasin edhe më tutje të pa argumentuara dhe pa bazë të mirëfilltë shkencore, për çka mendojmë se duhet një qasje serioze dhe e bazuar shkencërisht.

Në mesin e mikrotoponimeve me shtrirje të gjerë, të cilat njëherit edhe janë fjalë të rralla popullore, në zonat malore e hasim edhe fjalën **Shtrungë**, të cilën e gjejmë edhe në disa gjuhë ballkanike, në turqishte etj. Mikrotoponimi *shtrungë* quhet një shteg i ngushtë afër derës së vathës ku kalojnë dhentë e dhitë një nga një kur i mjelin, ose edhe shtegu në vend të thurur tek mrizi ku ulen mjelëset t'i mjelin delet. Është një fjalë me burim të diskutuar siç e quan prof. **I. Ajeti**,³¹ prof. **E. Çabej** e nxjerr nga folja *shtroj*,³² kemi pra një formim me prapashtesën vendëse shqipe ungë.

Ky mikrotoponim i qasur në aspektin shoqëror, na lë të kuptojmë detyrimin që i bëhet dikujt për ta detyruar të bëjë ashtu si i thuhet, për ta vënë nën urdhëra të prerë, në këtë rast nënkuptojmë rëndësinë e qumështit për banorët, si burim të rëndësishëm jete, mënyrën e përpiktë të menaxhimit përmes *shtrungës* dhe lehtësinë e realizimit.

Toponimi **Orrnicë**, të cilin e hasim edhe në anë të tjera të Kosovës: *Orrnica* (jp), kullosë e gjave, kurse dikur ka qenë ara – *Arrnica*³³ në *Rugovë* ka shtirije në disa fshatra dhe në vështrimin shoqëror na bën me dije se toka në fjalë është më e plleshme dhe më e përshtatshme për dhënie të rendimenteve që kultivohen në këto anë, po ashtu janë vende të rrethuara dhe të ruajtuara mirë nga pronarët, ngase janë më të përshtatshmet edhe për kullota bagëtish.

Me anë të parashtesimit ose edhe me njërin veprim, edhe me tjetrin gjetëm të jetë formuar një numër shumë më i vogël i toponimeve p.sh. *me parashtesën për*, sa duket janë formuar këto toponime: **Përlaga**, **Përllina** dhe **Përpregj** kurse tek toponimi **Gërdegi** kemi një formim me parashtesën *gër*, që ne të vërtetë është parashtesa *gë* – *me një repentetike*.

31. Ajeti, Idriz, Për his. e marr. të hershme gjuh. Shq. slave, në GJA, SSHF II – 1972, Prishtinë 1974 f. 38.

32. E. Çabej, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, në SGJ, Prishtinë I, 1976.

33. Doçi, Rexhep, Onomastika e Drenicës, IAP, Prishtinë 2005, f. 155, 57.

Toponimi **Zhdredhinë** përmban prefiksin zh – rrënjën –dredh – dhe prapashtesën –inë. Megjithëkëtë, është vështirë të hetohet përbërja e disa toponimeve me një siguri të madhe që këtu u shtruan ose edhe e ndonjë toponimi tjetër si Meteriz, Pllaqijat, Dromodoli etj. Toponimi **Zabel** ka në përbërje parashtesën za – dhe rrënjën bel. Edhe në toponiminë e Pejës si edhe në anë të tjera përdoren edhe emërtime të vendeve me fjalë të përngjitura, të cilat fjalë dhe fjalëza, duke u gjendur pranë njëra-tjetrës dhe duke pasur një shqiptim të shpejtë, këndej me kohë, u bë përngjitja e tyre dhe sot shqiptohen si një fjalë e vetme.³⁴

Toponimi **Zhdredhinë**, të cilin e hasim në disa fshatra më të rrëpinjta, na paraqet konfiguracionin e vështirë të terrenit të po atyre fshatrave, si: Dugaivës, Haxhajve, Llaz – Bellopaçit etj. dhe kujdesin që duhej pasur me rastin e kalimit nëpër to. Toponimi zabel e hasim pothuajse në të gjitha fshatrat e komunës së Pejës, në Rugovë përdoret mjaft rrallë, ndoshta për shkak se e gjithë kjo trevë është e përshkuar me pyje të larta dhe të dendura. Edhe pse dihet mirëfilli se zabeli është koriye, vend me drurë e me shkurre të dendura, në këto anë ky toponim në aspektin social përdoret për pyllin e ruajtur mirë, me bukuri të rrallë, konfiguracion të përshtatshëm, gjelbërim të pakursyer, i përshkuar nga sheu dhe me gurrë a gurra në të etj., që është i përshtatshëm për bagëtitë si për të kullotur po ashtu edhe për të shuar etjen. Këtë toponim e hasim mjaft dendur në anë të tjera të Kosovës, por me një konotacion tjetër, p.sh.:

Në Pollog të Gostivarit:³⁵ *Zabeli, Zabeli Plak, Zabeli i Llomnecës, Zabeli i Katundit, Zabeli Premë, Zabeli Pejçe.*

Në Drenicë: *Zabelet e Nuroviqe (v) – pyje; Zabeli i Hazir Kadris i – pyll; Zabeli i Çollakut, (jl) – pyll, Zabeli i Madh (jl) – pjesë e madhe pyjore; Zabeli i madh, (v) – pyll me drunj të mëdhenj, Zabeli i Vorreve (l) pyll që konsiderohet si i shenjtë, sepse drunjtë e tij përdoren vetëm për dërrasa të varreve*³⁶ etj.

Në Dushkajë të Gjakovës: *Zabelet e Stublinave, (l), nga Stublinëm –a, Zabeli i Hajratit (v.), ngase ishte hajrat, Zabeli i Podrimçakit (l), sipas një podrimçaku etj.*³⁷

34. Mujaj, Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 704.

35. Durmishi, Izmit, Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit, Gostivar, 2008, faq. 66.

36. Doçi, Rexhep, Onomastika e Drenicës, IAP, Prishtinë 2005, f. 63, 78.

37. Hoxha, Skënder, Toponimia e Dushkajës, Art Poetika, 2006, Gjakovë, f. 234.

Toponimet kompozita në anën e gjurmimit tonë rëndom formohen duke u ngjitur një apelativ me një parafjalë të përdorur, natyrisht, në trajtën ligjërimore vendëse ose edhe duke u ngjitur me ndonjë fjalëz tjetër në funksion të parafjalës, kurse apelativi përdoret në emëroren e shquar të njëjësit; në të këtilla raste elementi i parë i kompozitës është parafjalë p.sh. ³⁸ *Darçesmjja, Darbuza, Paskodra, Pirruga, Piçesmjja Darruga Darllazi, Pasmaja, Darvada, Dargurra, Mesdreni* etj. Nga këndvështrimi social toponimet kompozita saktësojnë vendin a sendin në sipërfaqen a në hapësirën në të cilën ndodhet a lëviz dikush a diçka, bëhet a zhvillohet diçka, kryhet një veprim nën, mbi, sipër etj.

Përveç këtyre, mund të gjendet në këtë anë edhe ndonjë toponim po me këtë rrugë ndërtimi veçse apelativi tash shkon dhe përdoret në emëroren e pashquar të shumësit ose, ndonjëherë, edhe në të shquarën p.sh. *Dergrujna, Pidbana, Piçetat*;

Hetohen në këtë anë edhe toponime të cilat janë formuar nga ngjitja e disa lokucioneve duke dhënë kështu një emërtim të veçantë p.sh. *Natanat dhe Matanat*, sa shihet, nga shprehjet me atë anë dhe në atë anë.

6.4. Emërtime të vendeve në mbështetje të konfiguracionit të vendit

a) *Emërtime sipas konfiguracionit, përcaktuar nga emri i pronarit i përdorur në rasën gjinore p.sh.:* *Brije Shabanit, Bregu i Martalekës, Bregu i Mujit, Gropa e Hasan Bajrit, Gropa e Ram's, Llazet e Lekës, Llazi Broqit, Kodre Bali's Kërshi Halilit, Lugu i Binakut, Mali Sahitit, Orrnicat e Avdis, Shkalle Bal's, Grope Syl's, Mali Zek's, Brije Ded's, Sheu i Selmanit, Qafe Broqit, Brije Uk's Lugu i Ujk's* etj.;

b) *Emërtime vendesh sipas konfiguracionit të vendit, ndjekur nga emri dhe mbiemri i pronarit p.sh.:* *Kodre Kadri Bajrit, Maje Nik' Dem's, Podet e Ali Met's, Kërshat e Zek Smajlit, Zhari Dan'Mustaf's, Podi Rexhep Syl's, Maja Kol' Molit* etj.;

Emërtime vendesh sipas konfiguracionit, ndjekur nga gjinorja e emrit të personit ose nga gjinorja e emrit të përkatësisë kombëtare, të cilit mund t'i ketë ndodhur diçka e shënueshme në atë vend si për shembull mund të jetë vrrarë, të jetë rrëzuar, të jetë ngrirë, të jetë gjetur i arratisur në atë vend për ndonjë vepër etj. p.sh.: *Bregu i Kocit, Bregu i Zenelagës, Mali i Djegu'n, Kërshi i Kuq, Kërshi i Ladurit, Qafa e Martinit, Fieraje Hykës, Shpelle Sykut, Podi Jakupit, Brije Dedës, Grope Zenelit, Kroni Mehmetit, Lame Kadri's, Gurre Kol Molit* etj.

d) *Toponime që emërtohen sipas konfiguracionit, ndjekur nga emri në gjinore i ndonjë artikulli ushqimor pas të cilit ka ndodhur ndonjë ngjarje ose ndjekur nga emri apo nga emrat e aktorëve midis të cilëve ka ndodhur ndonjë ndodhi sipas gojëdhënash p.sh.:*

Sheu i Sharrës, Sheu i Grave, Guri i Kadisë, Qafë Bardhë, Qafë e Qyqes, Qafa e Dromodolit, Qafa e Gjonit, Lugu i Territ, Gurra e Bicit, Kodra e Lekiqe, Gropa e Krelekës, Bregu i Drave, Shpella e Borës, Zharrët e Lule, Llazi i Fakut, Qafe Kunor's, Guri Qobane etj.; dh) *emërtime vendesh sipas konfiguracionit ose sipas ndonjë objekti të ngritur, ndjekur nga gjinorja e emrit të femrës: Kërshi i Hykës, Kroni i Mrisë, Sheu i Marës, Kërshi i Sofisë, Lugu i Hykës, Qafa e Kudrës, Bregu i Janës etj*

Toponimet e këtilla janë të pakta, megjithëkëtë, ato janë dëshmi e jetës së vështirë të femrës në këto anë në të kaluarën, ato pasqyrojnë rrethanat e rënda jetësore të femrës të nxitura nga kushtet e vështira duke kryer kështu shpeshherë edhe punët e burrit.

Nga sa u tha më lartë, secili emërtim bartë në vete nga një rrjedhë ngjarjeje të shënuar në mbamendje dhe të ruajtura breznish. Secili emërtim i referohet një ngjarjeje konkrete nga jeta e rugovasve, duke shenjësuar kështu edhe përpjekjet e pareshtuara për të mbijetuar. Mjafton të përmendim emërtimin Kodre Kadri Bajrit, që në mjedisin shoqëror edhe sot e kësaj dite të ruhet imazhi për personalitetin e njohur të kësaj ane, udhëheqësin luftarak në shumë luftëra e beteja, njëherit bajraktarin e Koshutanit. Këto emërtime gjejnë përdorim të dendur edhe në letërsinë popullore të kësaj krahine.

e) *Emërtime vendesh sipas konfiguracionit, përcaktuar nga emri i fshatit me banorë të të cilit vendi ka qenë përkohësisht i banuar sidomos me bjeshkatarë të anëve të tjera ose edhe nga emri i fshatit banorët e të cilit kanë bërë rrugë nëpër atë vend p.sh.:* Lugu i Beranit, Lugu i Vranocit, Ruge Bukelit, Lugu i Shkodr's etj. ose; përcaktuar nga emri i fshatit vendës p.sh. Riekat e Stanke, Lugu i Shkrelit, Brigjet e Dugaiv's, Qarrishte Drele, Ashti Shkrelit, Hajle Koshutanit, Maje Dugaiv's etj. Nga emri i fshatit zakonisht përcaktohen vendet që janë më markante për nga ndonjë veçori e konfiguracionit dhe, si të tilla, kapin një sipërfaqe të gjerë, e cila shfrytëzohet nga pjesa më e madhe e banorëve të fshatit sipas të cilit edhe përcaktohet.³⁹

6.5. Toponime, emërtimi i të cilave bëhet sipas ndonjë objekti të ngritur

a) *Toponime që emërtohen sipas ndonjë objekti të ngritur në një vend (gurrë, krua, dhan, trap etj). që mund të jetë zhdukur me kohë ose mund të ekzistojë edhe sot, ndjekur nga*

gjinorja e emrit të pronarit ose e emrit të ndërtuesit të objektit p.sh.: Gurre Smajlit, Mullini Baliqkve', Gardhi Demukve, Shtegu i Bek's, Dbani Syku't, Staje Salihit, Dbani Kamerit, Pojate Isufit, Kroni Keqit, Sharre Myrtit etj.

b) *Emërtime vendeve sipas objekteve të ndryshme*, përcaktuar nga emri dhe mbiemri i një personi, që është ose pronar ose autor i objektit p.sh. Dbant e Sadik Bajramit, Shpie Imer Danës, Gurre Gjek'Ivanit, Trapi Azem Isufit, Kroni Shenbardhëve, Ziti Haxhi Zek's etj.

c) *Emërtime vendesh sipas ndonjë objekti të ndërtuar nga individi*, ndjekur nga një patronim, që rëndom, tregon përkatësinë e objektit p.sh. Dbant e Bajrimerajve, Mullini Kurbogajve, Shpie Husajve, Gardhiqet e Demajve, Dbant e Abazajve, Gurre Reçkut, etj.

6.6. Emërtime vendesh sipas pamjes së tyre përcaktuar nga një emër i botës shtazore

p.sh.: Kodra e Bletës, Llazi i Shtjerrave, Qafa e Qyqes, Shpella e Arushës, Bregu i Lopëve, Kërshi i Gjarpnit, Kroni i Lepurit, Lugu i Lopëve, Sheu i Qyqes, Llazi i dhive, Bregu i Hutit, Kodra e Dëshve, Shpelle Kigjave, Llazet e Krapojve, Kroni Kalit, Grope Qeve, Bregu i Dhëpn's, Shpelle Kafshqe, Grope Qakajve, Bjeshke Shtjerrave, Shpelle Gjarpnit, Shpelle Arush's, Llazi Qene, Kroni Gjelit, Llazi Kuale, Kroni Minit, Brie Lugu Love, Sheu i Qyqes, Kodre Blet's, Kërshi Pllumave etj.

Përcaktimi për këto toponime e kanë bërë ngase duke jetuar në kushte të vështira natyrore, në rastet më të shpeshta emërtimet e vendeve që përcaktohen nga emrat e shtazëve flasin edhe për ndonjë ngjarje që mund të ketë ndodhur lidhur me shtazën me emër të së cilës përcaktohet vendi; për shembull mund të jetë parë shpesh shtaza përkatëse në atë vend, mund të jetë vlarë ose të ketë bërë ndonjë dëm; kur është fjala për shtazë shtëpiake, vendi mund të jetë kullotur për shembull më së shpeshti me shtazë me emrin e

të cilave përcaktohet. Emërtimet e këtilla në këtë anë, njëherës, shprehin edhe praninë e shumëllojshmërisë së botës shtazore në këtë terren, ashtu sikundër tregojnë pjesërisht edhe rrethanat jetësore dhe zhvillimin e blegtorisë në anë të Rugovës. Këto toponime më tepër janë emërtime të hershme, kurse kohët e fundit ndeshim më rrallë në emërtime të reja të vendeve përcaktuar nga emrat e shtazëve.⁴⁰

Të përballur me botën shtazore, toponimet e këtilla në një farë mënyre kanë shërbyer për banorët rugovas edhe si paralajmërim për mundësinë e rrezikut nga shtazët, sidomos në

38. Fjalëza pi këndeje përdoret për paraqitjen mbi.

39. Mujaj, Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 704.

40. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 711

një farë mënyre vet emërtimi ngërthen në vete edhe shenjën e kujdesit të shtuar gjatë lëvizjes nëpër to.

Emërtime vendesh me emra bimësh, ndjekur nga një atribut që tregon ndonjë cilësi të bimës p.sh.: Kaqat e K'qija, Rrushit i Qenit, Qurrshija e Vogël, Qetinë e Poshtë, Qufrrat e Rrasta, Pishë e Keqe, Glliat e G'iata, Ahat e voj'l', Molikë e Shkallës etj.

6.7. Emërtime vendesh sipas ngjyrës së terrenit p.sh.: Kërshat e Kuq, Kërshi i Korbave, Gurrë e Bardh', Maja e Zez', Pusat e Verdh', Bote Kuqe, Kroni Bardh', Lugjet e Verdha, Rrasat e Zeza, Shkalle Kuqe, Qafë Bardh', Vrellat e Bardha etj.

6.8. Toponime që emërtohen sipas konfiguracionit ose edhe sipas ndonjë objekti të ngritur, ndjekur nga një mbiemër që shpreh ndonjë veçori të vendit si për shembull dimensionin e shtrirjes, pozicionin gjeografik etj.

Mund të thuhet se kjo mënyrë e emërimit të toponimeve kap numrin më të madh të toponimeve nëse vështrohet në aspektin krahasimtar me ndonjë mënyrë tjetër të emërimit p.sh.: Kërshi Gjan', Kërshat e Gjat', Kroni Ftoft', Lame Madhe, Mali Prem', Qafat e Bukura, Rruge Gjan', Rruge Moçme, Sheu i Math, Kroni Poshtë, Kroni Cirm', Llazi i Vogël, Mali Djegun, Shpiat e Moçme, Ograje Keqe, Rruge Re, Grope Mir', Kodre Shog't, Grope Fell', Kodre Gjat', Kodre Madhe, Brigjet e Egra, Kroni Ftoft', Mali Vogël, Lugu i Ri, Lugu i Gusht', Bjeshke Madhe, Kërshi But', Maja That', Brije Madhe, Lugu i Bukur, Shkalle Keqe etj.

6. 9. Emërtime vendesh sipas pamjes së tyre, ndjekur nga gjinorja e emrit të vendit tek gjendet toponimi i emërtuar në pjesën e parë; në të këtilla raste kemi një emërtim toponimik, por të përbërë nga dy toponime; pjesa e parë e toponimit është emërtim vendi apo objekti, kurse pjesa e dytë në fakt është emërtim vendi, por që në këso rastesh tregon përkatësinë e pjesës së parë ose edhe afrinë e emërimit të parë ndaj të dytit p. sh.: Fierajat e Zharit, Gurre Peklen's, Grope Than's, Gjije Shkal's, Kërshi Lugut, Kodre Zharit, Kodre Dromodolit, Orrnicat e Zhasheut t'Peklen's, Staje Sheut, Kërshi Rrahit, Kodre Pllan's, Grope Llazit, Mali Rrahit, Mali Vrell's, Maje Kodr's, etj.

Siç mund të shihet edhe nga shembujt, në bazë të pjesës së dytë të emërimit bëhet edhe dallimi i një vendi nga një tjetër; tek ky grup toponimesh pjesa e dytë e emërimit tash është në funksion të një përcaktori ndonjëse jashtë mbërthimeve të këtilla toponimike,

është toponim që gjithashtu ndiqet nga një përcaktor e që, të shpeshtën është një cilësor.

6.10. Emërtime vendesh sipas pamjes së tyre, ndjekur nga një përcaktor numëror me të cilin shprehet radha e shtrirjes së vendeve të njëjta për nga konfiguracioni dhe si të tilla, pjesën e parë të emërimit e kanë të njëjtë, kurse dallimi bëhet vetëm me anë të përcaktorit numëror p. sh.: Lugu i Par', Lugu i Dyt', Lugu i Tret', Vllaqegu i Par', Vllaqegu i Dyt', Vllaqegu i Tret', Grope Par', Grope Dyt', etj.⁴¹

6.11. Toponime, emërtimi i të cilave fillon me parafjalë

Këtu dallojmë:

a) *Emërtimi i disa toponimeve fillon me parafjalën te, por edhe me parafjalën tu dhe, ndonjëherë, me parafjalën mbi përkatësisht me pi pas së cilës vjen emri i një objekti të ngritur në atë vend, ndjekur edhe nga emri ose nga emri dhe mbiemri i pronarit p. sh.: Te Shpie Beq' Alis', Tu Dbani Malë Balis', Pi Shpit' Bal Qosit, Pi Shpi t' Iber Dush's, Tu Shpie Isuf Istrefit, Tu Mullini Banushit etj.*

Vlera shoqërore e këtyre toponimeve është dykahore, përpos përcaktimit të objektit përmes tyre me lehtësi mësojmë edhe për mbiemrin e pronarit të shtëpisë, njëkohësisht mësojmë edhe llagapin, fisin etj., po edhe vendndodhjen e objekteve me rëndësi shoqërore, bie fjala mulliri.

Sikundër vërehet edhe nga shembujt, në struktura të tilla toponimike kapen dy emërtime vendesh, por që përdorimi i parafjalës që i paraprin emërimit tregon se është fjala për një vend afër objektit të përmendur në emërtim dhe për të cilin nuk mund të kuptohet, sipas emërtimeve të këtilla, se çfarë terreni është.

b) *Emërtime vendesh sipas ndonjë objekti të ngritur që fillon me parafjalë, emri i objektit të ngritur pas të cilit vjen një atribut me anë të të cilit shprehet ndonjë veçori e objektit të ngritur, ndjekur edhe nga emri dhe mbiemri i pronarit p. sh.: Pi Shpi t' Vjetër t' Hyse' Bek's, Tu Shpie Vjetër e Mustaf' Mal's etj.*

c) *Emërtime vendesh që fillojnë me parafjalën pas së cilës rëndom vjen emri krye, që tregon sosjen e shtrirjes së terrenit të tillë, ndjekur nga një apelativ që shpreh pamjen e vendit p. sh.: N' Krye t' Kërshave, N' Krye t' Leqeve, N' Krye t' Bregu Xholle, N' Krye t' Lugu Giat', N' Krye t' Podeve, N' Krye t' Cetave etj. Po me parafjalë, me tu,⁴² fillon*

41. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 713

42. Kjo parafjalë përdoret në trajtë të çunguar n'.

edhe emërtimi i disa vendeve që përmbajnë emra shtëpish, emra varresh, emra gurësh etj. pas të cilave emërtime zakonisht vie edhe një patronim apo një antroponim, i cili shpreh përkatësinë e objektit të ngritur p.sh.: Tu Shpiat e Ibëralie, Tu Vorret e Lule etj. Mund të gjendet ndonjë rast ku parafjala shkon dhe futet në mes të strukturës toponimike si për shembull Gropa Tu Dardha, duke treguar kështu se gropa gjendet afër një dardhe sipas së cilës edhe mund të dallohet nga gropat e tjera. Në emërtime vendesh këndeje përdoret shpesh edhe parafjala dar p.sh. Dar Kërsh t' Dershan's etj.

6.12. Toponime që emërtohen me anë patronimesh, të quajtura patronime të toponimizuara, të cilat prihen nga parafjala dhe nga nyja p.sh. N't'Nimahysenajve, N't'Abazajve etj. Në këso emërtime tregohet përkatësia pronësore.

6.13. Emërtime vendesh sipas konfiguracionit që lidhen me besimin fetar

Emërtimet e këtij grupi përcaktohen nga gjinorja e emrit të kishës ose të xhamisë p. sh.: Kërshi Xhamis' Brije Kish's, Gurre Hoxh's, Kodre Kish's, Bregu i Xhamis' etj. Emërtimet e kësaj dore janë mjaft të hershme dhe të rralla.

6.14. Emërtime vendesh sipas konfiguracionit apo sipas ndonjë objekti të ngritur, ndjekur nga një emër fisi apo nënfisi p.sh.: Kërshi Motit, Rruge Shaljan've Kroni Kastratit, Sheu i Nikçit, Brie Kastratit etj.⁴³

Në vijim do të vështrojmë toponimet sipas pikëpamjes së dytë, që është pikëpamja kuptimore. Sipas kuptimit, toponimet e anëve në gjurmim janë të shumëllojshme. Shumëllojshmëria e toponimeve të kësaj ane në pjesën më të madhe është e lidhur me relievin kodrinor-malor të kësaj zone si dhe me fushat e veprimtarisë së popullatës. Toponimet në të shumtën e rasteve trashëgojnë, ato përcjellen nga brezi në brez, por me kohë, me depërtimin e risive në shoqëri, me ngritjen e objekteve të reja, natyrisht, lindin edhe emërtime të reja. Pra, ky fakt për anën tonë është mjaft evident, domethënë emërtimet e reja janë mjaft evidente, por përjashtim rremërtimi bëjnë toponimet e hershme, kryesisht ato të cilat në bazë kanë një termin vendpërshkrues. Toponimet e kësaj ane, sipas kësaj pikëpamjeje po i ndajmë në dy grupe:

43. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 704.

Toponime sipas konfiguracionit dhe

Toponime sipas punës së individit.

6.15. Toponime sipas konfiguracionit:

6.15.1. Emra brigjesh

Në fshatin Shtupeç i Vogël : *Bregu i Kishës, Bregu i Fratit, Bregu i Nelit.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Bregu i Brezës, Bregu i Love, Bregu i Haskut, Bregu i Janës, Bregu i Martalekës, Bregu i Molikës, Bregu i Vorreve etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Bregu i Brahimagës, Bregu i Lumbardhit, Bregu i Lopëve, Bregu i Bukur, Bregu i Rudinës-Gurët etj.*

Në fshatin Malaj: *Bregu i Kocit, Bregu i Prebrisë, Bregu i Liqejve, Bregu i Cisë, Bregu i Mullive, Bregu i Zenelagës etj.*

Në fshatin Pepiç: *Bregu i Orëve, Bregu i Brahimagës etj.*

Në fshatin Drelaj: *Bregu i Hut's, Bregu i Zenelagës, Bregu i Vorreve etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Bregu i Gurulaj's, Bregu i Hajdare, Bregu i Pul's, Bregu i Plakut, Bregu i Love etj.*

Në fshatin Koshutan: *Bregu i Bukur, Bregu i Hormoqe, Bregu i Helmët etj.*

Në fshatin Shkrel: *Bregu i Nimanajve, Bregu i Mujit, Bregu i Puzit, Bregu i Luzit etj.*

Në fshatin Bogë: *Bregu i Hukut, Bregu i Kishës, Bregu i Rexhë Hasanit, Bregu i Samarit, Bregu i Qerre, Bregu i Mashit etj.*

Në fshatin Stankaj: *Bregu i Jeksimit, Bregu i Halil Nikës, Bregu i Xholle, Bregu i Nike, Bregu i Dershan's etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Bregu i Preshtës, Bregu i Kishës, Brigjet e Sirme, Bregu i Dash's, Bregu i Love, Bregu i Hormoqe etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Bregu i Kuçishtës, Bregu i Shabit, Bregu i Arushës, Bregu i Mom's, Bregu i Syl's, Bregu i Molik's, Bregu i Brek's, Bregu i Qardakut etj.*

6.15.2. Emra brinjash

Në fshatin Shtupeç i Vogël: *Brie Gjekës, Brie Ded's, Brie Kastarate, Brie Shukut etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Brie Kocit, Brie Uk's, Brie Quranit, Brie Zenelit etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Brie Zenelit, Brie Dedës, Brie Nice etj.*

Në fshatin Malaj: *Brie Gjek's, Brie Madhe, Brie Fierit, Brie Ograj's, Brie Kocit etj.*

Në fshatin Pepiç: *Brie Shpis', Brie Ujk's etj.*

Në fshatin Drelaj: *Brie Selmanit, Brie Latuj's etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Brie Haxhie, Brie Gurr's, Brie Malit etj.*

Në fshatin Koshutan: *Briat e Prel's, Brie Kish's, Brie Bishtit etj.*

Në fshatin Shkrel: *Brie Bruqit, Brie Kastratit, Brie Kurboge, Brie Lugu Love etj.*

Në fshatin Bogë: *Brie Ali Brahimit, Brie Brezave, Brie Mekajve etj.*

Në fshatin Stankaj: *Brie Frashnit, Brie Qylit, Brie Ded's, Brie Lugu Love etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Briat e Lugu Dash's etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Brie Shabe, Brie Gjevuke, Brie Nimasejdajve, Brie Licit etj.*

6.15.3. Emra lugjesh

Në fshatin Shtupeç i Vogël : *Lugu i Qilerit, Lugu i Kastratit, Lugu i Vjesht's etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Lugu i Love, Lugu i Otavave, Lugu i Deme etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Lugu i borës, Lugu i Math, Lugu i Brez's, Lugjet e Hokajve, Lugjet e Pece, Lugjet e Ibre's, Lugu i Bor's etj.*

Në fshatin Malaj: *Lugu i Lezit, Lugu i Hithe, Lugu i Giat', Lugu i Theknisht's etj.*

Në fshatin Pepiç: *Lugu i Bunarit, Lugu i Smake, Lugu i Lakut etj.*

Në fshatin Drelaj: *Lugu u Zharrit, Lugu i Husës, Lugu i Sylës, Lugu i Qorre, Lugu i Shabe etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Lugu i Love, Lugu i Cubit, Lugu i Kelit, Lugu i Keq etj.*

Në fshatin Koshutan: *Lugu i Zymere, Lugu i Hykës, Lugu i Elbisht's, Lugu i G'jatë, Lugu i Vukës, Lugu i Territ etj.*

Në fshatin Shkrel: *Lugu i Shkrelit, Lugu i Mrizeve, Lugu i Hajdare, Lugu i Murrize, Lugjet e Mullive, Lugu i Paj's, Lugjet, Lugu Omerit etj.*

Në fshatin Bogë: *Lugjet e Qakut, Lugu i Madh, Lugu i Halilit, Lujt, Lugu i Vrell's, Lugjet e Haxhi'e etj.*

Në fshatin Stankaj: *Lugu i Pasqafës, Lugu i Lulashit, Lugu i Lakut etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Lugu i Kollomoqit, Lugu'Dash's, Lugu i Fetabardhë, Lugu i Kishës, Lugu i Lulashit etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Lugu i Rekut, Lugu i Cemit, Lugu i Rekut, Lugu i Brez's etj.*

6.15.4. Emra gropash

Në fshatin Shtupeç i Vogël: *Gropa e Madhe, Gropa e Qilerit, Gropa e Ramës, Grope Alis', Grope Majës etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Grope Qeve, Grope Dbanit, Gropat e Qyqes etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Grope Bërllës, Gopat e Hysen Ibre, Grope Poshtër, Grope Cirme, Grope Zhujit etj.*

Në fshatin Malaj: *Gropa Tu Dardha, Grope Fell', Grope Lllazit etj.*

Në fshatin Pepiç: *Grope Mir', Gropat e Qyqes, Gropat e Syke etj.*

Në fshatin Drelaj: *Grope Cirme, Grope Poshtër, Grope Lllazit etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Gropat e Haxhis', Grop Hyk;s, Grope Rrshaj's, Grope Mir' etj.*

Në fshatin Koshutan: *Gropa e Ballës, Gropat e Camit, Gropa e Krelekës, Gropat e Nizam've, Grope Cirme, Grope Zhujit, Gropa Lucit etj.*

Në fshatin Shkrel: *Gropat e Huse, Grope Madhe, Grope Zenelit, Grope Madhe etj.*

Në fshatin Bogë: *Grope Qokajve, Grope Drelës, Gropat, Grope Madhe etj.*

Në fshatin Stankaj: *Grope Qakaje, Grop Pashit, Grope Kaj's, Gropat e Vogla, Gropat e M'dha etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Gropat e Maxhup've, Gropat e Ram's, Grope Selmanit, Grope Isufalis' etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Grope Qibrit's, Gropa Tu Dardha, Grope Krojve, Grope Poshtër, Grope Lllazit etj.*

6.15.5. Emra kodrash

Në fshatin Shtupeç i Vogël: *Kodre Bletës, Kodre Mullive, Kodre Vorreve, Kodre Trimave, Kodre Kurtit, Kodre Halilit, Kodre Zhujit, Kodre Rexh's etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Kodre Smake, Kodre Bajram Halilit, Kodre Ahit, Kodre Bek's etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Kodre Gurinës Madhe, Kodre Pasqafe, Kodra e Kujit etj.*

Në fshatin Malaj: *Kodre Shpis' Moçme, Kodre Dardhe etj.*

Në fshatin Pepiç: *Kodre Stankut, Kodre Bletës, Kodre Madhe etj.*

Në fshatin Drelaj: *Kodre Xhamis, Kodre Ndreut, Kodre Vorreve, Kodre Koqe'je, Kodre Ahmet Zek's etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Kodre Dbanave, Kodre Giat', Kodre Mehit, Kodre Llazisyle etj.*

Në fshatin Koshutan: *Kodre Dbanave, Kodre Hajl's, Kodre Kish's, Kodre Molik's, Kodre Pllan's, Kodre Lekiqit, Kodre Pele, Kodre Lugjeve etj.*

Në fshatin Shkrel: *Kodre Hajl's, Kodre Bajrimerve, Kodra e Ahit, Kodra e Dashit, Kodre Vuthe, Kodre Vorreve etj.*

Në fshatin Bogë: *Kodre Lushëve, Kodre Vorreve, Kodre Hajl's, Kodre Deme, Kodre Melit, Kodre Leshun, Kodre Bog've etj.*

Në fshatin Stankaj: *Kodre Grunit, Kodre Staj's, Kodre Sadri Bardhit, Kodre Livadit Muq's, Kodre Haxhijajve, Kodre Dake, Kodre Rrahit, Kodre Frath've etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Kodre Kish's, Kodra e Zharre, Kodre Lek' Sanik's, Kodre Sekut, Kodre Mrizit, Kodre Shog't, Kodre Vorreve etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Kodra e Samarit, Kodra e Gjeloshit, Kodra e Deshve, Kodra e Kishës, Kodra e Ali Dedës, Kodra e Dardhe, Kodre Pish's, Kodre Maxhupit, etj.*

6.15.6. Emra majash

Në fshatin Shtupeç i Vogël: *Maje Volljakut, Maje Zez', Maje Hasanit (Peklena) etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Maja e Kolëmuqës, Maja e Zez' etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Maje Thatë, Maje Smake etj.*

Në fshatin Malaj: *Maje Bregut, Maje Kodr's etj.*

Në fshatin Pepiç: *Maje Kërshit, Maje Nik'Pep's etj.*

Në fshatin Drelaj: *Maje Kol' Muq's, Maje Domnik's etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Maje Lujve, Maje Qet's etj.*

Në fshatin Koshutan: *Maje Hajl's, Maje Dromodolit, Maje Malushajve etj.*

Në fshatin Shkrel: *Maja Huse, Maje Hajl's, Maje Dromodolit, Maje Zezë etj.*

Në fshatin Bogë: *Maje That', Maje Shis', Maje Hajduçe, Maje Sejdit etj.*

Në fshatin Stankaj: *Maje Gjele, Maje Cerrkaqit, Maje Hasanit, Maje Omerit, Maje Skërkoqit, Maje Gllogjisë etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Maje Stankut, Maje Vaganicës etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Maje Salihe, Maje Leqinatit, Maje Elezit, Maje Licit etj.*

6.15.7. Emra malesh

Edhe emrave të maleve, **oronimeve**, në këtë zonë nuk u është kushtuar vëmendje hulumtimi. Falë konfiguracionit të terrenit, kryesisht malor hasim mjaft emra të tillë si: *Mali i Kishës, Mali Pllan's, Mali Met's, Mali Vrell's, Mali Rrahit, Mali Vogël, Mali Balis', Mali Syl's, Mali Djegun, Mali Sheut, Mali Prem, Mali Shabe, Mali Selimit, Mali i Bek's, Mali Ri etj.* Disa sish përfshijnë në vete qindra hektarë.

Emrat më të zakonshëm për male janë emrat e maleve individuale: *mali i Husajve, Mali i Premë - Dugajevë, Mali i Veselmusajve - Bogë, vargjet malore: Mali i Sheut, Mali i Djegun, Ashti i Shkrelit, Brija e Shpell's, Mali i Koshuatanit, majat: Maja e Zezë - Stankaj, Maja e Licit - Haxhaj, Maja e Prehtë - Stankaj*, por edhe emrat e objekteve të vendosura brenda një vargu malor, për shembull zonat pyjore, livadhet, kullotat, fushat, rrugët, madje edhe lumenjtë dhe ujëvarat si dhe emrat e të gjitha objekteve në mal (p.sh.. vendbanimet, ndërtesat, parqet natyrore, etj.).

6.15.8. Emra shpellash

Në fshatin Shtupeç i Vogël : *Shpelle Arush's, Shpelle e Dheln'e, Shpelle Avdi's etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Shpelle Kaçak've, Shpelle Dheln'es, Shpelle Dhive, Shpelle Bor's etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Shpelle Kigjave, Shpelle Arush's etj.*

Në fshatin Malaj: *Shpelle Pëllume, Shpelle Kol's, Shpelle Arush's, Shpelle Bor's, Shpelle Kaçak've etj.*

Në fshatin Pepiç: *Shpella e Shkive, Shpelle Bek's, Shpellat e Celive, Shpelle Binakut etj.*

Në fshatin Drelaj: *Shpelle Zharit, Shpelle Gjarpnit, Shpelle Mishit etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Shpelle Kafshqe, Shpelle Otergut, Shpelle Beqire, Shpelle Selimit, Shpelle Staks etj.*

Në fshatin Koshutan: *Shpella e Sykut, Shpella e Hajlës, Shpella e Brishpell's etj.*

Në fshatin Shkrel: *Shpella e Teshe, Shpella e Bali Hunit, Shpelle Arush's, Shpelle Dhene, Shpelle Kaut, Shpelle Gjane etj.*

Në fshatin Bogë: *Shpelle Binakut, Shpellat e Meke, Shpelle Tahir Colit etj.*

Në fshatin Stankaj: *Shpelle Dheln'es, Shpelle Nek's, Shpelle Zylfis' etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Shpelle Malit, Shpelle Borës etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Shpelle Pal Gjokës, Shpelle Kaçak've, Shpelle Arush's, etj.*

6.15.9. Emra sherash

Në fshatin Shtupeç i Vogël: *Sheu i Llazit t'Vogël etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Sheu i Kronit t'Isuf Nikçit, Sheu i Math, Sheu i Nikçit,*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Sheu i Sharr's etj.*

Në fshatin Malaj: *Sheu i Pervarës, Sheu i Ibishit, Sheu i Keq etj.*

Në fshatin Pepiç: *Sheu i Love, Sheu i Pep's etj.*

Në fshatin Drelaj: *Sheu i Dreje, Sheu i Stanisht's, Sheu i Kodr's etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Sheu i Lopëve etj.*

Në fshatin Koshutan: *Sheu i Grop's, Sheu i Myrt'e etj.*

Në fshatin Shkrel: *Sheu i Bregu Puzit, Sheu i Katunit, Sheu i Bulit, Sheu i Syl's, Sheu i Zekajve etj.*

Në fshatin Bogë: *Sheu i Melisht's, Sheu i Mollis etj.*

Në fshatin Stankaj: *Sheu i Rexhit, Sheu i Shahit etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Sheu i Bregu Dash's, Sheu i Livadit, Sheu i Samaraqit, Sheu i Kurtit etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Sheu i Kronit t'Bardh' Sheu i Lunajve etj.*

6.15.10. Emra shkallësh

Shkalle Shkieve, Shkalle Pepiçit, Shkalle Shkjaut, Shkalle Haxhie, Shkalle Brahimit, Shkalle Dershan's, Shkalle Madhe, Shkalle Otergut, Shkalle Ahmetit, Shkalle Dbanit, Shkalle Shkaut, Shkalle Lugu Bulit, Shkalle Kuçe, Shkalle Drele etj.

6.15.11. Emra livadhesh

Në fshatin Shtupeç i Vogël : *Livadhi i Marashit, Livadet e Kastrate, Livadet e Zhuj'e etj.*

Në fshatin Shtupeç i Madh: *Livadi i Filipe, Livadi i Bajrame, Livadet e Beke, Livadi i Bezhanije, Livadi Math etj.*

Në fshatin Rekë e Allagës: *Livadi Prel's, , Livadi Lek's etj.*

Në fshatin Malaj: *Livadet e Hasane, Livadet e Mom's etj.*

Në fshatin Pepiç: *Livadi Tahirit, Livadi Balis', Livadi Isuf Ram's, Livadi Ram's etj.*

Në fshatin Drelaj: *Livadi Martinit, Livadi Feke etj.*

Në fshatin Dugajevë: *Livadet e Hasa Smajle, Livadi Vorreve, Livadi Brozhit etj.*

Në fshatin Koshutan: *Livadi Mariqit, Livadi Sadikut, Livadi Lushit, Livadi Sakut etj.*

Në fshatin Shkrel: *Livadi i Abazit, Livadi i Mariqe, Livadi Balis, Livadi i Math, Livadi i Zek's, Livadi i Isuf Sadikut, Livadi i Bule etj.*

Në fshatin Bogë: *Livadi i Ram've, Livadet e Meka, Livadet n'Busi, Livadi i Avdyllit etj.*

Në fshatin Stankaj: *Livadet e Bukura, Livadi 'Bregut, Livadet e Kurte, Livadi i Vogël n'Joshanic' Livadi i Madh n'Joshanic' etj.*

Në fshatin Haxhaj: *Livadi i Licit, Livadi Latit, Livadi Imerit, Livadet e Cuk' etj.*

Në fshatin Kuçishtë: *Livadi Mirit, Livadi Poshtër, Livadi Bek's, Livadi Aliçkut etj.*

6.15.12. Emra qafash

*Qafat e Bukura, Qafe Livadit, Qafe Qyqes, Qafe Broqit, Qafe Llazit, Qafe Ortegut, Qafe Rexhe, Qafe Curulaj's, Qafat e Noce, Qafe Shkjeve, Qafe Smajlit, Qafe Pudarollit, Qafe Lakut, Qafe Kunor's, Qafe Cirme, Qafe Poshtër, Qafe Bardh', Qafe Topoll;s, Qafe Mustaf's, Qafat e Male, Qafe Martinit, Qafe Gjonit, Qafat e Malushe etj.*⁴⁴

S'ka dyshim se fusha e toponimisë është terren shumë i çmueshëm edhe për ruajtjen e relikteve leksikore. Kështu për shembull fjalët **melishtë, hejdishtë** etj. nga rrënjorët *mel* dhe *hejd* këndeje sot ruhen vetëm në toponimi, pasi këto bimë kohë më parë në këtë anë kanë pushuar së kultivuari.

6.16. Zoonime

E rëndësishme për socioonomastikë, onomastikë, toponimi, linguistikë, botanistikë, zoolistikë dhe për fushat e tjera të dijes, zoonimia zë vend të dukshëm në toponiminë e kësaj ane përmes emërtimeve që në strukturë kanë emra shtazësh apo shpezësh të egra apo shtëpiake, si një dëshmi për praninë e shumëllojshmërisë së tyre si dhe fushëveprimtarinë e popullatës së këndejshe, e cila, në masë të konsiderueshme është e lidhur me botën shtazore. Me ndryshimet infrastrukturore dhe shkatërrimin në masë të pyjeve, sidomos në Rugovë, zonë malore e Pejës, jemi dëshmitarë të zhdukjes së disa llojeve të fitonimisë, bimëve drunore, barishteve si dhe largimin dhe zhdukjen e disa llojeve të shtazëve dhe shpesëve të egra, emrat e të cilëve kanë mbetur të ngurosur në formime, gjegjësisht në emërtime toponimike. Rugovasit në vazhdimësi duket të kenë pasur kontakte të shpeshta me botën shtazore në përditësinë e veprimtarisë, duke i çmuar, duke i kultivuar dhe madje duke jetuar me të ardhura nga shtazët shtëpiake si dhe duke i kryer punët e ndryshme

bujqësore me to, duke e përfshirë këtu edhe ndonjë ndodhi që mund të ketë ndodhur lidhur me shtazë, s'është habi që sipas tyre të jenë ndërtuar mjaft emërtime vendesh duke u mbështetur edhe në pamjen e vendit tek gjenden ato më tepër ose në të cilin vend ka ndodhur ndonjë ngjarje e shënueshme lidhur me shtazën me emër të së cilës shoqërohet emërtimi. Edhe emërtimet sipas faunës në një farë dore janë pasqyrim i rrethanave dhe i kushteve jetësore të popullatës vendëse dhe kështu kanë edhe rëndësi njohëse shoqërore p. sh.: *Kodre Pele, Shpelle Kigjave, Lugu i Love, Llazi Kuale, Shpelle Arush's, Ograje Vjetave, Shtegu i Krapojve, Brie Lugu Love, Rrasat e Dhive, Lugu i Thive, Bregu i Dhëlp's, Kroni Lepurit, Shpelle Kafshqe etj.*

6.17. Hidronime

Në toponiminë e Pejës me rrethinë toponimet hidronime nuk janë të pakta. Edhe emërtimet e sferës ujore kapin një pjesë të mirë të toponimisë së këtyre anëve duke dhënë kështu edhe një pasqyrim të terrenit përkatës. Emërtimet toponimike të kësaj sfere ndonjëherë paraqesin konfiguracionin ujqor të vendit, kurse në ndonjë rast paraqesin përpjekjet e vënësve dhe emërtimet sipas këtyre përpjekjeve që të kenë sa më afër ujë të pijshëm apo edhe tjetër për nevoja shtëpiake, bie fjala krrua, gurrë, lug uji etj., prandaj edhe emërtimet me bazë ujore mund të shihen në dy grupe:

a) emërtime të sferës ujore natyrore dhe b) emërtime të sferës ujore artificiale.

Në grupin e parë bëjnë pjesë emra sherash, emra burimesh, emra rrjedhash ujore, emra lumenjsh etj.;⁴⁴ kurse në grupin e dytë bëjnë pjesë emërtimet ujore në të cilat ka punuar ose ka ndikuar në një mënyrë dora e individit që të quhen si të tilla. Edhe toponimet hidronime rëndom shoqërohen me një përcaktor i cili shpreh ndonjë veçori të emërtimit ose ndiqet nga një antroponim apo patronim që tregon përkatësinë, mund të tregojë autorin e punës së bërë ose ka raste kur hidronimi shoqërohet me emrin e personit të cilit mund t'i ketë ndodhur diçka e rëndësishme në atë vend. Ka raste edhe kur hidronimi toponim përcaktohet nga një emër shtaze apo shpeze p. sh. Kroni Kalit, Gurrat e Kastrate, Sheu i Math, Rieke Shabanit, Rieke Haxhie, Gurre Lujve, Vrella, Kroni Bog've, Gurre Bardhë etj.

44. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 717.

6.18. Patronime në funksion toponimesh

Toponimet që emërtohen me anë patronimesh këndeje janë mjaft të shpeshta. Ato emërtojnë vendin pa pasur mundësi të japin ndonjë sqarim lidhur me terrenin përkatës. Ato përfshijnë një hapësirë të gjerë gjeografike brenda së cilës gjenden edhe shumë mikrotoponime. Patronimet e toponimizuara, siç dihet, shkojnë dhe formohen nga antroponimet me anë të prapashtesës –aj p.sh. Bardhaj, Lulaj, Rexhaj, Dreshaj, Lukaj, Hasansmajlaj, Ibërdemaj, Gjevukaj nga Gjon Vukaj etj. Emërtimet e këtilla zakonisht përfshijnë vendbanimin e një lagjeje apo edhe një fshati. Në ndonjë rast për emërtime vendesh këndeje përdoren edhe antroponimet të prira nga parafjala në p. sh. Në Arifit, Në Melit, Në Zykes, Në Kelit, Në Mehit, Në Bardhes, Në Tahirit, Në Bek's, etj. Në këso emërtime toponimike, midis parafjalës dhe antroponimit, shkon dhe futet nyja të në trajtë të cungur t', po në trajtë të shkurtuar përdoret edhe parafjala p.sh. N't' Balis', N't'Rexh's, N't'Ademit, N't' Lushit etj.⁴⁵

6.19. Toponime me burim për diskutim

Për disa toponime që do të shënohen në vijim, me këtë rast, nuk mund të japim një mendim përfundimtar me të dhëna të mbështetura mirë dhe bindëse andaj edhe, për sot, po i quajmë toponime të diskutueshme sa i takon anës burimore. Të tilla janë: Dromodoli, Neçinati, Gërdeqi, Vjellaku, Peklena, Qiknishta, Dreshiqi, Gaxheviqet, Gjenishta, Meterizi, mbase nga turqishtja Shtupuraku, Rashiqet, Shtupeçi Madh, Shtupeçi Vogël, Hajla, Llutova, Prevari, Murgashi e ndonjë tjetër. Për toponimin e fundit, që shënon një mal të madh dhe të dendur në terren gjetëm shpjegimin sipas të cilit ky emërtim mbeti nga muratorët e fisit të Gashit; kujtojmë se burimi i emërimit Murgash do kërkuar tek fjala murg. Në fund të kësaj pjese, edhe dy fjalë rreth përdorimit të nyjave në emërtimet toponimike: emrat mashkullorë që sosin në grykoret k,g, sikundër edhe në ligjërimin e përditshëm vendës edhe në përdorimet toponimike, në rastet e shquarsisë së njëjësit marrin mbaresën shquese-u p. sh. Bregu i Shejit, Lugu i Keq, Shtegu i Ashtit etj. Po më në fund dalin edhe toponimet emërtimi i të cilave, tek gjymtyra e parë, sos në zanore të theksuara në të pashquarën p.sh. Sheu i Math, Sheu i Nikçit etj. Në këso strukturash toponimike ku elementi fundor i gjymtyrës së parë është –u, ruhet i-ja para gjymtyrës së dytë të emërimit qoftë si nyje e gjinore, qoftë si nyje e një mbiemri të paranyjësuar p.sh. Shtegu i Giat',

Shtegu i Katundit, Bregu i Syl's, Bregu i Shejit etj. Rreth çështjes së përdorimit të nyjave të përparme në emërime vendesh me dy apo më shumë gjymtyrë nuk mund të thuhet një mendim i prerë. Megjithëkëtë, lypset thënë se nyja i nuk dëgjohet tek emërtimet që ndiqen nga një atribut i paranyjëzuar e që gjymtyra e parë e emërtimit përfundon në mbaresën shquese – i p.sh. Kroni Ftoft', Mali Djegun, Kërshi Kuq etj. Sa për nyjën e të emërtimeve në njëjës, edhe kur ndiqen nga një mbiemër, edhe kur ndiqen nga gjinorja e një emri mund të thuhet se ajo elidohet nga vendi që i përket duke e zënë kështu vendin e mbaresës shquese –a të gjymtyrës së parë p.sh. Are Ademit, Gurre Vuthe, Molle Egër, Ruge Poshtër etj. Por, ruhet rregullisht nyja e para mbiemrash dhe para gjinore kur gjymtyra e parë e emërtimit përdoret në shumësin e shquar p.sh. Gropat e Syke, Cufrrat e Rrasta, Gardhiqet e Rexhe etj.

45. Mujaj Hasan, Koha 5-6, Titograd, 1982, faq. 718.

KREU I SHTATË

Pjesa e dytë

FJALOR TOPONIMIK

7. Toponime të shënuara në fshatin Raushiq

A

Toponimia e arave

Ara e Kumbullës

Ara e Begit / beut

Ara e Plavës

Ara te Verrishta

Ara Ndërvadë

Arat e Pavada

Ara e Stojkit

Arat e Zadruges

Ara te Kroi i Etheve

Arat te Qershia

Arrnica e Arapit

B

Emra batllaqesh

Batllaki i Zhushit

Batllaki i Vocit

Batalliki

Toponimia e bahçeve

Barica e Poshtme

Barica e Epër

Bahçja e Hoxhës

Bahçja e Maj's

Bahçja e Sakakit

Bahçja e Nimon Zhutit

Bahçja e bacës Tahir

Batallinat

Binxha, binça

Bishtaki

Bregu i Sumës

Bunari i bacës Beqir

Bunari i Bajramrrustemëve

D

Toponimia e drumeve

Dardha e Haxhiahmetëve

Dardha e Zhushit

Dera e Arave

Drumi i Baranit

Drumi i Kajnakit

Drumi i Telit

Dugoja e Zhutëve

Dyfiqet

F

Fusha e Pejës

G

Toponimia e grykave

Gjoli i Zllapekut

Granapi i Beq Kurtit

Grazhdi i Mullinit

Grella e Boqollëve

Gryka e Lybeniqit

Gunga e Kramavikëve

Gunga e Vocëve

Gurina e Zekmiftarëve

Gurra e Bardhë

Toponimia e jazeve

J

Jazi i Epër

Jazi i Midisëm

Toponimia e krojeve

K

Kalldremet

Kamsorja ka Breja

Kanali i Derzhav's

Kodra e Halitdemëve

Kodra e Nov's

Kodra e Toplanës

Kopiniqja e Cocëve

Kopshti i Ferizit

Kopshtijet

Krojet e Spacit

Kroi i Arr's

Kroi i Llug's

Kroi i Moçëm

Kroi i Ryve Hamzes

Kroi i Xhamisë

Ku ndahen Drumet

Toponimia e lëndinave

L

Lama e Grunit

Lendina e Lecit

Lajthija

Leqet

Leqja e Madhe

Lisat e Zlalpekit

Livadhet e Egra

Livadhet e Malit

Livadhi i Begut

Livadhi i Dardhës

Livdhi i Kollçakut

Livdhi i Shelnjes

Livadhi i Stojkut

Livadhi të Kroit të Etheve

Livadhi të Mullirit

Lugu i Maksimit

Lugu te Malsorët
Lugu u Drinit
Lugi i Sallahuskit
Lugina e Dinasllanëve
Lugshtina e Salidemëve

Toponimia e llugave

Ll

Llagëmi
Lluga e Arapit
Lluga e Batllakit
Lluga e Gradinëve
Lluga e Grudës
Lluga e Kroit T'etheve
Lluga e Grudës

Toponimia e maleve

M

Mali i Mihalit/ Mihajlit
Mali i Zagermës
Mas Mali
Mi Mal
Miskeret
Monasellat
Mullini i Bajraktarve

Toponimia e oborreve

O

Oborri i Zadrugës

Orrnica

Orrnica e Arapit

Otergi i Arës

Otergi i Madh

Otergjet

Toponimia e podeve

P

Podi i Qukarës

Podi i Sav's

Podi i Vllakav'

Presa e Cocëve

Presa e Stojkit

Prroi i Skoroviçit

Pusi i Islamëve

Pusi i Maxhupit

Toponimia e qardakëve

Q

Qardaki i Bajram Rustem've

Qardaki i Shaban Xhaferëve

Qershijat e Raushiqit

Qukarja

Quku i Fetahëve

Quku i Zekmiftarëve

Quku

Toponimia e rrugëve

Rr

Rrahi

Rrasa e Keqe

Rrahishta

Rrethi i Gradinës

Rrethi i Vjetav’

Rruga e arave

Rruga e Dubovikut (*te Xhamia*)

Rruga e Fushës

Rruga e Grazhdit

Rruga e Gurinave

Rruga e Kopshtijeve

Rruga e Livadheve

Rruga e Monasellav’

Rruga e Vllakave

Rrotullaki i Dinasllan’ve

Toponimia e shpatijeve

S

Selishta e Boqoll’ve

Shpati i Lybeniqit

Shpati i Qukaris

Shushica e Bellopoj’s

Shushica e Lybeniqit

Toponimia e trojeve

T

T’Pavadat

T’Thorja

Te Blini i Bajraktarëve

Te Plepi i Fetahëve

Te Rrasat e Beqir Hamzës

Trualli i Hysen Avdullahit

Trualli i Malsorëve

Trualli te Çardaku

Toponimia e udhëve

U

Udha e Arave

Udha e Bardhë

Udha e Drinit

Udha e Kishës

Udha e Kuqe

Udha e Mullirit

Udha e Vneshtijeve

Udha e Vozit

Udha Trupe

Uj’t e Epër

Uj’t e Felekit

Uj’t e Grazhdit

Uj’t e Mikserëve

Urat e Mullirit

Toponimia e verrishtave

V

Varoshet

Verrat e Ramës

Verrishta

Vreshti i Jahëve

Vidhi i Vidakut

Vija e Katundit

Vija e Loxh's

Varret e Ademajve

Varret e Katundit

Varret e Kryqalive

Varret e Shehitëve

Toponimia e zabeleve

Z

Zabeli i Fetahëve

Zalli i Bardhë

Zalli i Lybeniqit

Zekserishta

7.2. Fshati Kosuriq (Frashnjeti)

A

Arat e Epërme

Ara e Ali Ukve

Arat e Dezdarit

Arat e Guxhve

Arat e Rugov've

Arat e Mullnit

B

Bahçja e e Dezdarëve,

Bahçja e Shaba'n Haxhive

Bahçja e Pangjajve

Brigjet e Medoshit

Bunari i Dezdarit

Bunari i Vokshjanve

Bunari i Aliçut

D

Dardha e Ham'z Rams

Dardhat e Guxh've

Drumi i Qekve

Drumi i Sulte

Dugoja e Sulaj'v

Dugoja e Dezdar've

F

Fush Errnicat

Fush Gorinat

Fush duzhicat

G

Grazhdi i Shaba Haxhive

Grazhdi i Mal Salihit

Grellat e Qilit

Grella e Vokshjanve

Gurina e Beqhoxhve

Gurinat e Brahim Keqes

Gurina e Met Mehmetit

K

Kalldemi i Tamnikut

Kamsorja e Sul've

Kamsorja e Beqhoxhve

Kamsorja prej Selman Bajr's deri te Pangj't

Kanali i Llug's Kronit

Kodra e Tupanit

Kopshti i Izlam Rustve,

Kroni i Madh

Kroni i Qylines

L

Lama e Rugov've,

Lama e Beqhoxhve

Ledina e Zabelit
Ledina e Tamnikut
Lisat e Smajl Sadrive
Lisi i Kajushes
Livadhet e Dezdarit
Livadhet e Rugov've,
Livadhet e Guxh've
Lugu i thana'v,
Lugu i Plepav,
Lugu i Abratines
Lugu i Smajlit
Lugjet e vorrev,
Lugjet e Ali Gashit
Lugjet e Zabelit
Lugjet e Gjonit
Lumi Behoc

LI

Llagami i Brahim Keq's
Lluga e kronit

M

Mali i Pangjajve
Mali i Shaba Haxhive
Mullini
Mullini i Aliçk've
Mullini i Met Mehmetit

O

Oborri i Ibish Uk's

Orrnicat e m'dha

Orrnicat e Vogla

P

Podi i Adem Kadris

Podi i Buçanit

Presa e Gorinave

Prroni i Dugaj's

Pusi i Fazes

Rr

Rrahishta e Lugut vorre'v

Rruga e Kodra'v

Rrruga e Malit

Rruga e Fush's

Sh

Shpati i Pavada'v

T

Trulli i Begut

Trulli i Rugov've

U

Udha e Behocve

Udha e Rugov've

Udha e Qekeve
Udha e Beqhoxhve
Uj't e Behocit,
Ura e Behocit

V

Verrat e Guxhve
Vorret e Epërme
Vorret e Poshtme

Z

Zabeli i Begut
Zabeli i Lugut
Zalli te Boxhaku

7.3. Toponime të shënuara në fshatin Naberxhan (Kelmend)

A

Ara e Nushit (*çipqi*)
Ara e Lisit
Ara te Seishtat
Ara e Zallit
Ara e Shtetit
Ara e Metës
Ara e Balis
Ara e Lloqit

B

Bashqja e Belkajve
Bashqja e Ram Tahirit
Bashqja e Shaba' Syl's
Bunari i Katunit (mahalla e mesme)
Bunari i Husajve

D

Dardha e Bajram Hysenit
Dardha e Syl Alis
Dardha e Kerit (Ker Sadris)
Drumi i Berbatve
Drumi i Iberdemajve
Drumi i Kolushve
Drumi i Lunajve
Drumi i Shkollës,
Dugoja e Sak Larit
Dugoja e Halilit
Dugoja e Bajraktarve
Dugoja e Dervish Ilve

F

Fusha Letiqet
Fusha e Nabergjanit
Fusha e Sylalive
Fusha e Mahalls Nushit

G

Grazhdi i Osman Ram's,
Grazhdi i 9 – ditve
Grazhdi i 18 – ditve
Grazhdi i Husajve

Grazhdi i Bali Çukut
Grella e Dhelpnave
Grella e Hysen Selimit (Nokshiqit)
Gurina e Isuf Vesel've
Gurra e bacit Musë
Gurra e Osman Tahirit
Gurra e Ali Kadrisë

K

Kamsorja e Mahhall's Nushit
Kanali i katunit
Kanali i Jahovcii
Kanali i nan ditve
Kanali Kujavci
Kanali i 15 ditve
Kodra e Dhelpnave
Kodra e Kuqit
Kodra e Hyse'n Selimit
Kodra e Vorreve
Kopshti i Husajve
Kroni i Ali Kadris
Krooni i Vorreve
Krooni i i Nushit
Krojet e Kujavcit

L

Lama e Sejdi Veselit
Lama e Shabajve
Lama e Muriqve

Lama e Husajve
Lama e Bali Çuk've
Lame Lun'e
Lame Bajraktarve
Ledina e Kronit
Ledina e Katunit
Ledina e Vorrev
Lisat e Naklles
Lisat e Dervish Ilit
Lisi i shkollës
livadhet e Ram Qukve
Livadet e Shaba'n Kapllanve
Livadhet e Lune
Livadhi i Shkollës
Livadhet e Egra
Lugi i bacit Mus
Lugu I Drinit (Pejë – Jagodë)
Lumi Drini i Bardhë

LI

Lluga e Nushit
Lluga e Idrizit
Lluga e Kesh Qorrit
Llugat e Drinit

M

Mali i Ali Met's
Mali i Hyse Mekulit
Mali i Ali Suk's

Mali i Kuçit

Mullini i Murat Ram's

Mullini i Savës

Mullini i Devollit

Mullini i Bakraçit (bakërpunues)

O

Oborri i Belkajve

Orrnica e Shaba Syl's

Orrnica e Larit

P

Presa e Shaban Sylës

Presa e Nezir Voksh've

Prroni Kujavci

Pusi i Vorreve t' Shkijeve

Rr

Rrahishta e Hus'e

Rruga e Ibërdemajve

Rruga e Dervish Ilit

Rruga e Lunajve

Rruga e Mahall's Sirme

Rruga e Bajrakyatve

Rruga e Belkajve

S

Selishta e Nushit

Sh

Shpati i Kuçit

Shpati i Mahhall's Midisme

U

Udha e Madhe

Urat e Al'e

Urat e Bllagaj's

V

Verrat e Huse

Vorret e femij've

Vorret te Xhamia

Vorret e Mahall's Cirme

Vorret e Shkijeve

7.4. Toponime të shënuara në fshatin Zahaq (Siparunt)

A

Ara - Bostanishta

Ara Kuçishta

Arat e Sokolit

B

Baltat e Zahaqit

Bahçja e e Sadri Ram's

Bahçja e Kamerve

Bahçja e Shaban Salihit

Brigjet e Metushve

Bog't

Bunari i Ulic's

Bunari i Katunit

Bunari i Kastratve

Bunari i Qerretve

Bunari i Bardh Mehmetit

Bunari i Ledin's

D

Dardha e Egër

Dardha e Kamerve

Dardhat e Qerretve

Drumi i Bekë Faslisë

Drumi i Zahaqit

Dugoja e Azemit

Dugoja e Vllad's

F

Fusha e Bistricës

Fusha e Ramunit

Fusha e Epërme

Fusha e Zahaqit

Fusha e Toplan've

G

Grazhdi i Sokolit

Grazhdi i Ram Shabanit

Gurra e Bistric's

Gurra e Sokolit

Gurra e Qerret've

Gurina e Bistricës

Gurina e Rrahishtës

Gj

Gjadja

Gjadja e vjetër

H

Hani i Bil Gjikollit

J

Jazi i Mullinit

K

Kamsorja e Kastratve

Kamsorja e Zhivkut

Kodra e Zahaqit

Kopshti i Rexhë Uk's

Kopshti i Toplanve

Kopshti i Bajram Shabanit

Kroni i Baltave

Krojet e Jazit

Krojet e Soklit

Krojet e Salihit

Kroni i Ibisht

Kroni i Nazifit

Kuçishta e Ramë Begut

L

Ledina e Zahaqit

Lisi i Kajushes

Lisi i Llabjanit

Livadhi i Mullinit

Livadhët e Gjona

Livadhët e Buta

Livadhët e Rugov'vë,

Livadhët e Qerretvë

Lugu i Toplanvë

LI

Lluga e Kastratvë

Lluga e Ram Shabanit

Lluga e Ram Salihit

M

Mali i Vuthajvë

Mullini i Sof's

Mullini i Daut Zeqirit

Mullini i Cenë Rustemit

Mullini i Ramunit

O

Oborri i Berish'vë

Otavat

P

Plepat e Kamerve
Pusi i Ibish Bajramit

R

Ramhalilt
Ramzeqt

Rr

Rrahishtat
Rrahishta e Llugave
Rrahishta e Sadri Ram've
Rrahishta e Azemit
Rruga e Vjeter

S

Sojishta
Sternishta

Sh

Shevarina

T

Trulli i Rugov've

U

Udha e vad's
Ura e Mullinit

Uj't e Jazit

Uj't e Bistric's

Urat e Jazit

V

Verrat

Verrishtat

Verrishtat e Sokol Salihit

Verrat e Cenë Rustemit

Verrat e Kamerve

Vorrat e Zahaqit

Z

Zalli i Bistric's

Zalli i Sami Kastratit

7.5. Toponime të shënuara në fshatin Shkrel

Emra livadhesh

Livadi i Lek's, Livadi i Luce, Livadi i Abazit, Livadi i Mariqe, Livadi Balis, Livadi i Math, Livadi i Zek's, Livadi i Isuf Sadikut, Livadi i Bule etj.

Emra sherash

Sheu i Bregu Puzit, Sheu i Katunit, Sheu i Bulit, Sheu i Syl's, Sheu i Zekajve etj.

Emra shpellash

Shpella e Teshe, Shpella e Bali Hunit, Shpelle Arush's, Shpelle Dhene, Shpelle Kaut etj.

Emra majash

Maja Huse, Maje Hajl's, Maje Dromodolit, Maje Zezë etj.

Emra kodrash

Kodre Hajl's, Kod're e G'iat, n' Koder t' Bajrimere, Kodra e Ahit, Kodra e Dashit, Kodre Vuthe, Kodre Vorreve etj.

Emra gropash

Gropat e Huse, Gropa e Camit, Grope Madhe, Grope Zenelit, etj.

Emra lugjesh

Lugu i Shkrelit, Lugu i Mrizeve, Lugu i Hajdare, Lugu i Murrize, Lugjet e Mullive, Lugu i Paj's, Lugjet, Lugu Omerit etj.

Emra brigjesh

Bregu i Gurrave, Bregu i Nikës, Bregu i Nimanajve, Bregu i Mujit, Bregu i Puzit, Bregu i Luzit etj.

Emra brinjash

Brie e Vulit, Brie Bruqit, Brie Kastratit, Brie Shpell's, Brie Lugu Love etj.

Emra qafash

Qafa e Dasmorëve, Qaf Mullini, Qaf t'Hormoqit etj.

Emra gurrash

Gurra e Martinit, Gurra e Gjeloshit, te Gurra e Niman'e, Gurra e Ftof't, Gurra e Reqke etj.

Emra kopshtijesh

Kopshti i Shaba'ne, kopshti i Harabadajve, kopshti i Bulit, kopshti i Nimanajve, Kopshti i Shpenajve, kopshti i Mus Tahirit etj.

Emra krojesh

Kroni i Gjelit, Kroni i Cirm etj.

Emra dardhash

Dardhe Bul'e, dardhe Niman'e etj.

Emra kumbullash

Kumbullat e Ibishit

Emra trapash

Trapat e Niman'e, Trapi i Zek's, trapi i Hazir Ali's, trapi i Syl Istrefit, Trapi i Bulit, trapat e Ram Bajramve, trapi i Shab'a Haxhis, Trapi i Shpen'e, Trapi i Ujkan Kurbog's etj.

Emra pojatash

Pojatat e Rambajramve, Pojatat e Shpen'e, Pojatat e Hazir Ali's, Pojatat e Nimanajve, Poajta e kual'e, Pojata e Lo've, Pojta e Shabanajve, Pojat e Avdi Rexhepit etj.

Hysenaj Valdet. Arkivi personal pasurohet me mbi 1200 toponime të reja

Shënim: Gjatë punës në terren kam mbledhur mbi 1000 toponime të patrajuara deri me sot.

7.6. EMËRTIMET E REJA TË VENDBANIMEVE NË PEJË

Pas luftës së fundit në mënyrë euforike shumë emërvende u ndërruan, si të tilla, me ndonjë përjashtim të rrallë ato nuk zunë vend. Më poshtë po japim emrin e vendit dhe proozimin e ri.

Emri – Emri i ri

Babiqi - Babaj

Barani - Bardhan-i

Bellopoja - Guranjak-u

Bllagaja - Arrishtë-a

Bogët – Bokaj

Brestoviku - Gurinë-a

Brezheniku – Lagja Dardania

Broliqi - Brolaj

Bungeti - Doboçaku

Çunguri - Çungur-i

Dobërdoli - Lugmir-i

Duboçaku - Bungajë-a

Dubova e Madhe - Driloni i Madh

Dugaiva - Dukaj

Gllaviçica - Shëngjon-i

Glllogjani - Dukëgjin-i

Haxhaj - Haxhaj

Jabllanica - Gjergjizë-a

Jabllanica e Madhe - Alba e Madhe

Jabllanica e Vogël - Alba e Vogël

Gorazhdeci - Kastrat-i

Graboci - Shkozet-i

Kotradiqi - Kodrinë-a

Katundi i Ri - Katundi i Ri

Kërstoci - Kryth-i
Klinçina - Ardian-i
Koshutani - Gjekaj
Kosuriqi - Kodranik-u
Krysheci - Dardhesh-i
Kuqishta - Kuqishtë-a
Leshani - Leshan-i
Lëvosha - Lëvoshë-a
Lipa - Nikuçaj
Loxha - Logjë-a
Lybeniqi - Drinisht-i
Lutogllava - Arbanë-a
Llabjani - Labion-i
Llazi - Llaz-i
Bellopaqi - Lerth-i
Llutova - Ujmirë-a
Llozhani - Loshan-i
Llugaxhia - Luki-a
Cërrnovërri - Cërrovërr-i
Malajt - Malaj
Millavanci - Haxhizekaj
Nabërxhani - Kelmend-i
Naklla - Nakëll-lla
Nepola - Fusharë-a
Novosella - Fierëz-a
Orasha - Arrëz-za
Osoja - Ujishhtë-a
Ozrimi - Drinesh-i
Pavlani – Plakan - i - Paulan - i
Pepiqi - Pepaj
Pishtani - Pishtan-i

Poqesta - Fushëmirë-a
 Qyshku - Qyshk-u
 Radafci - Kryedrin-i
 Rashiqi - Rashaj
 Raushiqi - Raush-i
 Raushiqi i Ri - Raushi i Ri
 Reka e Allagës - Prelaj
 Ramuni - Ramun-i
 Rosuja - Rrasujë-a
 Ruhoti - Ruhot-i
 Shkreli - Shkrel-i
 Shtuqepi i Madh - Shtuqepi i Madh
 Shtuqepi i Vogël - Shtuqepi i Vogël
 Siga - Cigë-a
 Svërka - Thatinë-a
 Tropoviqi - Blinisht-i
 Tresteniku - Trefis-i
 Turjaka - Turjakë-a
 Vitomirica - Arbnesh-i
 Vragoci - Zogaj
 Vranoci - Vrandoci
 Zagërma - Rrëzinë-a
 Zahaqi - Siperant-i
 Zllapeku - Dardan-i
 Fushë Peja - Fushë-Peja
 Pecaj - Pecaj
 Llazoviq - Llazaj
 Dushakaja - Dushkajë-a
 Hokaj - Hokaj
 Llazajt e Drelajve - Llazdrelaj
 Bardhajt – Bardhaj


KREU I TETË

Pjesa III


8. HISTORIKU I FSHATRAVE TË TRAJTUARA

FSHATI SHKREL

Fshati Shkrel shtrihet në pjesën veriperëndimore të Pejës me një sipërfaqe prej 193 km², në një lartësi mbidetare mbi 1700 m. Fshati kufizohet me fshatrat: Koshutan, Dugaivë, Bogë dhe Malin e Zi. Në Shkrel deri në luftën e fundit kishte 12 shtëpi me 70 banorë gjatë dimrit, kurse gjatë verës 90 shtëpi me 320



banorë. Sot, gjatë stinës së dimrit, në këtë fshat nuk banon askush. E nëse kjo çështje vërehet me kujdes, na del se duke i përfshirë këtu familjet dhe banorët e përthshëm, si dhe familjet dhe banorët e përkohshëm, madje edhe ata banorë që janë në ekzil të përkohshëm, Shkreli përfshin 75 familje me 430 banorë.¹ Të shtojmë këtu se në ekzil, në fillim të vitit 1992, ndodheshin rreth 220 shkrelas. Kjo dëshmon se kanë filluar emigrimet e mëdha, jo vetëm në botën e jashtme, por edhe në viset e tjera të Kosovës. Një njohës i mirë i rrjedhave demografike përkritazi me shpërnguljen e kësaj popullate, pos tjerash shkruan: “Shpërngulja e popullsisë nga treva e Rugovës ka qenë dhe është proces i vazhdueshëm, që mund të shpjegohet me gjendjen e vështirë ekonomike, rritjen demografike, si dhe me ndikimin e periudhave karakteristike historike dhe nga aplikimi i programeve diskriminuese të pushtuesve shekullorë”. Ne mendojmë se shpërngulja e rugovasve është më tepër e përkohshme, sepse pasuritë e tyre edhe sot e kësaj dite janë të patjetërsuara, madje shumica prej tyre kanë punuar objekte banimi në vendlindjet e tyre.



Sipas traditës popullore dhe të dhënave jo të plota historike, rugovasit trajtohen si kelmendas. Shkrelasit e Rugovës jetojnë në katundin Shkrel, që e mori emrin, sipas të parëve që erdhën e u ngulitën këtu. Pleqtë e kësaj ane, thonë se të parët e tyre erdhën nga Shkreli (Malësia e Madhe, atëherë kur erdhën kelmendasit dhe shokët e tjerë, që i kanë në Peshtër.² Nga kjo del edhe dualizmi se a janë shkrelasit kelmendas apo fis më vete. Ne, nuk po thellohem këtu në këtë çështje, veçse mendojmë se ky problem duhet shikuar në rrafshin etnik. Shkreli duhet të lidhet edhe me kelmendasit e Peshterit, për të cilët mendohet se, pa u kthyer në Kelmend më 1707, disa nga ato familje mbetën përgjithmonë

në Rugovë. Pos tri vëllazërive shkrelase (Husajt, Bajrimerajt dhe Rexhajt), këtu jetojnë edhe Kurtbogajt, që janë bark i Vuklit dhe Hysenajt, bark i Nikçit. E fisit Shkrel, sipas traditës popullore është edhe vëllazëria e Bardhajve të Kuqishtës. Kjo duhet të jetë kështu, sepse nuk mbahet mend - thonë të gjithë rugovasit -të jetë bërë farë martese midis tyre². E folmja e Shkrelit ka afri të dukshme me të folmet e Malësisë së Madhe, veçanërisht me të folmen e Kelmendit, të Hotit e të Shkrelit (Shqipëri), me të folmen shqipe të Plavës e të Gucisë, si dhe me të folmen shqipe të Rozhajës me rrethina. Gjithashtu, kjo e folme shkon edhe me të folmen shqipe të Peshterit, por ka mjaft pika takimi me kosovarishten. mirëpo, për shkak të kontakteve të gjata të banorëve të këtij fshati me banorët e Pejës dhe të Rrafshit të Dukagjinit vërehen edhe ndikime të ndërsjella, me gjithë ruajtjen e trajtave të vjetra fonetike, morfologjike e leksikore të kësaj zone të thellë malore³. Na e merr mendja se në bazë të disa mikrotoponimeve sllave, që i hasim në Shkrel e në Kelmend, në Kosovë e në mbarë viset shqiptare, kurrësi nuk mund të flitet për etnosin sllav, sepse dihet mirë se ato nuk janë të kësaj periudhe por mikrotoponime të mëvonshme. Edhe në fshatin Shkrel, në vendin Bregu i Gurrave të Hajlës, hasim në themelet e kishës së vjetër, sikurse edhe në fshatrat e tjera të Rugovës, si në bjeshkët përreth, në Smilovicë, në Gloxhi, në Neçinat), dëshmi këto të cilat flasin për një etnos të hershëm shqiptar. Këtë s'e vërtetojnë mikrotoponimet: **Selishta, Llazi, Osojna, Vrella**, që i sjell M. Barkatareviqi, po toponimet mesjetare shqiptare **Malaj, Bardhaj, Stankaj, Lulaj** etj., si dhe patronimet shqiptare: **Balaj, Lulaj, Mekaj** e shumë të tjera.⁴ Çështja e mosregjistrimit të Rugovës në Defterët e ndryshëm, si në ata slave, ashtu edhe në ata osmanë, na duket se mund të lidhet me faktin se në viset malore të banuara me fiset shqiptare kurrë nuk është vendosur sistemi administrativ.

Dihet mirëfilli se përhapjen e myslimanizmit e morën përsipër qeveritarët turq kah fundi i shek. ⁵ Ky proces vazhdoi gjatë gjithë shek. 16 dhe atij 17. Meqenëse krahinat malore u bënë ballë presioneve të islamizimit, na del se në Rugovë ky proces u krye mjaft vonë. Kështu, fjala vjen, në Shkrel (Hajlë) ekziston rrënoja e kishës katolike shqiptare përreth së cilës ka varre, që kapin një sipërfaqe gati sa ajo e varreve myslimane, që janë bërë gjatë dy shekujsh. Po t'i ndjekim brezat, shohim se i pesti ose i gjashti brez zë rrënjë nga një kryefamiljar shqiptar i besimit të krishterë: Isë Elezi, Tarçuku, Mehmeti, Mustafa, Kurti, Ivani, Leka; Ali Rama, Sahiti, Veseli, Sylja, Kurti, Laku, Pepa; Arif Reka, Smajli, Arifi,

Hajdari, Elezi, Kurti etj.⁶

1. *Selman Lajçi*, në vështrim: Numri i familjeve dhe i banorëve të Rugovës më 1991... (dorëshkrim)
2. *Dr. Latif Mulaku - Mehdi Bardhi*, Mbi të folmen shqipe të Peshterit, në SGj (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275 e tutje.
3. *Shi gjerësisht, Mark Krašniqi*, Popullsia e Rugovës, në Rugovë, Monografia etnografike, 1975, f. 35-48.
4. *Ahmet Kelmendi*, vep. e cit. në OK, f. 304.
5. *Adem Hajdaraj*, E folmja e Rugovës, IAP, Prishtinë, 1996
6. *Po ayty*

8.1. RAUSHIQI (Rauza)

Fshati Raushiq shtrihet në pjesën më perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, 4 km. në jug të qytetit të Pejës, është vendbanim fushor, me shtëpi të grumbullara afër njëra – tjetrës, me përjashtim të disa shtëpive që ndodhen në periferi të fshatit, kurse tashmë, me industrializimin dhe ndërtimet e shumë objekteve afariste përgjatë rrugës magjistrale Pejë – Deçan, pothuajse është shndërruar në paralagje të qytetit të Pejës, me sipërfaqe 728 ha. dhe 550 m. lartësi mbidetare. Kufizohet me fshatin Loxhë, Raushiq i Ri, Lybeniq, fusha e Strelcit të Epërm, Bellopojë dhe Zagermë si dhe me malin e rrëpinjtë, Shaptin e Lybeniqit. Fshati mospërmas përshkohet nga lumi Bingja (Binça), dëshmi kjo toponimike që këtu ka gjurmë të një vendbanimi ilir në nënshtresat e tokës së tij.

Mikrotoponimet Varoshet, Kalldremet, Udha e Varosheve, Monasella, Miskeret, Kodra e Mdenit si dhe hidronimet Feliki, (Kroi i Felikit), Drini, Kroi i Dishtimit, (Dështimi)¹, etj., po ashtu janë dëshmi të qarta për një vendbanim të lashtë.

Në vendbanimin e zhdukur në fushën e Varoshit janë gjetur gjurmë të materialit arkeologjik si: qeramikë prej tjegullave, qeramikë të dyshemesë, qeramika drejtkëndëshe, tjegulla të rrafshita, tulla, gyp ujësjellësi nga plumbi, gurë të latuar me mbishkrime, kada mermeri, shtiza metali, monedha madhësish dhe vlerash të ndryshme, që sipas ekspertëve i takojnë periudhës së Justinianit të I dhe të II.

Në dokumente të shkruara e hasim që nga Kristobula e Manastirit të Deçanit e vitit 1330² Sipas studiueses P. Huta, në veprën e saj: “ Fshatrat në Sanxhakun e Shkodrës në shek. XV dhe XVI” emri i fshatit Radavaçë, që ekziston në “Defterin regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës”, i vitit 1485, është emri i Raushiqit të sotëm.

Banorët e fshatit të Radavaçës (Raushiqit) në Defterin e regjistrimit të vitit 1845, sipas emrave të tyre të gjithë ishin të krishterë.

Ka elemente dhe dëshmi se ky vendbanim ka poseduar edhe me ujësjellës. Mendohet se ka qenë vendbanim municipium³.

Në një hartë austriake të vitit 1689 është regjistruar me emrin R (B)aucu.

Ky vendbanim në vitet 1836 – 1938, në hartat e Lepieut mbante emrin Raouchitza.

Më periudhën 1922 – 1924 nga pushteti malazias në Raushiq janë vrarë 16 veta dhe janë plaçkitur 20 shtëpi³.

Të dëgjueshmit që ishin të privilegjuar shpërbleheshin me sipërfaqe të mëdha tokash të quajtura **bashtina**, siç ishte rasti i bashtinës së Bogosavit, i bashtinës së Stojkit (Livadhi i Stojkit), që edhe sot e mban këtë emër.

Ndërrimi i fesë dhe i emrave kushtëzohej me sigurimin e ekzistencës dhe jetës së familjeve, prandaj gjatë kësaj kohe ndryshuan edhe shumë toponime.

Raushiqi në shek. XVIII ishte sulmuar rëndë nga kolera.

Në vitin 1912 ushtria malazeze ushtroi terror të paparë mbi raushiqasit.

Edhe Jugosllavia e Titos nuk e la këtë fshat pa e vërshuar me kolonë të rinj.

Studiuesi Demë Mulliqi tregon se nga ky fshat në vitet e pesëdhjeta familja e Sadik Gradinës ishte shpërngulur në Turqi, familja e Rexhë Gradinës në Shkup, kurse disa persona të tjerë të fshatit kishin ikur në Shqipëri.

Sipas të dhënave, në regjistrimin civil të vitit 1981, Raushiqi kishte 251 shtëpi me 2548 banorë, (2533 shqiptarë, 7 malazezë dhe 8 myslimanë)⁴.

Lufta e fundit dogji dhe shkatërroi gati të gjitha kullat, shtëpitë, shkollën objekti i së cilës ishte ndërtuar në vitin 1930, xhaminë e fshatit, objektet ekonomike etj., me një fjalë 90 % e fshatit u shkatërrua.

- 1) Mulliqi. D. Raushiqi mbi themelet e antikitetit (Monografi).2012. Art Club.Ulqin
- 2) Novaković. S. Zakonski spomenici srpskih drzava srednjega veka, Beograd, 1912.
- 3) Osmani. J. Vendbanimet e Kosovës (11). f. 203. Prishtinë. 2004.
- 4) Po aty, faq. 203.

8.2. FRASHNJETI (Kosuriqi)

Ky fshat bën pjesë në fshatrat e Lugut të Baranit, nga qendra e Pejës ka 22 km, i shtrirë në juglindje të tij. Shtëpitë ekzistuese në fushë janë afër njëra – tjetrës, kurse të tjerat janë rrëzë kodrës.

Sipas të dhënave fshati ka një sipërfaqe gjithsej prej 826 ha.

Në Kosuriq akoma mbizotëron rendi fisnor, ngase jetojnë disa fise si: Kelmendi (Hoxhaj, Sylaj, Shkreli, Rugova, Tigani, Pashiqët), Thaçi (Gërgoc, Panxhaj), Gashi (Maznikollët, Shllaku, Aliçkaj, Dezdarët, Tredhakët), Berisha (Stanojë, Deskaj, Dodaj, Danaj), Krasniqe (Nikaj, Gugaj), Shala (Tekajt), Shllaku (Gashi), Çekaj (Shala), Muhaxherët (Mërrnicët). Përveç shqiptarëve jetojnë edhe romët, familja malazeze Mushiq (deri në vitin 1999) dhe familjet boshnjake.

Në pjesën kodrinore afër fshatit, të quajtur Bregu, ekzistojnë varreza të moçme të krishtera, që dëshmojnë gurët me kryqa. Në anën e poshtme lindore të asaj kodre vërehen gjurmët – themelet e shtëpive.

Aty afër është ruajtur edhe mikrotoponimi – Lugu i Gjonit (mbas kodre).

Në këtë vendbanim familja më e vjetër është ajo Stanojet (fisi Berishë), që thuhet se dikur moti ishin të konfesionit ortodoks.

Kosuriqi përmendet në dokumentat e shekullit XIV. Mbreti Stefan Deçani më 1327 me një dokument merr vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet igumanit të Hilandarit dhe fshati Kosuriq në lidhje me mezhdat e pronave të Hilandarit në këto anë.

Më 1348 mbreti Dushan Nemanjiqi ia fal Qelisë së Kares, ndër të tjerat edhe fshatin Kosuriq me mahallët Nepole, Dolan (Glloxhan), Çeskovë, Çellopek. Pra, Kosuriqi duhet

të ketë qenë fshat me rëndësi, vendbanim qendror i kësaj zone. S'ka dyshim se ai duhet të ketë ekzistuar edhe shumë kohë para shekullit XIV, kur përmendet si vendbanim i rëndësishëm. Më vonë në defterin kadastral osman të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, me emrin Kosuriq, kishte 47 shtëpi, 12 beqarë e 2 të veja.

Me emrin Kosuriq është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893.

Në vitin 1962 në këtë vendbanim u vendos familja muhaxhere shqiptare Merrnica, e dëbuar nga Sanxhaku i Nishit, e cila deri në këtë vit kishte jetuar në fshatin Kastriot (Novosellë e Ulët) e komunës së Gjakovës. Këta vendosen në tokën e familjes Gashi e shpërngulur në Turqi.

Pushteti agrar, duke filluar nga viti 1920 e deri në vitin 1933, në pjesën e afërt e fshatit, në Lugun e Smailit dhe Lugun e Saricave, në pjesën lindore, kishte vendosur 49 familje kolone malazeze.

Në vitin 1955-56 nga ky vendbanim janë shpërngulur në Turqi rreth 10 familje shqiptare (Panxha, Gashi etj.), kryesisht në Izmir, por më vonë nga aty janë shpërngulur në Belgjikë. Familja e Beqëbajramëve është shpërngulur në Shkup.

Sipas regjistrimit serb të vitit 1991, në këtë vendbanim jetonin 8 banorë malazez. Banorët shqiptarë e kishin bojkotuar regjistrimin. Para agesionit serb në vitin 1998-99 fshati kishte rreth 150 familje me rreth 1400 banorë.

Regjimi serb gjatë luftës shkatërroi e rrënoi 70 shtëpi banimi dhe objekte të tjera, ndërsa janë të vrarë dhe masakruar 24 banorë të fshatit, të moshës 22-40 vjeçare, përveç tre pleqve më të vjetër se 80 vjeç. Në mesin e të vrarëve ishin 6 ushtarë të UÇK-së.

Shënimet janë marrë nga libri i dr. Jusuf Osmanit, vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, 2004, Prishtinë, faq. 118, 119, 120.

8.3. SIPARUNTI (Zahaqi)

Shtrihet në rrugën magjistrale Pejë – Prishtinë, në km. e 6-të dhe 7-të, në lindje të Pejës. Fshati është i shtrirë në një fushë me sipërfaqe prej 261 ha., me shtëpi të grumbulluar dhe me një kodrinë të vetme.

Supozohet se fshati është ndërtuar mbi gërmadhat e qytetit të lashtë ilir Siparunt, emër i cili është i gjallë edhe sot e kësaj dite. Fshati është i banuar nga fise të ndryshme. Përpos shqiptarëve, në fshat jetojnë edhe familje rome. Fshati është i ndarë në lagje në të cilat jetojnë këto familje: Gjemarifët, Sadriramët, Tahirukët, Kastrati, Kamerët, Bardhmehmetët, Nilajt (Bekëfazlitë – Rugovët, Rustemjahët e Bekteshajt), Nikçi, Lajçi, Hyseni, Toplana, Çerreti, Demaku dhe familje të tjera të ardhura nga viset e ndryshme, si dhe familjet serbe: Marjanoviq, Vratnica, Bojanic, Kazhiq etj., por dhe familjet rome Muçaj, Braha etj. Në fshat ekzistojnë lagjet, përveç katundit të vjetër, në kodër, ekzistonin Mahalla e Begut, Bashçja e Madhe dhe Fusha e Sirme. Kjo e fundit është popullzuar në 30 – 40 vjetët e fundit.

Është vendbanim i vjetër antik i periudhës romake në të cilën ka jetuar popullata vendëse ilire-dardane. Këtu është gjetur një pitos (qyp) i madh romak dhe kanë ekzistuar varrezat të vjetra. Te Fusha e Epërme, te Kuçishta e Ramë Begut, tani Rrahishta, janë gjetur themele të shtëpive. Aty ku janë varrezat e sotme serbe ka ekzistuar një kishë e vjetër katolike. Thuhet se tërë lokaliteti prej Zahaqi e deri të Burimi i Drinit të Bardhë ka qenë i banuar dhe macja ka mundur të ecë nëpër kulme.

Në dokumentet e shkruara përmendet si vendbanim i bletarëve dhe vajlarëve në Bistricë, në kartën e mbretit Milutin të vitit 1318, të Manastirit të Hilandarit me emrin Zahak. Gjithashtu Car Dushani në vitin 1348 ia jep këtë vendbanim Hilandarit.

Në Defterin kadastral osman të Sanxhakut të Shkodrës ishin të regjistruar 5 shtëpi, 1 e ve e 1 mysliman.

Përmendet në një hartë austriake të vitit 1689 me emrin Suhaq dhe pastaj në regjistrin e Manasirit të Deviçit në vitin 1770 dhe 1780.

Sipas thënies së popullit këtë vendbanim si dhe disa të tjera i kishte faruar kolera. Kështu që një kohë ky vendbanim sikurse edhe disa të tjerë ishte i braktisur.

Me këtë emër është i regjistruar si vendbanim në një hartë osmane të fundit të shek. XIX dhe në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893.

Gjatë së kaluarës historike ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë. Beglerët i ndërronin çipçinjët nga vendet e ndryshme. Gjatë kohës së Mbretërisë jugosllave në këtë vendbanim u kolonizuan 14 familje kolone malazeze. Disa familje shqiptare u shpërngulën në Shqipëri.

Shënimet statistikore: Në fund të shek. XIX kishte 40 deri 50 shtëpi shqiptare; në vitin 1971 – 99 shtëpi me 782 banorë (678 banorë; 23 serbë, 66 malazez, 15 të tjerë); në vitin 1981 – 141 shtëpi me 1148 banorë (1031 shqiptarë, 19 serbë, 56 malazez, 42 të tjerë).

Para agresionit serb fshati kishte 152 shtëpi (pa e llogaritur lagjen Bahçja e Madhe, e cila në vitin 1981 ishte në kuadrin e këtij vendbanimi, tani llogaritet lagje e fshatit Nakëll), me 850 banorë shqiptarë dhe 6 familje serbe e malazeze.

Gjatë ofensivave serbe në vitin 1999 u vranë e u masakruan 27 banorë shqiptarë (1 dëshmor, 2 fëmijë, të tjetër gra, burra e pleq) dhe një banor rom i pushkatuar, shumica në oborret e shtëpive të tyre. Nga ky numër 18 persona janë të humbur. Janë rrënuar 42 shtëpi banimi dhe shumë objekte të tjera përcjellëse. Popullata ka qëndruar në fshat.

Pjesa më e madhe e të dhënave janë marrë nga libri i dr. Jusuf Osmanit, vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, 2004, Prishtinë, faq. 208, 209.

8.4. NABERGJANI (Kelmendi)

Fshati Nabexhan (Kelmend), shtrihet në lindje të Pejës , 8 km nga qendra e tij. Ka gjithsej katër lagje, njëra prej të cilave është e shpërndarë, kurse të tjerat janë të grumbulluara, kryesisht përgjatë rrugës Pejë – Trestenik, rreth 4 km., me gjithsej 437 ha sipërfaqe.

Lagjet: Fshati i Vjetër, Kodra e Ukut, Mahalla e Nushit, Mahalla përtej Drumit.

Edhe në këtë fshat janë zbuluar varreza të vjetra që sipas hulumtuesve i takojnë kohës së mesjetës. Mbeturina të varrezave dhe disa toponime dëshmojnë vjetërsinë e fshatit, si p.sh.: Vorrezat e spahijve (me kryqa), Vorrezat Ilire, Fusha e Gjionit, Fshati i Vjetër, Mahalla e Nushit, Mahalla përtej Drumit etj.

Në dokumentet e shkruara me emrin Nobonani, përmendet në Defterin kadastral osman të Sanxhakut të Shkodrës në Kazanë e Pejës, të vitit 1485, me 12 shtëpi, 3 beqarë e 1 e ve.

Në defterin tjetër të Sanxhakut të Shkodrës, të vitit 1582, me emrin Nabërxhan, kishte 14 shtëpi, 3 beqarë dhe 6 bashtina. Më vonë përmendet ky vendbanim në regjistrin e manastirit të Deviçit në vitin 1761, 1763 dhe 1789.

Si duket, një kohë fshati ka qenë i pabanuar, kryesisht i pyllëzuar me lisa të rrallë, që me të ardhur të banorëve të rinj, kryesisht nga bjeshkët e Rugovës, të cilët kishin filluar që t'a përshtasin për tokë pune dhe vendbanim. Flitet për një fushë të quajtur "Fusha e Gjonit".

Sipas shënimeve historiografike, prej vitit 1800 e deri në vitin 1875, qarqet ushtarake dhe qeveritare serbe i larguan nga trevat e Sanxhankut të Nishit dhe nga Lugina e Moravës, siç thotë aty, rreth 150.000 banorë shqiptarë, (Të dhënat nga Stefan L. Popoviq-Putovanje po Novoj Serbiji. Beograd, 1950), gjë pas kësaj tragjedie edhe në këtë fshat ka pasur të ardhur të cilët ishin vendosur në lagjen e Mahallës së Nushit.

Me emrin Nabërxhan është regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896.

Në këtë vendbanim janë vendosur edhe 3 familje serbe të quajtura "rajë". Ndërsa, në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në këtë vendbanim, me qëllim të ndërrimit të strukturës nacionale të popullsisë, u kolonizuan 4 familje kolone malazeze. (5)

Nga ky vendbanim për në Turqi janë shpërngulur: në vitin 1956 tri shtëpi, në vitin 1963 tri shtëpi, në Shqipëri – në vitin 1956 dy shtëpi. Më vonë në vitin 1990 të shpërngulur ka 10 shtëpi në ShBA etj.

Në vazhdimësi ky fshat është populluar kryesisht nga banorë të ardhur nga fshatrat e Plavës, Rugovës dhe Peshterit etj.

Ky vendbanim është shkatërruar e djegur gjatë të kaluarës historike nga pushtuesit malazias e serbë, si në vitin 1912, 1918 dhe 1944. Në katundin Nabërxhan, me datën 20.V.1922, janë vrarë 8 persona dhe janë grabitur shumë bagëti të imëta e të trasha 15.000 copë, 200 shtëpi me grurë, misër, rrobe etj.

Sipas shënimeve statistikore rreth vitit 1905 ky fshat kishte kishte 5 shtëpi shqiptare e 3 serbe; në vitin 1912 – 40 shtëpi, ndërsa, në vitin 1918 – 9 familje shqiptare me 88 banorë; sipas regjistrimit të vitit 1981 fshati kishte gjithsej 161 shtëpi me 1811 banorë (1743 shqiptarë, 68 serbë).

Para agresionit ser btë vitit 1998 – 99 fshati ka pasur 279 shtëpi shqiptare, 19 shtëpi serbe, 10 shtëpi ashaklinj dhe 4 shtëpi boshnjake.

Me 1 dhe 3 maj 1999 forcat ushtarake e policore kanë djegur gati gjithë fshatin, pra 250 shtëpi, kurse në qershor të vitit 1999 janë djegur edhe 19 shtëpi të serbëve. Prej datës 1 maj e deri me 17 maj 1999 janë vrarë 31 veta. Pas lufte fshati është rindërtuar dhe sot ka infrastrukturë të shkëlqyer.

Pjesa më e madhe e të dhënave janë marrë nga libri i dr. Jusuf Osmanit, vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, 2004, Prishtinë, faq. 135, 136, 137.

KREU I NËNTË

9. PËRMBLEDHJE

9.1. Motivimi dhe Objektivat

Gjatë studimeve kemi pasur rastin të ndjekim ligjërata cilësore nga profesorët e fushës profesionale në ligjëratat e ciklit të tretë të shkollës doktorale në **UEJL**, në Tetovë, **Fakulteti i Kulturave, Gjuhëve dhe Komunikimit**, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Si rrjedhojë jemi të nxitur me dëshirë dhe motiv për studim dhe hartim të projekteve nga fusha e dijeve të reja gjuhësore, gjithmonë duke pasur si objektive zbatimin e këtyre dijeve në segmente të ndryshme të jetës. Në këtë rrjedhë logjike është përzgjedhur për t'u trajtuar disiplina e re gjuhësore deri me tani, e po ashtu edhe tema: **”Socioonomastika e Pejës me rrethinë”**.

Mungesa e njohurive të mjaftueshme për këtë dije është një nga arsyet që kjo shkencë nuk është mësuar, trajtuar dhe hulumtuar deri në ditët e sotme dhe si rrjedhojë, deri më tani nuk ka pasur interesim të duhur për hulumtimin dhe zhvillimin e kësaj shkence në filologjinë shqiptare, andaj përmes lëndës së trajtuar do të dëshmojmë se socioonomastika është e rëndësishme së veçantë dijesh heterogjene.

Motivim, po ashtu kanë qenë pikëpamjet e shkollave më të njohura gjuhësore dhe të autorëve të shquar të gjuhësisë së përgjithshme për nocionin socioonomastikë, si koncept

fundamental i hulumtimit dhe mëtimit të aplikimit të aspekteve të reja teorike dhe praktike të gjuhësisë.

Rëndësi e veçante e kësaj qasjeje do të jetë prezantimi i faktorëve shtytës të kjo dije në sferën e motivimit emërvënës dhe hapësirat e mundshme të hulumtimeve socioonomastike.

9.2. Rezultatet e pritura

Rezultati i përfundimit të kësaj teme nuk është i njëvlershëm dhe i mjaftueshëm me përfundimin e studimeve të doktoratës në rrafshin personal, por kontribut konkret për të dëshmuar se me socioonomastikën mund të shkojmë tutje, duke parë atë si një disiplinë të aplikuar filologjike, duke i dhënë vend të veçantë në sajë të interesit të përgjithshëm për përmbajtjen dhe trajtimin e gjerë të saj në dritën sociale.

Me përfundimin e kësaj teme, përmes sociopikëpamjeve do të ravijëzojmë praktikën brenda shoqërive të caktuara, gjithashtu do të vëmë në pah shqyrtimin se si gjuha dhe shoqëria kanë ndërvepruar në të kaluarën.

Përmes hulumtimit, analizës dhe shqyrtimit socioonomastik, do të paraqesim anët sociale më të ndërlikuara të kohës të të gjitha dijeve si dhe hedhjen dritë në shqyrtime dhe gjurmime shkencore përmes kënvështrimeve socioonomastike antroponimike e toponimike, si paraqitje shoqërore, me theks të veçantë origjinën dhe kuptimet e emrave nga këndvështrimi social dhe ndikimin e raportin e tyre shtytës në rrethana të caktuara shoqërore.

Pretendoj që të sjellë rezultate konkrete që do të shërbejnë si pikënisje për gjeneratat e reja.

9.3. Hipoteza gjenerale

Sqarimi dhe hedhja dritë mbi socioonomastikën me onomastikën në thelb, si një ndër çështjet e pastudiuara sa duhet në gjuhësinë shqiptare dhe më gjerë, përmes dëshmive të

përfundohet se antroponimia, toponimia dhe patronimia janë epistemologjia dhe aksiologjia e Pejës me rrethinë, gjë e cila argumentohet përmes veçorive natyrore, etnografike, historike, autoktone, mjeshtërore, kulturore, arsimore etj. dhe se pjesa dërrmuese e emërtimeve pejane kanë bazë të gjuhës shqipe.

9.4. Hipotezat e ngritura

Hipoteza 1:

Vazhdimi i të arriturave të shkollave më të njohura gjuhësore dhe të autorëve të shquar të gjuhësisë së përgjithshme për nocionin socioonomastikë, si koncept fundamental i hulumtimit dhe mëtimit të aplikimit të aspekteve të reja teorike dhe praktike të gjuhësisë.

Hipoteza 2:

Hetimi i faktorëve shtytës në sferën e motivimit emërvënës antroponimik, toponimik e patronimik në hapësirat e mundshme të hulumtimeve socioonomastike dhe i emërvendeve të dukshme të kulturës materiale.

Hipoteza 3:

Pohimi se në Pejë, para myslimanizmit jetonte popullata e besimit të krishterë, përmes dëshmive toponimike, po ashtu shkon të të mirë të interesave gjithëkombëtare, pasi që në përgjithësi ka mungesë të njohurive dhe të ekspertizës shkencore në këtë lloj qasjeje.

Hipoteza 4:

Shqyrtimi sociotoponimik në terren dhe ndriçimi e përpjekjeve qëllimkëqija të historiografisë së huaj për periudha të caktuara gjoja për autoktoninë e banorëve sllavë në qytetin e Pejës dhe gati në të gjitha fshatrat e saja.

Hipoteza 5:

Ndikimi i faktorëve politikë dhe fetarë në njëërën anë si dhe gjuha në kontakt në anën tjetër shekuj me radhë dëmtuan onomastikën dhe socioonomastikën tonë.

9.5. Variablat e hulumtimit

H0 Shkathhtësia hulumtuese është faktor ndikues në suksesin e shenjëzimit toponimik.

9.6. Hipotezat e ndihmëse

- H1 Shkathhtësia e parashikimit ndikon në suksesin e përcaktimit të vendit;
- H2 Shkathhtësia e komunikimit ndikon në suksesin e grumbullimit të materialit;
- H3 Shkathhtësia e iniciativës ndikon në suksesin e arritjeve të reja;
- H4 Shkathhtësia e retorikës ndikon në suksesin e gjetjeve sa më të shumta në terren;
- H5 Shkathhtësia e analizës ndikon në suksesin e klasifikimit dhe përfundimeve shkencore;
- H6 Shkathhtësia e përshtatjes në rrethanat e reja ndikon në rezultatet e pritura.

9.7. TRAJTIMI SOCIOONOMASTIK

Për të trajtuar socioonomastikën toponimike në dritën sociale, brenda kufirit socioonomastik, pas përdorimit të literaturës në dispozicion, vendore dhe të huaj, punës në terren si dhe burimeve të tjera me vlera të caktuara, vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar toponimisë së grupeve të ndryshme sociale, emërvendeve të kompetencave (*njohurive dhe përdorimit të toponimeve*), ndryshueshmërisë së toponimeve jo të standardizuara, toponimeve zhargon, toponimeve shoqërore të kushtëzuara dhe riemërtimit të lirë toponimik të peizazhit gjuhësor (*realizuar përmes intervistës anketuese*), bazuar edhe në aspektet gjuhësore dhe ndërdisiplinare, gjithnjë përmes analizës sociale nga perspektiva e onomastikës funksionale.

Përdorimi socioonomastik i toponimeve është shumë i ndjeshëm dhe njëkohësisht edhe përkufizimi i tij është i vështirë, sidomos në mungesë të të dhënave të shkruara, por, në përgjithësi mund të thuhet se puna sociotoponimike është më e përqendruar në emrat e grupeve të ndryshme sociale, për çka edhe jemi përcaktuar për të bërë një hulumtim në disa zona të caktuara.

Në përputhje me fokusin e këtij hulumtimi, përmes pyetësorit social, vëmendje të veçantë i kemi kushtuar kërkimit të njohurive të emërvendeve dhe përdorimit të tyre në lokalitetet ku jemi përqendruar. Sipas të dhënave që kemi hasur, një hulumtim i tillë është bërë gjatë viteve të 60-ta dhe të 70-ta në Hungari dhe Finlandë. Tashmë, së fundi, në ditët e sotme, kjo çështje ka filluar të merr hov dhe ka tërhequr më shumë vëmendjen e studiuesve nga vendet e tjera (Bullgaria, Republika Çeke, Zvicra, Italia, Skocia, Sllovakia, Gjermania, Amerika, Finlanda, ShBA-të etj).

9.8. Hulumtimi

Kjo pjesë e punimit të temës së disertacionit paraqet objektivat, metodat dhe rrjedhën e hulumtimit. Vëmendje gjithashtu i kushtohet sqarimit të përzgjedhjes së vendeve në të cilat është kryer hulumtimi. Po ashtu, përshkruan pjesën cilësore dhe sasiore të hulumtimit, pastaj, një sasi e konsiderueshme e hapësirës i kushtohet përshkrimit të përbërjes së pyetësorit social. Në pjesën e fundit kemi të bëjmë me metodat e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë futjen e testeve të përdorura për testimin e hipotezave statistikore (test Wilcoxon dhe test Kruskal-Wallis) dhe rezultatet përfundimtare.

9.8.1. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ishte analiza sociale e ekzistencës së emrave lokalë, emërvendeve, në vendet e caktuara, në fshatrat: Raushiq, Kosuriq, Zahaq dhe Nabergjan, fshatra këto të nga rrethi i Pejës, të përzgjedhura për hulumtim dhe fshatin Shkrel nga krahina e Rugovës, si dhe mëtimi për të hetuar lidhshmërinë e tyre me hapësirën, *(të gjitha toponimet)* dhe përdorimin e tyre nga banorët e zonave përkatëse, shtrirja e të cilëve varet edhe nga marrëdhëniet ndërmjet banorit dhe shfrytëzuesit.

Nga këndvështrimi ynë socioonomastik, del në pah se përdorimi i toponomisë tregon karakterin, marrëdhënien e dikujt me hapësirën *(njohuritë për hapësirat e caktuara të fshatit ku jeton, lidhjet e tyre emocionale me hapësirat e caktuara)* dhe marrëdhënien e dikujt me emrat lokalë *(mendimet për vendosjen e emrave ekzistues)*, bie fjala ndikimi i llojeve të ndryshme të hapësirës *(lokacioni turistik, parku kombëtar, etj.)*.

Në këtë kontekst përmes hulumtimit sadopak kemi arritur të ndjekim nga afër marrëdhëniet e mëposhtme:

Efektin e karakteristikave *sociale, ideologjike, emocionale* dhe të tjera të banorëve rreth njohurive dhe përdorimit të toponimeve në fshatin ku jetojnë si dhe ndikimet *ekonomike, sociale, historike dhe demografike* në njohuritë që kanë rreth përdorimit të tyre në vendin ku jetojnë.

9.8.2. Metodatat e hulumtimit

Kjo tezë doktrate është duke u bazuar në kërkime dhe hulumtime. Fillimisht janë paraqitur të dhënat teorike të mbledhura nga hulumtimet shkencore. Të dhënat shitesë janë mbledhur nga intervistat të cilat janë burim primar i informacionit, duke u bazuar në hulumtim sasior (*kuantitativ*) dhe cilësor (*kualitativ*).

Puna për parapërgatitjen e temës filloi që nga herrja e materialeve ku shtrohej problemi në planin teorik, parimor dhe metodik, më konkretisht punimi është i bazuar në të dhëna të klasifikuara dhe në të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore (*primare*) përbëhen nga librat që përfshijnë si temë socioonomastikën, kurse ato dytësore (*sekondare*) nga artikujt shkencorë nga kjo fushë si dhe të dhënat nga interneti etj.

Pra, përveç trajtimeve hyrëse teorike – shkencore mbi rolin dhe rëndësinë që ka koncepti i toponimisë sosioonomastike, pjesa më e madhe e punimit do të hulumtojë njohuritë socioonomastike të popullatës në një hapësirë të caktuar. Për nevojat e përgatitjes së këtij punimi, duke u bazuar në problemet e hulumtimit, janë realizuar kërkimet mbi të cilat janë përdorur kombinime të ndryshme të metodave shkencore për qëllimet e diskutimit dhe vlerësimit të hipotezave të caktuara.

Ky studim empirik është kryer përmes një studimi të strukturuar.

Në bazë të anketimit kemi arritur deri te grumbullimi i të dhënave të cilat janë analizuar dhe nga këto rezultate kemi nxjerrur konkluzionet dhe rekomandimet në lidhje me njohjen sociale toponimike nga banorët e disa fshatrave të përzgjedhura të Pejës.

Në përzgjedhjen e metodologjisë së hulumtimit kemi zgjedhur një kombinim të metodave cilësore dhe sasiore në lidhje me objektivat e përcaktuara.

Në këtë studim, metodat më të rëndësishme janë:

- **Metoda cilësore (kualitative)** - (grumbullimi i të dhëna lidhur me temën nga publikime shkencore, raste studimi, libra dhe dokumente të ndryshme fizike dhe virtuale;
- **Metoda e vëzhgimit** (grumbullimi i të dhënave dhe informacioneve në lidhje me studimet socioonomastike toponimike);
- **Metoda e induksionit** (konkluzionet dhe vërtetimi i teorisë ekzistuese për njohuritë sociotoponimike;

- **Metodat e vrojtimit** (identifikimi i toponimeve dhe vrojtimi i përdorimit dhe ndikimit të tyre në mjedisin e caktuar. Gjatë hulumtimit do të përdoren metoda e intervistimit dhe anketimit me banorë të moshave të ndryshme, gjinisë, arsimit etj.,
- **Metoda statistikore** (matja e njohurive mbi toponiminë dhe testimi i i variablave kërkimore të punimit në bazë të përmbajtjes);
- **Metoda e krahasimit** (që ka të bëjë me krahasimin e rezultateve të pyetjeve, të cilat ndikojnë në përcaktimin e njohjes toponimike në dritën sociale);

Në fazën e parë të hulumtimit arritëm të mbledhim toponime jo të standardizuara (të gjalla) në lokalitete të caktuara, duke përdorur intervista të menaxhuara. Toponimet e drejtpërdrejta të zgjedhura në mënyrë të rastësishme u përdorën pastaj për të ndërtuar një pyetësor të fokusuar në mënyrë *socio-autonome*. Më pas, kemi kryer një sondazh pyetësor në vendet e përcaktuara. Të dhënat që kemi marrë janë përpunuar dhe vlerësuar statistikisht në lidhje me objektivat e kërkuara të hulumtimit.

Gjatë hulumtimit, fillimisht kemi zgjedhur disa fshatra në Rrafshin e Dukagjinit dhe në krahinën e Rugovës si : Raushqin, Kosuriqin, Naberxhanin, Zahaqin dhe Shkrelin
Hulumtimi cilësor - mbledhja e toponimeve të gjalla, pastaj është kryer sondazhi social i pyetësorit pasues duke trajtuar veç e veç specifikat shoqërore të akcilit vend të trajtuar.
Pas përfundimit, pyetësorët janë vlerësuar dhe janë përfshirë në rezultatet e përmbledhura.


9.9. Grumbullimi i toponimeve të gjalla në vende të caktuara

Me një punë shumëvjeçare, gati prej dy dekadash, përmes punës individuale në terren dhe përmes informatorëve, kam bërë mbledhjen e shumë toponimeve të gjalla. Po ashtu përmes anketës së bërë, përmes intervistave të kontrolluara me 40 informatorë, kam bërë mbledhjen e shumë toponimeve të tilla. Informatorët ishin përfaqësues të gjeneratave të mesme dhe të vjetra, persona të cilët janë përzgjedhur në bazë të rekomandimeve shoqërore dhe njohurive të të njëjtëve për fushën e studimit tonë, pra,

njerëz me njohuri të mira për vendin (fshatin) të cilit i referohen. Një listë e plotë e toponimeve të mbledhura jepet në këtë punim te fjalori toponimik.

9.10. Sondazhi socioonomastik i pyetësorit (analiza e të gjeturave)

Sondazhi socioonomastik është kryer prej nëntorit 2017 deri në tetor 2018. Në total ne kemi mbledhur 250 pyetësorë për 5 lokalitete të trajtuara, nga 50 sish për secilin fshat.



Diagrami 1. Lokalitet e të intervistuarve dhe numri i tyre.

Në hulumtim janë përfshirë fshatrat: Shkrel, Raushiq, Kosuriq, Zahaq dhe Naberxhan. Fshati Kosuriq dhe Naberxhan pas luftës së fundit në Kosovë janë riemërtuar, por sipas statistikave dhe intervistave me banorët lokalë, këto emërtime nuk kanë mbijetuar, madje shumica e banorëve as që i kanë dëgjuar e as që i dinë.

Avdyl Sadrija, 86- vjeçar nga fshati Kosuriq, i ka ditur pothuajse të gjitha mikrotoponimet e fshatit të tij, Kosuriqit, por ai as që kishte dëgjuar për emrin e ri të fshatit të tij *Frashnjetin*. Mikrotoponimet e vjetra Siparunt dhe Rauzë, për fshtin Zahaq dhe Raushiq, në përgjithësi janë të njohura për banorët lokalë.

	FSHATRAT E PËRFSHIRA NË HULUMTIM	
--	---	--

Gj i n i a	Shkrel	Raushiq <i>Rauza</i>	Kosuriq <i>Frashnjët</i>	Zahaq <i>Siparunt</i>	Naberxhan <i>Kelmend</i>	T o t a l
Meshkuj	34	32	26	22	29	143
Femra	16	18	24	28	21	107
<u>Total</u>	<u>50</u>	<u>50</u>	<u>50</u>	<u>50</u>	<u>50</u>	<u>250</u>

Tabela nr. 1 Raporti ndërmjet pozitës dhe gjinisë së të të anketuarve (respondentëve), si dhe fshatrat e trajtuara.

Pjesa e parë përmbante një listë toponimesh të përzgjedhura rastësisht nga kërkimet tona, (toponime të cilat ishin të ndryshme për secilin fshat) dhe për të cilat dëshironim të verifikonim përdorimin e tyre.

Shembulli 1

1. Arat e Mullnit 0 1 2 3
2. Arat e Eperme 0 1 2 3
3. Bahçja e Pangj'Ve 0 1 2 3
4. Brigjet e Medoshit 0 1 2 3
5. Baret 0 1 2 3
6. Bunari i Vokshjanve 0 1 2 3
7. Dallama 0 1 2 3
8. Dardhat e Guxh'Ve 0 1 2 3
9. Drezgat 0 1 2 3
10. Drumi i Qekve 0 1 2 3

Pjesa e dytë përfshinte pyetje rreth karakteristikave sociologjike, mendimit, anës emocionale të të intervistuarit, njohuritë për toponiminë dhe lidhjen e tij me hapësirën.

Shembulli 2

2. Cila është mosha juaj?

- a) 6-11 b) 12-15 c) 16-20 d) 21- 30 e) 31 deri 40 f) 41-60 g) 61 ose më shumë vjet

3. Cili është arsimimi juaj?

- a) Nuk kam përgatitje shkollore b) shkolla fillore c) shkolla e mesme
d) fakultet e) master f) doktoratë

Me këtë pjesë u synua gjetjet e përbashkëta sociologjike, karakteristikat, mendimet, qëndrimet dhe ndjenjat e të anketuarve, duke përdorur variabla të zakonshme sociologjike (gjinia, mosha, arsimi) etj.

Pjesa e tretë kërkonte nga të anketuarit që vet të emërtonin vendet e caktuara me toponime të reja, si pjesë të peizazhit, duke plotësuar secilën pamje në fotografinë e dhënë të fshatit përkatës, duke pasur kështu parasysh orientimin gjuhësor, kulturor, emocional, historik, patriotik etj., si vlera të mirëfillta kombëtare.

Shembulli 3

Dhe së fundmi një punë krijuese. Hidhni një sy në skicën e peizazhit dhe përpikuni që përmes imagjinatës të shpikni emrin për çdo objekt. Ju mund t'i emërtoni në çfarëdo mënyre, varësisht prej jush dhe intuitës tuaj. Nëse do t'i emërtoni disa vende, do të jem i lumtur të përshkruaj se çfarë ishte frymëzimi Juaj.

Ka qenë me interes shembulli i përcaktimit të toponimisë, i detajuar, nga David Macha i cili ka publikuar emrat e vendeve – sipas kujtesës, identitetit dhe trashëgimisë kulturore.

Toponimet e grumbulluara për secilin vend janë renditur në mënyrë alfabetike.

Informatorët janë përzgjedhur nga të gjitha grupmoshat dhe me përgatitje të ndryshme shkollore.

Modeli i pyetësorit është dhënë në shtojcën e kësaj teze të doktotes.

Ne jemi përpjekur që të vlerësojmë sa më mirë të anketuarit, kështu që gjatë analizimit statistikor kemi përdorur shkallën e mëposhtme:

0 Nuk i kam dëgjuar

1 I kam dëgjuar, pjesërisht.

2 I kam dëgjuar, por nuk e di se saktësisht se çfarë vendi i referohet.


3 I kam dëgjuar dhe e di se çfarë përshkruajnë, madje edhe vet i zbatoj në komunikim.

9.11. Përpunimi i të dhënave

Ne kemi grumbulluar të gjithë pyetëtorët, janë numëruar, janë krahasuar, janë vlerësuar me pikë, pastaj kemi klasifikuar të dhënat dhe kemi nxjerrë përfundimet në total. Kemi shënuar të gjitha përgjigjet e ngjashme, duke i vlerësuar me pikë dhe duke nxjerrë përfundimet, p.sh. sa është në dijeni për përdorimin e toponimeve të dhëna, (*pjesa e parë e pyetësorit*).

Ne kemi përdorur dy lloje të testeve për të llogaritur vlerën p: testin Wilcoxon dhe testin Kruskal-Wallis.

Rezultaet e pjesës së parë të numëruara, të krahasuara dhe të vlerësuara



Diagrami nr. 2. Numri dhe gjinia e të intervistuarve.


	0 Nuk i kam dëgjuar	1 I kam dëgjuar pjesërisht	2 I kam dëgjuar, por nuk e di se saktësisht se cilit vend i referohen	3 I kam dëgjuar dhe e di se çfarë përshkruajnë, madje edhe vet i përdor në komunikim
F	14.95 %	13.08 %	29.90 %	42.05 %
M	8.39 %	7.69 %	30.06 %	53.84 %

Tabela nr. 2. Rezultatet përfundimtare sipas numrit dhe gjinisë.

9.12. Ndikimi i variablave sociologjike në kompetencën toponimike

9.12.1. Gjinia

Karakteristika e parë sociologjike që kemi marrë në konsideratë në lidhje me njohuritë dhe përdorimin e toponimisë së gjallë, ishte gjinia e të anketuarit. Të dhënat që rezultojnë treguan se meshkujt kanë rezultate më të mira në këtë drejtim sesa femrat.




Diagrami nr. 3. Numri dhe gjinia e të intervistuarve.

Pas shqyrtimit të gjetjeve dhe përpunimit të pyetësorëve kemi ardhur në këto të dhëna përfundimtare statistikore:

Në anketë janë intervistuar 250 persona: 143 meshkuj (57.2 %) dhe 107 femra (42.8 %).

9.12.2. Moshë

Një aspekt tjetër që ne kemi trajtuar në lidhje me kompetencën toponomastike ishte moshë e respondentit. Në anketë kemi përfshirë të gjitha grupmoshat. Rezultatet më të mira në anketuarve janë treguar mbi moshën 60 vjeçare.



Diagrami nr. 4. Mosha e të intervistuarve.


Sa i përket moshës janë përfshirë të gjitha grupmoshat të cilat pas trajtimit dolën këto të dhëna statistikore:

Mosha e të intervistuarve						
a) 6-11	b) 12-15	c) 16-20	d) 21- 30	e) 31 deri 40	f)41-60	g) 61 e më shumë
Femrat						
8. 39 %	16.08 %	13.28 %	11.18 %	18.88 %	17.48%	14.68 %
Meshkujt						
8.41 %	16.8 %	14.0 %	14.0 %	15.8 %	16.8 %	14.0 %

Tabela 3. Rezultatet statistikore sipas moshës së të intervistuarve.

9.12.3. Arsimi

Një pyetje tjetër që ne trajtuam në hulumtimin tonë ishte edukimi i të anketuarve. Në këtë rast tek te anketuarit me arsimim të lartë rezultatet e njojeve toponimike ishin më të larta për gjeneratat e njëjta, kurse në raport me më të moshaurit, të cilët e kanë kaluar gjithë jetën në fshat dhe kanë qenë aktiv në jetën e fshatit, rezultatet e njohurive sipas anketës janë më të vogla, gjë që na bën të supozojmë se njohja dhe përdorimi i toponimisë nuk ka të bëjë me arsimin.



Diagrami nr. 5. Përgatitja arsimore e të intervistuarve

Rezultatet e të dhënave statistikore për përgatitjen shkollore rezultoi se femrat e intervistuar kishin në përqindje më të mirë të shkollimit.


	a) Nuk kam përgatitje shkollore	b) shkolla fillore	c)shkolla e mesme
Femra	0 %	5.6 %	28.9 %
Meshkuj	0 %	5.59 %	27.2 %
	d) fakultet	e) master	f) doctorate
Femra	35.5 %	6.54 %	0 %
Meshkuj	29.3 %	5.59 %	1.39 %

Tabela 4. Rezultatet statistikore për përgatitjen shkollore sipas përqindjes.

9.13. Ndikimi i lidhjes me lokalitetin në kompetencën toponimike

Një aspekt i rëndësishëm që pasqyron njohjen dhe përdorimin e toponimisë së gjallë është marrëdhënia e popullatës me hapësirën në fjalë. Kjo marrëdhënie kushtëzohet jo vetëm

nga koha e kaluar nga banorët në zonën e caktuar (gjatësia e qëndrimit në lokalitet), por edhe nga rrethanat në të cilat ndodhi qëndrimi. Të rriturit kanë karakter të ndryshëm nga kombinimi i hapësirës me përvojën e fëmijërisë, një marrëdhënie tjetër me hapësirën është edhe atëherë kur një individ e viziton fshatin vetëm për rekreacion ose për arsye pune herë pas here. Në lidhje me toponimin vendor, gjithashtu manifestohet edhe aktiviteti i banorit në zonën përkatëse - nëse lëviz rreth ambientit të tij, nëse është aktivisht i përfshirë në ngjarjet e komunitetit etj.



Diagrami nr. 6. Ndikimi i lidhjes me lokalitetin, interesimi për fshatin.

Pas llogaritjeve të dhënave statistikore dolën si në vijim:

	a) Janë të interesuar	b) Janë, por jo aktivë	c) Nuk janë të interesuar	d) Të tjera
F	46. 72 %	42. 99 %	10. 28 %	X
M		69. 23 %	32. 16 %	X


Tabela nr. 5. Rezultatet statistikore për ndikimin e lidhjes me lokalitetin.

9.13.1. Kohëzgjatja dhe gjatësia e qëndrimit në fshat

Njohje të mirë të toponimive kanë treguar të anketuarit të cilën në fshat kanë jetuar për më shumë se 40 vjet. Kohëzgjatja e qëndrimit në mes 4-10 dhe 11-20 vjet në lidhje me kompetencën e emrave të vendeve nuk ka treguar një ndryshim të rëndësishëm statistikor (njohurive në mesin e grupit të dytë të të anketuarve, ne mund të themi se dallimet në njohjen e toponimive janë të përafërta.

Grupi i të anketuarve që banojnë në fshat për një kohë shumë shumë të shkurtër tregojnë rezultat më të ulët. Ky devijim mund të shkaktohet nga një përfaqësim i pabarabartë i të anketuarve. Njohuritë mesatare rreth toponimeve dhe përdorimit të tyre tek të anketuarit është konstatuar të gjithë ata të cilët kanë jetuar, banuar në më pak se tre vjet, për çka mendojmë se arritja e shkallës së duhur të kompetencave të emrave të vendeve, varet nga gjatësia e qëndrimit dhe se e njëjta duhet të përfshijë afatin kohor të jetesës në fshat për më shumë se një dekadë.

Megjithatë, në studimet e variacionit diakronik në emrat e vendeve është vënë re se një pjesë e mirë e emrave të vendeve në fshatrat rurale, pas industrializimit të fshatrave, sidomos fshtart më të afërta me qytetin, Pejën, në një kohë relativisht të shkurtër gradualisht janë duke u zhdukur, për faktin e ndryshimeve në vet fshat.



Diagrami nr. 7. Kohëzgjatja e qëndrimit dhe interesimi për fshatin.

Pas shqytrimit të rezultateve dhe zbërthimeve matematikore vërejtëm se meshkujt kanë qëndrim më të madh në fshat sesa femrat, prandaj mendojmë se përpos emigrimit,


kushteve ekonomike, studimeve etj., një gjë e tillë ndodh edhe për faktin e lidhjeve martesore.

	a) Më pak se 3 vite	b) 4 - 10 vite	c) 11 - 20 vite	d) 20 - 40 vite	e) 41 vj. e lart
F	15.88 %	21.49 %	18.69 %	11.21 %	26.16 %
M	24.47 %	27.27 %	20.27 %	10.48 %	22.37 %

Tabela nr. 6. Rezultatet statistikore sipas kohëzgjatjes së qëndrimit në fshat.

9.13.2. Krenaria e karakterit të fshatit

Po ashtu, trajtimi i pyetjes rreth anës emocionale të të anketuarve rreth karakterit të fshatit, në të gjitha fshatrat ka treguar shkallë të lartë mburrjeje dhe krenarie, që mendojmë se ka treguar ndikimi pozitiv në marrëdhëniet e popullsisë me toponimin, sidomos në çështjet e trajtimit të patriotizmit akcili sish ndihej krenar për të bëmat e fshatit N.N. në atë zonë dhe mendojmë se kjo ka ndikuar në njohjen e kompetencës për emërvendet e kësaj natyre.



Diagrami nr. 8. Krenaria për karakterin e fshatit.


9.13.3. Lloji i qëndrimit

Qëndrimi reflektohet në kompetencën toponimike me të njëjtën masë si kohëzgjatja e qëndrimit në lokalitet. Supozojmë se një marrëdhënie më e thellë emocionale në një vend, e kombinuar me një njohuri më të mirë, do të thotë kompetencë më e madhe e toponimeve. Faktori që reflektohet fuqishëm në këtë marrëdhënie është nëse përdoruesi ka kaluar fëmijërinë në zonën përkatëse, ka migruar në moshë madhore, ose ku ai ose ajo jeton vetëm në baza rekreative ose në vendin e punës.

Kështu që i kërkuam të anketuarit tanë për karakterin e qëndrimit të tyre në fshat.

Doli se njerëzit që e kanë kaluar fëmijërinë në fshat treguan rezultate më të mira toponimike.

Rezultatet tona janë në përputhje me deklaratat Ainalys, cili ka theksuar: "Banorët të cilët e kanë kaluar fëmijërinë dhe rininë e tyre në zonën e caktuar, (në fshatin të cilit i referohemi, vështirësi ynë) shpesh dinë më shumë emra për këtë zonë se njerëzit që kanë lëvizur vetëm atje si të rritur." Ainalys arsyet i sheh si një njohuri më të mirë të zonës dhe sidomos në lidhje më të forta emocionale.



Diagrami nr. 9. Koha e kaluar në fshatin.

Pasi që janë analizuar të dhënat kemi ardhur në këto rezultate statistikore:

	a)	b)	c)	d)	e)
F	21.49 %	19.62 %	16.82 %	29.90 %	12.40 %
M	23.07 %	21.67 %	17.48 %	39.16 %	1.39 %

Tabela nr. 7. Rezultatet statistikore për kohën e kaluar në fshat.


9.14. Njohja e fshatit dhe rrethinës

9.14.1. Interesi në komunitet

Interesimi i personit dhe marrëdhënia e tij me mjedisin në të cilin jeton reflektohet gjithashtu edhe nga intensiteti në të cilin ai ose ajo është i (e) interesuar për mjedisin.

Gjatë hulumtimit kemi marrë lidhjen midis shkallës së interesit në komunitet dhe kompetencës toponimike. Njohja më e ulët e toponimeve lokale është konstatuar tek personat që nuk kanë qenë të interesuar në komunitetin lokal, pra nuk kanë marrë ose nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në organizimin e jetës në fshat.

Mund të konfirmojmë gjithashtu se niveli i njohurive dhe i përdorimit të emërveve lokale varet nga shkalla e interesimit të të anketuarve për fshatin dhe komunitetin.



Diagrami nr. 10. Numri dhe gjinia e të intervistuarve.


Në bazë të të dhënave, meshkujt e njohin më mirë komunitetin, lagjet dhe gjithçka tjetër që lidhet me jetën e fshatit. Kjo gjë dëshmohet edhe nga të dhënat statistikore si rezultat i diagramit të cilit po i referohemi, gjë që e konstatojmë edhe në vazhdim:

a) E njoh komunitetin		b) i di të gjitha vendet	c) i njoh vetëm përafërsisht	d) të tjera
F	32. 71 %	24. 29 %	39.25 %	3. 73 %
M	52. 44 %	23. 77 %	22.37 %	1. 39 %

Tabela nr. 8. Rezultatet statistikore për njohuritë mbi fshatin.

9.14.2. Njohja e dialektit

Një aspekt tjetër në të cilin mund të reflektohet marrëdhënia e popullsisë me lokalitetin është njohja e dialektit lokal. Pyetja rreth dialekteve ishte gjithashtu pjesë e pyetësorit tonë. Duhet të theksohet se ne nuk kemi pasur mundësi të dimë saktësisht se sa e kontrollojnë dialektin të anketuarit tanë, përpos përshtypjelënies gjatë intervistimit, por ata të cilët kishin njohuri për dialektin e fshatit, doli që të kenë njohuri më të mira në raport me ata që sipas nesh kishin njohuri të pjesshme për dialektin. Prandaj, mund të supozohet se ekziston një varësi midis kompetencës toponimike dhe dijes së dialektit



Diagrami nr. 11. Njohja e dialektit.

Edhe njohja e dialektit lokal ka rëndësi sociale për njohje sa më të mirë të emërtimeve sociotoponimike, sa më mirë e njohim dialektin lokal, aq më mirë i dimë edhe emërvendet që lidhen me fshatin. Po ashtu, edhe në këtë pikëpamje meshkujt dolën më me njohri më të mira, gjë e cila dëshmohet me të dhënat statistikore si vijojnë:

	a) po	b) jo	c) nuk e di	d) tjetër
F	41.12 %	18.69 %	37.38 %	2.80 %
M	46.15 %	23.77 %	26.57 %	3.49 %


Tabela nr. 9. Rezultatet statistikore për njohjen e dialektit lokal.

9.15. Ndikimi i opinionit dhe aspekteve emocionale në kompetencën toponimike

9.15.1. Qëndrimi për riemërimin e fshatit

Në pyetjen e parashtruar se a e dinin emrin e ri të fshatit dhe se a do ta ndryshonin të njëjtin në formën zyrtare, të anketuarit treguan se nuk do të mbështetnin ndryshimin e

emrit të fshatit të tyre. Rreth kësaj çështjeje kemi intervistuar një numër të madh të banorëve të fshatrave të trajtuara të cilët në përgjithësi nuk e përkrahën idenë e riemrimit.



Diagrami nr.12. Mendimi dhe qëndrimet e banorëve për ruajtjen e emrit të fshatit.

Ndryshimi i emrit të fshatit nuk ka hasur në përkrahje nga të intervistuarit. Në përkrahje të mikrotoponimit ekzistues kanë dalur 81.13 % femra dhe 78.32 % meshkuj.

Pjesa më e madhe e banorëve të lokaliteteve të caktuar nuk përkrahin ndërrimin e emrit me arsyetimin se emri ekzistues ka vlera njohjeje dhe prezanton trashëgiminë kulturore të fshatit që nga e kaluara, përfshirë këtu edhe dëshmitë arkeologjike, historike, gjuhësore, fetare, kulturore etj.


a)	b) jo	c) nuk e di	d) tjetër
F 81.13 %	10.28 %	3.73 %	0.93 %
M 78.32 %	18.88 %	4.19 %	1.39 %

Tabela nr. 10. Rezultatet statistikore për ruajtjen e emrin ekzistues të fshatit.

9.15.2. Mundësia e ndërrimit të emërvendit – fshatit

Sa i përket riemërimit të fshatit dhe njohurive se a ka ndërruar i njëjti, në kuadër të hulumtimeve toponimike vend të rëndësishëm zënë mikrotoponimet - emra fshatrash,

andaj këtu ka mundësi të trajtimit sociotoponimik. Nisur nga aspektet ideologjike përemes dritës sociale, pothuajse në të gjitha fshatrat këto mikrotoponime kanë ndikim të mundshëm në kompetencën e emrave të vendeve, prandaj edhe në këtë pikëpamje qëndrimi i popullsisë ishte i larmishëm gjë që do ta shohim në tabelën e paraqitur më poshtë, por ajo që vlen të përmedet është mosdeklarimi për njohje apo ndërrim emri, ku nga të gjithë të anketuarit në këtë pyetje 72.89 % (femrat) dhe 60.83 % (meshkuj) nuk u deklaruan fare, (nuk dhanë përgjigje) gjë që lë për të kuptuar se përkundër ndërrimeve të mikrotonimeve të pjesës dërmuese të fshatrave të Pejës, megjithëkëtë, banorët nuk janë në dijeni. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në diagramin e më poshtëm:



Diagrami nr. 13. Njohuritë për riemërim të fshatit.

Si qëndroni deri tek çështja e riemërtimit? A ka ndryshuar dhe a dëshironi që emri të ndryshojë?				
	A) po	b) jo	c) nuk e di	d) tjetër
F	19.06 %	7.47 %	72.89 %	X
M	27.97 %	18.18 %	60.83 %	X

Tabela nr. 11. Rezultatet statistikore për emrin e ri të fshatit.

Të gjithë të intervistuarit e të gjitha fshatrave të hulumtuara, fshatin e tyre e konsiderojnë të veçantë, gjë e cila dëshmohet me përgjigjet në pyetjen me mundësi të rrumbullakësimit të më shumë se një përgjigjeje.

Të gjithë të intervistuarit duke pretenduar se me përgjigjen e kësaj pyetjeje janë në përkrahje të ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe se janë të denjë t'i mbrojnë këto vlera, pavarësisht kuptimësisë, pa përjashtime, kanë dhënë përgjigje pozitive, duke i rrumbullakësuar që të gjitha si p.sh.:

kulturore: si pjesë e kulturës lokale, traditës, dokeve, zakoneve etj.;


gjuhësore: si burim i rëndësishëm i njohurive në aspektin e dialektit, gjuhës etj.;

historike: si pjesë të historisë së fshatit, si burim i rëndësishëm i njohurive për të gjitha etapat e caktura kohore, sidomos për historianët etj.;

emocionale: si pjesë e kujtimeve që lidheshin me shtëpinë, peizazhin etj.;


patriotike: si shprehje juridiksioni lokal, forcimin e krenarisë se kush jemi dhe ku ne jetojmë.

Kjo, siç vërehet edhe nga diagrami, është plotësuar me 100 %.



*Diagrami nr. 14. Njohuritë për vlerat socioonomastike të fshatit.***9.15.3. Lidhja me shtëpinë**


Aspekti tjetër emocional i parashtruar në anketë në kërkimin të kompetencës toponimike ishte edhe marrëdhënia me shtëpinë, pra nëse ata e konsiderojnë fshatin e tyre si shtëpinë e tyre. Të gjithë të anketuarit u shprehën për një lidhje të fortë me fshatin, gjë që pas analizimit dhe vlerësimit të pyetësorëve, sipas gjetjeve, si femrat ashtu edhe meshkujt, pavarësisht arsimit, moshës, qëndrimit, treguan lidhje të fortë emocionale me fshatin dhe 100 % u ndien krenar për të përfshirë këtu të gjitha fshatrat e trajtuara.

*Diagrami nr. 15. Konsiderata ndaj fshatit.***9.16. Toponimi si pjesë e peizazhit**

Në pjesën e tretë jemi përqendruar tek të shprehurit e lirë, të vullnetshmëm dhe imagjativ të të anketuarve, duke pasur mundësinë që ata të përshkruajnë me fjalët e tyre fotografinë e pamjes së fshatit, sidomos në pjesën ku jetojnë, sepse më së miri e njohin atë pjesë, prandaj të anketuarit patën mundësinë që vet t'i emërtonin vendet sipas dëshirës, vullnetit, emocionit, anës artistike, ngjarjeve të caktuara etj. Nga ky kënd i vështrimit

pjesa dërrmuese e të anketuarve kanë hezituuar për të shkruar, për t'u shprehur, gjegjësisht për të plotësuar këtë pjesë, megjithatë ata që u shprehën në masë të madhe kanë riemëruar pjesët e caktuara të fshatit po me emrat ekzistues.

Në këtë hulumtim ne i krahasuam vetëm të dhënat e plotësuara të të anketuarve, ritoponimet e fshatrave si pjesë të peizazhit.



Digrami nr. 16. Toponimia si pjesë e peizazhit

Pyetja e parashtruar kërkonte një punë krijuese që të vrojtohej foto – skica e dhënë e peizazhit dhe i intervistuari të përpiquej që të shpikte emra të rinj për çdo objekt në çfarëdo mënyre, varësisht prej imagjinatës. Mendoj se kjo pyetje ka pasur përgjigje më të pakëta, sigurisht se nuk ka munguar frymëzimi, por kam vërejtur hezitim nga ta, me frikën se mos po përshkruajnë gabim etj., megjithatë, në njërin anë ka pasur emërtime të reja toponimike mjaft interesante, kurse në anën tjetër ka mbizotëruar përsëritja toponimike. Gjithsej 131 të intervistuar nuk kanë bërë asnjë përshkrim.

Disa emërtime peizazhi të kësaj natyre janë vërtetë me interes hulumtimi e gjurmimi. Të gjeturat e nxjerra po i paraqesim si vijon:

Nga 21 deri 31 përshkrime topon.		Nga 11 deri 20 përshkrime topon.	Nga 5 deri 10 përshkrime topon.	Asnjë toponim i përshkruar
F	1. 07 %	2. 80 %	40. 18 %	57. 00 %
M	1. 07 %	10.28 %	43. 35 %	49. 65 %

Tabela nr. 12. Rezultatet statistikore për emrat e peizazhit sipas dëshirës.

KREU I DHJETË

10. PATRONIMIA

Mbiemrat famijarë kanë zanafillë mjaft të hershme tek të gjithë popujt dhe gjuhët e tyre, i hasim të përdorur edhe në shumë gjuhë të familjes indo-evropiane e po ashtu edhe në gjuhën tonë. Fillimisht, mbiemrat janë formuar nga emrat e pararendësve, anëtarëve të familjes, në vijimësi, duke iu referuar emrit të familjarit që shquheshin për vepra madhore dhe akte të rëndësishme në rrethana sociale. I hasim kryesisht tek të krishterët, që nga shek. VII, nga Dhjata e Vjetër etj., për të vazhduar më pastaj me vendosjen e rendit feudal, me përjashtim të atyre personave që bënin pjesë në popullatën e thjeshtë, të cilët mbanin vetëm një emër të krishterë. Patronimisti **Ilir Sinanaj** shton se nevoja për të pasur një mbiemër erdhi gjatë kohës së kryqëzatave. Kjo për faktin se në ushtritë e kryqëtarëve kishte shumë persona të ndryshëm, të cilët kishin të njëjtin mbiemër dhe nevojitej të dalloheshin njëri nga tjetri. Kështu lindin mbiemrat e parë ose siç quheshin në atë kohë “noms de guerre (emra lufte)”. Një emër i dytë apo një “mbiemër” i jepej luftëtarit i cili kishte shpesh një nofkë lidhur me cene apo tipare fizike të theksuara si qorri, doraci etj. Kështu edhe lindën mbiemrat e parë ndër europianë. Edhe në etninë tonë patronimia, në rrjedhë motesh pati një zhvillim të ngjashëm krahas kulturave dhe popujve të tjerë, zhvillim ky që e hasim edhe në Pejë. Shikuar nga këndvështrimet sociale, vërejmë në mënyrë të argumentuar ndryshime të shumta gjatë hapërimeve nëpër kohë në pikëpamje të strukturës e veçorive gramatikore dhe fonetike, me theks të veçantë në rastin tonë hasim ndryshime nyjëtimesh rajonale, ndryshime të gjedhes fjalëformuese, shkurtime dhe zgjatje mbiemrash, rregullime etj., në atë mënyrë që në Pejë me rrethinë, sikundër edhe anekënd trojeve etnike, edhe një emër i vetëm ka prodhuar shumë variante patronimesh, p.sh. nga Bardh na dalin disa varietete si: Bardhi, Bardhaj, Bardhoshi, Bardheci etj., me ç’rast shembujt në vijim nga këndi social paraqesin një pamje origjinale të zhvillimit patronimik.

Është i ruajtur në këto anë edhe sot e kësaj dite patronimi qorr, nofkë kjo e lidhur me tipare fizike të theksura. Nga aspekti socioonomastik ky patronim na tregon shumëkuptimësi si: njeriun e verbër, me një sy, qoftë edhe nga lindja, vendin që ka pak dritë, që lejon të kalojë pak dritë, dhomë qorre, kandil qorr, xham qorr, i marrtë, që është i mbyllur nga fundi, që nuk ka dalje, rrugë qorre etj., njeri i pavëmendshëm, ai që nuk shikon se ç'bëhet përreth, njeri i shushatur, ai që është pa shkollë e i paditur, nisur një punë që nuk do të ketë përfundime të mira etj., mendojmë se ky patronim shkon edhe më tej se ky tipar fizik, duke e parë në konotacionin pozitiv, e ruan si qorri syrin e vetëm, kujdeset shumë për dikë a për diçka, e ruan si sytë e ballit. Vetëm si i tillë, bazuar në një vepër me përmasa gjithëpërfshirëse, mund të ketë mbijetuar, e në këtë rast edhe ky patronim. Sigurisht se vrojtime sociale mund të ketë edhe më, por datimin e përdorimkohës së kësaj nofke dhe shumë të tjerave, në mungesë të të dhënave shkrimore për periudha të caktuara mbase s'mund t'i vërtetojmë, por ekzistencën e tyre në lashtësi gjithsesi.

Patronimet, ose emrat e familjeve, përbëjnë një nga pjesët më të qëndrueshme të thesarit onomastik, pasi, meqenëse nuk lidhen me individë të veçantë, që rrojnë jo më shumë se tre breza, po me grupe individësh të shumë brezave të cilët i bashkon pikërisht prejardhja nga një i parë i përbashkët, ato ruhen më gjatë në gjuhë, duke ndryshuar vetëm për arsye shumë të forta. Si të tilla, ato marrin një vlerë të veçantë, pasi, duke u mbështetur në to, mund të nxjerrim të dhëna të rëndësishme për historinë, për besimin dhe për mënyrën e jetesës së një bashkësie.¹ Shqyrtimi i lëndës socioonomastike në Pejë me rrethinë duhet parë në dy vështirime: në vështirimin sinkronik, me qëllim që të zbulohen veçoritë strukturore të këtyre njësisë, dhe atë diakronik, për të parë vijimësinë e emërtimeve dhe të gjedheve prejardhëse (*derivuese*) të tyre.

Trajtimi diakronik i lëndës është më i vështirë, pasi jo gjithnjë forma në të cilën shfaqen këto emërtime lejon të zbulohet prejardhja e tyre.

10.1. Ndryshimet patronimike, faktorët

Nga ana e hulumtimit tonë ndryshimet antroponimike, toponimike dhe patronimike në vijimësi ndodhin për shkak të rritjes së numrit të banorëve në kohën bashkëkohore, botën e moderuar, përfshirë këtu edhe lëvizjet demografike, eksploruese etj., procesit gjithnjë e më të avancuar dhe të dendur (*intensiv*) të urbanizmit, komercializimit të vlerave

kulturore, teorive dhe praktikave të ndërtimit dhe të rregullimit të qyteteve dhe fshatrave sipas planeve të caktuara, në tëpamje të synimeve të afërta dhe të largëta për krijimin e kushteve më të përshtatshme për jetesë në rrethet sociale dhe për punë në përputhje me kërkesat e sistemit ekonomik e në veçanti atij shoqëror, si dhe rrjedhave sociale jetësore, pastaj mekanizimit dhe automatizimit jetësor shumëdimensional, si në fshatra ashtu edhe

Bidollari, Çlirim, Hulumtime onomastike, Tiranë 2012.

në qytete, rritja e standardit jetësor, ekonomitë familjare, të vogla dhe të mëdha, mënyra e shfrytëzimit të kohës së lirë si pasojë e zhvillimeve të reja teknologjike etj.

Ndryshimet e tilla universale në rrethana dhe kushte specifike, në kohë të ndryshme, që ruajnë karakteristika të përbashkëta dhe që dallojnë nga rasti në rast, kanë qasjet socioonomastike që për shumëçka janë të veçanta, duke filluar nga analizimi i përmbajtjeve sociale, gjegjësisht këto qasje janë tregues gjithnjë e më të mëdhenj të zvogëlimit të distancës sociale antroponimike, toponimike dhe patronimike, në mes të grupeve të veçanta shoqërore: klasave, shtresave, profesioneve, moshave, gjinive etj.

Ndryshimet e tilla socioonomastike-patronimike, mes tjerash u mundësojnë njerëzve që të kuptojnë realitetin jetësor dhe të zbulojnë të vërtetën për të, të lehtësojnë kuptimin e saj si pjesë përbërëse të sociolëvizjeve, e mu për këtë kanë rëndësi të veçantë po në këto lëvizje, duke i sqaruar jo vetëm si rezultate, por edhe duke treguar sociorrugën deri te rezultati. Një pjesë e mirë e patronimeve me kalimin e kohës janë zëvendësuar me patronime të reja (emërtim të ri), sepse pasardhësit e këtyre familjeve bazuar në ndryshimet që i zumë në gojë, kanë krijuar një mentalitetin e ri në mjedisin shoqëror ku jetojnë e veprojnë, p.sh. familja e e madhe Lajçi, nga fashti Drelajt, e vendosur në Pejë, ka ndryshuar mbiemrin nga Lajçi në Kelmend, (shkrimtari i njohur Ramiz Kelmendi) të cilin e ka ruajtur edhe sot e kësaj dite. Familja Mekaj nga Bogët, lagjeja Dreshaj, në Rugovë kanë ruajtur mbiemrin Mekaj, kurse me rënien në qytetin e Pejës dhe në fshatin Nabergjan si dhe socializimin në këto mjedise, pjesa dërrmuese e kanë ndryshuar patronimin në Dreshaj, andaj kemi hasur dy vëllezër që jetojnë nën një çati me mbiemra të ndryshëm.

Edhe profesori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Çlirim Bidollari ka radhitur edhe një fjalor ku ka përfshirë të gjithë mbiemrat shqiptarë, nga më i famshmi e deri te më pak i përdoruri, i cili po ashtu shpjegon se në kohën e Romës së lashtë ka ekzistuar një sistem

tregjymtyrësh antroponimik: **nomen** (emri), **gens** (farefisi) dhe **cognomen** (sipëremri apo emri i familjes).²

Qytetarët e lirë të Romës ndaheshin në dy grupe: patricët dhe plebejtë. Patricët ishin banorët më të lashtë të qytetit, të parët e të cilëve e kishin themeluar atë. Plebejtë, sipas studiuesve, mendohen të kenë qenë banorë që erdhën më vonë në Romë dhe u

2. **Sinanaj. Ilir.** Onomastika, shkenca që studion origjinën e emrave, shqiperialive.com/tag/onomastika/

natyralizuan dhe u socializuan si qytetarë romakë.

Fakti se dikush ishte patric tregonte se të parët e tij kishin luftuar për themelimin e qytetit. Fisnikëria fitohej me sakrificën e betejës. Si rrjedhojë patricët kishin më shumë pushtet, por edhe sistemi i tyre antroponimik ndryshonte nga plebejtë.

Fillimisht një qytetar romak kishte një emër të vetin dhe atë të fisit të tij (*nomen gentilicum*).

Në shekullin e tretër para erës sonë, me rritjen e popullsisë fisi filloi të ndahej në shumë familje. Kështu filloi të shtohej edhe emri i familjes (*cognomen*), si gjymtyrë e tretë e antroponimit, për shembull ushtaraku i famshëm që ngadhnjeu mbi forcat kartagjenase: Publius Cornelius Scipio. Kjo dukuri vihej re vetëm tek patricët.

Ushtaraku i lartpërmendur filloi karrierën e tij si oficer i lartë në legjionet romake (*tribunes militum*). Ai shquhet për goditjen që i dha **Hanibalit** gjatë betejës së Zamas, në Tunizinë e sotme, duke i dhënë Romës epërsi gjeopolitike dhe strategjike mbi të gjithë Mesdheun. Për arritjet e tij ushtarake, atij iu dha edhe një emër personal (*agnomen*), i lidhur me toponimin apo emërtimin e zonës, ku u zhvillua beteja: “Africanus”.³

Sipas të dhënave ekzistuese shohim se zhvillimi i mbiemrave ka ecur në shek XII-XX.

Në rreth 5-6 shekuj histori, procesi i vënies së mbiemrave ka ecur nga lart poshtë. Kështu, fillimisht janë pajisur me mbiemra shtresat e larta, më pas shtresat e hierarkisë fetare, ndërsa më vonë ka zbritur deri në shtresat e ulëta. Qëllimi fillestar i mbiemrave ka qenë për të dalluar njerëzit nga njëri-tjetri.

Mbiemrat janë stabilizuar në shek XX në Shqipëri. Deri më 1912 shumica e popullsisë në Shqipëri nuk kishte mbiemra. Pas këtij viti filluan të kryheshin regjistrimet e para të popullatës.

Gjatë shqyrtimit të patronimeve kemi konstatuar se emra nga lashtësia janë që lidhen me kafshë, si për shembull: Uka, Zoga, Shpendi, bimë Lulja, etj., në Pejë me rrethinë kanë përdorim të dendur si patronime.

3. **Sinanaj. Ilir.** Onomastika, shkenca që studion origjinën e emrave, shqiperialive.com/tag/onomastika/

10.2. Patronimia disiplinë shkencore

Me ardhjen e periudhës së iluminizmit në Europë, disiplina të ndryshme shkencore filluan të lulëzonin. Një nga këto shkenca që mori një rëndësi të veçantë ishte edhe *linguistika apo gjuhësia*.

I pari që iu përkushtua studimit të emrave dhe emërtimeve ishte studiuesi francez **Albert Dauzet**. Në vitin 1938 ai kryesoi *Kongresin e Parë Ndërkombëtar të Antroponimisë dhe Toponimisë* në Paris.

Më vonë këto lëmi studimi do të përfshiheshin në shkencën që do të quhej **onomastikë** ku zë vend edhe patronimia.

10.3. Klasifikimet

Shumica e patronimistëve tanë kanë bërë këto klasifikime kategorish të patronimeve:

10.3.1. a) Në kategorinë e parë përfshihen mbiemrat që tregojnë vijimësinë e birërisë

Në këtë kategori futen ata mbiemra që rrjedhin nga emrat e të parëve të cilët mund të jenë në formën e plotë të emrit si: *Nimani, Zeneli, Abazi*, por edhe në trajtat e tyre të shkurtuara si: *Daka, Pepa, Hysi, Leka, Luca apo Luka*.

10.3.2. b) Në kategorinë e dytë përfshihen mbiemrat që tregojnë origjinë ose prejardhje

Ndër patronimet më të përhapura të kësaj kategorie janë: **Shala, Kastrati, Berisha, Kelmendi, Shkreli, Bogu, Hasi, Radoniqi etj.**

“Kushti numër një i vendosjes së mbiemrave të këtij lloji ishte që familja që merrte këtë mbiemër të kishte lëvizur nga vendbanimi i mëparshëm. Gjithashtu, kur prijësit e

familjeve të zhvendosura nuk arrinin të gjenin një paraardhës të denjë për të mbajtur si mbiemër, atëherë ata përdornin emrat e fshatrave ose të qyteteve nga vinin siç është rasti i mbiemrave Shkreli, Shala, Kastrati, Berisha etj.”⁴.

Lëvizjet e pupullsisë për shkaqe të ndryshme, ekonomike, politike, kanunore etj., janë shumë të pranishme, zaten këto lëvizje kanë qenë një formë mjaft e dukshme e ndërtimit

4. Migena, A. “Patronimet, mbiemrat familjarë në Gjakovë” në bashkëautorësi me prof. M. Rogova (Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Gjakovë 2015)

të mbiemrave, duke ruajtur kështu emrin e vendit se nga kishte ardhur fisi ose familja dhe ishte ngulitur këtu, madje si një lloj dëshmie historike për gjeneratat e mëvonshme.

Kemi një numër të caktuar të mbiemrave të tillë që janë formuar duke marrë emrin e lokacionit a vendbanimit nga edhe kishin ardhur dhe nga ku përkiste familja. Mbiemra të tillë quhen mbiemra prejtoponimikë si p.sh.: **Shkreli** në *Shkrel*, **Kastrati** në *Llaz dhe Shtupeç të Vogël*, **Shala** në *Drelaj* dhe **Berisha** në *Stankaj* apo *Joshanicë* si e hasim në dukumente zyrtare etj.

Këto patronime i kanë përballuar kohës dhe kanë mbetur të përdoren edhe sot e kësaj dite, kurse prejardhja e tyre nuk është një dëshmi kohe për mënyrën e formimit të mbiemrit nga zona e prejardhjes së fisit, familjes a individit të vendosur kohë më parë kryesisht nga zonat rurale.

Kemi raste kur patronimi shërben si saktësues për emrin vetjak, për identifikimin e mëtejshëm të emrit dhe si i tillë vie nga një **etnonim**:

Gega (*i trevave veriore*), të cilin e kemi hasur në fshatin Shkrel, në vëllezërinë e Rexhajve, pastaj etnonimi **Toska** (*i trevave jugore*) të cilin e hasëm në qytetin e Pejës, në Lagjen Fidanishte. Ky tip sot mund të konsiderohet i mbyllur nga këndi patronimik.

10.3.3. c) Një tjetër kategori janë mbiemrat që tregojnë zanate dhe profesione apo tituj si:

Sapunxhiu, Kapuçi, Buçuku, Begolli, Anadolli, Kasapolli, Berlajolli, Agusholli, Kajolli, Dejolli, Katanolli, Rizvanolli, Çarkaxhiu Kondirolli, Devolli, Pasha, Kasapi, Sahatçiu,

Aga, Tigani, Hoxha, Shehu, Prifti, Zajmi, Myftari, Belegu, Kovaçi, Berberi, Mullajusufi, Pushka etj., kategori kjo e trashëguar nga gjuha turke.

Bazuar nga të dhënat që disponojmë, po shqyrtojmë **patronimin Bajraktari**, që është mjaft përdorur, e hasim pothuajse në të gjitha fshatrat e Pejës, e po ashtu ka shtrirje të dukshme edhe në qytet, gjë që edhe këtu kemi parametra të dëshmimeve për jetën e vështirë në këto anë, rezistencën, mosnënshtrimin, luftërat e pareshtura, mosbashkëpunimin me pushtuesin etj., pikërisht ky patronim na e dëshmon një gjendje të tillë me vet faktin se periudha e vënies së mbiemrave edhe pse ka përkuar në kohë me pushtimin turk është jetësuar. Është me interes të potencojmë edhe të dhënë historiografike se patronimi bajraktari, fillimisht paraqiste një personalitet me ndikim që ndërmjetësonte në mes të popullit dhe pushtetit (dovletit e milletit), kurse me ironi përfaqësonte njerun me sjellje të këqija dhe mendjemadhësi.

Sipas studiueses Shpresa Hoxha, në **Fjalor fjalësh e shprehjesh turke**, bajraktari ishte i pari, prijësi, flamurtari, (flamur – bajrak, hist. njësi ushtarake e më vonë administrative në organizimin fisnor shqiptar)⁵, kurse sipas fjalorit Fjalë shqip: **BAJRAKTAR** *m.*

1. *vjet. Flamurtar* (edhe fig.). *Bajraktar i mendimit shqiptar.*
2. *hist. Kreu i bajrakut*, që përfaqësonte interesat e shtresës më të pasur e të privilegjuar dhe që drejtonte bajrakun në bazë të kanuneve patriarkale. *Kullat e bajraktarit. Sillej si bajraktar.*
3. *keq. Njeri që sillet ashpër e me mendjemadhësi, që i pëlqen vetëm të sundojë e të urdhërojë; ai që drejton punën me metoda të vjetruara, patriarkale e konversatore. Bajraktar i vogël. Ishte bërë bajraktar.*
4. *etnogr. Krushku* që mbante bajrakun e dasmës, kur shkonin të mermin nusen; krushku i parë. *Bajraktari ecte përpara.*⁶

Nga drita sociale mund të analizojmë edhe:

bajraktaribajraktarizëmbajrakbajrakasbajraku

10.3.4. d) Ndërsa kategoria e katërt në klasifikimin e mbiemrave përfshin mbiemrat që janë formuar në formën e nofkave dhe llagapeve si:

Vokshi, Duraku, Nikçi, Lajçi, Muriqi, Muqolli, Qorri, Bardhi etj., duke iu dhënë fillimisht disa personave në formën e epiteteve, me kalimin e kohës ato janë konsoliduar në mbiemra. Këto epitete kanë qenë të formave të ndryshme, me ngjyresa pozitive dhe negative, por me kalimin e kohës ngjyresa e tyre ka humbur. Çdo bashkësi dallon nga të tjerat edhe për mënyrën se nga i merr dhe si i ndërton emrat dhe emërtimet e përveçme, dhe kjo përbën një fushë tjetër që duhet hulumtuar.

Jo pa interes janë edhe veçoritë gjuhësore të këtyre njësive: veçoritë formale gramatikore dhe sidomos ndryshimet fonetike që kanë pësuar. Duke kaluar në gojën e dhjetëra e dhjetëra brezave, emrat e përveçëm dhe emrat e vendeve doemos që pësojnë ndryshime tingullore, nën veprimin e rregullave fonetike të gjuhës së cilës i përkasin. Emrat me një moshë tepër të vjetër bartin me vete pasojat e rregullave fonetike që kanë vepruar mbi ta në epoka të ndryshme të jetës së tyre. Kështu që studimi i ndryshimeve tingullore bën të mundur të zbulohen rregullat që i kanë shkaktuar dhe të bëhet një kronologjizim i këtyre rregullave.

Veç këtyre ndryshimeve spontane, të pavetëdijshme të formës, ka edhe të tjera që e kanë burimin në përpjekjet e vetëdijshme të anëtarëve të bashkësisë së cilës i përkasin këto emërtime. Lidhja arbitrare me frymorët dhe objektet që emërtojnë përbën “*thembrën e Akilit*” të emrave të përveçëm vetjakë, të emrave të familjeve dhe të toponimeve.⁵

Duke mos pasur lidhje të ngushta me objektet që emërtojnë, ato mund t’i nënshtrohen ndërhyrjes së njeriut, i cili, në mënyrë të vetëdijshme, mund t’i ndryshojë dhe t’i zëvendësojë me emërtime të tjera, siç ndodh gjatë periudhave të pushtimeve, kur një bashkësi ndërron besimin e vet apo kur individit a bashkësia, për një arsye ose për një tjetër, kërkojnë ndryshimin e emërtimeve të vjetra. Kategori e pestë do të duhej të ishte: patronime të pashpjegueshme, në të cilat do të përfshihen ato mbiemra për të cilët sistemi i sotëm gjuhësor nuk jep shpjegime. Kësaj ndërhyrjeje i nënshtrohen sidomos emrat e përveçëm vetjakë, por në një shkallë më të vogël.

10.4. Patronimet rugovase

Për shkak të pamundësisë për të trajtuar mbiemrat e Pejës me rrethinë në një spektër të gjerë, këtë hulumtim e kam bërë në krahinën e Rugovës. Sipas traditës popullore dhe të dhënave jo të plota historike, rugovasit trajtohen si kelmendas. Tradita popullore, nga ana tjetër thotë se kelmendas janë vetëm këto katër vëllezëri: ⁶ **Nikçi, Selca, Vukli dhe Muriqi.**

Në **Shtupeçin e Madh Nikçi** është i shpërndarë në pesë barqe: *Plakaj, Imeralijaj, Kuklecaj, Smakaj dhe Elezalijaj*;

5. Hoxha, Shpresa. Fjalor fjalësh e shprehjesh turke. Prishtinë, 2015, faq. 16,17

6. FGJSH Fjalë shqip

Në **Riekën e Allagës** në pesë barqe: *Tafaj, Cukaj, Metukaj, Alimetaj dhe Zeqiraj*;

Në **Shkrel** vetëm në barkun *Hysenaj*;

Në **Kuçishtë** banorët janë **Vukël**, të cilët janë të ndarë në tri barqe: *(Xhevukajt, Dreshajt dhe Bardhajt)*;

Në **Bogë** me katër barqe: *Lucajt, Plakajt, Kurdedajt, Rexhaj*;

Në **Haxhaj** në tri barqe: *Lekajt, Cukajt, Lakajt*.

Do thënë këtu se muriqas janë edhe Lucajt e Bogëve.

Edhe nga **Vukli**, aty - këtu ndonjë shtëpi në Shtupeçin e Madh, në Shtupeçin e Vogël, në Drelaj dhe në Shkrel.

Për fisin **Lajç**, tradita popullore thotë se nuk janë kelmendas, po lidhen me fisin Hot⁷. *Dreshaj, Kurtbogaj, Bajramaj, Selimaj, Abazaj, Cukaj, Lulaj, Çelaj*.

Siç vërejmë pjesa dërrmuese e mbiemrave në Rugovë i takojnë përkatësisë fisnore.

Nga studimet tona të derisotme për patroniminë e Rugovës, kemi konstatuar se patronimet në Rugovë nuk kanë karakteristika të veçanta, me pak dallime të theksuara nga një katund në tjetrin, veçanërisht kemi vërejtur mbajtjen e një patronimi në përgjithësi në një fshat, bie fjala Nikç, në Shtupeçin e Madh dhe Rekë të Allagës, Lajç, në Pepiç, në Shtupeç të Vogël etj., megjithatë, vërehen disa dallime midis brezave: brezit të shkolluar dhe atij të pashkolluar, brezit të vjetër dhe atij të mesëm etj. Gjatë hulumtimit dhe punës në terren kam hasur shumësi mbiemrash në një familje, që njëherësh është dukuri socioonomastike, bie fjala, në fshatin Shkrel, në një familje, tre vëllezër mbajnë tre mbiemra të ndryshëm.

Babain e tyre, në Rugovë të gjithë e kanë njohur për Ujkan **Smajli**, përderisa djali i madh i tij, Ademi, gazetar, shkrimtar dhe publicist mban patronimin **Rugova**, i vëllai, Azemi, pena e artë e letrave shqipe ka mbajtur patronimin **Shkreli** ndërsa vëllai tjetër i tyre, Afrimi, ish skitar elitari mban patronimin **Demaj**.

	Fshati Shkrel-Rugovë	
	<i>Kryefamiljari:</i> Ujkan Smajli	
<i>Djali i madh:</i> Adem Rugova	<i>Djali i dytë:</i> Azem Shkreli	<i>Djali i tretë:</i> Afrim Demaj

a) Skemë shumësie patronimike brenda një familjeje

Po ashtu aktori i mirënjohur i kinematografisë shqiptare Çun Lajqi nga fshati Drelaj mban patronimin Lajqi, të njëjtin mbiemër nuk e mbajnë vëllezërit e tij, ngase mbajnë mbiemrin Qorraj. Raste të tilla kemi hasur edhe në fshatra të tjera.

Mjetet e informimit publik në gjuhën shqipe si dhe mjetet teknike në përgjithësi si dhe shkolla në veçanti, kanë ndikuar edhe ndikojnë sot e gjithë ditën në futjen e patronimeve të reja, në një anë, po ashtu kontakti i përhershëm me qendrën administrative – Pejën dhe qendra të tjera në anën tjetër, kanë sjellë një varg patronimesh risimtare.

Një dukuri e tillë është më e pranishme në katundet që janë më afër Pejës, (në Shtupeç të Vogël dhe në Shtupeç të Madh), se sa në katundet që shtrihen në zona më të thella malore, bie fjala Shkrel dhe Koshutan, ku janë ruajtur format e vjetra të partonimeve. Kur bëjmë fjalë për ndërrimin e besimit, mund të themi se patronimia në Rugovë deri në vitin 1703 i qëndroi besnik identitetit të të parëve, ngase siç kemi thënë edhe më parë, deri në atë kohë në Rugovë nuk gjendej asnjë mysliman, sepse kishat në të 13 fshatrat e Rugovës luanin rol të rëndësishëm edhe në fushën e patronimisë, mirëpo, pas këtij viti Perandoria Osmane jo vetëm që rrënoi kishat, por tok me to rrënoi edhe besimin, antroponimet, toponimet e patronimet.

Edhe pse veprimet e tilla osmaneske u jetësuan përmes dhunës, prapëseprapë gjurmë të identitetit të të parëve u përcollën deri në ditët e sotme. Këtë e argumentojnë patronimet

Kurtaj, Kurtbogaj, Kurdedajt, Lucajt etj. Po ashtu, në këtë trevë hasim edhe në binjakëzim besimesh përmes patronimesh si: Rexhëbogaj, Demëbogaj, Hysnikaj etj. Në vështrimin sinkronik, emrat e familjeve mund të shqyrtohen nga disa këndvështrime: nga pikëpamja e strukturës, e gjedhes fjalëformuese, e veçorive gramatikore dhe fonetike⁸. Ashtu si ka vërejtur edhe studiuesi **Rami Memushaj**, duke analizuar patronimet e Himarës, duke i parë nga pikëpamja e strukturës, ngjashëm edhe patronimet e fshatrave të Rugovës mund të ndahen në dy grupe të mëdha: **njëfjalëshe** dhe **dyfjalëshe**.

Sikurse është vënë në dukje nga studiues shqiptarë dhe të huaj, në popullin tonë ka qenë i përhapur gjerësisht individualizimi “vetëm me anë të një emri të veçantë tjetër, duke u përdorur përgjithësisht si emër familje emri vetjak i babait ose i gjyshit⁷, p.sh.: *Adem Abazaj, Agron Selimaj, Halil Çelaj etj.*

Edhe në fshatrat e Rugovës tek emërtimet dygjymtyrëshe dominues janë emrat e përveçëm vetjakë dhe emri i babait ose i gjyshit si: **Idriz Kurbogaj, Demë Dembogaj, Balë Hysnikaj** etj. Në të kaluarën, në këtë trevë ishte zakon përdorimi i emrit vetjak dhe i emrit të babait. Po sjellim kështu një dëshmi të kësaj tradite nga fshati Shkrel, në të cilën kemi shënuar gjenealogjinë e familjes deri në tetë breza para tij, d.m.th. gjer aty nga fillimi i shek. XVI: *Daorsa – Valdeti – Mehmeti – Sadiku – Bajrami – Nimani – Hyseni – Aliu – Ujka – Nela – Bruçi*. Historia, mënyra e formimit apo numri i përdorimit të mbiemrit që mban secili prej nesh, nuk do të përbëjë më një mister. Së shpejti në dorë do të kemi edhe një fjalor të mbiemrave nga prof. Bidollari i cili është në përfundim e sipër, me ç’rast gjatë përpilimit të tij ka shfrytëzuar burime dhe informacione të shumta duke filluar nga regjistrimet e popullsisë në vazhdimësi e për të vazhduar deri te listat e zgjedhjeve, me qëllim saktësimi dhe zbulimi të vatrave nga ku ka lindur patronimia. Së këndejmi pjesa më e vështirë e patronimeve është vet historia e tyre për të cilën më së miri do të deklaroheshin bartësit patronimikë. Edhe mbiemrat nga hierarkia fetare në Rugovë nuk kanë zënë vend, përkundër përhapjes masive të myslimanizmit, pas pushtimit turk nuk hasim në patronime të tilla, përkatësisht tituj të fesë bektashiane dhe asaj ortodokse. Në fund mund të konstatojmë se emrat e përveçëm nuk janë në vijimësi të pandryshueshëm, sigurisht se për shkaqe e arsye të ndryshme edhe ata ndryshojnë: qofshin ato të religjionit, politikës, ideologjisë, e kohëve të fundit edhe për shkak të modës etj. Numër i konsideruar

i emrave të përveçëm ashtu si arkaizmat, dalin nga përdorimi duke u zëvendësuar me emra të tjerë dhe si të tillë kanë vetëm rëndësi historike. Edhe në këtë aspekt pjesa më e madhe e antroponimeve të cilat njëkohësisht janë të lidhura edhe me kulturën shpirtërore e materiale të tyre, me traditën, historinë, jetën sociale, besimin, janë ruajtur të paprekura, prandaj me këtë mund të shpjegojmë se pse antroponimet dhe patronimet përbëjnë një nga shtresat gjuhësore më me interes për të provuar përkatësinë etnike dhe karakterin autokton të një grupi të caktuar etnik.

7. Hajdaraj. A. E folmja e Rugovës. IAP. 2005

8. Memushaj, Rami, Patronimia e Himarës, kallarati.com/

Shembuj patronimike në të gjitha fshatrat e Rugovës

FSHATI	MËHALLA	MBIEMRAT
B o g ë	<i>Beqirbogaj</i>	Beqiraj
	<i>Demëbogaj</i>	Demaj, Demëgogaj
	<i>Dreshaj</i>	Dreshaj, Mekaj, Muçkurtaj
	<i>Rexhëbogaj</i>	Rexhëbogaj, Selimaj
	<i>Isufhaxhijaj</i>	Haxhijaj
D u g a i v ë	<i>Hajdarelezaj</i>	Hajdaraj
	<i>Hasanaj</i>	Haxhijaj, Zekaj
	<i>Lukaj</i>	Lukaj
	<i>Mujaj</i>	Mujaj
	<i>Xhaferaj</i>	Xhaferaj
H a x h a j	<i>Cukaj</i>	Cukaj, Rugova, Mustafaj
	<i>Lekaj</i>	Ibraj, Kurtaj, Selmanaj
	<i>Lulaj</i>	Isufaj, Kelmendi, Selimaj

K o s h u t a n	<i>Kurdedaj</i>	Muriqi
	<i>Lekaj</i>	Muriqi
	<i>Lucaj</i>	Muriqi
	<i>Palaj</i>	Muriqi
	<i>Rexhaj</i>	Muriqi
S h k r e l	<i>Nimanaj</i>	Hysenaj
	<i>Husaj</i>	Husaj
	<i>Kurbogaj</i>	Kurbogaj
	<i>Rexhaj</i>	Rexhaj
	<i>Bajramaj</i>	Bajramaj
	<i>Harabadaj</i>	Abazaj, Selimaj
	<i>Bajrimeraj</i>	Demaj, Shkreli, Rugova
S t a n k a j	<i>Dakaj</i>	Dakaj
	<i>Halilaj</i>	Halilaj
	<i>Hysnikaj</i>	Hysnikaj
	<i>Kurtaj</i>	Kurtaj
	<i>Lamaj</i>	Lulaj
	<i>Mekaj</i>	Mekaj
S t a n k a j	<i>Shabanaj</i>	Shabanaj
	<i>Sadribardhaj</i>	Bardhaj
	<i>Lulaj</i>	Lulaj
	<i>Haxhijaj</i>	Çelaj, Kelmendi
	<i>Berisha</i>	Berisha
	<i>Bardhaj</i>	Gjevukaj, Kelmendi
	<i>Gjevukaj</i>	Gjevukaj

Ku ç i s h t ë	<i>Dreshaj</i>	Dreshsaj
	<i>Bare</i>	Delijaj, Salihaj, Sejda

b) Skemë partonimesh në 7 fshatra të Rugovës.

KREU I NJËMBËDHJETË

11. PRAGMATIKA E EMRAVE

Socioonomastika, një disiplinë e re në kërkimet onomastike së cilës i takon të ndjekë shenjimin social të emërtimeve antroponimike, toponimike dhe patronimike, shenjim ky me interes për të hetuar:

- *shtysën motivuese sociale të emrave të personave që vihen në emërtimet onomastike;*
- *shtysën motivuese sociale të emërmbendeve në emërtimet onomastike,, emërmbendeve dhe*
- *shtysën motivuese sociale të mbiemrave që vihen në emërtimet onomastike.*

Shenjimët e tilla tregojnë se si njerëzit vlerësojnë dhe tumirin strukturat e mbiçmuara makro - shoqërore dhe aspektet ndërvepruese (*interaksionale*) të ndikuara në pozicionim social. Emërvënja e kësaj periode na ofron mjaft argumente se variacionet e vërejtura shoqërore shpjegohen më së miri nga dëshira e prindërve për të identifikuar me të emërmarrësit duke kontribuar kështu në krijimin e modeleve të ndryshme për shoqërinë, në të cilën vlerat shoqërore të ndryshme dhe atributet janë një çështje e rëndësishme. Në këtë kontekst, si interes kërkimor doemos do të duhej të paraqitej edhe historia dhe teoria e gjuhësisë, letërsia sociale, stilistika, dialektologjia (territoriale dhe sociale), onomastika, etj.

Gjuhët, si kulturat, rrallë i mjaftojnë vetvetes. Nevoja për marrëdhënie i sjell folësit e një gjuhe në kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ata të gjuhës fqinje ose me gjuhën e folësve që kanë kulturë mbizotëruese. Kjo marrëdhënie mund të jetë miqësore ose

armiqësore. Ajo mund të përparojë ndonjë plan të merzitshëm afarist dhe marrëdhëniet tregtare, ose mund të konsistojë me huazime apo këmbime të gjërave shpirtërore – të shkencës, të fesë. (*Gjuha – hyrje në studimin e ligjërit, Edusrd Sapir, Prishtinë 1980, faq. 219*).

Edhe emrat, ashtu si gjuhët, nuk mjaftohen me gjendje të përhershme, qëndrueshmërie, statike, sepse kontaktet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta me kulura të ndryshme, marrëdhiet kulturore, politike, tregtare, ekonomike, sociale, sportive, mjetet e informimit publik, shpiejnë drejt ndryshimeve të drejtpërdrejta emërvënëse, ku përmes procesit të emërdhënies, prindërit me rastin e emrit të parë për fëmijën e tyre, angazhohen në një veprim shoqëror, i cili ka çasje parësore për të shprehur identitetin e tyre, duke u bazuar në burime gjuhësore, që si pikënisje kanë kulturën mbizotëruese e cila mundëson përdorimin e emrit në mënyrë aktive, kreative ose në mënyrë të zakonshme për të ndërtuar një sërë kuptimesh të ndryshme shoqërore dhe ndërtimin e një identiteti të shprehur për fëmijën e tyre.

Në zgjedhjen e emrit për fëmijët, në përshkrimin e identitetit të tyre përmes emrit, në rolin e emrit të parë në pozicionimin social, përfshihen pikëpamjet e prindërve për veten e tyre, për shoqërinë në të cilën jetojnë dhe për llojin e vlerave që janë të rëndësishme ose të dobishme në po këtë shoqëri. Shpesh procesi i zgjedhjes së emrit përshkon marrëdhëniet e gjuhëve në kontakt si dhe lidhjen me të tjerët, e që supozohet se zgjedhja e emrit për fëmijët do të jetë e një rëndësie të veçantë në të ardhmen dhe se të njëjtit do të jenë po ashtu, të dëshiruar për fëmijët edhe në raste kur emrat do të jenë të huazaur apo të këmbyer, në kontekstin miqësor.

Duke ju referuar **David G. Myers**, në librin: *Socialpsikologjia, Eugen, Tiranë 2013, faq. 157, 158*, duke folur për ndikimet shoqërore shpjegon: Socialpsikologjia nuk studion vetëm si mendojmë për njëri – tjetrin, por edhe si ndikojmë dhe lidhemi me të tjerët. **Myers** prezanton shqetësimin qendror të socialpsikologjisë: fuqitë e ndikimit shoqëror. Për të hetuar prurje të reja në dritën sociale, gjegjësisht në fushën socioonomastike, në këtë kontekst duhet analizuar natyrën njerëzore dhe dallimet kulturore sipas **Myers-it**:

Evoluimin dhe sjelljen;

Kulturën dhe sjelljen.

Për të shpjeguar lidhjet mes gjinive njerëzore dhe të të gjitha gjinive, natyralisti **Çarls Darwin** (1859) propozoi një proces evolutiv. Meqë organizmat janë të shumë, natyra zgjedh ata më të aftë për të mbijetuar dhe u lejon të riprodhohen në mjedise të caktuara. Në këtë rast kemi të bëjmë me përzgjedhje natyrore.

Nuk do të mund të shpreheshim kështu për emrin, por gjithsesi do t'i referoheshim një evoluimi të tij nëpër kohë, sepse zgjedhja e një emri për një fëmijë është një çështje e rrallë, pra, është një proces i gjatë dhe kompleks, sepse krahas evoluimit dhe sjelljes emrat shqyrtohen fillimisht për frymëzim, pastaj krahasohen dhe në fund vlerësohen nga prindërit.

Shumë aspekte merren në konsideratë dhe (pak a shumë me vetëdije) shikohen në dritën e qëndrimeve emocionale, estetike, ideologjike dhe shoqërore të prindërve, si dhe përvojat personale dhe shpresat për fëmijën. Pra, socioonomastika në këtë kontekst analizon emërdhënien edhe sipas burimeve frymëzuese, emërtimit të kriterëve, eëmrimit të emrave dhe të shijes, duke pasur gjithnjë parasysh rëndësinë e emrit për të ardhmen e fëmijës.

Dallimi mes gjuhëve, zakoneve dhe sjelljeve shprehëse sugjeron se shumica e sjelljeve tona janë të programuara në mënyrë shoqërore, dhe jot ë hedhura në tru. Zinxhiri i gjenetikës është me të vërtetë i gjatë.

Njohja me mitologjinë e Greqisë së Lashtë dhe të vendeve të tjera na zgjeron horizontin kulturor dhe na bën të kuptojmë më mirë arritjet dhe zhvillimin e njerëzimit në rrjedhën e shekujve, që ja nisi rrugën e tij nga ajo botë primitive e fantazisë së ndezur dhe e perceptimit naiv të realitetit nëpërmjet miteve, që ruajnë dhe do të ruajnë gjithnjë freskinë.

(Fjalor i mitologjisë, Rilindja, Prishtinë, 1988, faq. 19, 20)

Sipas statistikave të bëra në terren, nga kjo sferë edhe sot e kësaj dite kemi përdorim të dukshëm të disa emrave, e sa për shpjegim po i referohem emrit Afërdita, hyjneshë e dashurisë, e pllenimit dhe e bukurisë.

Sipas Homerit, Afërdita ishte biao e Zeusit dhe e Dionës.

Sipas një legjende më të përhapur, që e gjejmë te Hesiodi, ajo doli nga shkuma e detit, prandaj edhe shpesh i ngjitet epiteti Afërdita andioomena, që do të thotë e dalë nga deti.

Te grekët ajo u bë hyjneshë qiellore e dashurisë, ishte martuar me Hefestin dhe apti disa fëmijë si Harmoninë, Erosin, Fobin, Anterotin, Dejmin, Eneun etj.

Kulti i Afërditës u soll në Greqi nga Lindja, prej Fenikasve.

Siaps Homerit, ajo përkrahu troajnët dhe ndërhyri pr të mbrojtur Paridin, Enean dhe trupin e Hektorit etj. Një nga vendet kryesore të kultit të Afërditës ishte qyteti Pafia (i vjetri) në ishullin Qipro. Që këtej e aknë origjinën edhe epitetet Aferdita Qiprida, Afërdita Pafia, hyjnesha e Pafisë etj.

Si hyjneshë e detit asaj i kishin kushtuar delfinin (gjatë hulumtimit kam hasur në numër të konsideruar të emrit Delfina në të gjitha etapat kohore) kurse si hyjneshë e pllenimit i kishin kushtuar harabelin, pëllumbin (po ashtu emër i përdorur tek ne) lepurin etj. Atribut i përhershëm ishte brezi i saj i çuditshëm në të cilin fshihej sekreti i nurit të saj. (po ashtu Nuri – e/je ar. dritë, i ndritshëm; tur. Eëmr femre muslimane, emër ky mjaft i përhapur. Gratë që martoheshin i dhuronin afërditës breza që i endnin vetë.

Priftëreshat e Afërditës, që jetonin në tempuj (p.sh.në Korint), i shërbenin hyjneshës, duke u dhënë për të holla, si një akt fetar, zakon ky i cili rridhte drejpërdrejt nga martesat në grupe.

Në Romë, ajo identifikohet me Venerën (emër po ashtu, mjaft i përhapur nga fusha e hulumtimit tonë), e cila mori karakterin, legjendat dhe atributet e Afërditës. Venera fitoi një rëndësi të madhe në kultin romak. Ajo konsiderohej si mbrojtësja e dashurisë bashkëshortore. Në shek. I para e.s. Cezari e quante Venerën si nënn e Eneut.

Nga më të dëgjaurat është statuja e Milosit (Luvër). Kulti i Afërditës erdhi prej Fenikasve. Nga këndi socioonomastik mund të shtojmë:

Pasi shqyrtuam shumë të dhëna rreth emrit Afërditë, dhe pasi nga retrospektiva shpjeguam shembuj konkretë, bazuar në të dhëna historike, të shkruara në rrjedhë motesh dhe të trajtuar nga pararendës fushash nga më të ndryshmet, mund të konstatojmë se për prindërit, me rastin e pagëzimit të fëmijës së tyre, të dhënat që i kishin dëgjuar për vet emrin, i përdorën si motiv për zgjedhjen e emrit për fëmijën e tyre.

Motivimi për këtë emër të vjetër për vajzë, në këtë rast nuk është si një emër “i modës”, dmth. nuk shfaqet në reklamat e ndryshme gjatë gjithë kohës, por është një emër “real”, historik, socialpsikologjik, nga bota e mitologjisë.

Të kësaj natyre hasëm në numër të konsideruar të emrave.

11.1. Eponimia e emrit

Nuk do të sqarohej si duhet eponomia e emrit nëse nuk do të shqyrtonim në parim të menduarit dhe të imagjnuarit emërvënës përmes një analogjie reflektive (imitimi) do të ishte mirë që të t'i referohemi veprës së Zherar Zhenet : Mimiologjia, imitimi për kuptimin tjetër, sikundër kishte vërejtur edhe Nysret Krasniqi, në fjalën e tij hyrëse në veprën : *Teori dhe kritikë, SHB Rozafa, Prishtinë, 2008, ...* Mimiologjia, vepër në të cilën hulumtohet paralelizmi historik, pra që nga poetika e Platonit dhe Aristotelit, i përshtatshëmrisë apo konvencionalitetit të emrave, Kratili dhe Hermoxheni), derivimet shkencore e filozofike të të cilave (paralelizmave) janë debate të nxehta edhe në ditët e sotme.

Duke ju referuar veprës në fjalë, sipas parashtrimit të problemit nga ana e Kratilit, Sokrati qëndronte në mes të dy kundërshtarëve, Hermoxhenit dhe Kratilit.

1. Hermoxheni, kishte pranuar tezën konvencionale (thesei) sipas së cilës emrat janë thjeshtë pjellë e një konvence, pra një marrëveshjeje (*sunthëkë kai homologia*), ndërmjet njerëzve,

2. Kratili, mbronte të ashtuquajturën tezën natyraliste (physei), sipas së cilës çdo objekt ka marrë “emërtimin korrekt” që i përket atij nëpërmjet përshtatshmërisë natyrale.

Duket se, në fillim, Sokrati e përkrah tezën e dytë kundër të parës, por më vonë e përkrah të parën kundër të dytës. (*Teori dhe kritikë moderne, zgjedhur dhe përkthyer nga Nysret Krasniqi, SHB Rozafa, Prishtinë, 2008, faq. 18,20*).

Duke trajtuar përkthimin e Foulerit: (*Kratili i Platonit*), rikujtojmë se qëndrimi fillestar i Hermoxhenit e definon korrektësinë (përshtatshmërinë) e emrit si pjellë të asgjëje më shumë se sa të një konvence dhe një marrëveshjeje. Mirëpo, kjo bëhet pa e thënë se “përshtatshmëria” (orthotës) në këtë rast mund ta shenjëzohë jo një barazim të tillë të fjalësh me sendin, por më shumë një korrespondencë artificiale që pranohet dhe njihet nga çdokush: Prandaj, ssnjë emër nuk i përket asnjë sendi të veçantë sipas natyrës së tij, por kjo ndodh vetëm sipas zakononit e marrëveshjeve (*nomoi kai ethei*) të atyre që e përdorin atë dhe që e kanë vendosur atë përdorim”. Gjithashtu, nuk thuhet se “konvenca” së cilës i referohet, mund të jetë vetëm sociale, ose, fundi i fundit, të jetë një konsensus brenda individual.

Para së gjithash i merakosur që ta bëjë të qartë këtë, sipas tezës së tij, por edhe të Kratilit, të gjithë emrta janë korrektë – “prandaj, më duket mua, pa marrë parasysh se çfarë emri ju i ngjitni një sendi, ai emër që i ngjitet është një emër i përshtatshëm”. (*modifikim*) – ose, sipas këtij kuptimi, për të, një konvencë është e mirë, e pranueshme, sa një konvencë tjetër.

Brenda onomastikës, një pikëpamje sociologjike mbi emrat e parë dhe emërtimin e fëmijëve është përdorur tradicionalisht në fushën e socioonomastikës. Aktiviteti i prindërve që e krijojnë veten dhe fëmijën e tyre si qenie shoqërore përmes zgjedhjes së emrit, duket se janë një proces potencialisht i pafund duke krijuar diçka që i ngjan një rrethi hermeneutik. Së këndejmi, në të dyja rastet e sipërthëna, zgjedhjeve të emrave të parë mund t'u jepen kuptime të ndryshme shoqërore, duke mos i përgjithësuar në praktikat e emërtimit, qoftë konvencional, qoftë natyral, por variacioni i emrit dhe ndryshimi i motiveve të emrit për emrat lidhen me variacionet e vendeve gjeografike, shoqërive, pozicioneve shoqërore brenda shoqërive, periudhave të ndryshme kohore etj. (*shih për shembull, Debus et al., 1973, Sondergaard 1976, Vandebosch 1998, Bloothoof 2006*)

Prandaj, mund të themi se emrat, deri diku, luajnë rolin e dokumentimit historik në bazë të të cilit mund të vërehen ecuritë shoqërore në periudha të caktuara. (*Mustafa Ibrahimi, Trajtesa leksiko-frazeologjie të shqipes, Interlingua, 2015, Shkup, Onomat në “Bletën shiptare” të Thimi Mitkos*).

Edhe pas emërdhënies, prindërit shprehin pikëpamjet dhe mëtimet e tyre se çfarë në të vërtetë duan të perceptojnë si dhe çfarë lloj njerëzish shpresojnë që fëmijët e tyre do të bëhen. Prandaj, aktiviteti i prindërve me rastin përcaktimit të emrit për fëmijën e tyre si qenie shoqërore, përmes zgjedhjes së emrit, duket se janë një proces potencialisht i pafund duke krijuar diçka që i ngjan një rrethi hermeneutik.

Mund të veçojmë edhe faktorë të tjerë me ndikim në kuadër të dhënies së emrit, si: faktorët e lidhur me familjen e fëmijës p.sh. statusi socio-ekonomik i familjes, niveli i shkollimit të prindërve të fëmijëve të tyre, klima familjare, leximi i librave në familje, leximi i gazetave dhe revistave në rrethin familjar, numri i fëmijëve në familje, gjendja gjinore dhe mosha e secilit prej tyre. pastaj përkatësia klasore e familjes dhe e fëmijëve të saj, shkalla e zhvillimit të përgjithshëm kulturor të mjedisit shoqëror, sistemi i zhvillimit të raporteve të përgjithshme ekonomike të mjedisit, synimet e zhvillimit dhe ritmet e

zhvillimit social dhe ekonomik të mjedisit të gjerë etj. Dhënia e emrit mund të ndikohet edhe nga ideologjitë, personalitetet, lëvizjet sociale, si dhe marrëdhëniet brenda grupeve sociale, p.sh. vendet e punës, burokracia, mediet etj.

Në faktorin kohë dhe hapësirë, socioonomastika koncepton nevojën për paraqitjen e kushteve të reja, si problem specifik terminologjik, me theks të veçantë analizën strukturore të llojeve të ndryshme të emrave risimtarë duke zëvendësuar kështu termat e vjetëruar përmes pozicionimit gjuhësor.

11.2. Ndryshimet, burimet, domethënia, rëndësia dhe zgjedhja e emrit

Zgjedhja e emrit paraqet një pasqyrë të aktiviteteve shoqërore në etapa të caktuara kohore, individuale dhe kolektive, zgjedhja pasqyron reflektim të kategorive sociale si një argument bindës dhe reflektues nga jashtë.

Procesi i emërimit për prindërit ngërthen në vete faktorë të ndryshëm përmes të cilëve përfshihen pikëpamjet e tyre për shoqërinë dhe për veten e tyre, për vlerat shoqërore, historike, kulturore, familjare etj. Me rastin e dhënies së emrit prindërit në njëfarë mënyre i riprodhojnë këto vlera si struktura të caktuara të shoqërisë ose kuptime të veçuara shoqërore të cilat përsëriten tok me emrin e dhënë. Emërtimet njëherësh ofrojnë edhe burime gjuhësore të cilat përdoren aktivisht në mënyrë të zakonshme.

Realizimi i këtij kapitulli është bërë duke u bazuar në dy studime përbërës të cilat do t'i analizojmë:

- *në mënyrë teorike (përmes analizës së bisedave) dhe*
- *statistike (përmes rezultateve të anketës së realizuar me prindër dhe interpretimit teorik).*

Për të hetuar ndryshimet e emrit, burimet e frymëzimit, domethënien, rëndësinë për të ardhmen, faktorët shtytës, arsyen, pozicionin, klasifikimin, stilin, shprehjekuptimësinë dhe një varg faktorësh të tjerë socioonomastikë, kemi bërë një hulumtim në terren në disa shkolla të komunës së Pejës, gjegjësisht në:

Shfmu “ Lidhja e Prizrenit”, Pejë;

Shfmu “Xhemail Kada”, Pejë;

Shfmu “ Naum Veçilharxhi”, Kličinë;

Shfmu “Zef Serembe”, Gllaviqicë;

Shfmu “Haxhi Zeka” Zahaq dhe

Shfmu “ Rilindja” në Trestenik.

Në hulumtim janë përfshirë emrat e 750 nxënësve, prej tyre 405 emra të datëlindjes 2002 dhe 345 emra të vitlindjes 2012.

VITI I LINDJES SË NXËNËSVE TË PËRFSHIRË NË HULUMTIM : 2002				
Nr.	Shkollat	nr. nx.	f.	m.
1	SHFMU “ XHEMAIL KADA” PEJË	135	55	80
2	SHFMU “ LIDHJA E PRIZERENIT” PEJË	120	74	46
3	SHFMU “ RILINDJA” TRESTENIK	57	31	26
4	SHFMU “ HAXHI ZEKA” ZAHAQ	39	22	17
5	SHFMU “ NAUM VEÇILHARXHI” KLIÇINË	31	19	12
6	SHFMU ” ZEF SEREMBE” GLLAVIÇICË	23	10	13
	Gjithsej	405	211	194

Tabela nr. 1. Shkollat, numri, gjinia dhe viti i lindjes së nx. të përfshirë në hulumtim

VITI I LINDJES SË NXËNËSVE TË PËRFSHIRË NË HULUMTIM : 2012				
Nr.	Shkollat	nr. nx.	f.	m.
1	SHFMU “ XHEMAIL KADA” PEJË	128	56	72
2	SHFMU “ LIDHJA E PRIZERENIT” PEJË	107	59	48
3	SHFMU “ RILINDJA” TRESTENIK	38	23	15

4	SHFMU “ HAXHI ZEKA” ZAHAQ	31	18	13
5	SHFMU “ NAUM VEÇILHARXHI” KLIÇINË	32	14	18
6	SHFMU ” ZEF SEREMBE” GLLAVIÇICË	9	3	6
	Gjithsej	345	176	169

Tabela nr. 2. Shkollat, numri, gjinia dhe viti i lindjes së nx. të përfshirë në hulumtim

Nga shqyrtimi i bërë kemi vërejtur se brenda një dhjetëvjeçari burimi onomastik ka ndryshuar tërësisht. Është me interes socioonomastik e dhëna se nga 405 emrat e nxënësve të lindur në vitin 2002 vetëm 16 të tillë përsëriten në vitin 2012.

Përsëritja e emrave 2002 – 2012			
Nr.	Shkollat	Viti 2002	Viti 2012
		Nr. nx. 405	Nr. nx. 345
1	SHFMU “ XHEMAIL KADA” PEJË	10	
2	SHFMU “ LIDHJA E PRIZERENIT” PEJË	2	
3	SHFMU “ RILINDJA” TRESTENIK	2	
4	SHFMU “ HAXHI ZEKA” ZAHAQ	1	
5	SHFMU “ NAUM VEÇILHARXHI” KLIÇINË	1	
6	SHFMU ” ZEF SEREMBE” GLLAVIÇICË	0	
	Gjithsej	16	

Tabela nr. 3. Përsëritja e emrave të njëjtë 2002 - 2012

11.3. REZULTATET E TË GJETURAVE

Pjesa e parë

Përpos konstatimit demografik, rënies së numrit të fëmijëve, pjesa më e madhe e emrave nuk përkojnë me matrikulen kombëtare shqiptare. Janë të paktë emrat fetarë dhe emrat e vjetër të të gjitha sferave si: Arbër, Ali, Ramë, Xhafer, Muharrem, Kimete, Ibrahim, Islam, Zog Yll etj.,

Kemi një rilindje emrash emocionalë, të realitetit, risimtarë me shije si: Ajas, Aksa, Albi, Anëza, Anea, Anuar, Alea, Art, Arsa, Ari, Auron, Edis, Eralp, Lea, Lorena, Leova, Morea, Modest, Rea, Rumjesa, Rubina, Sibora, Sufjan, Sumea, Tiara, Valina etj.

Po ashtu, për këtë qëllim socioonomastik është zhvilluar një anketë në të cilën janë përfshirë 60 prindër, fëmijët e të cilëve kanë lindur në vitin 2012.

